

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 9 *Instrumentet Financiare*

Kapitulli 1 Objektivi

- 1.1 Objektivi i këtij Standardi është të caktojë parimet për raportimin financiar të *aktiveve financiare* dhe *detyrimeve financiare*, që do të paraqesë një informacion të rëndësishëm dhe të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare, në vlerësimin e tyre të shumave, afatit dhe pasigurisë së flukseve monetare të ardhshme të një njësie ekonomike.

Kapitulli 2 Objekti

- 2.1 Kjo SNRF do të aplikohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentet financiare, përveç:
- (a) ato interesa në filiale, pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkëta që janë kontabilizuar në përputhje me SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*, SNK 27 *Pasqyra financiare individuale ose SNK 28 Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta*. Megjithatë, në disa raste, SNRF 10, SNK 27 ose SNK 28 kërkojnë ose lejojnë një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët përputhje me kërkesat e këtij Standardi. Njësitë ekonomike do të zbatojnë gjithashtu këtë standard për të gjithë derivativët mbi një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët përveç rastit kur këta derivativë plotësojnë përkufizimin e një instrumenti të kapitalit neto sipas SNK 32. *Instrumentet financiare: Paraqitja*.
 - (b) të drejtat dhe detyrimet për qiratë për të cilat zbatohet SNK 16 *Qiratë*. Megjithatë:
 - (i) të arkëtueshme nga qiraja financiare (d.m.th investimet neto në qira financiare) dhe të arkëtueshmet nga qiraja e zakonshme të njohura nga një qiradhënës janë subjekt i kërkesave për mosnjohje (çregjistrim) dhe rënie në vlerë të këtij Standardi;
 - (ii) detyrimet e qirasë të njohura nga një qiramarrës janë subjekt i kërkesave për mosnjohje (çregjistrim) në paragrafin 3.3.1 të këtij Standardi; dhe
 - (iii) derivativët që janë të përfshirë në qiratë janë subjekt i kërkesave të derivativëve të përfshirë të këtij Standardi.
 - (c) të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve sipas skemave të përfitimit të punonjësve, për të cilat zbatohet SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve*.
 - (d) instrumenteve financiare të emetuara nga njësi ekonomike që plotësojnë përkufizimin e instrumenteve të kapitalit në SNK 32 (përfshirë opsionet dhe garancitë) ose që kërkohet të klasifikohen si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose me paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32. Megjithatë, mbajtësit e këtyre instrumenteve të kapitalit do të zbatojnë këtë Standard për këto instrumente, përveç rastit kur plotësojnë përjashtimin në pikën (a).
 - (e) të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga një kontratë sigurimi siç theksohet në SNRF 17 *Kontratat e Sigurimeve*, përveç të drejtave dhe detyrimeve të lëshuesit që rrjedhin nga një kontratë sigurimi që plotëson përcaktimin si një kontratë garancie financiare. Megjithatë, ky Standard zbatohet (i) për një derivativ që është i përfshirë në një kontratë brenda objektit të SNRF 17 në qoftë se derivativi nuk është në vetvete një kontratë brenda objektit të SNRF 17. dhe (ii) përbërësi investime që veçohet nga kontrata brenda objektit të SNRF 17, nëse ky veçim kërkohet nga SNRF 17. Sidoqoftë, nëse lëshuesi i kontratave të garancisë financiare ka pohuar më parë në mënyrë të qartë se i sheh këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur kontabilitetin e zbatueshëm për kontratat e sigurimit, lëshuesi mund të zgjedhë të zbatojë ose këtë Standard ose SNRF 17 për kontrata të tilla të garancisë financiare (shih paragrafin B2.5-B2.6). Lëshuesi mund të bëjë zgjedhjen kontratë për kontratë, por zgjedhja për secilën kontratë është e pakthyeshme.

- (f) çdo kontratë "forward" midis një blerësi dhe një aksionmbajtësi shitës për të blerë ose shitur një të blerë që do të rezultojë në një kombinim biznesi brenda objektivit të SNRF 3 *Kombinime Biznesi* në datë blerje të mëvonshme. Termi kontratë forward nuk duhet të tejkalojë një periudhë të arsyeshme që normalisht do ishte e domosdoshme për të marrë çdo aprovim të kërkuar dhe të kompletohet transaksioni.
- (g) angazhimeve për hua përveç atyre angazhimeve për hua të cilësuar në paragrafin 2,3. Megjithatë, një lëshues i angazhimeve për hua do të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit të këtij Standardi për angazhimet për hua që nuk janë brenda qëllimit të këtij Standardi. Gjithashtu, të gjitha angazhimet për hua janë subjekt i kërkesave të mosnjohjes të këtij Standardi.
- (h) instrumenteve financiare, kontratat dhe detyrimet e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione për të cilat zbatohet SNRF 2 *Pagesa të bazuara në aksione*, me përjashtim të kontratave që janë brenda objektivit të paragrafit 2.4-2.7 të këtij Standardi, për të cilin zbatohet ky Standard.
- (i) të drejtave mbi pagesat për të rimbursuar njësinë ekonomike për shpenzimin që i kërkohet të bëjë për të shlyer një detyrim që është njohur si një provizion në përputhje me SNK 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara*, ose për të cilin, në një periudhë më të hershme, ka njohur një provizion në përputhje me SKN 37.
- (j) të drejtave dhe detyrimeve brenda objektivit të SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët* që janë instrumente financiare, përveç atyre që specifikon SNRF 15 kontabilizohen në përputhje me këtë Standard.

2.2 Kërkesat për zhvlerësim të këtij Standardi do të zbatohen për ato të drejta që specifikon SNRF 15 kontabilizohen në përputhje me këtë Standard për qëllim të njohjes së fitimeve ose humbjeve të cvlerësimit.

- 2.3 Angazhimet për hua të mëposhtme janë brenda objektit të këtij Standardi:**
- (a) angazhimet për hua që njësia ekonomike i përcakton si detyrime financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (shih paragrafin 4.2.2). Një njësi ekonomike që ka një praktikë të mëparshme të shitjes së aktiveve që rrjedhin nga angazhimet e saj për hua pak kohë pas fillimit do të zbatohë këtë Standard për të gjitha angazhimet për hua në të njëjtën klasë.
 - (b) angazhimet për hua që mund të shlyhen neto në mjete monetare ose duke livruar apo duke emetuar një tjetër instrument financiar. Këto angazhime për hua quhen derivativë. Një angazhim për hua nuk konsiderohet si hua që shlyhet neto vetëm sepse huaja paguhet në këste (p.sh. një hua hipotekare për ndërtesë që paguhet në këste sipas shkallës së përfundimit të ndërtesës).
 - (c) angazhimet për të ofruar një hua me normë interesi më të ulët se ajo e tregut (shih paragrafin 4.2.1 (d)).
- 2.4 Ky Standard do të zbatohet për ato kontrata për të blerë ose për të shitur një element jo financiar që mund të shlyhet neto me mjete monetare ose instrument financiar tjetër, ose duke këmbyer instrumentet financiarë, sikur kontratat të ishin instrumenta financiarë, me përjashtim të kontratave të përfunduara dhe që vazhdojnë të mbahen për qëllimin e marrjes ose dhënies së një elementi jo financiar në përputhje me kërkesat e blerjes, shitjes ose përdorimit të pritshme të njësisë ekonomike. Megjithatë, ky Standard do të zbatohet për ato kontrata që një njësi ekonomike i përcakton si të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 2.5.**
- 2.5 Një kontratë për të blerë ose për të shitur një element jo financiar që mund të shlyhet neto me mjete monetare ose instrument financiar tjetër, ose duke këmbyer instrumentet financiarë, sikur kontratat të ishin instrumente financiarë, mund të jenë të përcaktuara në mënyrë të pakthyeshme si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes edhe nëse është kryer me qëllim marrjen ose dhënien e një zëri jo financiar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë ekonomike për blerjen, shitjen ose përdorimin. Ky përcaktim është i përshtatshëm vetëm në fillim të kontratës dhe vetëm nëse ai eliminon ose zvogëlon në mënyrë të ndjeshme një mospërputhje njohjeje (që ndonjëherë i referohemi si një 'mospërputhje kontabël'), që përndryshe do të rridhte nga mosnjohja e kësaj kontrate sepse ajo është e përjashtuar nga objekti i këtij Standardi (shih paragrafin 2,4).**
- 2.6 Ka disa mënyra sipas të cilave mund të shlyhet neto një kontratë për të blerë ose për të shitur një element jo financiar me mjete monetare ose instrument financiar tjetër ose duke këmbyer instrumentet financiarë. Këto përfshijnë:**
- (a) kur kushtet e kontratës lejojnë secilën palë ta shlyejnë atë neto me mjete monetare ose instrument financiar tjetër ose duke këmbyer instrumentet financiarë;
 - (b) kur aftësia për të shlyer neto me mjete monetare ose instrument financiar tjetër, ose duke këmbyer instrumentet financiarë, nuk është shprehur në mënyrë eksplicite në kushtet e kontratës, por njësia ekonomike e ka në praktikën e vet që të shlyejë kontratat e ngjashme neto me mjete monetare ose instrument financiar tjetër, ose duke këmbyer instrumentet financiarë (qoftë me kundërparti, duke përfunduar kontrata kompensimi ose qoftë duke shitur kontratën përpara ushtrimit ose parashkrimit të saj);
 - (c) kur, për kontrata të ngjashme, njësia ekonomike ka një praktikë të vetën për marrjen e aktivitetit kryesor dhe shitjen e tij brenda një periudhe të shkurtër mbas marrjes për qëllimin e gjenerimit të një fitimi nga luhatjet afatshkurtra në çmim ose marzhin e ndërmjetësit; dhe
 - (d) kur elementi jo financiar që është subjekt i kontratës është menjëherë i konvertueshëm në mjete monetare.
- Kur një kontratë për të cilën zbatohet (b) ose (c) nuk përfundohet për qëllimin e marrjes ose dhënies së elementit jo financiar në përputhje me kërkesat e blerjes, shitjes ose përdorimit të pritshme të njësisë ekonomike dhe, si pasojë, ajo është brenda objektit të këtij Standardi. Kontratat e tjera për të cilat zbatohet paragrafi 2,4 vlerësohen për të përcaktuar nëse ato janë përfunduar dhe vazhdojnë të mbahen për qëllimin e marrjes ose dhënies së elementit jo financiar në përputhje me kërkesat e blerjes, shitjes ose përdorimit të pritshme të njësisë ekonomike dhe për këtë arsye, nëse ato janë apo jo brenda objektit të këtij Standardi.
- 2.7 Një opsion i shkruar për të blerë ose për të shitur një element jo financiar që mund të shlyhet neto me mjete monetare ose me një instrument financiar tjetër, ose duke këmbyer instrumentet financiarë, në përputhje me paragrafin 2,6(a) ose 2.6(d) është brenda objektit të këtij Standardi. Një kontratë e tillë nuk mund të nënshkruhet për qëllimin e marrjes ose dhënies së elementit jo financiar në përputhje me kërkesat e blerjes, shitjes ose përdorimit të pritshme të njësisë ekonomike.**

Kapitulli 3 Njohja dhe çregjistrimi

3.1 Njohja fillestare

- 3.1.1 Një njësi ekonomike do të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, atëherë, dhe vetëm atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit (shih paragrafët B3.1.1 dhe B3.1.2). Kur një njësi ekonomike njihet për herë të parë një aktiv financiar, ajo do ta klasifikojë atë në përputhje me paragrafët 4.1.1-4.1.5 dhe do ta masë atë në përputhje me paragrafët 5.1.1-5.1.3. Kur njësia ekonomike njihet për herë të parë një detyrim financiar, ajo do ta klasifikojë atë në përputhje me paragrafët 4.2.1 dhe 4.2.2 dhe do ta masë atë në përputhje me paragrafin 5.1.1.

Blerje ose shitje e aktiveve financiare sipas mënyrës së rregullt

- 3.1.2 Një blerje ose shitje në mënyrë të rregullt e aktiveve financiare do të njihet dhe çregjistrohet, sipas rastit, duke bërë kontabilizimin në datën e tregtimit ose në datën e shlyerjes (shih paragrafët B3.1.3-B3.1.6).

3.2 Çregjistrimi i aktiveve financiare

- 3.2.1 Në pasqyrat financiare të konsoliduara, paragrafët 3.2.2-3.2.9, B3.1.1, B3.1.2 dhe B3.2.1-B3.2.17 zbatohen në nivel konsolidimi. Kështu, një njësi ekonomike së pari konsolidon të gjitha filialet në përputhje me SNRF 10 dhe pastaj zbaton paragrafët e mësipërm në grupin që rezulton nga konsolidimi.

- 3.2.2 Para se të vlerësojë nëse, dhe deri në çfarë mase *çregjistrimi* duhet të bëhet sipas paragrafëve 3.2.3-3.2.9, një njësi ekonomike përcakton nëse këta paragrafë duhet të zbatohen për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të një grupi aktivesh financiare të ngjashme) ose për një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme) në tërësinë e tij, si më poshtë.

- (a) Paragrafët 3.2.3-3.2.9 zbatohen për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të një grupi aktivesh financiare të ngjashme) nëse, dhe vetëm nëse, pjesa që konsiderohet për çregjistrim plotëson një nga këto tri kushtet.
- (i) Pjesa përbëhet vetëm nga flukse mjeteve monetare të identifikuar në mënyrë specifike prej një aktivi financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme). Për shembull, kur një njësi ekonomike hyn në një marrëveshje për një interval të normës së interesit me anën e të cilës pala tjetër fiton të drejtën për flukset monetare të interesit, por jo për flukset monetare të principalit nga një instrument borxhi, zbatohen paragrafët 3.2.3-3.2.9 për këto flukse monetare nga interesi.
 - (ii) Pjesa përbën vetëm një pjesë plotësisht proporcionale (pro rata) të flukseve monetare nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme). Për shembull, kur një njësi ekonomike hyn në një marrëveshje ku pala tjetër përfiton të drejtën e 90 përqind të të gjitha flukseve monetare të një instrumenti borxhi, zbatohen paragrafët 3.2.3-3.2.9 për 90 përqind të këtyre flukseve monetare. Nëse ka më shumë se një palë, secila prej tyre nuk është e nevojshme që të ketë një pjesë proporcionale mjeteve monetare, me kusht që njësia ekonomike transferuese ka një pjesë plotësisht proporcionale.
 - (iii) Pjesa përbën vetëm një pjesë plotësisht proporcionale (pro rata) të flukseve monetare të identifikuar në mënyrë specifike nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme). Për shembull, kur një njësi ekonomike hyn në një marrëveshje ku pala tjetër përfiton të drejtën e një pjese 90 përqind të flukseve monetare të interesit nga një aktiv financiar, zbatohen paragrafët 3.2.3-3.2.9 për 90 përqind të këtyre flukseve monetare. Nëse ka më shumë se një palë, secila prej tyre nuk është e nevojshme që të ketë një pjesë proporcionale të mjeteve monetare të identifikuar në mënyrë specifike, me kusht që njësia ekonomike transferuese ka një pjesë plotësisht proporcionale.

- (b) Në të gjitha rastet e tjera, paragrafët 3.2.3-3.2.9 zbatohen për aktivin financiar në tërësinë e tij (ose për grupin e aktiveve financiare të ngjashme në tërësinë e tyre). Për shembull, kur një njësi ekonomike transferon (i) të drejtat për 90 përqindëshin e parë ose të fundit të arkëtimit në mjete monetare nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare), ose (ii) të drejtat për 90 përqind të flukseve monetare nga një grup llogarish të arkëtueshme, por ofron një garanci për të kompensuar blerësit për çdo humbje kredie deri në 8 përqind të shumës së principalit të llogarive të arkëtueshme, zbatohen paragrafët 3.2.3-3.2.9 për aktivin financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme) në tërësinë e tij.

Në paragrafët 3.2.3-3.2.12, termi “aktiv financiar” i referohet si një pjese të një aktivi financiar (ose një pjese të një grupi aktivesh financiare të ngjashme) të identifikuar si në pikën (a) më sipër, ashtu edhe , një aktivi financiar (ose një grupi aktivesh financiare të ngjashme) në tërësinë e tij.

- 3.2.3 Një njësi ekonomike do të çregjistrojë një aktiv financiar, kur, dhe vetëm kur:
- përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar, ose
 - transferon aktivin financiar siç është parashtruar në paragrafët 3.2.4 dhe 3.2.5 dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim në përputhje me paragrafin 3.2.6.
- (Shih paragrafin 3.1.2 për shitje në mënyrë të rregullt të aktiveve financiare.)
- 3.2.4 Një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar nëse, dhe vetëm nëse, ose:
- transferon të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të aktivit financiar, ose
 - ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të aktivit financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual t’u paguajë flukset monetare një ose më shumë marrësve në një marrëveshje që plotëson kushtet në paragrafin 3.2.5.
- 3.2.5 Kur një njësi ekonomike ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ('aktivi fillestar'), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t’ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësi ekonomike ('përfituesve eventualë'), njësi ekonomike e trajton transaksionin si një transferim të një aktivi financiar, nëse, dhe vetëm nëse, plotësohen njëkohësisht tre kushtet e mëposhtme.
- Njësia ekonomike nuk ka detyrimin t’ua paguajë shumat përfituesve eventualë, nëse nuk mbledh shumat ekuivalente nga aktivi fillestar. Paradhëniet afatshkurtra nga njësi ekonomike, me të drejtën e mbulimit të plotë të shumës së dhënë hua plus interesin e konstatuar sipas normave të tregut nuk e shkelin këtë kusht.
 - Njësia ekonomike nuk lejohet, nga kushtet e kontratës së transferimit, ta shesë ose vërë si kolateral aktivin fillestar, përveç se kur e përdor si garanci për përfituesit eventualë për detyrimin që t’u paguajë flukse monetare.
 - Njësia ekonomike ka detyrimin të dërgojë çfarëdo fluksi monetar që mbledh në emër të përfituesve të rastit pa vonesë të ndjeshme. Përveç kësaj, njësi ekonomike nuk ka të drejtë të ri investojë flukse të tilla monetare, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalentë të saj (siç përcaktohet në SNK 7 *Pasqyra e Fluxeve Monetare*) gjatë periudhës afatshkurtër të shlyerjes nga data e arkëtimit në datën e dërgimit të kërkuar prej përfituesve të rastit, dhe interesi i fituar në investime të tilla u kalohet këtyre përfituesve.
- 3.2.6 Kur një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar (shih paragrafin 3.2.4), ajo do të vlerësojë masën në të cilën ruan rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Në këtë rast:
- nëse njësi ekonomike transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ajo do ta çregjistrojë aktivin financiar dhe do të njohë veç e veç si aktive ose detyrime çdo të drejtë dhe detyrim të krijuar ose të mbajtur gjatë transferimit.
 - nëse njësi ekonomike mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, ajo do të vazhdojë ta njohë aktivin financiar.
 - nëse njësi ekonomike as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, ajo do të përcaktojë nëse ka ruajtur kontrollin e aktivit financiar. Në këtë rast:
 - në qoftë se njësi ekonomike nuk ka ruajtur kontrollin, ajo do ta çregjistrojë aktivin financiar dhe do të njohë veç e veç si aktiv ose detyrim çdo të drejtë dhe detyrim të krijuar ose mbajtur gjatë transferimit.
 - nëse njësi ekonomike e ka ruajtur kontrollin, ajo do të vazhdojë ta njohë aktivin financiar në masën e përfshirjes së vazhdueshme në të (shih paragrafin 3.2.16).

- 3.2.7 Transferimi i rreziqeve dhe i përfitimeve (shih paragrafin 3.2.6), vlerësohet duke krahasuar ekspozimin e njësisë ekonomike, para dhe pas transferimit, me ndryshueshmërinë në shumat dhe afatin e flukseve monetare neto të aktivitetit të transferuar. Një njësi ekonomike ka mbajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi financiar në qoftë se ekspozimi ndaj ndryshueshmërisë në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme neto nga aktivi financiar nuk ka ndryshuar dukshëm, si rezultat i transferimit (p.sh. për shkak se njësi ekonomike ka shitur një aktiv financiar që është subjekt i një marrëveshjeje për ta riblerë atë me një çmim të fiksuar ose me çmimin e shitjes plus kthimin e një huadhënësi). Një njësi ekonomike ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi financiar në qoftë se ekspozimi ndaj kësaj ndryshueshmërie nuk është më e rëndësishme në lidhje me ndryshueshmërinë e përgjithshme në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme neto të lidhura me aktivin financiar (për shembull për shkak se njësi ekonomike ka shitur një aktiv financiar që është subjekt vetëm i një opsioni për ta riblerë atë me *vlerën* e tij të *drejtë* në kohën e riblerjes apo ka transferuar një pjesë plotësisht proporcionale të flukseve monetare nga një aktiv financiar më i madh në një marrëveshje, siç është një nën-pjesëmarrje në hua, që plotëson kushtet e paragrafit 3.2.5).
- 3.2.8 Shpesh është e dukshme nëse njësi ekonomike ka transferuar ose ka mbajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk është nevoja të bëhet ndonjë llogaritje. Në raste të tjera, është e nevojshme të llogaritet dhe të krahasohet ekspozimi i njësisë ekonomike ndaj ndryshueshmërisë në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme neto para dhe pas transferimit. Llogaritja dhe krahasimi bëhen duke përdorur si normë skontimi një normë interesi aktuale të përshtatshme tregu. Të gjitha ndryshueshmëritë e mundshme të arsyeshme në flukset monetare neto merren parasysh, duke iu dhënë më tepër peshë atyre rezultateve që kanë më shumë gjasa të ndodhin.
- 3.2.9 Nëse njësi ekonomike e ka ruajtur kontrollin (shih paragrafin 3.2.6 (c)) e aktivitetit të transferuar, shitja e aktivitetit varet nga aftësia e atij që e ka marrë. Njësi ekonomike nuk ruan kontrollin, nëse marrësi ka aftësinë praktike t'ia shesë aktivin në tërësinë e tij një pale të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa qenë nevoja të vërë kufizime të tjera për transferimin. Në të gjitha rastet e tjera, njësi ekonomike ruan kontrollin.

Transferimet që kualifikohen për çregjistrim

- 3.2.10 Nëse një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar në një transferim që kualifikohet për çregjistrim në tërësinë e tij dhe e mban të drejtën për shërbimin ndaj aktivitetit financiar kundrejt një tarife, ajo do të njohë ose një aktiv shërbimi, ose një detyrim shërbimi për këtë kontratë shërbimi. Në qoftë se tarifa që do të merret nuk pritet ta kompensojë njësinë ekonomike në mënyrën të mjaftueshme për kryerjen e shërbimit, do të njihet një detyrim shërbimi me vlerën e drejtë për detyrimin e shërbimit. Në qoftë se tarifa që do të merret pritet të jetë më shumë se një kompensim i mjaftueshëm për shërbimin, do të njihet një aktiv shërbimi për të drejtën e shërbimit me shumën e përcaktuar në bazë të një shpërndarje të vlerës kontabël neto të aktivitetit financiar më të madh në përputhje me paragrafin 3.2.13.
- 3.2.11 Nëse, si rezultat i një transferimi, një aktiv financiar çregjistrohet në tërësinë e tij, por transferimi bën që njësi ekonomike të marrë një aktiv financiar të ri, ose të marrë përsipër një detyrim financiar të ri, ose një detyrim shërbimi, njësi ekonomike do të njohë një aktiv financiar të ri, detyrim financiar të ri ose detyrim shërbimi të ri me vlerën e drejtë.
- 3.2.12 Në çregjistrimin e një aktivi financiar në tërësinë e tij, diferenca midis:
- (a) vlerës kontabël neto (e matur në datën e çregjistrimit) dhe
 - (b) shumës së marrë (duke përfshirë çdo aktiv të ri të përftuar pakësuar me çdo detyrim të ri të pranuar)
- do të njihet në fitim ose humbje.
- 3.2.13 Në qoftë se aktivi i transferuar është pjesë e një aktivi financiar më të madh (p.sh. kur një njësi ekonomike transferon flukset monetare të interesit që janë pjesë e një instrumenti borxhi, shih paragrafin 3.2.2 (a)) dhe pjesa e transferuar kualifikohet për çregjistrim në tërësinë e saj, vlera kontabël neto e mëparshme e aktivitetit financiar më të madh do të ndahet midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që çregjistrohet, mbi bazën e vlerave të drejta përkatëse të këtyre pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, një aktiv shërbimi i mbajtur do të trajtohet si një pjesë që vazhdon të jetë e njohur. Diferenca midis:
- (a) vlerës kontabël neto (e matur në datën e çregjistrimit) të shpërndarë në pjesën e çregjistruar dhe
 - (b) shumës së marrë për pjesën e çregjistruar (përfshirë çdo aktiv të ri të përftuar pakësuar me çdo detyrim të ri të pranuar)

do të njihet në fitim ose humbje.

- 3.2.14 Kur një njësi ekonomike shpërndan shumën e mëparshme kontabël të një aktivi financiar më të madh midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që çregjistrohet, është e nevojshme të matet vlera e drejtë e pjesës që vazhdon të njihet. Kur njësi ekonomike ka një histori të shitjes së pjesëve të ngjashme me pjesën që vazhdon të njihet apo ekzistojnë transaksione tregu të tjera për pjesë të tilla, çmimet e fundit të transaksioneve aktuale japin vlerësimin më të mirë të vlerës së drejtë të saj. Kur nuk ka kuota çmimesh apo transaksione tregu të kohëve të fundit për të mbështetur vlerën e drejtë të pjesës që vazhdon të njihet, vlerësimi më i mirë i vlerës së drejtë është diferenca midis vlerës së drejtë të aktivitetit financiar më të madh në tërësi dhe shumës së arkëtuar nga marrësi për pjesën që nuk njihet.

Transferimet që nuk kualifikohen për çregjistrim

- 3.2.15 Njësia ekonomike do të vazhdojë të njohë aktivin e transferuar në tërësinë e tij dhe do të njohë një detyrim financiar për shumën e arkëtuar, nëse një transferim nuk çon në çregjistrim, sepse njësia ekonomike ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit të transferuar. Në periudhat e mëvonshme, njësia ekonomike do të njohë çdo të ardhur nga aktivi i transferuar dhe çdo shpenzim të kryer për detyrimin financiar.

Përfshirja e vazhdueshme në aktivet e transferuara

- 3.2.16 Nëse një njësi ekonomike as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktivi të transferuar, dhe ruan kontrollin e aktivitetit të transferuar, ajo vazhdon të njohë aktivin e transferuar në masën e përfshirjes së vazhdueshme. Masa e përfshirjes së vazhdueshme në aktivin e transferuar është shkalla në të cilën njësia ekonomike është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar. Për shembull:

- (a) Kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë ekonomike merr formën e garantimit të aktivitetit të transferuar, masa e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike është më e ulëta e (i) shumës së aktivitetit dhe (ii) shumës maksimale të shumës së arkëtuar që njësia ekonomike mund të jetë e detyruar të paguajë ('shuma e garancisë').
- (b) Kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë ekonomike merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) të aktivitetit të transferuar, masa e përfshirjes së vazhdueshme e njësisë ekonomike është shuma e aktivitetit të transferuar që njësia ekonomike mund ta riblerë. Megjithatë, në rastin e një opsioni të shkruar për një aktiv që matet me vlerën e drejtë, masa e përfshirjes së vazhdueshme e njësisë ekonomike është e kufizuar në më të ultën e vlerës së drejtë të aktivitetit të transferuar dhe çmimit të ushtrimit të opsionit (shih paragrafin B3.2.13).
- (c) Kur përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shlyer në mjete monetare ose të një kushti të ngjashëm mbi aktivin e transferuar, masa e përfshirjes së vazhdueshme e njësisë ekonomike matet në të njëjtën mënyrë si ajo që rezulton nga opsioni i shlyer në mjete jo monetare sikurse është parashtruar në pikën (b) më sipër.

- 3.2.17 Kur një njësi ekonomike vazhdon të njohë një aktiv në masën e përfshirjes së vazhdueshme, ajo njeh gjithashtu një detyrim të lidhur. Pavarësisht nga kërkesat e tjera për matjen në këtë Standard, aktivi i transferuar dhe detyrimi i lidhur maten mbi një bazë që pasqyron të drejtat dhe detyrimet që njësia ekonomike ka ruajtur. Detyrimi i lidhur matet në mënyrë të tillë që vlera kontabël neto e aktivitetit të transferuar dhe e tij është:

- (a) kostoja e amortizuar e të drejtave dhe detyrimeve që ka njësia ekonomike, nëse aktivi i transferuar matet me koston e amortizuar, ose
- (b) e barabartë me vlerën e drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që ka mbajtur njësia ekonomike duke i matur mbi një bazë të veçuar, në qoftë se aktivi i transferuar matet me vlerën e drejtë.

- 3.2.18 Njësia ekonomike do të vazhdojë të njohë çdo të ardhur të realizuar nga aktivi i transferuar në masën e përfshirjes së vazhdueshme dhe do të njohë çdo shpenzim të kryer për detyrimin e lidhur.

- 3.2.19 Për qëllimin e matjes së mëpasshme, ndryshimet e njohura në vlerën e drejtë të aktivitetit të transferuar dhe detyrimit të lidhur trajtohen vazhdimisht me njëri-tjetrin në përputhje me paragrafin 5.7.1, dhe nuk do të kompensohen.

- 3.2.20 Në qoftë se përfshirja e vazhdueshme e një njësie ekonomike është vetëm në një pjesë të një aktivi financiar (p.sh. kur një njësi ekonomike ka një opsion për të riblerë pjesë të një aktivi të transferuar,

apo ka një interes të mbetur që nuk çon në mbajtjen thelbësore të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë dhe ajo ruan kontrollin), njësia ekonomike shpërndan vlerën kontabël neto të mëparshme të aktivitetit financiar midis pjesës që vazhdon ta njohë sipas përfshirjes së vazhdueshme, dhe pjesës që nuk e njeh më, mbi bazën e vlerave të drejta përkatëse të këtyre pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, zbatohen kërkesat e paragrafit 3.2.14. Diferenca midis:

- (a) vlerës kontabël neto (e matur në datën e çregjistrimit) që i është caktuar pjesës që nuk njihet më dhe
- (b) shumës së arkëtuar për këtë pjesë

do të njihet në fitim ose humbje.

- 3.2.21 Në qoftë se aktivi i transferuar matet me koston e amortizuar, opsioni në këtë Standard për të përcaktuar një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nuk është i zbatueshëm për detyrimin e lidhur.

Të gjitha transferimet

- 3.2.22 Nëse një aktiv i transferuar vazhdon të njihet, aktivi dhe detyrimi i lidhur nuk do të kompensohen. Në mënyrë të ngjashme, njësia ekonomike nuk do të kompensojë çdo të ardhur të realizuar nga aktivi i transferuar me çdo shpenzim të kryer për detyrimin e lidhur (shih paragrafin 42 të SNK 32).

- 3.2.23 Nëse një transferues vendos kolateral jo monetar (të tillë si instrumente borxhi ose kapitali) për të transferuarin, kontabiliteti për kolateralin nga transferuesi dhe i transferuari varet nëse i transferuari ka të drejtën për ta shitur ose rivendosur kolateralin dhe nëse transferuesi nuk i ka plotësuar detyrimet. Transferuesi dhe i transferuari do ta trajtojnë kolateralin si më poshtë:

- (a) Nëse i transferuari ka të drejtën sipas kontratës ose zakonisht të shesë ose të rivendosë kolateralin, transferuesi do të ri klasifikojë atë aktiv në pasqyrën e tij të pozicionit financiar (psh si një aktiv i dhënë hua, instrumente kapitali të vendosura ose të arkëtueshme të riblerjes) veçmas nga aktivet e tjera.
- (b) Nëse i transferuari shet kolateralin e vendosur për të, ai do të njohë të ardhura nga shitja dhe një detyrim të matur me vlerën e drejtë për detyrimin e tij për ta kthyer kolateralin.
- (c) Nëse transferuesi nuk u përmbahet kushteve të kontratës dhe nuk ka më të drejtën ta mbajë kolateralin, ai do ta çregjistrojë atë, ndërsa i transferuari do ta njohë kolateralin si aktivin e tij të matur fillimisht me vlerën e drejtë ose, në qoftë se ai tashmë e ka shitur, çregjistron detyrimin e tij për kthimin e kolateralit.
- (d) Përveç rasteve të parashikuara në pikën (c), transferuesi do të vazhdojë ta mbajë kolateralin si aktivin e tij, dhe i transferuari nuk do ta njohë atë si një aktiv.

3.3 Çregjistrimi i detyrimeve financiare

- 3.3.1 Një njësi ekonomike do të heqë një detyrim financiar (ose një pjesë të një detyrimi financiar) nga pasqyra e tij e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë kur ai është likuiduar-d.m.th kur detyrimi i përcaktuar në kontratë është paguar, apo anuluar, apo ka skaduar.
- 3.3.2 Një shkëmbim në mes të një huamarrësi ekzistues dhe huadhënësi të instrumenteve të borxhit, me kushte në thelb të ndryshme, do të trajtohen si një shlyerje e detyrimit financiar fillestar dhe të njihet një detyrim financiar i ri. Në mënyrë të ngjashme, një modifikim thelbësor i kushteve të një detyrimi financiar ekzistues ose i një pjese të tij (qoftë i lidhur ose jo drejtpërdrejt me vështirësinë financiare të debitorit) do të kontabilizohet si një shlyerje e detyrimit financiar origjinal dhe do të njihet një detyrim financiar ri.
- 3.3.3 Diferenca midis vlerës kontabël neto të një detyrimi financiar (ose pjese të një detyrimi financiar) të likuiduar ose të transferuar në një palë tjetër dhe shumës së paguar, duke përfshirë të gjitha aktivet jo monetare të transferuara ose detyrimet e marra përsipër, do të njihet në fitim ose humbje.
- 3.3.4 Nëse një njësi ekonomike riblen një pjesë të një detyrimi financiar, ajo do ta shpërndajë vlerën kontabël neto të mëparshme të detyrimit financiar midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që është çregjistruar në bazë të vlerave të drejta përkatëse të këtyre pjesëve në datën e riblerjes. Diferenca midis (a) vlerës kontabël neto të caktuar për pjesën që njihet dhe (b) shumës së paguar, duke përfshirë të gjitha aktivet jo monetare të transferuara ose detyrimet e marra përsipër, për pjesën që njihet, do të njihet në fitim ose humbje.

- 3.3.5 Disa njësi ekonomike menaxhojnë, nga brenda ose nga jashtë, fonde investimesh të cilat u ofrojnë investitorëve përfitime të përcaktuara nga njësitë në fond dhe njohin detyrime financiare për shumat e paguara ndaj atyre investitorëve. Në mënyrë të ngjashme, disa njësi ekonomike emetojnë grupe të kontratave të sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë dhe këto njësi ekonomike mbajnë zërat bazë. Disa nga këto fonde ose zëra bazë përfshijnë detyrim financiar të njësisë ekonomike (për shembull një obligacion të emetuar të shoqërisë). Pavarësisht kërkesave të tjera të këtij Standardi për mosnjohjen (çregjistrimin) e detyrimeve financiare, njësia ekonomike mund të zgjedhë të mos çregjistrojë detyrimin e saj financiar të përfshirë në një fond të tillë ose që është një zë bazë, vetëm dhe vetëm kur njësia ekonomike riblen detyrimin financiar të saj për qëllime të tilla. Në vend të kësaj, njësia ekonomike mund të zgjedhë të vijojë trajtimin kontabël të atij instrumenti si detyrim financiar dhe të trajtojë instrumentin e riblerë sikur instrumenti të ishte një aktiv financiar dhe ta masë me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në përputhje me këtë Standard. Kjo zgjedhje është e pakthyeshme dhe bëhet instrument pas instrumenti. Për shkak të kësaj zgjedhjeje, kontratat e sigurimit përfshijnë kontrata investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë. (Shih SNRF 17 për termat e përdorur në këtë paragraf dhe të përkufizuar në atë Standard.)

Kapitulli 4 Klasifikimi

4.1 Klasifikimi i aktiveve financiare

- 4.1.1 Përveç rasteve kur zbatohet paragrafi 4.1.5, një njësi ekonomike do të klasifikojë aktivet financiare si të matura më pas me koston e amortizuar, me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse ose me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, duke u mbështetur në:

- (a) modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare dhe
- (b) karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar.

- 4.1.2 Një aktiv financiar do të matet me koston e amortizuar nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- (a) aktivi financiar mbahet sipas modelit të biznesit, objektivi i të cilit është mbajtja e aktiveve me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale dhe
- (b) kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar shkaktojnë në datat e specifikuara flukse monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit për shumën e papaguar të principalit.

Paragrafët B4.1.1–B4.1.26 japin udhëzime se si duhet të zbatohen këto kushte.

- 4.1.2A Një aktiv financiar do të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- (a) aktivi financiar mbahet sipas modelit të biznesit, objektivi i të cilit është arritur si duke arkëtuar flukse mjtesh monetare kontraktuale ashtu dhe shitur aktive financiare, dhe
- (b) kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar shkaktojnë në datat e specifikuara flukse monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit për shumën e papaguar të principalit.

Paragrafët B4.1.1–B4.1.26 japin udhëzime se si duhet të zbatohen këto kushte.

- 4.1.3 Për qëllim të zbatimit të paragrafëve 4.1.2(b) dhe 4.1.2A(b):

- (a) principal quhet vlera e drejtë e aktivitetit financiar në momentin e njohjes fillestare. Paragrafi B4.1.7B ofron udhëzime shtesë në kuptimin e principalit.
- (b) interesi konsiston në shpërblimin për vlerën në kohë të parasë, për rrezikun e kredisë i shoqëron shumën e principalit të pa paguar gjatë një periudhe të caktuar kohe dhe për rreziqet e tjera bazë të huadhënies, si dhe për marzhin e fitimit. Paragrafët B4.1.7B dhe B4.1.9E ofrojnë udhëzime shtesë në kuptim të interesit, përfshi dhe kuptimin e vlerës në kohë të parasë.

- 4.1.4 Një aktiv financiar do të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, përveçse është matur me koston e amortizuar në përputhje me paragrafin 4.1.2 ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 4.1.2.A. Megjithatë, një njësi ekonomike mund të bëjë një zgjedhje të parevokueshme në momentin e njohjes fillestare për investimet e veçanta në *instrumentet e kapitalit neto* të cilët mund të maten edhe ndryshe me vlerën e

drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ose ti pasqyrojnë ndryshimet e mëpasshme në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (shih paragrafët 5.7.5 - 5.7.6).

Opsioni për të caktuar një aktiv financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

- 4.1.5 Pavarësisht nga paragrafët 4.1.1-4.1.4, një njësi ekonomike, në njohjen fillestare, mund të caktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse duke bërë kështu eliminon apo redukton ndjeshëm një mospërputhje në matje ose njohje (nganjëherë referuar si një 'mospërputhje kontabël'), që ndryshe do të shkaktohej nga matja mbi baza të ndryshme të aktiveve ose detyrimeve apo njohjes së fitimeve dhe humbjeve nga to (shih paragrafët B4.1.29-B4.1.32).

4.2 Klasifikimi i detyrimeve financiare

- 4.2.1 Një njësi ekonomike do të klasifikojë të gjitha detyrimet financiare si të matura më pas me koston e amortizuar, me përjashtim të:
- (a) *detyrimeve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes*. Detyrime të tilla, përfshirë *derivativët* që janë detyrime, do të maten më pas me vlerën e drejtë.
 - (b) detyrimeve financiare që lindin kur një transferim i një aktivi financiar nuk kualifikohet për çregjistrim ose kur zbatohet mënyra e përfshirjes së vazhdueshme. Paragrafët 3.2.15 dhe 3.2.17 zbatohen për matjen e detyrimeve të tilla financiare.
 - (c) *kontratë e garancisë financiare* Pas njohjes fillestare, një emetues i një kontrate të tillë do ta masë më pas atë (përveçse kur zbatohet paragrafi 4.2.1 (a) ose (b)) me më të lartën e:
 - (i) shumës së *humbjes së zbritshme* së përcaktuar në përputhje me Seksionin 5.5 dhe
 - (ii) shumës të njohur fillimisht (shih paragrafin 5.1.1) pakësuar, kur është e përshtatshme, me amortizimin kumulativ të njohur në përputhje me parimet e SNRF 15.
 - (d) angazhimet për të siguruar një kredi me një normë interesi më të ulët se e tregut. Pas njohjes fillestare, një emetues i një angazhimi të tillë do ta masë më pas atë (përveçse kur zbatohet paragrafi 4.2.1 (a)) me më të lartën e:
 - (i) shumës së provizionit të humbjes së përcaktuar në përputhje me Seksionin 5.5 dhe
 - (ii) shumës të njohur fillimisht (shih paragrafin 5.1.1) pakësuar, kur është e përshtatshme, me amortizimin kumulativ të njohur në përputhje me parimet e SNRF 15.
 - (e) shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi për të cilin zbatohet SNRF 3. Shuma të tilla të kushtëzuara do që më pas të maten me vlerën e drejtë, dhe ndryshimi të njihet në fitim ose humbje.

Opsioni për të caktuar një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

- 4.2.2 Një njësi ekonomike, në njohjen fillestare, mund të caktojë në mënyrë të pakthyeshme një detyrim financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kur lejohet nga paragrafi 4.3.5, apo ngaqë duke vepruar kështu sigurohet informacion më i rëndësishëm, sepse ose:
- (a) eliminon apo redukton ndjeshëm një paqëndrueshmëri të metodës së matjes ose të njohjes (nganjëherë referuar si 'mospërputhje kontabël'), që ndryshe do të rridhte nga matja e aktiveve apo detyrimeve, apo njohja e fitimeve dhe humbjeve nga to mbi baza të ndryshme (shih paragrafët B4.1.29-4.1.32); ose
 - (b) një grup detyrimesh financiare apo aktivesh dhe detyrimesh financiare është menaxhuar dhe performanca e tij është vlerësuar mbi bazën e vlerës së drejtë, në përputhje me një menaxhim rreziku të dokumentuar ose strategji investimi dhe informacioni rreth grupit sigurohet nga brenda nga vetë personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike (siç përcaktohet në SNK 24 *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Palët e Lidhura*), për

shembull bordi i drejtorëve dhe drejtori ekzekutiv i njësisë ekonomike (shih paragrafët B4.1.33-B4.1.36).

4.3 Derivatvët e përfshirë

4.3.1 Një derivativ i përfshirë është një përbërës i një kontrate hibride që gjithashtu përfshin një jo-derivativ bazë-me efekt që disa nga flukset e mjeteve monetare të instrumentit të kombinuar të ndryshojnë në mënyrë të ngjashme me një derivativ të veçuar. Një derivativ i përfshirë shkakton disa ose të gjitha flukset e mjeteve monetare që përndryshe do të kërkoheshin nga kontrata që të modifikoheshin sipas një norme të caktuar interesi, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallrave, kursit të këmbimit valutor, indeksit të çmimeve ose normat, klasifikimi i kredive ose indeksit të kredisë, apo variabla të tjerë, siç është në rastin e një variabli jofinanciar që nuk është specifik për njërin palë të kontratës. Një derivativ që lidhet me një *instrument financiar*, por që nga pikëpamja kontraktuale është i transferueshëm në mënyrë të pavarur nga ky instrument, ose ka një palë tjetër të ndryshme, nuk është një derivativ i përfshirë, por një instrument i veçantë financiar.

Kontratat hibride me bazë një aktiv financiar

4.3.2 Nëse një kontratë hibride ka si bazë një aktiv që është brenda objektit të këtij Standardi, një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat në paragrafët 4.1.1–4.1.5 për gjithë kontratën hibride.

Kontratat e tjera hibride

4.3.3 Nëse një kontratë hibride ka një bazë që nuk është një aktiv brenda objektit të këtij Standardi, një derivativ i përfshirë do të ndahet nga baza dhe do të trajtohet si një derivativ sipas këtij Standardi, nëse, dhe vetëm nëse:

- (a) karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e derivativit të përfshirë nuk janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e instrumentit bazë (shih paragrafët B4.3.5 dhe B4.3.8);
- (b) një instrument i veçantë me kushte të njëjta si derivativi i përfshirë do të plotësonte përkufizimin e një derivativi; dhe
- (c) kontrata hibride nuk matet me vlerën e drejtë, ndryshimet në të cilën njihen në fitim ose humbje (d.m.th një derivativ që është i përfshirë në një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nuk veçohet).

4.3.4 Nëse një derivativ i përfshirë veçohet, kontrata bazë, do të trajtohet në përputhje me Standardin përkatës. Ky Standard nuk tregon nëse një derivativ i përfshirë do të paraqitet veçmas në pasqyrën e pozicionit financiare.

4.3.5 Pavarësisht nga paragrafët 4.3.3 dhe 4.3.4, nëse një kontratë përmban një ose më shumë derivativë të përfshirë dhe instrumenti bazë nuk është një aktiv brenda objektit të këtij Standardi, një njësi ekonomike mund ta përcaktojë të gjithë kontratën hibride me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse:

- (a) derivativi (derivativët) nuk modifikon (modifikojnë) dukshëm flukset e mjeteve monetare që përndryshe do të kërkoheshin nga kontrata; ose
- (b) është e qartë pa qenë nevoja të bëhet analizë e thellë, pasi që më parë, për një instrument të ngjashëm hibrid është ndaluar ndarja e derivativit të përfshirë, siç është një opion parapagimi i përfshirë në një kredi që lejon mbajtësin të parapaguajë kredinë afërsisht me koston e amortizuar të saj.

4.3.6 Nëse një njësi ekonomike kërkohet sipas këtij Standardi, të ndajë një derivativ të përfshirë nga instrumenti bazë i tij, por nuk është në gjendje të matë derivativin në mënyrë të veçantë si në blerje, apo në fund të një periudhe pasuese raportimi financiar, ajo do ta caktojë të gjithë kontratën hibride si kontratë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

4.3.7 Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të matë në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë të një derivativi të përfshirë, në bazë të afateve dhe kushteve të tij, vlera e drejtë e derivativit të përfshirë është diferenca midis vlerës së drejtë të kontratës hibride dhe vlerës së drejtë të instrumentit bazë. Nëse njësi ekonomike nuk është në gjendje të matë vlerën e drejtë të derivativit të përfshirë duke përdorur këtë metodë,

zbatohet paragrafi 4.3.6 dhe kontrata hibride (e kombinuar) konceptohet si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

4.4 Riklasifikimi

- 4.4.1 Kur, dhe vetëm kur, një njësi ekonomike ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare ajo do të riklasifikojë të gjitha aktivet financiare e prekura në përputhje me paragrafët 4.1.1–4.1.4 Shih paragrafët 5.6.1–5.6.7, B4.4.1–B4.4.3 dhe B5.6.1–B5.6.2 për udhëzime shtesë mbi riklasifikimin e aktiveve financiare.**
- 4.4.2 Një njësi ekonomike nuk do të riklasifikojë çfarëdo detyrimi financiar.**
- 4.4.3 Ndryshimet e mëposhtme në rrethanat nuk janë ri klasifikime për sa i përket zbatimit të paragrafëve 4.4.1 dhe -4.4.2:
- (a) një zë që ka qenë më parë një instrument mbulues efektiv dhe i caktuar në një mbrojtje të fluksit monetar apo mbrojtje investimi neto dhe nuk kualifikohet më si i tillë;
 - (b) një zë bëhet një instrument mbulues efektiv dhe i caktuar në një mbrojtje të fluksit monetar ose të investimit neto; dhe
 - (c) ndryshimet në matje në përputhje me Seksionin 6.7.

Kapitulli 5 Matja

5.1 Matja fillestare

- 5.1.1 Përveç llogarive të arkëtueshme tregtare brenda objektit të paragrafit 5.1.3, në njohjen fillestare, një njësi ekonomike do të matë një aktiv financiar ose detyrim financiar me vlerën e drejtë të tij plus ose minus, në rastin e një aktivi financiar ose detyrimi financiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, *kostot e transaksionit* që i ngarkohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të aktivit financiar ose detyrimit financiar.**
- 5.1.1A Megjithatë, nëse vlera e drejtë e aktivit financiar ose detyrimit financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafin B5.1.2A.**
- 5.1.2 Kur një njësi ekonomike bën kontabilizimin në datën e shlyerjes të një aktivi që matet më pas me koston e amortizuar, aktivi njihet fillimisht me vlerën e drejtë në datën e tregtimit (shih paragrafët B3.1.3-B3.1.6).
- 5.1.3 Pavarësisht kërkesave në paragrafin 5.1.1, në njohjen fillestare, njësi ekonomike do të masë llogaritë e arkëtueshme me çmimin e tyre të transaksionit (si përkufizohet tek SNRF 15) nëse llogaritë e arkëtueshme nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm në përputhje me SNRF 15 (ose kur njësi ekonomike zbaton praktikatat e përshtatshme në përputhje me paragrafin 63 të SNRF 15).

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

- 5.2.1 Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike do të matë një aktiv financiar, në përputhje me paragrafët 4.1.1-4.1.5 me:**
- (a) **koston e amortizuar;**
 - (b) **vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse; ose**
 - (c) **matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.**
- 5.2.2 Një njësi ekonomike do zbatojë kushtet e çylerësimit në Seksionin 5.5 për aktivet financiare që janë matur me koston e amortizuar në përputhje me paragrafin 4.1.2 dhe aktivet financiare që janë matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2.A.**
- 5.2.3 Një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës për një aktiv financiar të përcaktuar si element i mbrojtur, sipas paragrafëve 6.5.8 - 6.5.14 (dhe nëse janë të zbatueshëm**

paragrafët 89 - 94 të SNK 39 *Instrumentet Financiare - Njohja dhe Matja* për kontabilitetin mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit).¹

5.3 Matja e mëpasshme e detyrimeve financiare

- 5.3.1 Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike do të matë një detyrim financiar, në përputhje me paragrafët 4.2.1-4.2.2.
- 5.3.2 Një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës për një detyrim financiar të përcaktuar si element i mbrojtur, sipas paragrafëve 6.5.8 - 6.5.14 (dhe nëse janë të zbatueshëm paragrafët 89 - 94 të SNK 39 për kontabilitetin mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit).

5.4 Matja me koston e amortizuar

Aktivet financiare

Metoda e interesit efektiv

- 5.4.1 Të ardhurat nga interesi do të llogariten duke përdorur *metodën e interesit efektiv* (shih Shtojcën A dhe paragrafët B5.4.1 - B5.4.7). Kjo do të bëhet duke zbatuar *normën e interesit efektiv mbi vlerën bruto të mbetur të aktivit financiar* përveç:
- (a) *aktiveve financiare me kredit të çvlerësuar të blera apo të krijuara*. Për këto aktive financiare, njësi ekonomike do të zbatojë *normën e interesit efektiv të kreditit të rregulluar mbi koston e amortizuar të aktivit financiar* që nga momenti i njohjes fillestare.
 - (b) *aktiveve financiare që nuk kanë qenë si aktive financiare me kredit të çvlerësuar kur janë blerë apo kur janë krijuar, por më vonë janë kthyer në aktive financiare me kredit të çvlerësuar*. Për këto aktive financiare, njësi ekonomike do të zbatojë *normën e interesit efektiv mbi koston e amortizuar të aktivit financiar në periudhat e raportimit vijuese*.
- 5.4.2 Një njësi ekonomike e cila, në një periudhë raportuese llogarit të ardhurat nga interesi me metodën e normës së interesit efektiv mbi koston e amortizuar të aktivit financiar në përputhje me paragrafin 5.4.1(b), duhet që në periudhat pasardhëse të raportimit, të llogarisë të ardhurat nga interesi sipas metodës së normës së interesit efektiv mbi vlerën e bruto kontabël të aktivit financiar në qoftë se rreziku i kredisë së instrumentit financiar përmirësohet në atë mënyrë që aktivi financiar nuk quhet më me kredit të çvlerësuar dhe përmirësimi i ndodhur mund të lidhet objektivisht me një ngjarje e cila ka ndodhur pas aplikimit të kërkesave të paragrafit 5.4.1(b) (si p.sh., një përmirësim në renditjen e kreditit për huamarrësin).

Modifikimi i flukseve të mjeteve monetare kontraktuale

- 5.4.3 Kur flukset e mjeteve monetare kontraktuale të një aktivi financiar ri negociohen ose modifikohen ky ri negociim ose modifikim nuk rezulton në çregjistrimin e këtij aktivi financiar në përputhje me këtë Standard, një njësi ekonomike do të rillogarisë vlerën bruto të mbartur të aktivit financiar dhe duhet të njohë *fitimin ose humbjen nga modifikimi* nëpërmjet fitimit ose humbjes. Vlera bruto e mbartur e një aktivi financiar do të rillogaritet si vlera aktuale e flukseve të mjeteve monetare të ri negociuara të skontuara me normën efektive fillestare të aktivit financiar (ose me normën efektive të interesit të kreditit të rregulluar për aktivet financiare të blera apo të krijuara me kredit të çvlerësuar) ose, me normën e rishikuar të interesit efektiv të llogaritur në përputhje me paragrafin 6.5.10, kur është e zbatueshme. Çdo kosto apo tarifë që mund të ndodhin do të përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit financiar të modifikuar dhe do të amortizohen përgjatë periudhës së mbetur të aktivit financiar të modifikuar.

1

Në përputhje me paragrafin 7.2.21, një njësi ekonomike mund të zgjedhë si politikë kontabël të sajë të vazhdojë të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në SNK 39 në vend të kërkesave në Kapitullin 6 të këtij Standardi. Nëse një njësi ekonomike ka bërë këtë zgjedhje, atëherë referencat në këtë standard për kërkesat specifike të kontabilitetit mbrojtës në Kapitullin 6 nuk janë të përshtatshme. Përkundrazi, njësi ekonomike zbaton kërkesat përkatëse të kontabilitetit mbrojtës sipas SNK 39.

Pakësimi i vlerës

- 5.4.4 Një njësi ekonomike do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësi ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës konsiston në një ngjarje që ka të bëjë me një çregjistrim (shih paragrafin B3.2.16(r)).

5.5 Çvlerësimi

Njohja e humbjeve të parashikuara të një aktivi financiar

Përqasja e përgjithshme

- 5.5.1 Një njësi ekonomike do të njohë një *provizion për humbje për përkeqësimin e pritshëm të kredisë* të një aktivi financiar i cili matet në përputhje me paragrafët 4.1.2 ose 4.1.2A, të një qiraje financiare për tu arkëtuar, të një kontrate aktivi, apo të një angazhimi huaje dhe të një kontratë garancie financiare për të cilat plotësohen kushtet e çvlerësimit në përputhje me paragrafët 2.1(g), 4.2.1(c) ose 4.2.1(d).
- 5.5.2 Një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e çvlerësimit për njohjen dhe matjen e shumës së humbjes për aktivet financiare që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2A. Megjithatë, provizioni për humbjen do të njihet në të ardhurat e tjera përmbledhëse dhe nuk do të ulë vlerën e mbartur të aktivit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.
- 5.5.3 Në lidhje me paragrafët 5.5.13 - 5.5.16, në çdo datë raportimi, një njësi ekonomike do të masë provizionin për humbjen e një instrumenti financiar në atë shumë të barabartë me *humbjen e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së tij* nëse rreziku i kreditit të atij instrumenti financiar është shtuar ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare.
- 5.5.4 Objektivi i kërkesave të çvlerësimit është që të njohë humbjet e parashikuara të kredisë për gjithë ciklin e jetës për të gjithë instrumentet financiare për të cilat ka pasur rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë që nga njohja e tyre fillestare - të vlerësuar mbi baza individuale apo kolektive - duke marrë në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm mbështetës, përfshi këtu edhe atë që parashikohet të ndodhë.
- 5.5.5 Në lidhje me paragrafët 5.5.13 - 5.5.16, datën e raportimit, rreziku i kreditit të një instrumenti financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare, një njësi ekonomike duhet të masë provizionin për humbjen e atij instrumenti financiar në atë shumë të barabartë me *humbjen e pritshme të kredisë për 12-muaj*.
- 5.5.6 Për angazhimet për hua dhe kontrata të garancive bankare, data që njësi ekonomike bëhet pjesë e një angazhimi të pakthyeshëm do të konsiderohet si data e njohjes fillestare për qëllim të zbatimit të kërkesave të çvlerësimit.
- 5.5.7 Në qoftë se një njësi ekonomike ka matur provizionin e humbjes për një instrument financiar të barabartë me humbjen parashikuar të kredisë përgjatë gjithë jetës së tij në periudhat e mëparshme raportuese, por ka vendosur që në periudhën ushtrimore paragrafi 5.5.3 nuk është më i zbatueshëm, njësi ekonomike duhet të masë provizionin për humbjen me një shumë të barabartë me humbjen e parashikuar të kredisë për një periudhë 12 mujore nga data e raportimit.
- 5.5.8 Një njësi ekonomike do të njohë në fitim ose humbje, si një *fitim ose humbje nga çvlerësimi*, shumën e humbjes së parashikuar të kredisë (ose anulimin) që i duhet për të rregulluar humbjen llogaritur në datën e raportimit për të arritur tek shuma që i duhet të njohë në përputhje me këtë Standard.

Përcaktimi i rritjes në mënyrë të ndjeshme i rrezikut të kredisë

- 5.5.9 Në çdo datë raportimi, një njësi ekonomike do të vlerësojë nëse rreziku i kredisë së një instrumenti financiar është rritur në mënyrë të dukshme që nga njohja e tij fillestare. Kur bëhet ky vlerësim, një njësi ekonomike përdor ndryshimin në rrezikun që të ndodhë mospagimi përgjatë jetës së parashikuar të instrumentit financiar në vend të ndryshimit të madhësisë së humbjes së parashikuar të kredisë të këtij instrumenti. Për të bërë këtë vlerësim, një njësi ekonomike duhet të krahasojë rrezikun që të ndodhë mospagimi i instrumentit financiar në datën e raportimit me rrezikun që të ndodhë mospagimi i instrumentit financiar sipas datës kur është bërë njohja fillestare dhe të marrë në konsideratë informacionin mbështetës dhe të arsyeshëm, që është

i disponueshëm pa ndonjë përpjekje apo kosto të papërshtatshme, që tregon se rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm që nga koha e njohjes fillestare.

- 5.5.10 Një njësi ekonomike mund të hamendësojë se rreziku i kredisë së një instrumenti financiar nuk ka pësuar rritje të ndjeshme që nga njohja e tij fillestare në qoftë se për këtë instrument financiar përcaktohet se ka një rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit (shih paragrafët B5.5.22–B5.5.24).
- 5.5.11 Nëse informacione të arsyeshme dhe të mbështetura mbi të ardhmen janë të disponueshme pa ndonjë kosto apo përpjekje të pa përshtatshme, një njësi ekonomike nuk mund ti besojë vetëm informacionit të *së shkuarës* kur përcakton nëse rreziku i kredisë ka pësuar rritje të ndjeshme që nga data e njohjes fillestare. Megjithatë, kur informacioni i të ardhmes që shtrihet përtej datës së ripagimit (mbi baza individuale ose kolektive) nuk mund të sigurohet pa ndonjë kosto apo përpjekje të papërshtatshme, një njësi ekonomike mund të përdorë informacionin pas datës së ripagimit për të përcaktuar nëse ka pasur rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë që nga njohja e tij fillestare. Pavarësisht sesi një njësi ekonomike vlerëson rritjen e ndjeshme të rrezikut të kredisë, ka një hipotezë të kundërshtueshme që rreziku i kredisë të një aktivi financiar rritet në mënyrë të ndjeshme që nga momenti i njohjes fillestare në rast se pagesat kontraktuale janë vonuar me më shumë se 30 ditë. Një njësi ekonomike mund ta kundërshtojë këtë hipotezë nëse njësi ekonomike ka informacion të arsyeshëm dhe të mbështetur i cili mund të jetë i disponueshëm pa ndonjë kosto të papërshtatshme, i cili demonstroi që rreziku i kredisë nuk është rritur në mënyrë të ndjeshme që nga momenti i njohjes fillestare edhe pse pagesat kontraktuale janë vonuar me më shumë se 30 ditë. Kur një njësi ekonomike vendos që rreziku i kredisë ka pësuar rritje të ndjeshme më parë se pagesat kontraktuale të vonoheshim me më shumë se 30 ditë, atëherë parimi i hipotezës së kundërshtueshme nuk është më i aplikueshëm.

Aktivet financiare të modifikuara

- 5.5.12 Në qoftë se flukset e mjeteve monetare kontraktuale të një aktivi financiar janë ri negociuar ose modifikuar dhe aktivi financiar nuk është çregjistruar, njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë për aktivin financiar në përputhje me paragrafin 5.5.3 duke krahasuar:
- (a) rrezikun e ndodhjes së pagesës së vonuar në datën e raportimit (duke u bazuar në termat e modifikuar të kontratës); dhe
 - (b) rrezikun e ndodhjes së pagesës së vonuar në momentin e njohjes fillestare (duke u bazuar në termat origjinal të pa modifikuar të kontratës).

Aktiveve financiare me kredit të çvlerësuar të blera apo të krijuara

- 5.5.13 Pavarësisht nga paragrafët 5.5.3 dhe 5.5.5, në datën e raportimit, një njësi ekonomike për një aktiv financiar me kredit të çvlerësuar të blerë apo të krijuar, do të njohë si provizion për humbje vetëm ndryshimin e akumuluar të humbjeve të parashikuara të kredisë përgjatë gjithë jetës që nga njohja fillestare.
- 5.5.14 Në çdo datë raportimi, një njësi ekonomike do të njohë në fitim ose humbje shumën ndryshimit të humbjes së parashikuar të kredisë përgjatë gjithë jetës si një humbje ose fitim nga çvlerësimi. Një njësi ekonomike do të njohë ndryshimet e favorshme të humbjes së parashikuar të kredisë përgjatë gjithë jetës si një fitim nga çvlerësimi, edhe pse humbjet e parashikuara kreditit përgjatë jetës janë më të vogla se shuma e humbjeve të parashikuar të kredisë që janë përfshirë në flukset e parashikuara të mjeteve monetare në momentin e njohjes fillestare.

Përqasja e thjeshtuar për llogarite tregtare të arkëtueshme, aktivet kontraktual dhe llogaritë e arkëtueshme nga qiratë

- 5.5.15 Pavarësisht nga paragrafët 5.5.3 dhe 5.5.5, një njësi ekonomike gjithmonë do të masë provizionin për humbjen si një shumë të barabartë me humbjen e parashikuar të kredisë përgjatë jetës për:
- (a) llogaritë e arkëtueshme tregtare ose aktivet kontraktuale që rezultojnë nga transaksione që janë brenda objektit të SNRF 15, dhe që:
 - (i) nuk përmban një komponent financiar të rëndësishëm në përputhje me SNRF 15 (ose kur njësi zbaton praktika të përshtatshme në përputhje me paragrafin 63 të SNRF 15), ose
 - (ii) përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financiar në përputhje me SNRF 15, në qoftë se njësi ekonomike zgjedh si politikë kontabël matjen e provizionit të

humbjes në një shumë të barabartë me humbjet e parashikuara të kredisë përgjatë jetës. Kjo politikë kontabël do të zbatohet për të gjithë llogaritë tregtare të arkëtueshme ose aktiveve kontraktuale por mund të zbatohet veç për llogaritë tregtare të arkëtueshme dhe veç për aktivet kontraktuale.

- (b) **qira të arkëtueshme që rezultojnë nga transaksione që janë brenda objektivit të SNK 16, në qoftë se njësia ekonomike zgjedh si politikë kontabël matjen e humbjeve në një shumë të barabartë me humbjet e parashikuara të kredisë përgjatë jetës. Kjo politikë kontabël do të zbatohet për të gjithë qiratë e arkëtueshme, por mund të zbatohet veç për qiratë financiare dhe veç për qiratë e zakonshme.**

5.5.16 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë politika kontabël të pavarura nga njëra-tjetra për llogaritë tregtare të arkëtueshme, qiratë e arkëtueshme dhe aktivet kontraktuale.

Matja e humbjeve të parashikuara të kredisë

5.5.17 Një njësi ekonomike do të masë humbjen e parashikuar të kredisë të një instrumenti financiar në një mënyrë të tillë e cila reflekton:

- (a) **një shumë të paanshme dhe të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një gamë e rezultateve të mundshme;**
- (b) **vlerën në kohë të parasë; dhe**
- (c) **informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur i cili është i disponueshëm pa ndonjë kosto ose përpjekje të pa arsyeshme në datën e raportimit për ngjarjet e shkuara, situatën aktuale dhe parashikimet për kushtet ekonomike në të ardhmen.**

5.5.18 Kur bën matjen e humbjes së parashikuar të kredisë, një njësi ekonomike nuk i duhet me domosdo të identifikojë çdo skenar të mundshëm. Megjithatë, ajo do të marrë në konsideratë rrezikun ose probabilitetin që një humbje e kreditit mund të ndodhë duke reflektuar mundësinë që një humbje e kreditit mund të ndodhë si dhe mundësisë që një humbje e kreditit mund të mos ndodhë, edhe pse mundësia e humbjes së kreditit është shumë e ulët.

5.5.19 Maksimumi i periudhës së marrë në konsideratë kur bëhet matja e humbjes së parashikuar të kredisë është maksimumi i periudhës kontraktuale (përfshi mundësinë e zgjatjes) gjatë të cilës njësia ekonomike është e ekspozuar kundrejt rrezikut të kredisë dhe jo më gjatë, edhe pse një periudhë më e gjatë mund të jetë në përputhje me praktikën e biznesit.

5.5.20 Megjithatë, disa instrumente financiare përfshijnë edhe një hua edhe një përbërës të një angazhimi të pa ushtruar, dhe aftësia kontraktuale e njësies ekonomike për të kërkuar që të anulohet angazhimi dhe pa ushtruar nuk e kufizon ekspozimin e njësies ekonomike kundrejt humbjes së kreditit deri në masën e periudhës së njoftimit kontraktual. Për këta dhe vetëm për këta instrumente financiare, njësia ekonomike do të masë humbjen e parashikuar të kredisë përgjatë periudhës që njësia ekonomike është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë dhe humbja e parashikuar e kreditit mund të mos evitohet nga veprimet e menaxhimit të rrezikut të kredisë, edhe pse kjo periudhë mund të zgjatet përtej maksimumit të periudhës kontraktuale.

5.6 Riklasifikimi i aktiveve financiare

5.6.1 Nëse një njësi ekonomike i ri klasifikon aktivet financiare në përputhje me paragrafin 4.4.1, ajo do të zbatohet në mënyrë prospektive ri klasifikimin që nga *data e ri klasifikimit*. Njësia ekonomike nuk do riparaqesë fitimet, humbjet ose interesat e njohura më parë (përfshi humbjet dhe fitimet nga çvlerësimi). Paragrafët 5.6.2 - 5.6.7 përcaktojnë kërkesat për riklasifikimin.

5.6.2 Në qoftë se një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me koston e amortizuar tek kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlera e drejtë e tij do të matet në datën e riklasifikimit. Çdo fitim ose humbje neto që rrjedh nga një diferencë midis koston së amortizuar dhe vlerës së drejtë të aktivit financiar njihet në fitim ose humbje.

5.6.3 Në qoftë se një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes tek e matjes me koston e amortizuar, vlera e drejtë e tij në datën e riklasifikimit do të quhet si vlera e tij e re bruto. (Shih paragrafin B5.6.2 për udhëzime mbi përcaktimin e interesit efektiv dhe normës së interesit efektiv dhe të shumës së humbjes në datën e riklasifikimit.)

5.6.4 Në qoftë se një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me koston e amortizuar tek kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse,

vlera e drejtë e tij do të matet në datën e riklasifikimit. Çdo fitim ose humbje neto që rrjedh nga një diferencë midis vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës së drejtë njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse. Norma e interesit efektiv dhe matja e humbjeve të parashikuara të kredisë nuk rishikohen për shkak të këtij riklasifikimi. (Shih paragrafin B5.6.1.)

- 5.6.5 Në qoftë se një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse tek e matjes me koston e amortizuar, aktivi financiar riklasifikohet me vlerën e drejtë të tij në datën e riklasifikimit. Megjithatë, fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse zhvendoset nga kapitalet neto dhe kalon për të rregulluar vlerën e drejtë të aktivit financiar në datën e riklasifikimit. Si pasojë, aktivi financiar në datën e riklasifikimit do të matet sikur të ketë qenë matur gjithmonë me koston e amortizuar. Ky rregullim ka efekte në të ardhurat e tjera përmbledhëse por nuk ka efekte në fitimin apo humbjen e periudhës dhe si e tillë nuk është një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*). Norma e interesit efektiv dhe matja e humbjeve të parashikuara të kredisë nuk rishikohen për shkak të këtij riklasifikimi. (Shih paragrafin B5.6.1.)
- 5.6.6 Në qoftë se një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes tek kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, aktivi financiar do të vijojë të matet me vlerën e drejtë. (Shih paragrafin B5.6.2 për udhëzime mbi përcaktimin e interesit efektiv dhe normës se interesit efektiv dhe të shumës së humbjes në datën e riklasifikimit.)
- 5.6.7 Në qoftë se një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse tek kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, aktivi financiar do të vijojë të matet me vlerën e drejtë. Fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohet nga kapitalet neto dhe kalon në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1) në datën e riklasifikimit.

5.7 Fitime dhe humbje neto

- 5.7.1 Një fitim ose humbje neto nga një aktiv financiar ose detyrim financiar që matet me vlerën e drejtë do të njihet në fitim ose humbje përveç rasteve kur:
- është pjesë e një marrëdhënie mbrojtëse (shih paragrafët 6.5.8-6.5.14 dhe nëse janë të zbatueshëm, paragrafët 89-94 të SNK 39 për kontabilitetin mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit);
 - është një investim në një instrument të kapitalit neto dhe njësia ekonomike ka zgjedhur për të paraqitur fitimet dhe humbjet neto nga ky investim në të ardhura të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5;
 - është një detyrim financiar i përcaktuar si detyrim me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe njësia ekonomike duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në *rrezikun e kredisë* të detyrimit në të ardhura të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.7. ose
 - është një aktiv financiar i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2.A dhe njësia ekonomike duhet të njohë disa ndryshime në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.10.
- 5.7.1A *Dividendët* njihen në fitim ose humbje vetëm kur:
- përcaktohet e drejta e njësisë ekonomike për të marrë pagesën e dividendëve;
 - është e mundshme që përfitime ekonomike të lidhura me dividendin do të hyjnë në njësinë ekonomike; dhe
 - shuma e dividendit mund të matet në mënyrë të besueshme.
- 5.7.2 Një fitim ose humbje neto nga një aktiv financiar që matet me koston e amortizuar, që nuk është pjesë e një marrëdhënie mbrojtëse (shih paragrafët 6.5.8 - 6.5.14 dhe nëse janë të zbatueshëm, paragrafët 89-94 të SNK 39 për kontabilitetin mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit) do të njihet në fitim ose humbje kur aktivi financiar çregjistrohet, riklasifikohet në përputhje me paragrafin 5.6.2 nëpërmjet procesit të amortizimit ose kur njihet një humbje ose fitim nga çvlerësimi. Një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafët 5.6.2 dhe 5.6.4 në qoftë se riklasifikon aktivet financiare nga kategoria e matjes me koston e amortizuar.

Një fitim ose humbje nga një detyrim financiar që matet me koston e amortizuar dhe që nuk është pjesë e një marrëdhënie mbrojtëse (shih paragrafët 6.5.8-6.5.14 dhe nëse janë të zbatueshëm, paragrafët 89-94 të SNK 39 për kontabilitetin mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit) do të njihet në fitim ose humbje kur detyrimi financiar çregjistrohet dhe përmes procesit të amortizimit. (Shih paragrafin B5.7.2 për udhëzime mbi fitimet dhe humbjet nga këmbimi i monedhave të huaja.)

- 5.7.3 Një fitim ose humbje nga një aktiv financiar ose detyrim financiar që është element i mbrojtur në një marrëdhënie mbrojtëse, do të njihet në përputhje me paragrafët 6.5.8-6.5.14 dhe nëse është e zbatueshme, me paragrafët 89-94 të SNK 39 për kontabilitetin mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit.
- 5.7.4 Nëse një njësi ekonomike njeh aktivet financiare duke përdorur metodën e kontabilizimit në datën e shlyerjes (shih paragrafin 3.1.2, B3.1.3 dhe B3.1.6), çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitet gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes nuk njihet për aktivet e matura me koston e amortizuar. Për aktivet e matura me vlerën e drejtë, ndryshimi në vlerën e drejtë do të njihet në fitim ose humbje, ose në të ardhura të tjera të përmbledhëse, kur është e mundur, në bazë të paragrafit 5.7.1. Data e tregtimit do të konsiderohet si datë e njohjes fillestare për qëllime të zbatimit të kërkesave të çvlerësimit.

Investimet në instrumente kapitali

- 5.7.5 Në njohjen fillestare, një njësi ekonomike mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur në të ardhura të tjera të përmbledhëse ndryshimet e mëpasshme në vlerën e drejtë të një investimi në një instrument kapitali brenda objektit të këtij Standardi që as nuk është i *mbajtur për tregtim* dhe as nuk është një shumë e kushtëzuar e një blerësi në një kombinim biznesi për të cilin zbatohet SNRF 3. (Shih paragrafin B5.7.3 për udhëzime mbi fitimet dhe humbjet nga këmbimi i monedhave të huaja.)
- 5.7.6 Në qoftë se një njësi ekonomike bën një zgjedhje sipas paragrafit 5.5.5, ajo do të njohë në fitim ose humbje dividendët nga investimet në përputhje me paragrafin 5.7.1A.

Detyrimet e përcaktuar si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

- 5.7.7 Një njësi ekonomike do të paraqesë një fitim ose humbje nga një detyrim financiar të përcaktuar si detyrim me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 4.2.2 ose me paragrafin 4.3.5 si më poshtë:
- (a) Shuma e ndryshimit në vlerën e drejtë të detyrimit financiar që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë të këtij detyrimi do të paraqitet në të ardhura të tjera të përgjithshme (shih paragrafët B5.7.13-B5.7.20), dhe
- (b) shuma e mbetur e ndryshimit në vlerën e drejtë të detyrimit do të paraqitet në fitim ose humbje
- përveç rasteve kur trajtimi i efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë për detyrimin, të përshkruara në (a), do të krijonte ose rriste mospërputhjen kontabël në fitim ose humbje (rast në të cilin zbatohet paragrafi 5.7.8). Paragrafët B5.7.5 -B5.7.7 dhe B5.7.10-B5.7.12 japin udhëzime për të përcaktuar nëse është krijuar apo rritur një mospërputhje kontabël.
- 5.7.8 Në qoftë se kërkesat në paragrafin 5.7.7 do të krijonin ose rritnin një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje, një njësi ekonomike duhet të paraqesë të gjitha fitimet ose humbjet neto nga ky detyrim (duke përfshirë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të tij) në fitim ose humbje.
- 5.7.9 Pavarësisht nga kërkesat në paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8, një njësi ekonomike do të paraqesë në fitim ose humbje të gjitha fitimet dhe humbjet neto nga angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare të cilat janë përcaktuar si instrumente financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Aktivitet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse

- 5.7.10 Një fitim ose humbje nga një aktiv financiar i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2A do të njihet në të ardhurat e tjera përmbledhëse, përveç fitimeve ose humbjeve nga çvlerësimi (shih Seksionin 5.5) dhe fitimeve ose

humbjeve nga këmbimi i monedhave monetare (shih paragrafët B5.7.2-B5.7.2A), derisa aktivi financiar të çregjistrohet ose të riklasifikohet. Kur një aktiv financiar çregjistrohet, fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohet nga kapitalet neto dhe kalon në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1). Kur një aktiv financiar riklasifikohet nga kategoria e matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave përmbledhëse, njësisia ekonomike duhet të kontabilizojë fitimin ose humbjen e akumuluar të njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafët 5.6.5 dhe 5.6.7. Interesi i rillogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv njihet në fitim ose humbje.

- 5.7.11 Ashtu siç përshkruhet në paragrafin 5.7.10, në qoftë se një aktiv financiar i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2.A, shumat që do njihen në fitim ose humbje janë të njëjta me shumat që mund të njiheshin në fitim humbje në qoftë se aktivet financiare do të ishin matur me koston e amortizuar.

Kapitulli 6 Kontabiliteti mbrojtës

6.1 Objektivi dhe qëllimi i kontabilitetit mbrojtës

- 6.1.1 Objektivi i kontabilitetit mbrojtës është që të pasqyrojë në pasqyrat financiare efektin e aktiviteteve të menaxhimit të rrezikut të një njësie ekonomike që vë në përdorim instrumentet financiare për të menaxhuar ekspozimet që dalin nga rreziqe të veçanta që mund të ndikojnë në fitimin ose humbjen (ose të ardhura të tjera përmbledhëse, si në rastin e investimeve në instrumentet e kapitalit neto për të cilin një njësi ekonomike ka zgjedhur që të pasqyrojë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse sipas paragrafit 5.7.5). Ky trajtim ka për qëllim të përcjellë kontekstin e instrumenteve mbulues për të cilat zbatohet kontabiliteti mbrojtës me qëllim që të lejojë një pamje më të qartë të qëllimit dhe efektit të tyre.
- 6.1.2 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë që të përcaktojë një marrëdhënie mbrojtëse midis një instrumenti mbulues dhe një elementi të mbrojtur në përputhje me paragrafët 6.2.1-6.3.7 dhe B6.2.1-B6.3.25. Për marrëdhëniet mbrojtëse që plotësojnë kriteret e kualifikimit, një njësi ekonomike do të llogarisë fitimin neto ose humbjen mbi instrumentin mbulues dhe mbi elementin e mbrojtur në përputhje me paragrafët 6.5.1-6.5.14 dhe B6.5.1-B6.5.28. Në rastin kur elementi i mbrojtur është një grup zërash, një njësi ekonomike do të veprojë në përputhje me kërkesat shtesë në paragrafët 6.6.1-6.6.6 dhe B6.6.1-B6.6.16.
- 6.1.3 Për një mbrojtje me vlerën e drejtë nga ekspozimi i normës së interesit për një portofol aktivesh financiare ose detyrimesh financiare (dhe vetëm për një mbrojtje të tillë), një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në SNK 39 në vend të atyre që gjenden në këtë Standard. Në këtë rast, njësisia ekonomike duhet të zbatojë gjithashtu kërkesat specifike për kontabilitetin mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit dhe të përcaktojë në terma monetarë pjesën e portofolit që përbën elementin e mbrojtur (shih paragrafët 81A, 89A dhe UZ114-UZ132 të SNK 39).

6.2 Instrumentet mbulues

Instrumentet kualifikues

- 6.2.1 Një derivativ i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të përcaktohet si një instrument mbulues, me përjashtim të disa opsioneve të shitura (shih paragrafin B6.2.4).
- 6.2.2 Një aktiv financiar ose detyrim financiar jo derivativ i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të përcaktohet si një instrument mbulues, përveç rastit kur është një detyrim financiar i përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, për të cilin masa e ndryshimit në vlerën e drejtë që ka të bëjë drejtpërdrejt me ndryshimet në rrezikun e kreditë të atij detyrimi, pasqyrohet në të ardhura të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.7. Për një mbrojtje nga rreziku i kursit të këmbimit, përbërësi i rrezikut i monedhës së huaj i një aktivi ose detyrimi financiar jo derivativ mund të përcaktohet si një instrument mbulues me kusht që të mos jetë një investim në një instrument kapitali neto për të cilin një njësi ekonomike ka zgjedhur që të pasqyrojë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5.

- 6.2.3** Për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, vetëm kontratat me një palë të jashtme për njësinë raportuese (d.m.th. një palë e jashtme për grupin ose njësinë ekonomike individuale për të cilin raportohet) mund të përcaktohen si instrumente mbulues.

Përcaktimi i instrumenteve mbulues

- 6.2.4 Një instrument kualifikues duhet të përcaktohet në tërësinë e tij si një instrument mbulues. Përfshirjet e vetme të lejuara janë:
- (a) ndarja e vlerës së perceptuar dhe vlerës në kohë të një kontrate opsioni dhe përcaktimi si instrument mbulues vetëm ndryshimi në vlerën e perceptuar të një opsioni dhe jo ndryshimi në vlerën në kohë të tij (shih paragrafët 6.5.15 dhe B6.5.29-B6.5.33);
 - (b) ndarja e elementit të ardhshëm nga elementi aktual në një kontratë të ardhshme dhe përcaktimi si instrument mbulues vetëm i një pjese që i takon ndryshimit të vlerës së elementit aktual të një kontrate të ardhshme dhe jo të elementit të ardhshëm; në mënyrë të ngjashme, shpërndarja e bazës së monedhës së huaj mund të ndahet dhe përfshihet nga përcaktimi i një instrumenti financiar si instrument mbulues (shih paragrafët 6.5.16 dhe B6.5.34-B6.5.39); dhe
 - (c) një pjesë e instrumentit të plotë mbulues, si për shembull 50 për qind e vlerës nominale, mund të përcaktohet si instrument mbulues në një marrëdhënie mbrojtëse. Megjithatë, një instrument mbulues nuk mund të përcaktohet për një pjesë të ndryshimit të tij në vlerën e drejtë që rrjedh vetëm nga një pjesë e periudhës kohore gjatë së cilës instrumenti mbulues është në qarkullim.
- 6.2.5 Një njësi ekonomike mund t'i shohë në kombinim dhe së bashku të përcaktojë si instrument mbulues çdo kombinim të mëposhtëm (duke përfshirë ato rrethana në të cilat rreziku apo rreziqet që vijnë nga disa instrumente mbulues kompensojnë ato që burojnë nga të tjerët):
- (a) derivativët ose një pjesë e tyre; dhe
 - (b) jo derivativët ose një pjesë e tyre;
- 6.2.6 Megjithatë, një instrument derivativ që kombinon një opSION të shitur dhe një opSION të blerë (për shembull, një opSION investimi mbrojtës të normës së interesit) nuk kualifikohet si një instrument mbulues në qoftë se është, në fakt, një opSION i shitur në datën e përcaktimit (përveç rastit kur kualifikohet në përputhje me paragrafin B6.2.4). Në mënyrë të ngjashme, dy ose më shumë instrumente (ose pjesë të tyre) mund të përcaktohen së bashku si instrument mbulues vetëm nëse, në kombinim, ata nuk janë, në fakt, një opSION i shitur në datën e përcaktimit (përveç rastit kur kualifikohet në përputhje me paragrafin B6.2.4).

6.3 Elementët e mbrojtur

Elementët kualifikues

- 6.3.1** Një element i mbrojtur mund të njihet si aktiv ose detyrim, një *angazhim i përcaktuar* i panjohur, një *transaksion parashikues* ose një investim neto në një njësi ekonomike të huaj. Elementi i mbrojtur mund të jetë:
- (a) një zë i vetëm; ose
 - (b) një grup zërash (siç përcaktohet në paragrafin 6.6.1-6.6.6 dhe B6.6.1-B6.6.16).
- Një element i mbrojtur mund të jetë gjithashtu një përbërës i një zëri ose grup zërash (shih paragrafin 6.3.7 dhe B6.3.7-B6.3.25).
- 6.3.2** Elementi i mbrojtur duhet të jetë i matshëm me besueshmëri.
- 6.3.3** Nëse një element i mbrojtur është një transaksion parashikues (ose një komponent i tij), ky transaksion duhet të jetë me probabilitet të lartë.
- 6.3.4** Një ekspozim total i cili është një kombinim i një ekspozimi që mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në përputhje me paragrafin 6.3.1 dhe një derivativ, mund të përcaktohet si një element i mbrojtur (shih paragrafët B6.3.3-B6.3.4). Kjo përfshin një transaksion parashikues të një ekspozimi total (d.m.th. transaksionet e paangazhuara por të pritshme që do të shkaktonin një ekspozim dhe një derivativ) nëse ky ekspozim total është me probabilitet të lartë dhe pasi të ketë ndodhur e nuk është më një parashikim, plotëson kriteret e një elementi të mbrojtur.

- 6.3.5** Për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, vetëm aktivet, detyrimet, angazhimet e përcaktuara ose transaksionet parashikuese me probabilitet të lartë me një palë të jashtme me njësinë raportuese mund të përcaktohen si elemente të mbrojtur. Kontabiliteti mbrojtës mund të zbatohet për transaksione midis njësisë ekonomike brenda të njëjtit grup vetëm në pasqyrat financiare individuale ose të ndara të atyre njësisë ekonomike dhe jo në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit, me përjashtim të pasqyrave financiare të konsoliduara të një njësie ekonomike investuese, siç përcaktohet në SNRF 10, ku transaksionet midis një njësie ekonomike investuese dhe filialeve të saj të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nuk do të eliminohen në pasqyrat financiare të konsoliduara.
- 6.3.6** Megjithatë, si një përjashtim për paragrafin 6.3.5, rreziku nga monedha e huaj e zërit monetar të ndërgrupit (për shembull, një llogari e pagueshme/arkëtueshme ndërmjet dy filialeve) mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara nëse rezulton në një ekspozim të fitimit neto apo humbjes nga kursi i këmbimit të monedhave të huaja që nuk eliminohet plotësisht në konsolidim në përputhje me SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit*. Në përputhje me SNK 21, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit të monedhave të huaja në zërat monetarë të ndërgrupit nuk eliminohen plotësisht në konsolidim kur zëri monetar i ndërgrupit është krijuar ndërmjet dy njësisë ekonomike brenda grupit që kanë monedha funksionale të ndryshme. Si rrjedhojë, rreziku i valutës së huaj në një transaksion ndërgrupi të parashikueshëm me probabilitet të lartë mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara me kusht që transaksioni të jetë shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike që ka kryer këtë transaksion dhe rreziku nga valuta e huaj do të ketë ndikim në fitimin ose humbjen e konsoliduar.

Përcaktimi i elementeve të mbrojtur

- 6.3.7** Një njësi ekonomike mund të përcaktojë një zë në tërësinë e tij ose një përbërës të një zëri si element i mbrojtur në një marrëdhënie mbrojtëse. Një zë i tërë përfshin të gjitha ndryshimet në flukset e mjeteve monetare ose vlerën e drejtë të një zëri. Një përbërës përfshin më pak se ndryshimi i vlerës së drejtë të plotë ose ndryshueshmëria e fluksit monetar të një zëri. Në këtë rast, një njësi ekonomike mund të përcaktojë vetëm përbërësit e mëposhtëm (përfshirë edhe kombinimet midis tyre) si elemente të mbrojtur:
- (a) vetëm ndryshimet në flukset e mjeteve monetare ose vlerën e drejtë të një zëri që ka të bëjë drejtpërdrejt me një rrezik ose rreziqe të veçanta (përbërësi i rrezikut), me kusht që, bazuar në vlerësimin në kuadër të strukturës së veçantë të tregut, përbërësi i rrezikut të jetë i identifikueshëm veças dhe i matshëm me besueshmëri (shih paragrafët B6.3.8-B6.3.15). Përbërësit e rrezikut përfshijnë një përcaktim vetëm të ndryshimeve në flukset e mjeteve monetare ose në vlerën e drejtë të një elementi të mbrojtur mbi ose nën një çmim specifik ose variacione të tjera (një rrezik i njëanshëm).
 - (b) një ose më shumë flukse monetare kontraktuale të zgjedhura.
 - (c) përbërësit e një vlere nominale, d.m.th. një pjesë specifike e vlerës së një zëri (shih paragrafët B6.3.16-B6.3.20).

6.4 Kriteret kualifikuese për kontabilitetin mbrojtës

- 6.4.1** Një marrëdhënie mbrojtëse kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës vetëm nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:
- (a) marrëdhënia mbrojtëse përbëhet vetëm nga instrumentet mbulues të përshtatshëm dhe zërat e përshtatshëm të mbrojtur.
 - (b) në fillim të marrëdhënies mbrojtëse ka një përcaktim dhe dokumentacion formal për marrëdhënien mbrojtëse dhe objektivin e strategjinë e menaxhimit të rrezikut të njësisë ekonomike për të ndërmarrë mbrojtjen. Ky dokumentacion do të përfshijë identifikimin e instrumentit mbulues, elementin e mbrojtur, natyrën e rrezikut nga i cili synohet mbrojtja dhe mënyrën se si njësisë ekonomike do të vlerësojë nëse marrëdhënia mbrojtëse plotëson kërkesat e mbrojtjes efektive (duke përfshirë analizat e burimeve të mbrojtjes jo efektive dhe si e përcakton ajo *raportin e mbulimit*).
 - (c) marrëdhënia mbrojtëse plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme të mbrojtjes efektive:
 - (i) ka një marrëdhënie ekonomike midis elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues (shih paragrafin B6.4.4-B6.4.6);

- (ii) efekti i rrezikut të kredisë nuk i dominon ndryshimet në vlerë që vijnë si rezultat i marrëdhënies ekonomike (shih paragrafët B6.4.7-B6.4.8); dhe
- (iii) raporti i mbulimit i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me raportin e sasisë së elementit të mbrojtur që njësia ekonomike aktualisht mbulon dhe sasisë së instrumentit mbulues që njësia ekonomike aktualisht përdor për të mbuluar atë sasi të elementit të mbrojtur. Megjithatë, ky përcaktim nuk duhet të pasqyrojë një çekuilibër mes peshave përkatëse të elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues, që do të krijonte një mbrojtje jo efektive (pavarësisht nëse njihet apo jo) e cila mund të sjellë një rezultat kontabël të papajtueshëm me qëllimin e kontabilitetit mbrojtës (shih paragrafët B6.4.9-B6.4.11).

6.5 Kontabiliteti për kualifikimin e marrëdhënieve mbrojtëse

- 6.5.1** Një njësi ekonomike aplikon kontabilitetin mbrojtës në marrëdhëniet mbrojtëse që plotësojnë kriteret e kualifikimit në paragrafin 6.4.1 (të cilat përfshijnë vendimin e njësisë ekonomike për të përcaktuar marrëdhënien mbrojtëse).
- 6.5.2** Ka tre lloj marrëdhëniesh mbrojtëse:
- (a) mbrojtje me vlerën e drejtë: një mbrojtje nga ekspozimi i ndryshimeve në vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi të njohur ose një angazhimi të përcaktuar të panjohur, ose një përbërësi të një zëri të tillë, që mbart një rrezik të veçantë dhe që do të kishte ndikim në fitimin ose humbjen.
 - (b) mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare: një mbrojtje nga ekspozimi i ndryshimeve në flukset e mjeteve monetare që mbart një rrezik të veçantë që i shoqëron të gjitha, ose një përbërës të një aktivi ose detyrimi të njohur (siç janë të gjitha pagesat ose një pjesë e pagesave të interesit të ardhshëm mbi borxhin me normë të ndryshueshme) ose një transaksion të parashikueshëm me probabilitet të lartë dhe që mund të ketë ndikim mbi fitimin ose humbjen.
 - (c) mbrojtje e një investimi neto në një operacion të huaj siç përcaktohet në SNK 21.
- 6.5.3** Nëse elementi i mbrojtur është një instrument kapitali neto për të cilin njësia ekonomike ka zgjedhur që të pasqyrojë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5, paraqitja e mbrojtjes së cilës i referohet në paragrafin 6.5.2(a) duhet të jetë e tillë që të ketë ndikim në të ardhura të tjera përmbledhëse. Në këtë rast dhe vetëm në këtë rast, mbrojtja jo efektive pasqyrohet në të ardhura të tjera përmbledhëse.
- 6.5.4** Një mbrojtje nga rreziku i kursit të këmbimit të një angazhimi të përcaktuar mund të llogaritet si një mbrojtje me vlerën e drejtë ose një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare.
- 6.5.5** Nëse një marrëdhënie mbrojtëse nuk përmbush kërkesën e mbrojtjes efektive në lidhje me raportin mbrojtës (shih paragrafin 6.4.1 (c)(iii)) por objektivi i menaxhimit të rrezikut për atë marrëdhënie të përcaktuar mbrojtëse mbetet i njëjtë, një njësi ekonomike duhet të rregullojë raportin mbrojtës të marrëdhënies mbrojtëse në mënyrë që ai të plotësojë sërish kriteret kualifikuese (kjo gjë në këtë Standard do të quhet "vendosje rishtas në ekuilibër" - shih paragrafët B6.5.7 - B6.5.21).
- 6.5.6** Një njësi ekonomike do të ndërpresë kontabilitetin mbrojtës në mënyrë prospektive vetëm kur marrëdhënia mbrojtëse (ose një pjesë e marrëdhënies mbrojtëse) nuk përmbush kriteret kualifikuese (pasi të marrë në konsideratë çdo vendosje rishtas në ekuilibër të marrëdhënies mbrojtëse, nëse është e zbatueshme). Kjo përfshin rastet kur instrumenti mbulues ka skaduar ose është shitur, nuk merrren më përfitime ose është përdorur. Për këtë qëllim, zëvendësimi apo përtëritja e një instrumenti mbulues në një instrument tjetër mbulues nuk konsiderohet skadim apo ndërprerje e afatit nëse ky zëvendësim ose kjo përtëritje është pjesë e strategjisë mbrojtëse dhe në përputhje me objektivat e menaxhimit të rrezikut të dokumentuar të njësisë ekonomike. Përveç kësaj, për këtë qëllim nuk ka skadim apo ndërprerje të afatit të instrumentit mbulues, nëse:
- (a) si pasojë e ligjeve apo rregulloreve apo futjes së ligjeve ose rregulloreve, palët e instrumentit mbulues janë dakord që një ose më shumë prej palëve të tjera të kleringut të zëvendësojnë palën tjetër fillestare të tyre për t'u bërë palë tjetër e re në secilën prej palëve. Për këtë qëllim, një palë tjetër kleringu është pala tjetër kryesore (e quajtur nganjëherë një 'organizatë kleringu' ose 'agjenci kleringu') ose një njësi ekonomike apo disa njësi ekonomike, për shembull, një anëtar i një organizate kleringu ose një klient i një anëtari kleringu të një organizate kleringu, të cilat veprojnë si palë të tjera në mënyrë që të kryhet kleringu nga një palë kryesore tjetër. Megjithatë, kur palët e instrumentit mbulues

zëvendësojnë palët e tjera fillestare të tyre me palë të tjera të ndryshme kërkesat në këtë nënparagraf do të plotësohen vetëm në qoftë se secila prej këtyre palëve bëjnë kleringun me të njëjtën palë kryesore tjetër.

- (b) ndryshime të tjera, nëse ka ndonjë, në instrumentin mbulues kufizohen në ato që janë të nevojshme për bërë një zëvendësim të tillë të palës tjetër. Ndryshimet e tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që priten nëse instrumenti mbulues është likuiduar fillimisht me palën tjetër të kleringut. Këto ndryshime përfshijnë ndryshimet në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të kompensuar tepricat e llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe taksat e ngarkuara.

Ndërprerja e kontabilitetit mbrojtës mund të ndikojë në një marrëdhënie mbrojtëse në tërësi ose vetëm në një pjesë të saj (rast në të cilin kontabiliteti mbrojtës vazhdon deri në fund të marrëdhënies mbrojtëse).

6.5.7 Një njësi ekonomike do të zbatojë:

- (a) paragrafin 6.5.10 kur ndërpret kontabilitetin mbrojtës për një mbrojtje me vlerën e drejtë për të cilën elementi i mbrojtur është (ose është një përbërës i) një instrument financiar i matur me koston e amortizuar; dhe
- (b) paragrafin 6.5.12 kur ndërpret kontabilitetin mbrojtës për mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare.

Mbrojtjet me vlerën e drejtë

6.5.8 Për sa kohë që një mbrojtje me vlerën e drejtë plotëson kriteret kualifikuese në paragrafin 6.4.1, marrëdhënia mbrojtëse do të trajtohet si më poshtë:

- (a) fitimi ose humbja në instrumentin mbulues do të njihet në fitim ose humbje (ose në të ardhura të tjera përmbledhëse, nëse instrumenti mbulues mbulon një instrument kapitali neto për të cilin një njësi ekonomike ka zgjedhur që të pasqyrojë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5).
- (b) fitimi ose humbja mbuluese në elementin e mbrojtur do të rregullojë vlerën kontabël (neto) të elementit të mbrojtur (nëse është e zbatueshme) dhe do të njihet në fitim ose humbje. Në qoftë se elementi i mbrojtur është një aktiv financiar (ose një përbërës i këtij) që është matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2A, humbja ose fitimi nga mbulimi i elementit të mbrojtur duhet të njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, nëse elementi i mbrojtur është një instrument kapitali neto për të cilin njësi ekonomike ka zgjedhur që të pasqyrojë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5, këto vlera do të mbeten në të ardhura të tjera përmbledhëse. Në rastin kur elementi i mbrojtur është një angazhim i përcaktuar i panjohur (ose një përbërës i tij), ndryshimi kumulativ në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur që rrjedh nga përcaktimi i tij do të njihet si aktiv ose detyrim me një fitim ose humbje korresponduese që njihet në rezultat.

6.5.9 Në rastin kur një element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerën e drejtë është një angazhim i përcaktuar (ose një përbërës i tij) për të blerë një aktiv ose për të pranuar një detyrim, vlera kontabël (neto) fillestare e aktivit ose detyrimit që rezulton nga pranimi i angazhimit të përcaktuar nga ana e njësisë ekonomike rregullohet që të përfshijë ndryshimin kumulativ në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur që është njohur në pasqyrën e pozicionit financiar.

6.5.10 Çdo rregullim që vjen nga aplikimi i paragrafit 6.5.8(b) duhet të amortizohet e të kalojë në fitim ose humbje nëse elementi i mbrojtur është një instrument financiar (ose një komponent i tij) i matur me koston e amortizuar. Amortizimi mund të fillojë që në momentin që kryhet rregullimi dhe jo më vonë se kur elementi i mbrojtur nuk mund të rregullohet më për të mbuluar fitimin ose humbjen. Amortizimi bazohet në një normë interesi efektiv të rilogaritur në datën në të cilën fillon amortizimi. Në rastin e një aktivit financiar (ose një përbërës të tij) që është një element i mbrojtur dhe që është i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2A, amortizimi zbatohet në të njëjtën mënyrë por mbi shumën që përfaqëson fitimin ose humbjen e akumuluar të njohur më parë në përputhje me paragrafin 6.5.8 (b) dhe jo nëpërmjet rregullimit të vlerës së neto kontabël.

Mbrojtjet e fluksit monetar

6.5.11 Për sa kohë që mbrojtja e fluksit të mjeteve monetare plotëson kriteret në paragrafin 6.4.1, marrëdhënia mbrojtëse do të trajtohet si më poshtë:

- (a) përbërësit e veçantë të kapitalit që shoqërohen me elementin e mbrojtur (rezerva e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare) rregullohet për vlerat më të ulëta të elementëve të mëposhtëm (në vlera absolute):
- (i) fitimi neto ose humbja kumulative në elementin e mbrojtur që nga fillimi i mbulimit; dhe
 - (ii) ndryshimi kumulativ në vlerën e drejtë (vlerën aktuale) të elementit të mbrojtur (d.m.th. vlera aktuale e ndryshimit kumulativ të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme që pritet të mbrohen) që nga fillimi i mbulimit.
- (b) pjesa e fitimit ose humbjes në instrumentin mbulues që është përcaktuar të jetë një mbrojtje efektive (d.m.th. pjesa që është kompensuar nga ndryshimi në rezervën e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare e kalkuluar në përputhje me pikën (a)) do të njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse.
- (c) çdo fitim ose humbje e mbetur në instrumentin mbulues (ose çdo fitim ose humbje e nevojshme për të balancuar ndryshimin në rezervën e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare i llogaritur në përputhje me pikën (a)) është mbrojtje jo efektive që do të njihet në fitim ose humbje.
- (d) vlera që është akumuluar në rezervën e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare në përputhje me pikën (a) do të trajtohet si më poshtë:
- (i) nëse një transaksion parashikues i mbrojtur rezulton më pas në njohjen e një aktivi jo-financiar ose detyrimi jo-financiar, ose një transaksion parashikues i mbrojtur për një aktiv ose detyrim jo-financiar kthehet në një angazhim të përcaktuar për të cilin zbatohet kontabiliteti mbrojtës i vlerës së drejtë, njësia ekonomike duhet ta heqë këtë vlerë nga rezerva e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare dhe ta përfshijë në mënyrë direkte në koston fillestare ose në vlera të tjera kontabël të aktivit ose detyrimit. Ky nuk është një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1)kështu që ai nuk ndikon në të ardhura të tjera përmbledhëse.
 - (ii) për mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare të ndryshme nga ato që përmenden në pikën (i), ajo vlerë do të ri klasifikohet nga rezerva e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1) në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave flukset e mjeteve monetare të ardhshme që pritet të mbulohen kanë ndikim në fitim ose humbje (për shembull, në periudha në të cilat të ardhurat nga interesi ose shpenzimet për interesa njihen ose kur ndodh një shitje e parashikueshme).
 - (iii) megjithatë, nëse kjo vlerë është një humbje dhe njësia ekonomike gjykon që e gjithë humbja ose një pjesë e saj nuk do të rikuperohet në një ose disa periudha të ardhshme, menjëherë do ta ri klasifikojë vlerën që mendohet që s'mund të rikuperohet në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1).

6.5.12 Kur një njësi ekonomike ndërpret kontabilitetin mbrojtës për një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare (shih paragrafët 6.5.6 dhe 6.5.7 (b)) ajo do të kontabilizojë shumën që është akumuluar në rezervën e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare në përputhje me paragrafin 6.5.11 (a) si më poshtë:

- (a) nëse flukset e mjeteve monetare të ardhshme të mbrojtura pritet ende që të ndodhin, ajo vlerë do të mbetet në rezervën e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare deri në momentin kur ndodhin flukset e mjeteve monetare të ardhshme ose kur zbatohet paragrafi 6.5.11(d)(iii). Kur shfaqen flukset e mjeteve monetare të ardhshme, zbatohet paragrafi 6.5.11(d).
- (b) nëse flukset e mjeteve monetare të ardhshme të mbrojtura nuk pritet që të ndodhin më, ajo vlerë do të ri klasifikohet menjëherë nga rezerva e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1). Një fluks mjetesh monetare të ardhshme i mbrojtur që nuk ka më probabilitet të lartë që të ndodhë, përsëri mund të pritet që të ndodhë.

Mbrojtjet e një Investimi Neto në një Operacion të huaj

6.5.13 Mbrojtjet e një Investimi neto në një operacion të huaj, duke përfshirë mbrojtjen e një zëri monetar që do të trajtohet si pjesë e investimit neto (shih SNK 21), do të trajtohen në mënyrë të ngjashme për mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare:

- (a) pjesa e fitimit neto ose e humbjes në instrumentin mbulues që është përcaktuar për të qenë një mbrojtje efektive do të njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse (shih paragrafin 6.5.11); dhe

(b) pjesa jo efektive do të njihet në fitim ose humbje.

6.5.14 Fitimi ose humbja kumulative në instrumentin mbulues që lidhet me pjesën efektive të mbrojtjes që është akumuluar në rezervën e përkthimit të monedhës së huaj do të ri klasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1) në përputhje me paragrafët 48-49 të SNK 21 për nxjerrjen jashtë përdorimit ose nxjerrjen e pjesshme jashtë përdorimit të operacionit të kryer jashtë vendit.

Kontabiliteti për vlerën në kohë të opsioneve

6.5.15 Kur një njësi ekonomike e ndan vlerën e perceptuar dhe vlerën në kohë të një kontrate opsioni dhe përcakton si instrument mbulues vetëm ndryshimin në vlerën e perceptuar të opsionit (shih paragrafin 6.2.4(a)), kjo njësi ekonomike duhet ta trajtojë vlerën në kohë të opsionit si më poshtë (shih paragrafin B6.5.29-B6.5.33):

- (a) një njësi ekonomike do ta ndajë vlerën në kohë të opsionit nga lloji i elementit të mbrojtur që ky opsion mbulon (shih paragrafin B6.5.29):
- (i) një element i mbrojtur që lidhet me transaksionin; ose
 - (ii) një element i mbrojtur që lidhet me periudhën kohore;
- (b) ndryshimi në vlerën e drejtë të vlerës në kohë të një opsioni që mbron një element të mbrojtur që lidhet me transaksionin, do të njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse në atë masë që ai lidhet me elementin e mbrojtur dhe do të akumulohet në një përbërës kapitali të veçantë. Ndryshimi i akumuluar në vlerën e drejtë që rrjedh nga vlera në kohë e opsionit që është akumuluar në një përbërës kapitali të veçantë ('shuma') do të trajtohet si më poshtë:
- (i) në qoftë se elementi i mbrojtur do të rezultojë më pas në njohjen e një aktivi jo-financiar ose një detyrimi jo-financiar, ose në një angazhim të përcaktuar për një aktiv apo detyrim jo-financiar për të cilin zbatohet kontabiliteti mbrojtës me vlerën e drejtë, njësia ekonomike duhet ta heqë vlerën nga përbërësi i veçantë i kapitalit dhe ta përfshijë atë drejtpërdrejtë në koston fillestare ose në një vlerë tjetër kontabël (neto) të aktivit apo detyrimit. Ky nuk është një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1) kështu që ai nuk ndikon në të ardhura të tjera përmbledhëse.
 - (ii) për marrëdhëniet mbrojtëse të ndryshme nga ato që përmenden në pikën (i), kjo vlerë do të riklasifikohet nga përbërësi i veçantë i kapitalit në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1) në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave flukset e mjeteve monetare të ardhshme që pritet të mbuloohen kanë ndikim në fitim ose humbje (për shembull, kur ndodh një shitje e parashikuar).
 - (iii) megjithatë, nëse e gjithë vlera ose një pjesë e saj nuk pritet që të rikuperohet në një ose me shumë periudha të ardhshme, ajo vlerë që mund të mos rikuperohet do të riklasifikohet menjëherë në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1).
- (c) ndryshimi në vlerën e drejtë të vlerës në kohë të një opsioni që mbron një element të mbrojtur që lidhet me periudhën kohore, do të njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse në atë masë që ai lidhet me elementin e mbrojtur dhe do të akumulohet në një përbërës kapitali të veçantë. Vlera në kohë në datën e përcaktimit të opsionit si një instrument mbulues, në atë masë që ai lidhet me elementin e mbrojtur, do të amortizohet mbi baza sistematike dhe racionale në periudhën gjatë të cilës rregullimi mbrojtës për vlerën e perceptuar të opsionit mund të ndikojë në fitimin ose humbjen (ose në të ardhura të tjera përmbledhëse, nëse elementi i mbrojtur është një instrument kapitali neto për të cilin njësia ekonomike ka zgjedhur që të pasqyrojë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5). Kështu që, në çdo periudhë raportimi, vlera e amortizimit do të riklasifikohet nga përbërësi i veçantë i kapitalit në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1). Megjithatë, në qoftë se kontabiliteti mbrojtës ndërpritet për marrëdhënien mbrojtëse që përfshin ndryshimin në vlerën e perceptuar të opsionit si instrument mbulues, vlera neto (që përfshin edhe amortizimin kumulativ) që është akumuluar në përbërësin e veçantë të kapitalit do të riklasifikohet menjëherë në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1).

Kontabiliteti për elementin e ardhshëm të kontratave të ardhshme dhe shpërndarja e bazës së monedhës së huaj të instrumenteve financiare

- 6.5.16 Kur një njësi ekonomike e veçon elementin e ardhshëm nga elementi i çastit të një kontrate të ardhshme dhe përcakton si instrument mbulues vetëm ndryshimin në vlerën e elementit të çastit të kontratës së ardhshme, ose kur një njësi ekonomike e veçon shpërndarjen e bazës së monedhës së huaj nga një instrument financiar dhe e përjashton atë nga përcaktimi i atij instrumenti financiar si instrument mbulues (shih paragrafin 6.2.4(b)), njësia ekonomike mund të zbatojë paragrafin 6.5.15 për elementin e ardhshëm të kontratës së ardhshme ose për shpërndarjen e bazës së monedhës së huaj, në të njëjtën mënyrë që zbatohet për vlerën në kohë të një opsioni. Në këtë rast, njësia ekonomike do të zbatojë udhëzimet e zbatimit në paragrafët B6.5.34-B6.5.39.

6.6 Mbulimi i një grupi zërash

Përshtatshmëria e një grupi zërash si element i mbrojtur

- 6.6.1 Një grup zërash (duke përfshirë edhe një grup zërash që përbëjnë një pozicion neto; shih paragrafët B6.6.1-B6.6.8) janë një zë i përshtatshëm mbrojtës vetëm nëse:
- (a) përbëhet nga zëra (përfshirë edhe përbërës zërash) që janë, individualisht, zërat e përshtatshëm të mbrojtur;
 - (b) zërat në grup menaxhohen së bashku si grup për sa i përket menaxhimit të rrezikut; dhe
 - (c) në rastin e një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare të një grupi zërash, luhatjet në flukset e mjeteve monetare të të cilave nuk pritet që të jenë me përafërsi në proporcion me luhatjet e përgjithshme në flukset e mjeteve monetare të grupit dhe që në këtë mënyrë shfaqet rreziku i kompensimit:
 - (i) është një mbrojtje nga rreziku i kursit të këmbimit; dhe
 - (ii) përcaktimi i atij pozicioni neto specifikon periudhën e raportimit në të cilën transaksionet parashikuese pritet që të ndikojnë në fitim ose humbje, po ashtu edhe natyra dhe volumi i tyre (shih paragrafët B6.6.7-B6.6.8).

Përcaktimi i një përbërësi të një vlere nominale

- 6.6.2 Një përbërës që është pjesë e një grupi zërash, është një zë i përshtatshëm i mbrojtur me kusht që përcaktimi i tij si i tillë është në përputhje me objektivin e menaxhimit të rrezikut të njësisë ekonomike.
- 6.6.3 Një përbërës shtresor i një grupi të plotë zërash (për shembull, një komponent i shtresës së poshtme) është i përshtatshëm për kontabilitetin mbrojtës vetëm nëse:
- (a) është i identifikueshëm veças dhe i matshëm me besueshmëri;
 - (b) objektivi i menaxhimit të rrezikut është që të mbrojë një përbërës shtresor;
 - (c) zërat në grupin e plotë nga i cili identifikohet kjo shtresë, janë të ekspozuar ndaj të njëjtit rrezik të mbrojtur (kështu që matja e shtresës së mbrojtur nuk është ndikuar ndjeshëm nga fakti që zëra të veçantë të grupit të plotë janë pjesë e shtresës së mbrojtur);
 - (d) për një mbrojtje të zërave ekzistues (për shembull, një angazhim i përcaktuar i panjohur ose një aktiv i njohur) një njësi ekonomike mund të identifikojë dhe të ndjekë grupin e plotë të zërave nga i cili është përcaktuar shtresa e mbrojtur (në këtë mënyrë njësia ekonomike është në gjendje që të përmbushë kërkesat për kontabilitetin për marrëdhëniet mbrojtëse kualifikuese); dhe
 - (e) secili nga zërat në grup që përmban opsionet e parapagimit plotëson kërkesat për të qenë përbërës i vlerës nominale (shih paragrafin B6.3.20).

Paraqitja

- 6.6.4 Për mbrojtjen e një grupi zërash që mbajnë pozicionin e rrezikut të kompensimit (d.m.th. në një mbrojtje të një pozicioni neto), rreziku i mbrojtur i të cilit ka ndikim në nën zëra të ndryshëm në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në të ardhura të tjera përmbledhëse, çdo fitim ose humbje e mbrojtur në atë pasqyrë do të pasqyrohet në një linjë të ndryshme nga ato që ndikohen nga elementet e mbrojtur. Kështu që, në këtë pasqyrë vlera e nën zërit që lidhet me vetë elementin e mbrojtur (për shembull, të ardhurat ose kostoja e shitjeve) mbetet e pandikuar.
- 6.6.5 Për aktivet dhe detyrimet që mbulohen së bashku si grup në një mbrojtje me vlerën e drejtë, fitimi neto ose humbja në pasqyrën e pozicionit financiar për aktivet dhe detyrimet individuale do të njihet si një rregullim i vlerës kontabël (neto) të zërave individuale përkatës që përbëjnë grupin në përputhje me paragrafin 6.5.8(b).

Pozicionet neto me vlerë zero

- 6.6.6 Kur elementi i mbrojtur është një grup që është pozicion neto zero (d.m.th. elementët e mbrojtur ndërmjet tyre e kompensojnë totalisht rrezikun që menaxhohet në bazë grupi), një njësie ekonomike i lejohet që ta përcaktojë këtë element në një marrëdhënie mbrojtëse që nuk ka në vetvete ndonjë instrument mbulues, me kusht që:
- mbulimi është pjesë e një strategjie të mbulimit të rrezikut neto që përsëritet, me anë të së cilës njësia ekonomike në mënyrë rutinë mbulon pozicione të reja të të njëjtit lloj me kalimin e kohës (për shembull, kur transaksionet lëvizin në periudhën kohore gjatë të cilës zbatohet mbrojtja);
 - pozicioni neto i mbuluar ndryshon në madhësi gjatë jetës së strategjisë së mbulimit të rrezikut neto që përsëritet dhe njësia ekonomike përdor instrumente mbulues të përshtatshëm për të mbuluar rrezikun neto (d.m.th. kur pozicioni neto nuk është zero);
 - kontabiliteti mbrojtës normalisht zbatohet në pozicione neto të tilla kur pozicioni neto nuk është zero dhe mbulohet nga instrumente mbulues të përshtatshëm; dhe
 - mos aplikimi i kontabilitetit mbrojtës në pozicionet neto zero do të çonte në rezultate të papajtueshme të kontabilitetit, sepse kontabiliteti nuk do t'i njihë pozicionet e rrezikut të kompensimit që në rast të kundërt do të njiheshin në një mbulim të pozicionit neto.

6.7 Opsioni për të caktuar një ekspozim ndaj rreziqeve të kreditimit të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Përshtatshmëria e ekspozimit ndaj rreziqeve të kreditimit për përcaktimin si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

- 6.7.1 Nëse një njësi ekonomike përdor një derivativ kreditor që matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes për të menaxhuar rrezikun e kredisë të një instrumenti financiar në tërësi ose të një pjese të tij (ekspozim ndaj rreziqeve të kreditimit), kjo njësi ekonomike mund ta caktojë atë instrument financiar në atë masë që është i menaxhueshëm (d.m.th. i gjithë instrumenti ose një pjesë e tij) i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nëse:
- emri i ekspozimit ndaj rreziqeve të kreditimit (për shembull, huamarrësi, ose zotëruesi i një angazhimi për huadhënie) i referohet njësisë ekonomike të derivativit kreditor ('përputhje emri'); dhe
 - vjetërsia e instrumenteve financiare përputhet me atë të instrumenteve që mund të paraqiten në përputhje me derivativin kreditor.

Një njësi ekonomike mund ta bëjë këtë përcaktim pavarësisht nga fakti nëse instrumenti financiar që menaxhohet për rrezikun e kredisë është brenda objektit të këtij Standardi apo jo (për shembull, një njësi ekonomike mund të përcaktojë angazhime për hua që janë jashtë objektit të këtij Standardi). Njësi ekonomike mund ta caktojë këtë instrument financiar në njohjen fillestare ose më pas, ose kur ai është i panjohur. Njësi ekonomike do ta dokumentojë përcaktimin njëkohësisht.

Kontabiliteti për ekspozimin ndaj rreziqeve të kreditimit i përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

- 6.7.2 Nëse një instrument financiar është i përcaktuar në përputhje me paragrafin 6.7.1, i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes pas njohjes fillestare të tij, ose nëse ka qenë i panjohur më parë, diferenca në momentin e përcaktimit midis vlerës kontabël (neto), nëse ka dhe vlerës së drejtë, do të njihet menjëherë në fitim ose humbje. Për aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2A, fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më parë në ardhurat e tjera përmbledhëse duhet menjëherë të rriklasifikohet nga kapitali neto tek fitimi ose humbja si një rregullim rriklasifikimi (shih SNK1).
- 6.7.3 Një njësi ekonomike do të ndërpresë matjen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes të instrumentit financiar që solli rrezikun e kredisë, ose një pjesë të atij instrumentit financiar, nëse:
- (a) nuk përmbushen më kriteret e kualifikimit në paragrafin 6.7.1, për shembull:
 - (i) derivativi kreditor ose instrumenti financiar përkatës nga i cili rrjedh rreziku i kredisë, skadon ose shitet, ndërpritet ose shlyhet; ose
 - (ii) rreziku i kredisë i instrumentit financiar nuk menaxhohet më duke përdorur derivativat kreditorë. Për shembull, kjo mund të ndodhë për shkak të përmirësimeve në cilësinë e kredisë të huamarrësit, ose zotëruesit të angazhimit për hua, ose ndryshimeve në kërkesat e kapitalit që i janë ngarkuar njësisë ekonomike; dhe
 - (b) instrumenti financiar që sjell rrezikun e kredisë nuk është e nevojshme që të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (d.m.th. modeli i biznesit i njësisë ekonomike nuk ka ndryshuar gjatë kësaj kohe, në mënyrë që të jetë e nevojshme të bëhet një rriklasifikim në përputhje me paragrafin 4.4.1).
- 6.7.4 Kur një njësi ekonomike ndërpret matjen e instrumentit financiar, ose të një pjese të instrumentit financiar, që sjell rrezikun e kredisë, me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlera e drejtë e atij instrumentit financiar në datën e ndërprerjes bëhet vlera kontabël (neto) e re e tij. Rrjedhimisht, e njëjta matje që është përdorur para përcaktimit të instrumentit financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes do të vazhdojë të zbatohet (duke përfshirë edhe amortizimin që rezulton nga vlera kontabël (neto) e re). Për shembull, një aktiv financiar që është klasifikuar që nga fillimi si i matur me koston e amortizuar do të rikthehet në këtë metodë matjeje dhe norma e interesit efektiv të tij do të rillogaritet bazuar në vlerën kontabël të re të tij në datën e ndërprerjes së matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Kapitulli 7 Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

7.1 Data e hyrjes në fuqi

- 7.1.1 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2018 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zgjedh që të zbatojë këtë Standard ajo duhet që të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe në të njëjtën kohë të zbatojë të gjitha kërkesat në këtë Standard (shih gjithashtu dhe paragrafët 7.1.2, 7.1.21 dhe 7.3.2). Ajo duhet gjithashtu, në të njëjtën kohë të zbatojë dhe ndryshimet në Shtojcën C.
- 7.1.2 Pavarësisht kërkesave në paragrafin 7.1.1, për periudhat raportuese që fillojnë përpara 1 Janarit 2018, një njësi ekonomike mund të zgjedhë që të zbatojë kërkesat për paraqitjen e fitimeve dhe humbjeve mbi detyrimet financiare të përcaktuar si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në paragrafët 5.7.1(c), 5.7.7-5.7.9, 7.2.12 dhe B5.7.5-B5.7.20 pa aplikuar kërkesat e tjera në këtë Standard. Nëse një njësi ekonomike zgjedh që të zbatojë vetëm paragrafët më sipër, ajo duhet të japë informacion shpjegues mbi këtë fakt dhe duhet të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme dhënien e informacioneve shpjeguese të përcaktuara në paragrafët 10-11 të SNRF 7 (ndryshuar me SNRF 9, (2010)). (Shih gjithashtu paragrafët 7.2.2 dhe 7.2.15.)
- 7.1.3 *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012*, të publikuara në Dhjetor 2013, paragrafët 4,2,1 dhe 5,7,5 janë ndryshuar si një ndryshim i mëpasshëm që rrjedh nga ndryshimet e SNRF 3. Një njësi ekonomike do të aplikojë në mënyrë retrospektive këtë ndryshim tek kombinimet e bizneseve për të cilat aplikohet SNRF 3.
- 7.1.4 SNRF 15, e publikuar në Maj 2014, ka ndryshuar paragrafët 3.1.1, 4.2.1, 5.1.1, 5.2.1, 5.7.6, B3.2.13, B5.7.1, C5 dhe C42 dhe ka fshirë paragrafin C16 me gjithë titullin që lidhet me të. Janë shtuar paragrafët

- 5.1.3 dhe 5.7.1A, dhe një përcaktim për Shtojcën A. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 15.
- 7.1.5 SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafët 2.1, 5.5.15, B3.8, B5.5.34 dhe B5.5.46. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.
- 7.1.6 SNRF 17, i publikuar në Maj 2017, ndryshoi paragrafët 2.1, B2.1, B2.4, B2.5 dhe B4.1.30 si dhe shtoi paragrafin 3.3.5. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 17.
- 7.1.7 *Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ* (Ndryshime të SNRF 9) publikuar në Tetor 2017, ka shtuar paragrafët 7.2.29-7.2.34 dhe B4.1.12A dhe janë ndryshuar paragrafët B4.1.11(b) dhe B4.1.12(b). Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2019. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

7.2 Periudha kalimtare

- 7.2.1 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive, në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, me përjashtim të asaj që është specifikuar në paragrafët 7.2.4-7.2.26 dhe 7.2.28. Ky Standard nuk do të zbatohet për zërat që janë çregjistruar në datën e zbatimit fillestar.
- 7.2.2 Për qëllimet e provizioneve të periudhës kalimtare në paragrafët 7.2.1, 7.2.3-7.2.28 dhe 7.2.3, data e zbatimit fillestar është data kur një njësi ekonomike zbaton për herë të parë kërkesat e këtij Standardi dhe duhet të jetë fillimi i një periudhe raportimi pas daljes së këtij Standardi. Në varësi të zgjedhjes së njësies ekonomike për të aplikuar SNRF 9, periudha kalimtare mund të përfshijë një ose disa data të zbatimit fillestar për kërkesa të ndryshme.

Periudha kalimtare për riklasifikimin dhe matjen (Kapitulli 4 dhe 5)

- 7.2.3 Në datën e zbatimit fillestar, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse një aktiv financiar plotëson kushtet në paragrafin 4.1.2(a) ose 4.1.2A(a) në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në këtë datë. Klasifikimi përfundimtar do të zbatohet në mënyrë retrospektive pavarësisht nga modeli i biznesit të njësies ekonomike në periudhat e mëparshme raportuese.
- 7.2.4 Në qoftë se në datën e zbatimit fillestar, është e pamundur (siç përcaktohet në SNK 8) për një njësi ekonomike të vlerësojë një element të ndryshuar të vlerës në kohë të parësë në përputhje me paragrafët B4.1.9B-B4.1.9D mbi bazën e fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë karakteristikat e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të atij aktivitetit financiar në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në momentin e njohjes fillestare të aktivitetit financiar pa marrë në konsideratë kërkesat që lidhen me ndryshimin e elementit të vlerës në kohë të parësë në paragrafët B4.1.9B - B4.1.9D. (Shih gjithashtu paragrafin 42R të SNRF 7.)
- 7.2.5 Në qoftë se në datën e zbatimit fillestar, është e pamundur (siç përcaktohet në SNK 8) për një njësi ekonomike të vlerësojë nëse vlera e drejtë e një artikulli të parapaguar ka qenë dukshëm në mospërputhje me paragrafin B4.1.12(c) mbi bazën e fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë karakteristikat e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të atij aktivitetit financiar në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në momentin e njohjes fillestare të aktivitetit financiar pa marrë në konsideratë përjashtimin për artikullin e parapaguar në paragrafin B4.1.12. (Shih gjithashtu paragrafin 42S të SNRF 7.)
- 7.2.6 Nëse një njësi ekonomike mat një kontratë hibride me vlerën e drejtë, në përputhje me paragrafët 4.1.2A, 4.1.4 ose 4.1.5, por vlera e drejtë e kontratës hibride nuk është matur në periudhat krahasuese të raportimit, vlera e drejtë e kontratës hibride në periudhat krahasuese të raportimit do të jetë shumica e vlerave të drejta të përbërësve (d.m.th instrumentet bazë jo derivativë dhe derivativët e përfshirë) në fund të çdo periudhe raportimi krahasuese në qoftë se njësia ekonomike riparaqet periudhat raportuese të mëparshme (shih paragrafin 7.2.15).
- 7.2.7 Në qoftë se një njësi ekonomike ka aplikuar paragrafin 7.2.6 atëherë në datën e zbatimit fillestar njësia ekonomike duhet të njohë çdo diferencë midis vlerës së drejtë të kontratës hibrid të plotë në datën e zbatimit fillestar dhe shumës së vlerës së drejtë të përbërësve të kontratës hibrid në datën e zbatimit fillestar në tepriçën e çeljes së fitimeve të pashpërndara (ose tek përbërës të tjerë të kapitalit neto, siç mund të jetë më e përshtatshme) të periudhës raportues që përfshin datën e zbatimit fillestar.
- 7.2.8 Në datën e zbatimit fillestar një njësi ekonomike mund të përcaktojë:

- (a) një aktiv financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 4.1.5; ose
- (b) një investim në instrument kapitali neto si një instrument me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5.

Një përcaktim i tillë do të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

7.2.9 Në datën e zbatimit fillestar një njësi ekonomike:

- (a) do të anulohet përcaktimin e mëparshëm të një aktivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në qoftë se ky aktiv financiar nuk plotëson kushtet në paragrafin 4.1.5.
- (b) mund të anulohet përcaktimin e mëparshëm të një aktivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në qoftë se ky aktiv financiar i plotëson kushtet në paragrafin 4.1.5.

Anulime të tilla do të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

7.2.10 Në datën e zbatimit fillestar, një njësi ekonomike:

- (a) mund të caktojë një detyrim financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 4.2.2(a).
- (b) do të anulohet përcaktimin e saj të mëparshëm të një detyrimi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim është bërë në njohjen fillestare në përputhje tani me kushtin në paragrafin 4.2.2(a) dhe ky përcaktim nuk e përmbush këtë kusht në datën e zbatimit fillestar.
- (c) mund të anulohet përcaktimin e saj të mëparshëm të një detyrimi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim është bërë në njohjen fillestare në përputhje tani me kushtin në paragrafin 4.2.2(a) dhe ky përcaktim e përmbush këtë kusht në datën e zbatimit fillestar.

Ky përcaktim dhe anulim i tij do të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

7.2.11 Në qoftë se është e pazbatueshme (siç përcaktohet në SNK 8) për një njësi ekonomike të zbatohet në mënyrë retrospektive efektet e metodës së interesit efektiv, njësi ekonomike do të trajtojnë:

- (a) vlerën e drejtë të aktivit financiar ose detyrimit financiar në fund të çdo periudhe krahasuese të pasqyruar si vlera bruto kontabël e atij aktivi financiar ose kostoja e amortizuar e atij detyrimi financiar, në qoftë se njësi ekonomike riparaqet periudhat e mëparshme; dhe
- (b) vlerën e drejtë të aktivit ose detyrimit financiar në datën e zbatimit fillestar, si kostoja bruto kontabël e re e atij aktivi financiar ose kostoja e re e amortizuar e atij detyrimi financiar në datën e zbatimit fillestar të këtij Standardi.

7.2.12 Nëse një njësi ekonomike ka kontabilizuar më parë me kosto, në përputhje me SNK 39, një investim në një instrument kapitali neto, që nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument të njëjtit (d.m.th. një input të Nivelit 1) (ose një aktiv derivativ që është i lidhur dhe duhet të shlyhet duke dhënë një instrument të tillë kapitali neto), ajo do ta masë këtë instrument me vlerën e drejtë në datën e zbatimit fillestar. Çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës së drejtë do të njihet në fitimet e pashpërndara (ose në përbërës të tjerë të kapitaleve neto, siç mund të jetë më e përshtatshme) në periudhën raportuese që përfshin datën e zbatimit fillestar.

7.2.13 Nëse një njësi ekonomike ka kontabilizuar më parë me kosto, në përputhje me SNK 39, një detyrim derivativ, që është i lidhur dhe duhet të shlyhet duke dhënë një instrument kapitali neto, që nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument të njëjtit (d.m.th. një input të Nivelit 1), ajo do ta matë këtë detyrim derivativ me vlerën e drejtë në datën e zbatimit fillestar. Çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës së drejtë do të njihet në fitimet e pashpërndara në çelje të periudhës raportuese që përfshin datën e zbatimit fillestar.

7.2.14 Në datën e zbatimit fillestar, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse trajtimi sipas paragrafit 5.7.7 do të krijonte ose zgjeronte një mospërputhje kontabël në fitimin ose humbjen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar. Ky Standard do të zbatohet në mënyrë retrospektive mbi bazën e këtij përcaktimi.

- 7.2.14A Kur ky paragraf zbatohet për herë të parë, një njësi ekonomike lejohet që të bëjë përcaktimin e futur nga ky paragraf për kontratat që janë në fuqi në këtë datë, por vetëm nëse ai përcakton të gjitha kontratat e tilla. Ndryshimi në aktivet neto që rezultojnë nga të tilla paraqitje do të njihen tek fitimi i pashpërndarë në datën e zbatimit fillestar.
- 7.2.15 Pavarësisht kërkesave të paragrafit 7.2.1, një njësi ekonomike që zbaton kërkesat e riklasifikimit dhe të matjes të këtij Standardi (i cili përfshin kërkesat në lidhje me matjen e aktiveve financiare sipas kostos së amortizuar dhe me zhvlerësimin në Seksionin 5.4 dhe 5.5) duhet të japë informacione shpjeguese sipas paragrafëve 42L-42O të SNRF 7 por nuk ka nevojë të riparaqesë periudhat e mëparshme. Njësia ekonomike mund të riparaqesë periudhat e mëparshme nëse, dhe vetëm nëse, është e mundur pa përdorimin e gjykimit retrospektiv. Nëse një njësi ekonomike nuk riparaqet periudhat e mëparshme, ajo do të njohë çdo diferencë midis vlerës kontabël (neto) të mëparshme dhe vlerës kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese vjetore që përfshin datën e zbatimit fillestar, në fitimet e pashpërndara të çeljes (ose përbërës tjetër të kapitalit neto, si të jetë më përshtatshme) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar. Megjithatë, nëse një njësi ekonomike riparaqet periudhat e mëparshme, pasqyrat financiare të ri paraqitura duhet të pasqyrojnë të gjitha kërkesat në këtë Standard. Në qoftë se përjasja që ka zgjedhur një njësi ekonomike për zbatimin e SNRF 9 rezultojnë në më shumë se një datë të zbatimit fillestar për kërkesa të ndryshme, ky paragraf zbatohet në çdo datë të zbatimit fillestar (shih paragrafin 7.2.2). Ky do të jetë rasti, për shembull, në qoftë se një njësi ekonomike ka zgjedhur të zbatojë më herët vetëm kërkesat për paraqitjen e fitimeve dhe humbjeve në detyrimet financiare të përcaktuara si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 7.1.2 përpara zbatimit të kërkesave të tjera të këtij Standardi.
- 7.2.16 Nëse një njësi ekonomike përgatit raporte financiare të ndërmjetme në përputhje me SNK 34 *Raportimi Financiar i Ndërmjetëm*, nuk është e nevojshme që ajo të zbatojë kërkesat në këtë Standard për periudhat e ndërmjetme para datës së zbatimit fillestar, nëse është i pazbatueshëm (siç përcaktohet në SNK 8).

Zhvlerësimi (Seksioni 5.5)

- 7.2.17 Një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit në nenin 5.5 në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 sipas paragrafëve 7.2.15 dhe 7.2.18-7.2.20.
- 7.2.18 Në datën e zbatimit fillestar, një njësi ekonomike do të përdorë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme për të përcaktuar rrezikun e kredisë në datën që një instrument financiar është njohur fillimisht (ose për angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare në datën që njësia ekonomike u bë palë në angazhimin e parevokueshme, në përputhje me paragrafin 5.5.6) dhe të krahasojë atë ndaj rrezikut të kredisë në datën e zbatimit fillestar të këtij Standardi.
- 7.2.19 Kur bëhet përcaktimi nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që prej njohjes fillestare, një njësi ekonomike mund të zbatojë:
- kërkesat në paragrafët 5.5.10 dhe B5.5.22 - B5.5.24; dhe
 - hipotezën e kundërshtueshme në paragrafin 5.5.11 për pagesat kontraktuale që janë më shumë se 30 ditë me vonesë në qoftë se një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit duke identifikuar rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare e këtyre instrumenteve financiare mbi bazën e informacionit që i ka kaluar afati.
- 7.2.20 Nëse, në datën e zbatimit fillestar, përcaktimi nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare do të kërkonte kosto apo përpjekje të panevojshme, një njësi ekonomike do të njohë një kompensim për humbjen në një shumë të barabartë me humbjen e parashikuar të kredisë përgjatë jetës në çdo datë raportimi derisa ai instrument financiar të çregjistrohet (përveç kur ai instrument financiar është me rrezik të ulët të kredisë në një datë të raportimit, rast në të cilin zbatohet paragrafi 7.2.19 (a)).

Periudha kalimtare për kontabilitetin mbrojtës (Kapitulli 6)

- 7.2.21 Kur një njësi ekonomike zbaton për herë të parë këtë Standard, ajo mund të vendosë si politikë kontabël të saj që të vazhdojë të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në SNK 39 në vend të kërkesave në Kapitullin 6 të këtij Standardi. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë politikë për të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse të saj. Një njësi ekonomike që vendos të zbatojë këtë politikë, gjithashtu do të zbatojë KIRFN 16 *Mbrojtjet e një Investimi neto në një operacion të huaj*, pa ndryshimet që e përshtatin këtë Interpretim me kërkesat në Kapitullin 6 të këtij Standardi.
- 7.2.22 Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 7.2.26, një njësi ekonomike duhet të zbatojë në mënyrë prospektive kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në këtë Standard.

- 7.2.23 Në mënyrë që të zbatohet kontabiliteti mbrojtës që nga data e zbatimit fillestar të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës në këtë Standard, duhet të plotësohen të gjitha kriteret kualifikuese në këtë datë.
- 7.2.24 Marrëdhëniet mbrojtëse që janë kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës në përputhje me SNK 39 dhe që gjithashtu kualifikohen për kontabilitetin mbrojtës në përputhje me kriteret e këtij Standardi (shih paragrafin 6.4.1), pas marrjes parasysh të çdo vendosje rishtas në ekuilibër të marrëdhënies mbrojtëse në periudhën kalimtare (shih paragrafin 7.2.20(b)), do të konsiderohen si marrëdhënie mbrojtëse në vazhdim.
- 7.2.25 Në zbatimin fillestar të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi, një njësi ekonomike:
- mund të fillojë të vërë në zbatim ato kërkesa që nga momenti që ajo ndërpret zbatimin e kërkesave të kontabilitetit mbrojtës në SNK 39; dhe
 - do të marrë në konsideratë raportin e mbulimit në përputhje me SNK 39 si pikënisje për vendosjen rishtas në ekuilibër të raportit të mbulimit të një marrëdhënie mbrojtëse në vazhdim, nëse është e zbatueshme. Çdo fitim ose humbje që rezultojnë nga një vendosje rishtas në ekuilibër e tillë, do të njihet në fitim ose humbje.
- 7.2.26 Si një përjashtim për zbatimin në prospektivë të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi, një njësi ekonomike:
- do të zbatojë në mënyrë retrospektive kontabilitetin për vlerën në kohë të opsioneve në përputhje me paragrafin 6.5.15 në qoftë se, në përputhje me SNK 39, vetëm ndryshimi në vlerën e perceptuar të një opsioni është përcaktuar si një instrument mbulues në një marrëdhënie mbrojtëse. Ky zbatim retrospektiv zbatohet vetëm për ato marrëdhënie mbrojtëse që ekzistojnë që në fillim të periudhës më të hershme krahasuese ose janë caktuar pas kësaj.
 - mund të zbatojë në mënyrë retrospektive kontabilitetin për elementin e ardhshëm për kontratat e ardhshme në përputhje me paragrafin 6.5.16, në qoftë se, në përputhje me SNK 39, vetëm ndryshimi në elementin e çastit të një kontrate të ardhshme është përcaktuar si një instrument mbulues në një marrëdhënie mbrojtëse. Ky zbatim retrospektiv zbatohet vetëm për ato marrëdhënie mbrojtëse që ekzistojnë që në fillim të periudhës më të hershme krahasuese ose janë caktuar pas kësaj. Përveç kësaj, nëse një njësi ekonomike zgjedh zbatimin retrospektiv të këtij kontabiliteti, ai do të zbatohet për të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse që kualifikohen për këtë zgjedhje (d.m.th. në periudhë kalimtare ky përcaktim nuk mund të zbatohet në marrëdhënie mbrojtëse të marrëdhënies mbrojtëse). Kontabiliteti për shpërndarjen e bazës së monedhës së huaj (shih paragrafin 6.5.16) mund të zbatohet në mënyrë retrospektive për ato marrëdhënie mbrojtëse që ekzistojnë që në fillim të periudhës më të hershme krahasuese ose janë caktuar pas kësaj.
 - do të zbatojë në mënyrë retrospektive kërkesën në paragrafin 6.5.6 që nuk ka skadim apo ndërprerje të afatit të instrumentit mbulues, nëse:
 - si pasojë e ligjeve apo rregulloreve apo futjes së ligjeve ose rregulloreve, palët e instrumentit mbulues janë dakord që një ose më shumë prej palëve të tjera të kleringut të zëvendësojnë palën tjetër fillestare të tyre për t'u bërë palë tjetër e re në secilën prej palëve; dhe
 - ndryshime të tjera, nëse ka ndonjë, në instrumentin mbrojtës kufizohen në ato që janë të nevojshme për bërë një zëvendësim të tillë të palës tjetër.

Njësitë ekonomike që i kanë aplikuar herët SNRF 9 (2009) SNRF 9 (2010) ose SNRF 9 (2013) aplikimi i hershëm

- 7.2.27 Një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e periudhës kalimtare në paragrafët 7.2.1-7.2.26 në datën përkatëse të zbatimit fillestar. Një njësi ekonomike do të zbatojë secilin nga provizionet e periudhës kalimtare në paragrafët 7.2.3-7.2.14 dhe 7.2.17-7.2.26 vetëm një herë (d.m.th. nëse një njësi ekonomike vendos të zbatojë SNRF 9 që përfshin më shumë se një datë të zbatimit fillestar, ajo nuk mund të zbatojë ndonjë nga ato provizione nëse i ka zbatuar më herët). (Shih gjithashtu paragrafët 7.2.2 dhe 7.3.2.)
- 7.2.28 Një njësi që ka aplikuar SNRF 9 (2009), SNRF 9 (2010) ose SNRF 9 (2013) dhe më pas zbaton këtë Standard:
- do të anulojë përcaktimin e saj të mëparshëm të një aktivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë është bërë në përputhje me kushtin në paragrafin 4.1.5 por që ky kusht nuk përmbushet më si rezultat i aplikimit të këtij Standardi;
 - mund të përcaktojë një aktivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë nuk ka përmbushur kushtin në paragrafin 4.1.5 por që ky kusht përmbushet tani si rezultat i aplikimit të këtij Standardi;

- (c) do të anulohet përcaktimin e saj të mëparshëm të një detyrimi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë është bërë në përputhje me kushtin në paragrafin 4.2.2 por që ky kusht nuk përmbushet më si rezultat i aplikimit të këtij Standardi; dhe
- (d) mund të përcaktojë një detyrim financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë nuk ka përmbushur kushtin në paragrafin 4.2.2 por që ky kusht përmbushet tani si rezultat i aplikimit të këtij Standardi;

Ky përcaktim dhe anulim i tij do të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar të këtij Standardi. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

Periudha kalimtare për Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ

- 7.2.29 Një njësi ekonomike do të zbatojë *Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ* (Ndryshimet në SNRF 9) në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8, përveçse siç përcaktohet në paragrafët 7.2.30-7.2.34.
- 7.2.30 Një njësi ekonomike që zbaton këto ndryshime dhe njëkohësisht këtë Standard për herë të parë, zbaton paragrafët 7.2.1-7.2.28 në vend të paragrafëve 7.2.31-7.2.34.
- 7.2.31 Një njësi ekonomike që zbaton këto ndryshime për herë të parë pasi ajo ka zbatuar më parë këtë Standard do të zbatojë paragrafët 7.2.32-7.2.34. Gjithashtu njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e tjera të periudhës kalimtare në këtë Standard të nevojshme për zbatimin e këtyre ndryshimeve. Për këtë qëllim, referencat për datën e aplikimit fillestar do të lexohen duke iu referuar fillimit të periudhës raportuese në të cilën një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime (data e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve).
- 7.2.32 Në lidhje me përcaktimin e një aktivi financiar ose detyrimi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes një njësi ekonomike:
- (a) do të anulohet përcaktimin e saj të mëparshëm të një aktivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë është bërë në përputhje me kushtin në paragrafin 4.1.5 por si rezultat i aplikimit të këtyre ndryshimeve ky kusht nuk përmbushet më ;
 - (b) mund të përcaktojë një aktiv financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë nuk ka përmbushur kushtin në paragrafin 4.1.5 por si rezultat i aplikimit të këtyre ndryshimeve që ky kusht përmbushet tani ;
 - (c) do të anulohet përcaktimin e saj të mëparshëm të një detyrimi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë është bërë në përputhje me kushtin në paragrafin 4.2.2(a) por si rezultat i aplikimit të këtyre ndryshimeve që ky kusht nuk përmbushet më ; dhe
 - (d) mund të përcaktojë një detyrim financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë nuk ka përmbushur kushtin në paragrafin 4.2.2(a) por si rezultat i aplikimit të këtyre ndryshimeve që ky kusht përmbushet tani ;

Një përcaktim dhe anulim i tillë, do të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

- 7.2.33 Një njësi ekonomike nuk është e detyruar të ri paraqesë periudhat e mëparshme për të reflektuar zbatimin e këtyre ndryshimeve. Njësi ekonomike mund të riparaqesë periudhat e mëparshme nëse dhe vetëm nëse kjo është e mundur pa përdorimin e gjykimit retrospektiv dhe pasqyrat financiare të riparaqitura reflektojnë të gjitha kërkesat e këtij Standardi. Nëse një njësi ekonomike nuk riparaqet periudhat e mëparshme, ajo do të njohë çdo diferencë midis vlerës kontabël (neto) të mëparshme dhe vlerës kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese vjetore që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve, në fitimet e pashpërdara në çelje (ose një përbërës tjetër më të përshatshëm të kapitalit neto) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve.
- 7.2.34 Në periudhën raportuese që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve, njësi ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm për secilën klasë të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që janë prekur në datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve:
- (a) kategorinë e mëparshme të matjes dhe vlerën kontabël të përcaktuar menjëherë para zbatimit të këtyre ndryshimeve;
 - (b) kategorinë e re të matjes dhe vlerën e mbartur të përcaktuar në përputhje me këto ndryshime;

- (c) vlerën kontabël të çdo aktivi financiar dhe detyrimi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar të përcaktuar dhe të matur paraprakisht me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, por që nuk janë më të përcaktuara si të tilla; dhe
- (d) arsyet për çdo përcaktim ose jo të aktiveve ose detyrimeve financiare si të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

7.3 Tërheqja e KIRFN 9, SNRF 9 (2009), SNRF 9 (2010) dhe SNRF 9 (2013)

- 7.3.1 Ky Standard zëvendëson KIRFN 9 *Rivlerësimi i Derivatëve të Përfshirë*. Kërkesat e shtuara në SNRF 9 në Tetor 2010 përfshijnë kërkesat e përcaktuara më parë në paragrafët 5 dhe 7 të KIRFN 9. Si ndryshim i mëpasshëm, SNRF 1 *Miratimi për Herë të Parë i SNRF-ve* ka përfshirë kërkesat e parashtruara më parë në paragrafin 8 të KIRFN 9.
- 7.3.2 Ky Standard zëvendëson SNRF 9 (2009), SNRF 9 (2010) dhe SNRF 9 (2013). Megjithatë, për periudha vjetore që fillojnë përpara datës 1 janar 2018, një njësi ekonomike mund të zgjedhë të zbatojë këto variantet e hershme të SNRF 9 në vend të zbatimit të këtij standardi nëse, dhe vetëm nëse, datë përkatëse e aplikimit fillestar të njësisë ekonomike është para datës 1 shkurt 2015.

Shtojca A Kushtet e përcaktuara

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

Humbjet e parashikuara 12 mujore të kredisë	Ajo pjesë e humbjeve të parashikuara të kredisë përgjatë gjithë jetës që përfaqëson humbjet e parashikuara të kredisë që rezultojnë nga ngjarje të mospagesës për një instrument financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.
kosto e amortizuar e një aktivi financiar ose detyrimi financiar	Vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference mes shumës fillestare dhe vlerës së maturuar dhe, për aktivet financiare, rregullimin për çdo humbje të zbritur .
aktive kontraktuale	Ato të drejta që SNRF 15 <i>Të ardhurat nga kontratat me klientë</i> përcakton të cilat trajtohen në përputhje me këtë Standard për qëllimet e njohjes dhe matjes së fitimeve ose humbjeve nga zhvlerësimi.
aktivet financiare me kreditit të çvlerësuar	<p>Një aktiv financiar është me kredit të çvlerësuar kur kanë ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset e mjeteve monetare të ardhshme të vlerësuar të atij aktivi financiar. Dëshmi që një aktiv financiar është me kredit të dëmtuar përfshijnë të dhëna të vëzhgueshme në lidhje me ngjarjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) vështirësi financiare domethënëse të emetuesit ose huamarrësit; (b) një shkelje e kontratës, të tilla si vonesa në pagesë ose ngjarje pas datës së pagesës; (c) huadhënësi(t), për arsye ekonomike ose ligjore që lidhen me vështirësinë financiare të huamarrësit, i japin huamarrësit një ose disa koncesione që huadhënësi(t) nuk do ti merrnin në konsideratë në kushte të tjera; (d) është bërë e mundshme që huamarrësi do të hyjë në proces falimentimi ose ndonjë riorganizim tjetër financiar; (e) zhdukja e një tregu aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare; ose ose (f) blerja ose krijimi i një aktivi financiar me një skontim të thellë që pasqyron humbjet e pësuar të kredisë. <p>Mund të mos jetë e mundur të identifikohet një ngjarje e vetme e veçantë-përkundrazi, efekti i kombinuar i një sërë ngjarjesh mund të ketë shkaktuar aktivet financiare për tu kthyer me kredit të çvlerësuar.</p>
humbja e kredisë	Diferenca në mes të të gjitha flukseve monetare kontraktuale që janë për tu paguar nga një njësi ekonomike, në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukseve të mjeteve monetare që njësi ekonomike pret të marrë (d.m.th të gjitha mungesat në para), të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv (ose me normën e interesit efektiv të rregulluar të kredisë për aktivet e blera apo krijuara si me kreditit të çvlerësuar). Një njësi ekonomike do të çmojë flukset e mjeteve monetare duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, parapagimin, zgjatjen, thirrjen dhe opsionet të ngjashme) përmes jetës së pritshme të atij instrumenti financiar. Flukset e mjeteve monetare që janë konsideruar do të përfshijë flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose aktiveve të tjera të mbajtura si garanci për kredinë e dhënë të cilat janë pjesë integrale kushteve kontraktuale. Ekziston një supozim se jeta e pritshme e një instrumenti financiar mund të matet në mënyrë të besueshme. Megjithatë, në ato raste të rralla kur nuk është e mundur të vlerësohet në mënyrë të besueshme jeta e pritshme e një instrumenti financiar, njësi ekonomike do të përdorë afatin kontraktuale të mbetur të instrumentit financiar.

norma e interesit efektiv të kredisë së rregulluar	Norma që skanton pagesat e ardhshme monetare ose arkëtimet gjatë jetës së pritshme të aktivit financiar për të arritur tek kosto e amortizuar e një aktivi financiar që është një aktiv financiar i blerë ose i krijuar me kredit të zhvlerësuar . Kur llogaritet norma efektive të interesit të kredisë së rregulluar, një njësi ekonomike do të çmojë flukset e pritshme të mjeteve monetare duke konsideruar të gjitha kushtet kontraktuale të aktivit financiar (për shembull, parapagimin, zgjatjen, thirrjen dhe opsionet e ngjashme) dhe humbjet pritshme të kredisë . Llogaritja përfshin të gjitha tarifatat dhe pikët e paguara ose të marra midis palëve të kontratës që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit (shih paragrafët B5.4.1-B5.4.3), kostot e transaksionit , dhe të gjitha primet ose zbritjet e tjera. Ekziston një supozim se flukset e mjeteve monetare dhe jeta e pritshme e një grupi instrumentesh financiarë të ngjashëm mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Megjithatë, në ato raste të rralla kur nuk është e mundur për të vlerësuar në mënyrë të besueshme flukset e mjeteve monetare ose jetën e mbetur të një instrumenti financiar (ose grup të instrumenteve financiare), njësi ekonomike do të përdorë flukset kontraktuale të mjeteve monetare gjatë afatit të plotë kontraktual të instrumentit financiar (ose grupi instrumentesh financiarë).
çregjistrimi	Heqja e një aktivi financiar ose detyrimi financiar të njohur më parë nga pasqyra e pozicionit financiar të një njësie ekonomike.
derivativ	Një instrument financiar ose kontratë tjetër brenda objektit të këtij Standardi që i ka të tre karakteristikat e mëposhtme. <ul style="list-style-type: none"> (a) vlera e tij ndryshon në vartësi të ndryshimit në një normë interesi të caktuar, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallrave, kursit të këmbimit të monedhës së huaj, indeksit të çmimeve ose të normave, klasifikimit të kredisë ose indeksit të kredisë, ose të variablave të tjerë, siç është rasti i një variabli jo-financiar që nuk është specifik për një palë të kontratës (që nganjëherë quhet ‘variabël bazë’). (b) nuk kërkohet investim fillestar neto ose një investim fillestar neto që është më i vogël se sa do të ishte e nevojshme për llojet e tjera të kontratave që pritet të ndikohen në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në faktorët e tregut. (c) shlyerja e tij bëhet në të ardhmen.
dividendët	Dividendët—shpërndarja e fitimeve mes mbajtësve të instrumenteve të kapitalit neto në përputhje me kuotat përkatëse të kategorive të caktuara të kapitalit.
metoda e interesit efektiv	Metoda që është përdorur në llogaritjen e kostos së amortizuar të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar dhe në shpërndarjen dhe njohjen e të ardhurave nga interesat ose shpenzimeve për interesa në fitim ose humbje gjatë periudhës përkatëse.
norma e interesit efektiv	Norma që skanton pagesat e ardhshme monetare ose arkëtimet gjatë jetës së pritshme të aktivit financiar ose detyrimit financiar për të arritur tek vlera bruto kontabël e një aktivi financiar ose tek kosto e amortizuar e një detyrimi financiar . Kur llogaritet norma efektive të interesit, një njësi ekonomike duhet të çmojë flukset e pritshme të mjeteve monetare duke konsideruar të gjitha kushtet kontraktuale të aktivit financiar (për shembull, parapagimin, zgjatjen, thirrjen dhe opsionet e ngjashme) por nuk duhet të konsiderojë humbjet pritshme të kredisë . Llogaritja përfshin të gjitha tarifatat dhe pikët e paguara ose të marra midis palëve të kontratës që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit (shih paragrafët B5.4.1-B5.4.3), kostot e transaksionit , dhe të gjitha primet ose zbritjet e tjera. Ekziston një supozim se flukset e mjeteve monetare dhe jeta e pritshme e një grupi instrumentesh financiarë të ngjashëm mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Megjithatë, në ato raste të rralla kur nuk është e mundur për të vlerësuar në mënyrë të besueshme flukset e mjeteve monetare ose jetën e pritshme të një instrumenti financiar (ose grup të instrumenteve financiare), njësi ekonomike do të përdorë flukset kontraktuale të mjeteve monetare gjatë afatit të plotë kontraktual të instrumentit financiar (ose grupi instrumentesh financiarë).
humbjet e pritshme të kredisë	Mesatarja e ponderuar e humbjeve të kredisë me rreziqet përkatëse të mospagesës.

kontratë e garancisë financiare	Një kontratë sipas së cilës i kërkohet emetuesit të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që pëson për shkak se një debitor i caktuar nuk bën pagesat kur ato kërkohen në përputhje me termat fillestare ose të modifikuara të një instrumenti borxhi.
detyrimi financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	Një detyrim financiar që plotëson një nga kushtet e mëposhtme. <ul style="list-style-type: none"> (a) plotëson përkufizimin i mbajtur për tregtim. (b) pas njohjes fillestare ai është përcaktuar nga njësia ekonomike si instrument financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 4.2.2 ose 4.3.5. (c) është i përcaktuar ose në njohjen fillestare ose më pas, me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 6.7.1.
angazhim i përcaktuar	Një marrëveshje detyruese për shkëmbimin e një sasive të caktuar burimesh me një çmim të caktuar në një datë apo data të caktuara në të ardhmen.
transaksion parashikues	Një transaksion ku njësia ekonomike nuk është angazhuar ende por që parashikohet në të ardhmen.
vlera bruto kontabël e një aktivi financiar	Kosto e amortizuar e një aktivi financiar , përpara rregullimit për ndonjë kompensim humbje .
raporti i mbulimit	Marrëdhënia midis sasisë së instrumentit mbulues dhe sasisë së elementit të mbrojtur në aspektin e peshës së tyre relative.
i mbajtur për tregtim	Një aktiv financiar ose detyrim financiar që: <ul style="list-style-type: none"> (a) është blerë apo krijuar kryesisht për qëllime të shitjes ose të riblerjes në afat të afërt kohor; (b) në njohjen fillestare është pjesë e portofolit të instrumenteve financiare të identifikueshëm që janë të menaxhuara së bashku dhe për të cilat ka evidencë të një modeli aktual të kohëve të fundit për realizimin e fitimeve afatshkurtra; ose (c) është një derivativ(me përjashtim të një derivativi që është një kontratë e garancisë financiare ose një instrument mbulues i përcaktuar dhe efektiv).
fitimet ose humbjet e çvlerësimit	Fitimet ose humbjet që janë njohur në fitim ose humbje në përputhje me paragrafin 5.5.8 dhe që lindin nga zbatimi i kërkesave të zhvlerësimit në Seksionin 5.5.
humbjet e kreditit gjatë jetës së pritshme	Humbjet e pritshme të kredisë që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.
kompensim humbje	Kompensimi për humbjet e pritshme të kredisë nga aktivet financiare të matura në përputhje me paragrafin 4.1.2, qiratë e arkëtueshme dhe aktivet kontraktuale , shuma e akumuluar nga çvlerësimi për aktivet financiare të matura në përputhje me paragrafin 4.1.2A dhe provizioni për humbjet e pritshme të kredisë mbi angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare .
fitimet ose humbjet nga modifikimi	Shuma që rrjedh nga rregullimi i vlerës kontabël bruto të aktivit financiar për të pasqyruar flukset monetare kontraktuale të ri negociuara ose të modifikuara. Njësia ekonomike rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivit financiar si vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të parashikuara të mjeteve monetare ose si vlerën e të ardhurave përgjatë jetës së pritshme të aktivit financiar të ri negociuar ose të modifikuar që janë të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar (ose me normën fillestare të interesit të rregulluar të kredisë për aktivet financiare të blera apo të krijuara me kreditit të çvlerësuar)ose, kur është e zbatueshme, me normën e rishikuar të interesit efektiv e llogaritur në përputhje me paragrafin 6.5.10. Kur bën vlerësimin e flukseve monetare të pritshme të një aktivi financiar, një njësi ekonomike do të marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të aktivit financiar (për shembull shlyerjen, blerjen, dhe opsionet e ngjashme të blerjes), por nuk do të marrë parasysh humbjet e pritshme të kredisë , përveç rastit nëse aktivi financiar është blerë ose krijuar si aktiv financiar me kreditit të çvlerësuar , rast në të cilin një njësi ekonomike do gjithashtu të marrë në konsideratë humbjet fillestare të kredisë që janë marrë parasysh kur është llogaritur norma fillestare e interesit efektiv të kredisë së rregulluar .

për t'u shlyer se i ka kaluar afati	Një aktiv financiar është për t'u shlyer nëse një palë tjetër ka dështuar në bërjen e një pagese të kërkuar sipas kontratës.
aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar të blera apo të krijuara	aktiv(e) financiare të blera ose të krijuara që janë me kredit të zhvlerësuar që në fillim të tyre.
data e riklasifikimit	Dita e parë e periudhës së parë të raportimit pas ndryshimit në modelin e biznesit që çon në riklasifikimin e aktiveve financiare në një njësi ekonomike.
mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje	Një blerje ose shitje e një aktivi financiar sipas një kontrate ku kërkohet që të bëhet dorëzimi i aktivitet brenda kuadrit kohor të vendosur në përgjithësi nga rregullorja ose konventa në tregun përkatës.
kostot e transaksionit	Kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, emetimin ose likuidimin e një aktivi financiar ose detyrimi financiar (shih paragrafin B5.4.8). Një kosto shtesë është ajo që nuk do të kishte ndodhur nëse njësi ekonomike nuk do të kishte blerë, emetuar ose likuiduar instrumentin financiar.

Termat e mëposhtëm janë përcaktuar në paragrafin 11 të SNK 32, Shtojcën A të SNRF 7, Shtojcën A të SNRF 15 dhe janë përdorur në këtë Standard me kuptimet e specifikuar në SNK 32, SNRF 7, SNRF 13 ose SNRF 15:

- (a) rreziku i kredisë;²
- (b) instrument kapitali neto;
- (c) vlerën e drejtë;
- (d) aktiv financiar;
- (e) instrument financiar;
- (f) detyrim financiar;
- (g) çmimi i transaksionit.

2

Ky term (siç përkufizohet në SNRF 7) është përdorur në kërkesat për paraqitjen e efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë mbi detyrimet e përcaktuara si me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (shih paragrafin 5.7.7).

Shtojca B

Udhëzim për zbatim

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

Objekti (Kapitulli 2)

- B2.1 Disa kontrata kërkojnë një pagesë bazuar në tregues klimatikë, gjeologjike fizikë, ose të tjera. (Ata që bazohen në tregues klimatikë nganjëherë i referohemi si "instrumente derivativë që mbulojnë reziqet e lidhura me motin".) Në qoftë se këto kontrata nuk janë objekt i SNRF 17 *Kontratat e Sigurimit*, atëherë ato janë objekt i këtij standardi.
- B2.2 Ky Standard nuk ndryshon kërkesat në lidhje me skemat e përfitimit të punonjësve që janë në pajtim me SNK 26 *Kontabiliteti dhe Raportimi për Skemat e Përfitimit të Pensioneve* dhe marrëveshjet për përdorimin e pronës bazuar në vëllimin e shitjeve ose të ardhurave nga shërbimet që kontabilizohen sipas SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët*.
- B2.3 Ndonjëherë, një njësi ekonomike bën atë që ajo e sheh si 'investim strategjik' në instrumente të kapitalit neto të emetuara nga një njësi ekonomike tjetër, me synimin për të krijuar ose mbajtur një marrëdhënie operative afatgjatë me njësinë ekonomike në të cilën është bërë investimi. Investitori ose njësia ekonomike e sipërmarrjes së përbashkët përdor SNK 28 *Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta* për të përcaktuar nëse metoda e kontabilitetit të kapitalit neto duhet të zbatohet për një investim të tillë.
- B2.4 Ky Standard zbatohet për aktivet financiare dhe detyrimet financiare të siguriesve, përveç të drejtave dhe detyrimeve që përjashtohen nga paragrafi 2,1(e), për shkak se ato rrjedhin nga kontrata që janë brenda objektivit të SNRF 17.
- B2.5 Kontratat e garancisë financiare mund të kenë forma ligjore të ndryshme, të tilla si një garanci, disa tipe të letër kredisë, një kontratë për mos shlyerje kredie ose një kontratë sigurimi. Trajtimi kontabël i tyre nuk varet nga forma ligjore e tyre. Më poshtë jepen shembuj të trajtimit të përshtatshëm (shih paragrafin 2,1(e)):
- (a) Megjithëse një kontratë e garancisë financiare plotëson përkufizimin e një kontrate sigurimi në SNRF 4SNRF 17 (shih paragrafin 7(e) të SNRF 17), nëse rreziku i transferueshëm është i konsiderueshëm, emetuesi zbaton këtë Standard. Sidoqoftë, nëse lëshuesi ka pohuar më parë në mënyrë të qartë se i sheh këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur kontabilitetin e zbatueshëm për kontratat e sigurimit, lëshuesi mund të zgjedhë të zbatojë ose këtë Standard ose SNRF 17 për kontrata të tilla të garancisë financiare. Nëse zbatohet ky Standard, paragrafi 5.1.1 kërkon që lëshuesi të njohë një kontratë të garancisë financiare fillimisht me vlerën e drejtë. Në qoftë se kontrata e garancisë financiare i është lëshuar një pale që nuk ka lidhje me të në një transaksion të veçuar të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, vlera e drejtë e saj në fillim ka mundësi të jetë e barabartë me primin e marrë, deri në momentin që vërtetohet e kundërta. Si rrjedhojë, deri në momentin që kontrata e garancisë financiare përcaktohet që në fillim si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ose deri në momentin që zbatohen paragrafët 3.2.15-3.2.23 dhe B3.2.12-B3.2.17 (kur transferimi i një aktivi financiar nuk kualifikohet për çregjistrimin ose kur zbatohet metoda e përfshirjes së vazhdueshme), lëshuesi e mat atë me vlerën më të lartë të:
- (i) shumës së përcaktuar në përputhje me Seksionin 5,5; dhe
- (ii) shumës së njohur fillimisht minus, kur është e përshtatshme, shumën e të ardhurave të akumuluar të njohura në përputhje me parimet e SNRF 15 (shih paragrafin 4.2.1(c)).
- (b) Disa garanci të lidhura me kredinë nuk kërkojnë, si një parakusht për pagesën, që mbajtësi të jetë i ekspozuar dhe të pësojë humbje, nga moskryerja në kohën e duhur të pagesave nga debitori për aktivin e garantuar. Një shembull i një garancie të tillë është kur kërkohet të bëhen pagesa në përgjigje të ndryshimeve në klasifikimin specifik të kredisë ose indeksin e kredisë. Garanci të tilla nuk janë kontrata të garancisë financiare siç përcaktohet në këtë Standard dhe nuk janë kontrata sigurimi siç përcaktohet në SNRF 17. Garanci të tilla janë derivativë dhe lëshuesi zbaton për to këtë Standard
- (c) Në qoftë se një kontratë e garancisë financiare është emtuar në lidhje me shitjen e mallrave, emetuesi zbaton SNRF 15 në përcaktimin se kur ai njih të ardhurat nga garancia dhe nga shitja e mallrave.

- B2.6 Pohimet se një emetues i konsideron kontratat si kontrata sigurimi, gjenden në tërë komunikimet e emetuesit me klientët dhe rregullatorët, në kontratat, në dokumentacionin e biznesit dhe në pasqyrat financiare. Për më tepër, kontratat e sigurimit shpesh iu nënshtrohen kërkesave kontabël që janë të dallueshme nga kërkesat për llojet e tjera të transaksioneve, të tilla si kontratat e emetuara nga bankat ose shoqëritë tregtare. Në raste të tilla, pasqyrat financiare të një emetuesi, në mënyrë tipike përfshijnë një deklaratë që emetuesi ka përdorur këto kërkesa në politikat e tij kontabël.

Njohja dhe çregjistrimi (Kapitulli 3)

Njohja fillestare (Seksioni 3.1)

- B3.1.1 Si rrjedhojë e parimit në paragrafin 3.1.1, një njësi ekonomike i njuh të gjitha të drejtat e saj kontraktuale dhe detyrimet nga derivativët në pasqyrën e pozicionit financiar përkatësisht si aktive dhe detyrime, me përjashtim të derivativëve që parandalojnë një transferim të aktiveve financiare nga të qenit i trajtuar si një shitje (shih paragrafin B3.2.14). Në qoftë se një transferim i një aktivi financiar nuk kualifikohet për çregjistrim, i transferuari nuk e njuh aktivin e transferuar si aktivin e tij (shih paragrafin B3.2.15).
- B3.1.2 Më poshtë jepen shembuj të zbatimit të parimit në paragrafin 3.1.1:
- (a) Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme të pakushtëzuara njihen si aktive ose detyrime, kur njësia ekonomike bëhet palë në kontratë dhe, si pasojë, ka një të drejtë ligjore për të marrë apo një detyrim ligjor për të paguar në mjete monetare.
 - (b) Aktivet e blera dhe detyrimet që ndërmerren si rezultat i një angazhimi të përcaktuar për të blerë ose shitur mallra apo shërbime, në përgjithësi nuk njihen, të paktën deri sa një nga palët ka vepruar sipas marrëveshjes. Për shembull, një njësi ekonomike që merr një porosi të përcaktuar, në përgjithësi, nuk njuh një aktiv (dhe njësia ekonomike që bën porosinë nuk njuh një detyrim) në kohën e angazhimit, por, përkundrazi, njohja shtyhet deri sa mallrat ose shërbimet e porositura të jenë dërguar, dorëzuar ose dhënë. Nëse një angazhim i përcaktuar për të blerë apo shitur zëra jo-financiare është brenda objektit të këtij Standardi, në përputhje me paragrafët 2.4-2.7, vlera e drejtë neto e tij njihet si një aktiv ose detyrim në datën e angazhimit (shih paragrafin B4.1.30(c)). Përveç kësaj, në qoftë se një angazhim i përcaktuar i panjohur më parë, përcaktohet si një element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerën e drejtë, çdo ndryshim në vlerën e drejtë neto që ka të bëjë drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur njihet si një aktiv ose detyrim pas fillimit të mbrojtjes (shih paragrafët 6.5.8(b) dhe 6.5.9).
 - (c) Një kontratë e ardhshme që është brenda objektit të këtij Standardi (shih paragrafin 2.1) njihet si një aktiv ose detyrim në datën e angazhimit, në vend të datës në të cilën bëhet shlyerja. Kur një njësi ekonomike bëhet palë në një kontratë të ardhshme, vlerat e drejta të së drejtës dhe e detyrimit shpesh janë të barabarta, kështu që vlera e drejtë neto e kontratës është zero. Nëse vlera e drejtë neto e të drejtës dhe e detyrimit nuk është zero, kontrata njihet si një aktiv ose detyrim.
 - (d) Kontrata opsioni që janë brenda objektit të këtij Standardi (shih paragrafin 2.1) njihen si aktive ose detyrime kur mbajtësi apo shkruesi bëhet palë në kontratë.
 - (e) Transaksionet e planifikuara për të ardhmen, pa marrë parasysh sa janë të mundshme, nuk janë aktive dhe detyrime për shkak se njësia ekonomike nuk është bërë palë në një kontratë.


Blerja ose shitja e aktiveve financiare sipas mënyrës së rregullt

- B3.1.3 Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e aktiveve financiare njihet ose duke përdorur kontabilizimin në datën e tregtimit, ose në datën e shlyerjes, siç përshkruhet në paragrafët B3.1.5 dhe B3.1.6. Një njësi ekonomike do të zbatojë të njëjtën metodë në vazhdimësi për të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare, që janë klasifikuar në të njëjtën mënyrë në përputhje me këtë Standard. Për këtë qëllim, aktivet që janë matur detyrimisht me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes formojnë një klasifikim të veçantë nga aktivet e përcaktuara si të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Përveç kësaj, investimet në instrumente kapitali neto të kontabilizuara, duke përdorur opsionin e parashikuar në paragrafin 5.7.5, formojnë një klasifikim të veçantë.
- B3.1.4 Një kontratë që kërkon ose lejon shlyerjen neto të ndryshimit në vlerën e saj nuk është një kontratë në mënyrë të rregullt. Në vend të kësaj, një kontratë e tillë trajtohet si një derivativ në periudhën midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes.

- B3.1.5 Data e tregtimit është data që një njësi ekonomike angazhohet për të blerë ose shitur një aktiv. Kontabilizimi në datën e tregtimit i referohet (a) njohjes së një aktivi të marrë dhe detyrimit për të paguar për të në datën e tregtimit, dhe (b) çregjistrimit të një aktivi që është shitur, njohjes të ndonjë fitimi ose humbjeje neto nga shitja dhe njohjes së një të drejte të arkëtueshme nga blerësi për pagesën në datën e tregtimit. Në përgjithësi, interesi nuk ka filluar të rritet mbi aktivin dhe detyrimin përkatës deri në datën e shlyerjes, kur kalon titulli.
- B3.1.6 Data e shlyerjes është data që një aktiv është dorëzuar në ose nga një njësi ekonomike. Kontabilizimi në datën e shlyerjes i referohet (a) njohjes së një aktivi në ditën që është marrë nga njësi ekonomike, dhe (b) çregjistrimit të një aktivi dhe njohjes së çdo fitimi ose humbjeje nga shitja në ditën që ai është dorëzuar nga njësi ekonomike. Kur një njësi ekonomike bën kontabilizimin në datën e shlyerjes trajton çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit të marrë gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes në të njëjtën mënyrë sikurse ajo trajton aktivin e blerë. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivet e matura me koston e amortizuar; ai njihet në fitim ose humbje për aktivet e klasifikuara si aktive financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; dhe kjo njihet në të ardhurat e tjera përmbledhëse për aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 4.1.2A dhe për investimet në instrumentet e kapitalit neto kontabilizohet në përputhje me paragrafin 5.7.5.

Çregjistrimi i aktiveve financiare (Seksioni 3.2)

B3.2.1 Tabela e mëposhtme ilustron vlerësimin nëse dhe në çfarë mase një aktiv financiar çregjistrohet.



Marrëveshjet në të cilat një njësi ekonomike ruan të drejtat kontraktuale për të arkëtuar flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'u paguar flukse mjeteve monetare një apo më shumë marrësve (paragrafi 3.2.4 (b))

- B3.2.2 Situata e përshkruar në paragrafin 3.2.4 (b) (kur një njësi ekonomike ruan të drejtat kontraktuale për të arkëtuar flukse të mjeteve monetare të aktivitetit financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'u paguar flukse të mjeteve monetare një ose më shumë përfituesve) ndodh, për shembull, nëse njësi ekonomike është një njësi besimi dhe u jep investitorëve interesa përfitimi në aktivet financiare bazë që ajo zotëron dhe siguron shërbimin e këtyre aktiveve financiare. Në këtë rast, aktivet financiare kualifikohen për regjistrim, nëse janë plotësuar kushtet në paragrafët 3.2.5 dhe 3.2.6.
- B3.2.3 Në zbatim të paragrafit 3.2.5, njësi ekonomike mund të jetë, për shembull, nismëtarja e aktivitetit financiar, ose mund të jetë një grup që përfshin një filial që ka blerë aktivin financiar dhe i kalon flukset monetare tek investitorët që janë palë e tretë e palidhur.

Vlerësimi i transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë (paragrafi 3.2.6)

- B3.2.4 Shembuj kur një njësi ekonomike ka transferuar thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, janë:
- (a) një shitje e pakushtëzuar e një aktivi financiar;
 - (b) një shitje e një aktivi financiar së bashku me një opsion për ta riblerë aktivin financiar me vlerën e drejtë të tij në kohën e riblerjes; dhe
 - (c) një shitje e një aktivi financiar së bashku me një opsion blerje ose shitjeje që është vështirë të jetë me para (d.m.th. një opsion që është pa para sa që është shumë vështirë të ndodhë e kundërta para skadimit).
- B3.2.5 Shembuj kur një njësi ekonomike ka mbajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë janë:
- (a) një transaksion shitje dhe riblerje ku çmimi i riblerjes është një çmim fiks ose çmimi i shitjes plus kthimin e huadhënësit;
 - (b) një marrëveshje e letrave me vlerë të kreditimit;
 - (c) një shitje e një aktivi financiar së bashku me një kthim të përgjithshëm të kontratës së shkëmbimit që ia transferon përsëri njësisë ekonomike ekspozimin ndaj rrezikut të tregut;
 - (d) një shitje e një aktivi financiar së bashku me një opsion kthimi apo blerje që është vështirë të jetë me para (d.m.th. një opsion që është pa para sa që është shumë vështirë të ndodhë e kundërta para skadimit); dhe
 - (e) një shitje e llogarive të arkëtueshme afatshkurtra në të cilën njësi ekonomike garanton të kompensojë marrësin për humbjet e kredisë që kanë të ngjarë të ndodhin.
- B3.2.6 Nëse një njësi ekonomike përcakton se si rezultat i transferimit ka transferuar thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit të transferuar, ajo nuk e njeh aktivin e transferuar përsëri në një periudhë të ardhshme, nëse nuk e riblen aktivin e transferuar në një transaksion të ri.

Vlerësimi i transferimit të kontrollit

- B3.2.7 Një njësi ekonomike nuk ruan kontrollin e një aktivi të transferuar nëse i transferuari (marrësi) ka aftësinë praktike për ta shitur këtë aktiv. Një njësi ekonomike ruan kontrollin e një aktivi të transferuar nëse i transferuari nuk ka aftësinë praktike për ta shitur këtë aktiv. Një i transferuar ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin e transferuar në qoftë se ai tregtohet në një treg aktiv, sepse i transferuari mund ta ri blejë aktivin e transferuar në treg, nëse ai duhet t'ia kthejë aktivin njësisë ekonomike. Për shembull, një i transferuar mund të ketë aftësinë praktike për ta shitur një aktiv të transferuar, nëse aktivi i transferuar është subjekt i një opsioni që lejon që njësi ekonomike ta riblejë atë, por i transferuari mund të jetë i gatshëm ta marrë aktivin e transferuar në treg nëse ushtrohet opsioni. Një i transferuar nuk ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin e transferuar, nëse njësi ekonomike ruan një opsion të tillë dhe i transferuari nuk është i gatshëm ta marrë aktivin e transferuar në treg, nëse njësi ekonomike ushtron opsionin e saj.

- B3.2.8 I transferuari ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin e transferuar vetëm nëse ai mund t'ia shesë aktivin e transferuar në tërësinë e tij një pale të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa imponuar kufizime shtesë për të. Pyetja kritike është ajo që çfarë është në gjendje i të bëjë në praktikë i transferuari, dhe jo se çfarë të drejtash kontraktuale ka ai në lidhje me atë që mund të bëjë me aktivin e transferuar ose çfarë ndalime kontraktuale ekzistojnë. Në veçanti:
- (a) një e drejtë kontraktuale për të shitur aktivin e transferuar ka ndikim të vogël praktik, në qoftë se nuk ka treg për aktivin e transferuar, dhe
 - (b) aftësia për ta shitur aktivin e transferuar ka ndikim të vogël praktik, në qoftë se ajo nuk mund të ushtrohet lirshëm. Për këtë arsye:
 - (i) aftësia e të transferuarit për ta shitur aktivin e transferuar duhet të jetë e pavarur nga veprimet e të tjerëve (d.m.th. ajo duhet të jetë një aftësi e njëanshme), dhe
 - (ii) i transferuari duhet të jetë në gjendje për shitjen e aktivitetit të transferuar pa pasur nevojë të shtojë kushte kufizuese ose "pengesa" për ta transferuar (p.sh. kushtet për mënyrën se si një aktiv kredie është shërbyer apo një opsion i jep të transferuarit të drejtën për të riblerë aktivin).
- B3.2.9 Fakti që i transferuari nuk ka gjasa të shesë aktivin e transferuar nuk do të thotë se transferuesi ka ruajtur kontrollin e aktivitetit të transferuar. Megjithatë, në qoftë se një kontratë me opsion ose garanci kufizon të transferuarin nga shitja e aktivitetit të transferuar, atëherë transferuesi ka ruajtur kontrollin e aktivitetit të transferuar. Për shembull, në qoftë se një kontratë opsioni ose garanci është mjaft e vlefshme ajo kufizon të transferuarin nga shitja e aktivitetit të transferuar për shkak se marrësi, në praktikë, nuk do t'ia shiste aktivin e transferuar një pale të tretë pa shtuar një opsion të ngjashëm ose kushte të tjera kufizuese. Në vend të kësaj, i transferuari do të mbajë aktivin e transferuar në mënyrë që të marrë pagesat nën garanci ose kontrata e opsionit. Në këto rrethana transferuesi ka ruajtur kontrollin e aktivitetit të transferuar.

Transferimet që kualifikohen për çregjistrim

- B3.2.10 Një njësi ekonomike mund të ruajë të drejtën e një pjesë të pagesave të interesit për aktivet e transferuara, si kompensim për shërbimin ndaj këtyre aktiveve. Pjesa e pagesave të interesit që njësi ekonomike do të hiqte dorë me përfundimin ose transferimin e kontratës së shërbimit, shpërndahet në aktiv shërbimi ose detyrim shërbimi. Pjesa e pagesave të interesit që njësi ekonomike nuk do të heqë dorë është një interes i arkëtueshëm i shitur veçmas. Për shembull, në qoftë se njësi ekonomike nuk do të heqë dorë nga ndonjë interes mbi përfundimin ose transferimin e kontratës së shërbimit, i gjithë interesi i shpërndarë është vetëm një interes i arkëtueshëm i shitur veçmas. Për qëllime të zbatimit të paragrafit 3.2.13, vlerat e drejta të aktivitetit të shërbimit dhe të interesit të arkëtueshëm të shitur veçmas përdoren për të shpërndarë vlerën kontabël të llogarisë së arkëtueshme në mes të një pjesë të aktivitetit që është çregjistruar dhe pjesës që vazhdon të njihet. Në qoftë se nuk ka asnjë tarifë shërbimi të caktuar ose tarifa për t'u marrë nuk pritet që të kompensojë njësinë ekonomike në mënyrë adekuate për kryerjen e shërbimit, njihet një detyrim për detyrimin e shërbimit me vlerën e drejtë.
- B3.2.11 Gjatë matjes së vlerave të drejta të pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që çregjistrohet, për qëllime të zbatimit të paragrafit 3.2.13, një njësi ekonomike zbaton kërkesat për matjen me vlerën e drejtë në SNRF 13 *Matje me vlerën e drejtë përveç* paragrafit 3.2.14.

Transferimet që nuk kualifikohen për çregjistrim

- B3.2.12 Në vijim është një zbatim i parimit të përshkruar në paragrafin 3.2.15. Në qoftë se një garanci e dhënë nga njësi ekonomike për humbjet e pësuar nga aktivi i transferuar parandalon çregjistrimin e një aktivi të transferuar, sepse njësi ekonomike ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së tij, aktivi i transferuar vazhdon të njihet në tërësinë e tij dhe shuma e arkëtuar njihet si një detyrim.

Përfshirja e vazhdueshme në aktivet e transferuara

- B3.2.13 Në vijim janë dhënë shembuj se si njësi ekonomike mat një aktiv të transferuar dhe detyrimet që lidhen me të në bazë të paragrafit 3.2.16.

Të gjitha aktivet

- (a) Në qoftë se një garanci e siguruar nga një njësi ekonomike për të paguar për humbjet e pësuar nga një aktiv i transferuar parandalon çregjistrimin e tij në masën e përfshirjes së vazhdueshme,

aktivi i transferuar në datën e transferimit matet me më të ultën e (i) vlerës kontabël neto të aktivitetit dhe (ii) shumës maksimale të arkëtuar nga transferimi, që njësia ekonomike mund të jetë e detyruar ta kthejë ('shumë garancie'). Detyrimi që lidhet me të matet fillimisht me shumën e garancisë plus vlerën e drejtë të garancisë (e cila është zakonisht shuma e arkëtuar për garanci). Më pas, vlera e drejtë fillestare e garancisë njihet në fitim ose humbje kur (ose me) detyrimi është plotësuar (në përputhje me parimet e SNRF 15) dhe vlera kontabël e aktivitetit zvogëlohet me ndonjë kompensim humbjeje.

Aktivet e matura me koston e amortizuar

- (b) Në qoftë se një detyrim i kontratës me opsjon, e shkruar nga një njësi ekonomike ose e drejta e opsionit të blerjes e mbajtur nga një njësi ekonomike, parandalon çregjistrimin e një aktivi të transferuar dhe njësia ekonomike e mat aktivin e transferuar me koston e amortizuar, detyrimi i lidhur matet me koston e tij (d.m.th. shuma e arkëtuar) e rregulluar për amortizimin e ndonjë difference në mes kësaj kostoje dhe vlerës bruto kontabël të aktivitetit të transferuar në datën e skadimit të opsionit. Për shembull, supozojmë se vlera bruto kontabël e aktivitetit në datën e transferimit është 98 NJM dhe shuma e arkëtuar është 95NJM. Vlera bruto kontabël e aktivitetit në datën e ushtrimit të opsionit do të jetë 100NJM. Vlera fillestare kontabël e detyrimit të lidhur është 95NJM dhe diferenca në mes 95 NJM dhe 100NJM njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Nëse opsioni ushtrohet, çdo difference mes vlerës kontabël të detyrimit të lidhur dhe çmimi të ushtrimit të opsionit njihet në fitim ose humbje.

Aktivet e matura me vlerën e drejtë

- (c) Në qoftë se një e drejtë opsioni blerjeje e mbajtur nga një njësi ekonomike parandalon çregjistrimin e një aktivi të transferuar dhe njësia ekonomike e mat aktivin e transferuar me vlerën e drejtë, ai vazhdon të matet me këtë vlerë. detyrimi i lidhur matet me (i) çmimin e ushtrimit të opsionit pakësuar me vlerën në kohë të opsionit, nëse ky opsion është në ose me para, ose me (ii) vlerën e drejtë të aktivitetit të transferuar pakësuar me vlerën në kohë të opsionit nëse ky opsion nuk është me para. Rregullimi për matjen e detyrimit të lidhur siguron që vlera kontabël neto e aktivitetit dhe e detyrimit të lidhur të jetë vlera e drejtë e të drejtës së opsionit të blerjes. Për shembull, nëse vlera e drejtë e aktivitetit bazë është 80NJM, çmimi i ushtrimit të opsionit është 95NJM dhe vlera në kohë e opsionit është 5NJM, vlera kontabël e detyrimit të lidhur është 75NJM (80NJM – 5NJM) dhe vlera kontabël e aktivitetit të transferuar është 80NJM (d.m.th. vlera e tij e drejtë).
- (d) Në qoftë se një kontratë opsioni e shkruar nga një njësi ekonomike parandalon çregjistrimin e një aktivi të transferuar dhe njësia ekonomike e mat aktivin e transferuar me vlerën e drejtë, detyrimi i lidhur matet me çmimin e ushtrimit të opsionit plus vlerën në kohë të opsionit. Matja e aktivitetit me vlerën e drejtë është e kufizuar në më të ultën e vlerës së drejtë dhe çmimit të ushtrimit të opsionit për shkak se njësia ekonomike nuk ka të drejtë të rritë vlerën e drejtë të aktivitetit të transferuar mbi çmimin e ushtrimit të opsionit. Kjo siguron që vlera kontabël neto e aktivitetit dhe e detyrimit të lidhur të jetë vlera e drejtë e detyrimit të kontratës së opsionit. Për shembull, nëse vlera e drejtë e aktivitetit bazë është 120NJM, çmimi i ushtrimit të opsionit është 100NJM dhe vlera në kohë e opsionit është 5NJM, vlera kontabël e detyrimit të lidhur është 105NJM (100NJM + 5NJM) dhe vlera kontabël e aktivitetit është 100NJM (në këtë rast çmimi i ushtrimit të opsionit).
- (e) Nëse një investim mbrojtës, në formën e një opsioni blerjeje të marrë dhe opsioni kthimi të shkruar, parandalon një aktiv të transferuar të çregjistrohet dhe njësia ekonomike e mat aktivin me vlerën e drejtë, ajo vazhdon ta matë atë me vlerën e drejtë. Detyrimi i lidhur matet me (i) shumën e çmimit të ushtrimit të opsionit të blerjes dhe vlerës së drejtë të opsionit të kthimit pakësuar me vlerën në kohë të opsionit të blerjes, nëse ky opsion është në ose me para, ose me (ii) shumën e vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës së drejtë të opsionit të kthimit pakësuar me vlerën në kohë të opsionit të blerjes, nëse ky opsion është pa para. Rregullimi në detyrimin e lidhur siguron që vlera kontabël neto e aktivitetit dhe e detyrimit të lidhur të jetë vlera e drejtë e opsioneve të mbajtura dhe të shkruara nga njësia ekonomike. Për shembull, supozojmë një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar që matet me vlerën e drejtë, ndërsa në të njëjtën kohë ka blerë një opsion me një çmim ushtrimi 120NJM dhe ka shkruar një me një çmim ushtrimi i 80NJM. Supozojmë gjithashtu se vlera e drejtë e aktivitetit është 100NJM në datën e transferimit. Vlera në kohë e opsionit të kthimit dhe atij të blerjes janë 1NJM dhe 5NJM përkatësisht. Në këtë rast, njësia ekonomike njih një aktiv për 100NJM (vlera e drejtë e aktivitetit) dhe një detyrim për 96NJM [(100NJM + 1NJM) – 5NJM]. Kjo bën që vlera neto e aktivitetit të jetë 4NJM, që është vlera e drejtë e opsioneve të mbajtura dhe të shkruara nga njësia ekonomike.

Të gjitha transferimet

- B3.2.14 Deri në masën që një transferim i një aktivi nuk kualifikohet për çregjistrim, të drejtat kontraktuale të transferuesit ose detyrimet e lidhura me transferimin nuk trajtohen veçmas si derivativët në qoftë se njohja si e derivativit, ashtu dhe e aktivitetit të transferuar apo detyrimit që lind nga transferimi do të çojë në njohjen dy herë të të drejtave ose detyrimeve të njëjta. Për shembull, një opsion blerjeje i mbajtur nga transferuesi mund të parandalojë një transferim të aktiveve financiare nga kategoria e instrumenteve financiare për shitje. Në këtë rast, opsioni i blerjes nuk njihet veçmas si një aktiv derivativ.
- B3.2.15 Deri në masën që një transferim i një aktivi nuk kualifikohet për çregjistrim, i transferuari nuk e njeh aktivin e transferuar si aktivin e tij. I transferuari njeh një shumë të arkëtueshme nga transferuesi duke kredituar mjetet monetare ose shumën e paguar. Nëse transferuesi ka edhe të drejtën dhe detyrimin të rimarrë kontrollin e gjithë aktivitetit të transferuar për një shumë të caktuar (të tilla si në një marrëveshje riblerjeje), i transferuari mund matë llogaritë e tij të arkëtueshme me koston e amortizuar, nëse plotësohen kriteret në paragrafin 4.1.2.

Shembuj

- B3.2.16 Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë zbatimin e parimeve për çregjistrim të këtij Standardi.
- (a) *Marrëveshjet e riblerjes dhe të huadhënies të letrave me vlerë.*Nëse një aktiv financiar është shitur sipas një marrëveshjeje për ta riblerë atë me një çmim të caktuar ose me një çmim shitjeje plus kthimin e huadhënësit, ose në qoftë se ai është huazuar sipas një marrëveshjeje për t'ia kthyer atë transferuesit, ai nuk çregjistrohet, sepse transferuesi ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Në qoftë se i transferuari fiton të drejtën për ta shitur ose ta lerë si kolateral aktivin, transferuesi e riklasifikon aktivin në pasqyrën e pozicionit financiar, për shembull, si një aktiv të huajtur ose llogari të arkëtueshme të riblerë.
- (b) *Marrëveshjet e riblerjes dhe aktive nga huadhënia e letrave me vlerë që në thelb janë të njëjta.*Nëse një aktiv financiar është shitur sipas një marrëveshjeje për ta ri blerë të njëjtin ose kryesisht të njëjtin aktiv me një çmim të caktuar ose me një çmim shitjeje plus kthimin e huadhënësit, ose në qoftë se një aktiv financiar është huazuar apo marrë borxh në bazë të një marrëveshjeje për t'ia kthyer transferuesit të njëjtin ose kryesisht të njëjtin aktiv, ai nuk çregjistrohet, sepse transferuesi ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.
- (c) *Marrëveshjet e riblerjes dhe të drejtat e zëvendësimit nga huadhënia e letrave me vlerë.*Nëse një marrëveshje riblerjeje me një çmim fiks riblerje ose me një çmim të barabartë me çmimin e shitjes plus kthimin e huadhënësit, ose të një transaksioni të ngjashëm huadhënie të letrave me vlerë, i jep të transferuarit të drejtën të zëvendësojë aktivet që janë të ngjashme dhe me vlerë të drejtë të njëjtë me atë të aktivitetit të transferuar në datën e riblerjes, aktivi i shitur apo i huazuar sipas një marrëveshjeje riblerje ose kreditimi letrash me vlerë nuk çregjistrohet, sepse transferuesi i ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.
- (d) *E drejta e riblerjes të ofertës së parë me vlerën e drejtë.*Nëse një njësi ekonomike shet një aktiv financiar dhe mban vetëm të drejtën e ofertës së parë për ta riblerë aktivin e transferuar me vlerën e drejtë, nëse më pas i transferuari e shet, njësia ekonomike e çregjiston aktivin për shkak se ajo i ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.
- (e) *Transaksion shitblerjeje i parregullt.*Riblerja e një aktivi financiar menjëherë pasi ai është shitur disa herë quhet si një pastrim shitjeje shitblerjeje e parregullt. Një riblerje e tillë nuk përjashton çregjistrimin me kusht që transaksioni origjinal i plotëson kërkesat e çregjistrimit. Megjithatë, nëse një marrëveshje për të riblerë një aktiv financiar është lidhur në të njëjtën kohë me një marrëveshje të riblerjes të të njëjtit aktiv me një çmim fiks ose çmim shitjeje plus kthimin e huadhënësit, atëherë aktivi nuk çregjistrohet.
- (f) *Opsionet e shitjes dhe të blerjes që janë tërësisht në mjete monetare.*Nëse një aktiv financiar i transferuar mund të kërkohet përsëri nga transferuesi dhe opsioni i blerjes është tërësisht në mjete monetare, transferimi nuk kualifikohet për çregjistrim, sepse transferuesi ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se aktivi financiar mund të kthehet përsëri nga i transferuari dhe opsioni i kthimit është tërësisht në mjete monetare, transferimi nuk kualifikohet për çregjistrim, sepse transferuesi ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.
- (g) *Opsionet e shitjes dhe të blerjes që janë tërësisht pa mjete monetare.*Një aktiv financiar i transferuar çregjistrohet kur është objekt vetëm i një opsioni kthimi tërësisht pa mjete monetare i mbajtur nga i transferuari ose i një opsioni blerjeje tërësisht pa mjete monetare i mbajtur nga

transferuesi. Kjo për shkak se transferuesi ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

- (h) *Aktive lehtësisht të arritshëm që janë objekt i një opsioni blerjeje që nuk është as tërësisht në mjete monetare as tërësisht pa mjete monetare.* Nëse një njësi ekonomike ka një opsion blerjeje për një aktiv që është lehtësisht i arritshëm në treg dhe opsioni nuk është as tërësisht në mjete monetare, as tërësisht pa mjete monetare, aktivi nuk çregjistrohet. Kjo për shkak se njësi ekonomike (i) as ka ruajtur, as ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, dhe (ii) nuk ka ruajtur kontrollin. Megjithatë, në qoftë se aktivi nuk është lehtësisht i arritshëm në treg, çregjistrimi nuk bëhet në masën e shumës së aktivitetit që është objekt i opsionit të blerjes, sepse njësi ekonomike ka ruajtur kontrollin e aktivitetit.
- (i) *Një aktiv jo lehtësisht i arritshëm objekt i një opsioni kthimi i shkruar nga një njësi ekonomike që nuk është as tërësisht me mjete monetare, as tërësisht pa mjete monetare.* Nëse një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar që nuk është lehtësisht i arritshëm në treg, dhe shkruan një opsion që nuk është tërësisht pa mjete monetare, ajo nuk ruan as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë për shkak të opsionit të kthimit me shkrim. Njësi ekonomike ruan kontrollin e aktivitetit, nëse opsioni i kthimit është mjaft i vlefshëm për të parandaluar shitjen e aktivitetit nga transferuari, rast në të cilin aktivi vazhdon të njihet deri në masën e përfshirjes së vazhdueshme të transferuesit (shih paragrafin B3.2.9). Njësi ekonomike transferon kontrollin e aktivitetit, nëse opsioni i kthimit nuk është mjaftueshëm i vlefshëm për të parandaluar shitjen e aktivitetit nga i transferuari, rast në të cilin aktivi nuk çregjistrohet.
- (j) *Aktivet që janë objekt i një opsioni shitjeje apo blerjeje me vlerë të drejtë ose i një marrëveshjeje të ardhshme riblerjeje.* Një transferim i një aktiviteti financiar që i nënshtrohet vetëm një opsionit të kthimit apo blerjejeje ose një marrëveshjeje riblerjeje të ardhshme që ka një çmim të ushtrimit të opsionit ose riblerjes të barabartë me vlerën e drejtë të aktivitetit financiar në kohën e riblerjes bën të mundur çregjistrimin, për shkak të transferimit kryesisht të të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë.
- (k) *Opsionet e shitjes ose të blerjes të shlyera me mjete monetare.* Një njësi ekonomike vlerëson transferimin e një aktiviteti financiar, që është objekt i një opsioni kthimi apo blerjeje ose i një marrëveshjeje të ardhshme riblerjeje, që do të shlyhet neto në mjete monetare, për të përcaktuar nëse ka ruajtur ose transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Nëse njësi ekonomike nuk ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit të transferuar, ajo përcakton nëse ka ruajtur kontrollin e aktivitetit të transferuar. Fakti që opsioni i blerjes apo kthimit ose marrëveshja e ardhshme e riblerjes shlyhet për neto në mjete monetare nuk do të thotë automatikisht se njësi ekonomike e ka transferuar kontrollin (shih paragrafët B3.2.9 dhe (g), (h) dhe (i) më sipër).
- (l) *Heqja e kushtit të shlyerjes.* Një heqje e kushtit të shlyerjes është një opsion riblerjeje i pakushtëzuar që i jep një njësi ekonomike të drejtën të kërkojë aktivitetet e transferuara që janë objekt i disa kushtimeve. Me kusht që një opsion i tillë nuk çon në mbajtjen dhe as në transferimin thelbësisht të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë nga njësi ekonomike, çregjistrimi përjashtohet vetëm deri në masën e shumës së subjektit të riblerjes (duke supozuar se i transferuari nuk mund të shesë aktivitetet). Për shembull, në qoftë se vlera kontabël dhe të ardhurat nga transferimi i aktiveve të kredisë janë 100,000 NJM, dhe çdo kredi individuale mund të rimerret përsëri, por shuma e përgjithshme e kredive që do të mund të riblihen nuk mund të kalojë 10,000 NJM, shuma prej 90,000 NJM e kredive do të kualifikohet për çregjistrim.
- (m) *Opsion me balancë minimale.* Një njësi ekonomike, e cila mund të jetë një transferues, që shërben aktive të transferuara mund të mbajë një opsion me balancë minimale për të blerë aktivitetet e transferuara të mbetura kur shuma e aktiveve të papaguara bie në një nivel të caktuar në të cilin kostoja e shërbimit e këtyre aktiveve bëhet e madhe në raport me përfitimet e shërbimit. Me kusht që një opsion i tillë bën që njësi ekonomike as të mos ruajë, as të mos transferojë kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe i transferuari nuk mund të shesë aktivitetet, çregjistrimi përjashtohet vetëm deri në masën e shumës së aktiveve që është objekt i opsionit të blerjes.
- (n) *Interesat e varura të mbajtura dhe garancitë e kredisë.* Një njësi ekonomike mund t'i ofrojë të transferuarit zgjerimin e kredisë duke i dhënë në varësi disa ose të gjitha interesat e varura të saj të mbajtura në aktivin e transferuar. Nga ana tjetër, një njësi ekonomike mund t'i ofrojë të transferuarit zgjerimin e kredisë në formën e një garancie kredie që do të mund të ishte e pakufizuar ose e kufizuar në një shumë të caktuar. Nëse njësi ekonomike ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit të transferuar, aktivi vazhdon të njihet në tërësinë e tij. Nëse njësi ekonomike mban disa, por jo thelbësisht të gjitha, rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe e ka mbajtur kontrollin, çregjistrimi nuk bëhet deri në masën e shumës së mjeteve monetare ose aktiveve të tjera që mund t'i kërkojë njësi ekonomike të paguajë.

- (o) *E ardhura gjithsej e kontratave të shkëmbimit.*Një njësi ekonomike mund të shesë një aktiv financiar tek i transferuari dhe të lidhë një kontratë shkëmbimi, ku të gjitha flukset monetare të pagesës së interesave nga aktivi bazë i kalojnë njësisë ekonomike në këmbim të një pagese fikse ose me normë variabël dhe çdo rritje ose rënie në vlerën e drejtë të aktivitetit bazë amortizohet nga njësia ekonomike. Në një rast të tillë, është e ndaluar çregjistrimi i të gjitha aktiveve.
- (p) *Kontratave të shkëmbimit për normat e interesit.*Një njësi ekonomike mund të transferojë tek i transferuari një aktiv financiar me normë fikse dhe të lidhë me të transferuarin një kontratë shkëmbimi të normës së interesit për të marrë një normë interesi fikse dhe të paguajë një normë interesi të ndryshueshme të bazuar në një shumë të supozuar që është e barabartë me shumën e principalit të aktivitetit financiar të transferuar. Kontrata e shkëmbimit të normave të interesit nuk e përjashton çregjistrimin e aktivitetit të transferuar nëse pagesat për kontratën e shkëmbimit nuk janë të kushtëzuara nga pagesat që bëhen për aktivin e transferuar.
- (q) *Amortizimi i kontratave të shkëmbimit të normës së interesit.*Një njësi ekonomike mund të transferojë tek i transferuari një aktiv financiar me normë fikse që paguhet me kalimin e kohës, dhe të lidhë një kontratë shkëmbimi me të transferuarin për të marrë një normë interesi fikse dhe të paguajë një normë interesi të ndryshueshme bazuar në një shumë të supozuar. Nëse shuma e supozuar e kontratës amortizohet në mënyrë që ajo të jetë e barabartë me shumën e principalit të aktivitetit financiar të transferuar të papaguar në çdo moment kohor, kontrata e shkëmbimit në përgjithësi do të bëjë që njësia ekonomike të mbajë kryesisht rrezikun e parapagimit, rast në të cilin njësia ekonomike ose vazhdon të njohë të gjithë aktivin e transferuar ose vazhdon të njohë aktivin e transferuar në masën e përfshirjes së vazhdueshme. Në anën tjetër, nëse amortizimi i shumës së supozuar të kontratës së shkëmbimit nuk është i lidhur me shumën e principalit të papaguar të aktivitetit të transferuar, një kontratë shkëmbimi e tillë nuk do të çojë në mbajtjen e rrezikut të parapagimit mbi aktivin. Për këtë arsye, nuk përjashtohet çregjistrimi i aktivitetit të transferuar me kusht që pagesat për kontratën nuk janë të kushtëzuara nga pagesat e interesit të bëra për aktivin e transferuar dhe kontrata nuk çon në mbajtjen nga njësia ekonomike të çfarëdo rreziqeve dhe përfitimeve të tjera të rëndësishme të pronësisë mbi aktivin e transferuar.
- (r) *Pakësimi i vlerës.* Një njësi ekonomike nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rikuperojë flukse nga një aktiv financiar si në tërësinë e tij ashtu dhe ndonjë pjesë të tij.

B3.2.17 Ky paragraf ilustron zbatimin e metodës së përfshirjes së vazhdueshme, kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë ekonomike është në një pjesë të një aktiviteti financiar.

Supozojmë se një njësi ekonomike ka një portofol huash të para pagueshme me kupon dhe normë interesi efektive 10 përqind, dhe që shuma e principalit dhe kostoja e amortizuar është 10,000 NJM. Ajo hyn në një transaksion në të cilin, në këmbim të një pagese prej 9,115NJM, i transferuari fiton të drejtën e arkëtimit për 9,000NJM të principalit plus interesin mbi të për 9.5 përqind. Njësia ekonomike ka të drejtën e arkëtimit për 1,000 NJM të principalit plus interesin 10 përqind mbi të, plus marzhin e tepërt prej 0.5 përqind mbi shumën e mbetur 9,000 NJM të principalit. Arkëtimet nga parapagimet shpërndahen midis njësisë ekonomike dhe të transferuarit në mënyrë proporcionale në raportin 1:9, por çdo mospagim zbritet nga interesi 1,000NJM i njësisë ekonomike deri sa ai të shterojë. Vlera e drejtë e huave në datën e transaksionit është 10, 100 NJM dhe vlera e drejtë e vlerësuar e marzhit shtesë prej 0.5 për qind është 40NJM.

Njësia ekonomike përcakton se i ka transferuar disa rreziqe dhe përfitime të konsiderueshme të pronësisë (për shembull, rrezikun e rëndësishëm të parapagimit), por ka ruajtur edhe disa rreziqe dhe përfitime të konsiderueshme të pronësisë (për shkak të interesit vartës të mbajtur të saj) si dhe ka mbajtur kontrollin. Për këtë arsye ajo zbaton metodën e përfshirjes së vazhdueshme.

Për të zbatuar këtë Standard, njësia ekonomike analizon transaksionet si (a) një mbajtje të një interesi të plotë proporcional të ruajtur për 1,000NJM, plus (b) vartësinë e këtij interesi të mbajtur për të siguruar përmirësimin e kredisë tek marrësi për humbjet nga kredia.

Njësia ekonomike llogarit se 9,090NJM (90% X 10,100 NJM) e shumës së marrë 9,115NJM përfaqëson shumën për pjesën plotësisht proporcionale prej 90 përqind. Pjesa e mbetur e shumës së arkëtuar (25NJM) përfaqëson shumën e arkëtuar nga vartësia e interesit të mbajtur për të siguruar përmirësimin e kredisë tek marrësi për humbjet nga kredia. Përveç kësaj, marzhi i tepërt prej 0,5 përqind paraqet shumën e arkëtuar për aktivet që mbahen për të garantuar kredinë. Prandaj, shuma totale e arkëtuar për aktivin që mbahet për të garantuar kredinë është 65NJM (25NJM + 40NJM).

Njësia ekonomike llogarit fitimin ose humbjen nga shitja e pjesës prej 90 për qind e flukseve të mjeteve monetare. Duke supozuar se vlerat e drejta të pjesës së transferuar 90 për qind dhe pjesës së mbetur 10 për qind veç e veç, nuk janë të disponueshme në datën e transferimit, njësia ekonomike shpërndan vlerën kontabël neto të aktivitetit në përputhje me paragrafin 3.2.14 të SNRF 9 si vijon:

	<i>Vlera e drejtë</i>	<i>Përqindja</i>	<i>Vlera kontabël e shpërndarë</i>
Pjesa e transferuar	9090	90%	9000
Pjesa e mbetur	<u>1010</u>	10%	<u>1000</u>
Gjithsej	<u>10100</u>		<u>10000</u>

Njësia ekonomike llogarit fitimin ose humbjen e saj nga shitja e pjesës prej 90 përqind të flukseve të mjeteve monetare duke zbritur vlerën kontabël të shpërndarë të pjesës së transferuar nga shuma e arkëtuar, d.m.th 90NJM (9,090NJM - 9,000NJM). Vlera kontabël të pjesës së mbajtur nga njësia ekonomike është 1,000NJM.

Përveç kësaj, njësia ekonomike njihet për shprehjen e vazhdueshme që rezulton nga vartësia e interesit të saj të mbajtur për humbjet e kredisë. Prandaj, ajo njihet një aktiv për 1,000NJM (shuma maksimale e mjeteve monetare që nuk do të ketë nën vartësi), dhe një detyrim të lidhur për 1,065 NJM (e cila është shuma maksimale e mjeteve monetare që nuk do të ketë nën varësi, d.m.th 1,000NJM plus vlerën e drejtë të varësisë për 65NJM).

Njësia ekonomike përdor të gjitha të dhënat e mësipërme për ta trajtuar transaksionin si në vijim:

	<i>Debi</i>	<i>Kredi</i>
Aktivi fillestar	—	9000
Aktivi i njohur për varësinë ose interesin e mbetur	1000	—
Aktivi për shumën e arkëtuar në formën e marzhit të tepërt	40	—
Fitim ose humbje (fitim neto nga transferimi)	—	90
detyrimi	—	1065
Mjete monetare të arkëtuara	<u>9115</u>	<u>—</u>
Gjithsej	<u>10155</u>	<u>10155</u>

Menjëherë pas kryerjes së transaksionit, vlera kontabël e aktivitetit është 2040NJM e përbërë nga 1,000NJM, që paraqet koston e shpërndarë të pjesës së mbajtur, dhe 1,040NJM, që përfaqëson përfshirjen shtesë të vazhdueshme të njësisë ekonomike nga vartësia e interesit të saj të mbajtur për humbjet e kredisë (i cili përfshin marzhin e tepërt për 40NJM).

Në periudhat e mëvonshme, njësia ekonomike njihet shumën e arkëtuar nga aktivi që mbahet për të garantuar kredinë (65NJM) në proporcion me kohën, konstaton interesin e aktivitetit të njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe një humbje nga çvlerësimi për aktivitetin e njohur. Si një shembull të këtij të fundit, supozojmë se në vitin e ardhshëm ka një humbje nga zhvlerësimi për kreditë bazë prej 300NJM. Njësia ekonomike zvogëlon aktivitetin e vet të njohur me 600NJM (300NJM në lidhje me interesin e saj të mbajtur dhe 300 NJM në lidhje me përfshirjen shtesë të vazhdueshme që rrjedh nga vartësia e interesit të saj të mbajtur për humbjet nga çvlerësimi), dhe zvogëlon detyrimin e saj të njohur me 300NJM. Rezultati neto ngarkohet në fitim ose humbje për humbjen nga çvlerësimi për 300NJM.

Çregjistrimi i detyrimeve financiare (Seksioni 3.3)

B3.3.1 Një detyrim financiar (ose pjesë e tij) çregjistrohet kur debitori ose:

- (a) zvogëlon detyrimin (ose pjesë të tij), duke paguar kreditorin, normalisht me mjete monetare, aktive të tjera financiare, mallra ose shërbime; ose
 - (b) është shkarkuar ligjërisht nga përgjegjësia kryesore për detyrimin (ose pjesë të tij) ose nga procesi i ligjit ose nga kreditori. (Në qoftë se debitori ka dhënë një garanci ky kusht mund të vazhdojë të jetë ende.)
- B3.3.2 Nëse një emetues i një instrumenti borxhi e riblen këtë instrument, borxhi shlyhet edhe në qoftë se emetuesi është një krijues tregu në këtë instrument ose ka për qëllim ta rishesë atë në të ardhmen e afërt.
- B3.3.3 PAGESA PËR NJË PALË TË TRETË, duke përfshirë besimin (që nganjëherë quhet 'klauzolë për anulim borxhi'), nuk përbën, në vetvete, çlirimin e debitorit nga detyrimi i tij kryesor ndaj kreditorit, në mungesë të lirimimit ligjor.
- B3.3.4 Nëse një debitor paguan një palë të tretë për të marrë përsipër një detyrim dhe njofton kreditorin e tij që pala e tretë ka marrë përsipër detyrimin e borxhit të tij, debitori nuk e çregjistron detyrimin e borxhit përveç rastit kur plotësohet kushti në paragrafin B3.3.1 (b). Në qoftë se debitori paguan një palë të tretë për të marrë përsipër një detyrim dhe lirohet ligjërisht nga kreditori i tij, debitori çlirohet nga borxhi. Megjithatë, në qoftë se debitori bie dakord për t'a bërë pagesat e borxhit palës së tretë ose drejtpërdrejt kreditorit të tij fillestar, debitori njihet një detyrim të ri për borxhin ndaj palës së tretë.
- B3.3.5 Edhe pse lirimimi ligjor, qoftë juridikisht ose nga kreditori, ka si rezultat çregjistrimin e një detyrimi, njësia ekonomike mund të njohë një detyrim të ri nëse nuk janë plotësuar kriteret në paragrafët 3.2.1-3.2.23 për çregjistrimin e aktiveve financiare të transferuara. Nëse këto kriteret nuk janë përmbushur, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen, dhe njësia ekonomike njihet një detyrim të ri lidhur me aktivet e transferuara.
- B3.3.6 Për qëllim të paragrafit 3.3.2, kushtet janë në thelb të ndryshme në qoftë se vlera aktuale e skontuar e flukseve të mjeteve monetare në bazë të kushteve të reja, duke përfshirë çfarëdo pagese neto të çdo tarife të marrë dhe të skontuar duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10 përqind e ndryshme nga vlera aktuale e skontuar e flukseve të mjeteve monetare të mbetura të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikim i termave trajtohet si një shlyerje, çdo kosto ose pagese e bërë njihet si pjesë e fitimit ose humbjes neto nga shuarja e borxhit. Në qoftë se shkëmbimi apo modifikim nuk është trajtuar si një shlyerje, çdo kosto ose pagesë e bërë rregullon vlerën kontabël të detyrimit dhe amortizohet për periudhën e mbetur të detyrimit të modifikuar.
- B3.3.7 Në disa raste, një kreditor e liron një debitor nga detyrimi i tij aktual për të bërë pagesa, por debitori merr përsipër një detyrim garancie për të paguar nëse pala që ka marrë përgjegjësinë kryesore nuk i plotëson zotimet e veta. Në këto rrethana debitori:
- (a) njihet një detyrim financiar të ri të bazuar në vlerën e drejtë të detyrimit të tij për garanci, dhe
 - (b) njihet një fitim ose humbje neto të bazuar në diferencën midis (i) të gjitha shumave të paguara dhe (ii) vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar minus vlerën e drejtë të detyrimit të ri financiar.

Klasifikimi (Kapitulli 4)

Klasifikimi i aktiveve financiare (Seksioni 4.1)

Modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare

- B4.1.1 Paragrafi 4.1.1 (a) kërkon që një njësi ekonomike të klasifikojë aktivet financiare në bazë të modelit të biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e këtyre aktiveve financiare. Një njësi ekonomike vlerëson nëse aktivet e saj financiare përmbushin kushtin në paragrafin 4.1.2 (a) ose kushtin në paragrafin 4.1.2A (a) në bazë të modelit të biznesit siç përcaktohet nga personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike (siç përcaktohet në SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura*).
- B4.1.2 Modeli i biznesit të njësisë ekonomike përcaktohet në një nivel i cili reflekton se si grupet e aktiveve financiare menaxhohen së bashku për të arritur një objektivi të caktuar të biznesit. Modeli i biznesit të njësisë ekonomike nuk varet nga qëllimet e drejtimin për një instrument individual. Prandaj, ky kusht nuk është një mënyrë për të bërë klasifikimin instrument për-instrument dhe duhet të përcaktohet në një nivel më të lartë grupimi. Megjithatë, një njësi ekonomike e veçantë, mund të ketë më shumë se një model biznesi për menaxhimin e instrumenteve të saj financiare. Si pasojë, klasifikimi nuk duhet të përcaktohet në nivelin e njësisë raportuese. Për shembull, një njësi ekonomike mund të mbajë një portofol të investimeve që menaxhon në mënyrë që të mbledhë flukset kontraktuale të mjeteve monetare dhe një tjetër portofol investimesh që ajo e menaxhon në mënyrë që ta tregtojë për të realizuar ndryshimet e vlerës së drejtë. Në mënyrë të ngjashme, në disa rrethana, mund të jetë e përshtatshme për të ndarë një portofol të aktiveve

financiare në nën-portofole për të reflektuar nivelin në të cilin njësia ekonomike menaxhon ato aktive financiare. Për shembull, mund të jetë rasti nëse një njësi ekonomike krijon ose blen një portofol të kredive hipotekare dhe menaxhon disa nga kreditë me qëllim mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe menaxhon kreditë e tjera me qëllim shitjen e tyre.

- B4.1.2A Modeli i biznesit i një njësie ekonomike i referohet faktit se si një njësi ekonomike menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojnë flukse të mjeteve monetare. Që do të thotë, modeli i biznesit të njësise ekonomike përcakton nëse do të ketë flukse e mjeteve monetare nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale, nga shitja e aktiveve financiare, ose nga të dyja. Rrjedhimisht, ky vlerësim nuk është kryer në bazë të atyre skenarëve që njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret që të ndodhin, të tilla si i ashtuquajtur 'Rasti më i keq' ose skenari "rasti i stresit". Për shembull, nëse një njësi ekonomike pret që ajo do të shesë një portofol të veçantë të aktiveve financiare vetëm në një rast stresi, ky skenar nuk do të ndikojë në vlerësimin e modelit të biznesit për ato aktive të njësise ekonomike nëse njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme pret që një skenar i tillë nuk do të ndodhë. Nëse flukset e mjeteve monetare realizohen në një mënyrë që është e ndryshme nga pritshmëritë e njësise ekonomike në datën që njësia ekonomike e kishte vlerësuar modelin e biznesit (për shembull, nëse njësia ekonomike shet më shumë ose më pak aktive financiare nga sa pritej kur ajo ka klasifikuar aktivet), kjo as nuk nënkupton ndonjë gabim të periudhës pararendëse në pasqyrat financiare të njësise ekonomike (shih SNK 8 *Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*) dhe as nuk do të ndryshojë klasifikimin e aktiveve financiare të mbetura të mbajtura në atë model biznesi (d.m.th. ato aktive që njësia ekonomike ka njohur në periudhat e mëparshme dhe ende i mban) për atë kohë sa njësia ekonomike e ka konsideruar të gjithë informacionin përkatës që ka qenë në dispozicion në atë kohë që ajo ka bërë vlerësimin e modelit të biznesit. Megjithatë, kur një njësi ekonomike vlerëson modelin e biznesit për aktivet financiare të sapo krijuara ose të blera rishtas, ajo duhet të marrë parasysh informacionin se si flukset e mjeteve monetare janë realizuar në të kaluarën, së bashku me të gjitha informatat e tjera të përshtatshme.
- B4.1.2B Modeli i biznesit të njësise ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare është një çështje e faktit dhe jo vetëm një pohim. Kjo është zakonisht e dukshme përmes aktiviteteve që njësia ekonomike merr përsipër për të arritur objektivin e modelit të biznesit. Një njësi ekonomike do të duhet të përdorë gjykimin kur ajo vlerëson modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare dhe se vlerësimi nuk përcaktohet nga një faktor apo aktivitet i vetëm. Në vend të kësaj, njësia ekonomike duhet të marrë parasysh të gjithë evidencën përkatëse që është në dispozicion në datën e vlerësimit. Kjo evidencë përkatëse përfshin, por nuk kufizohet:
- (a) se si performanca e modelit të biznesit dhe të aktiveve financiare që mbahen brenda këtij modeli të biznesit janë vlerësuar dhe raportuar tek personeli drejtues kryesor i njësise ekonomike;
 - (b) rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe aktivet financiare të mbajtura brenda atij modelit të biznesit) dhe, në veçanti, mënyra në të cilën këto rreziqe janë menaxhuar; dhe
 - (c) si janë kompensuar drejtuesit e biznesit (për shembull, nëse kompensimi është i bazuar në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në bazë të flukseve monetare kontraktuale të mbledhura).

Një model biznesi objektivi i të cilit është mbajtja e aktiveve me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale.

- B4.1.2C Aktivet financiare që mbahen brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale menaxhohen për të realizuar flukse monetare duke mbledhur pagesat kontraktuale gjatë jetës së instrumentit. Që do të thotë, njësia ekonomike menaxhon aktivet e mbajtura brenda portofolit për të mbledhur këto flukse të mjeteve monetare kontraktuale të veçanta (në vend që të menaxhojë kthimin e përgjithshëm të portofolit qoftë nga mbajtja ashtu dhe nga shitja e aktiveve). Në përcaktimin nëse flukset e mjeteve monetare do të realizohen duke mbledhur flukset monetare kontraktuale të aktiveve financiare, është e nevojshme të marrin në konsideratë shpeshësinë, vlerën dhe kohën e shitjes në periudhat e mëparshme, arsyet për këto shitje dhe pritshmëritë rreth aktivitetit të ardhshëm të shitjes. Megjithatë shitjet në veten e tyre nuk e përcaktojnë modelin e biznesit dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohen në mënyrë të izoluar. Në vend të kësaj, informacioni në lidhje me shitjet në të shkuarën dhe pritshmëritë për shitjet në të ardhmen na sigurojnë dëshmi në lidhje me mënyrën se si është arritur objektivi i deklaruar i njësise ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare dhe, në veçanti, si janë realizuar flukset e mjeteve monetare. Një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë informacionin në lidhje me shitjet në të shkuarën brenda kontekstit të arsyeve për këto shitje dhe kushtet që ekzistonin në atë kohë në krahasim me kushtet aktuale.
- B4.1.3 Edhe pse objektivi i modelit të biznesit të një njësie ekonomike mund të jetë për të mbajtur aktive financiare në mënyrë që të mbledhë flukse kontraktuale të mjeteve monetare, njësia ekonomike nuk duhet të mbajë të gjitha këto instrumente deri në maturim. Kështu, modeli i biznesit i një njësie ekonomike mund të jetë për të

mbajtur aktivet financiare që të mbledhë flukse kontraktuale monetare edhe kur ndodh ose parashikohet të ndodhë në të ardhmen shitja e aktiveve financiare.

- B4.1.3A** Modeli i biznesit mund të jetë që të mbajë aktivet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale edhe nëse njësia ekonomike shet aktive financiare kur ka një rritje në rrezikun e kredisë të këtyre aktiveve. Për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje në rrezikun e kredisë së aktiveve, njësia ekonomike merr parasysh informacionin e arsyeshme dhe të mbështetur, duke përfshirë edhe informacion që i përket të ardhmes. Pavarësisht nga frekuenca e tyre dhe vlera, shitjet për shkak të një rritje në riskun e kredisë së aktiveve nuk janë në kundërshtim me një model biznesi objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, sepse cilësia e kredisë së aktiveve financiare është e rëndësishme për aftësinë e njësisë ekonomike për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Aktivitetet e menaxhimit të riskut të kredisë të cilat synojnë minimizimin e humbjeve të mundshme të kredisë për shkak të përkeqësimit të kredisë janë pjesë përbërëse të një modeli të tillë biznesi. Shitja e një aktiv financiar sepse ai nuk plotëson më kriteret e kreditit të specifikuar në politikën e dokumentuar të investimit të njësisë ekonomike është një shembull i një shitje që ka ndodhur për shkak të një rritje në rrezikun e kredisë. Megjithatë, në mungesë të një politike të tillë, njësia ekonomike mund të demonstrojë në mënyra të tjera se shitja ka ndodhur për shkak të një rritje në rrezikun e kredisë.
- B4.1.3B** Shitjet që ndodhin për arsye të tjera, të tilla si shitja e bërë për të menaxhuar rrezikun e përqendrimit të kredisë (pa një rritje në riskun e kredisë së aktiveve), mund gjithashtu të jetë në përputhje me një model biznesi objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Në veçanti, shitjet e tilla mund të jenë në përputhje me një model biznesi objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale në qoftë se këto shitjet nuk janë të shpeshta (edhe pse të rëndësishme në vlerë) ose të parëndësishme në vlerë si individualisht dhe në total (edhe pse të shpeshta). Në qoftë se janë bërë më shumë se sa disa shitje nga një 'portofol', dhe këto shitje janë më shumë sesa të parëndësishme në vlerë (qoftë individualisht ose në total), njësia ekonomike duhet të vlerësojë nëse dhe si shitje të tilla janë në përputhje me qëllimin e mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale. Nëse një palë e tretë imponon kërkesën për të shitur aktivet financiare, apo që aktiviteti është në gjykimin e njësisë ekonomike, kjo nuk ka lidhje me këtë vlerësim. Një rritje në frekuencën apo vlerën e shitjeve në një periudhë të caktuar nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me një objektiv për të mbajtur aktive financiare në mënyrë që të mbledhë flukse monetare kontraktuale, nëse një njësi ekonomike mund të shpjegojë arsyet për këto shitje dhe të tregojë pse këto shitje nuk reflektojnë një ndryshim në modelin e biznesit të njësisë ekonomike. Përveç kësaj, shitjet mund të jenë në përputhje me objektivin e mbajtjes së aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nëse shitjet janë bërë afër datës së maturimit të aktiveve financiare dhe të ardhurat nga shitja ti përfaqësojnë në kohë arkëtimeve të flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të mbetura.
- B4.1.4** Në vijim janë shembujt se kur mund të jetë objektiv i modelit të biznesit të një njësie ekonomike për të mbajtur aktive financiare që të mbledhë flukse monetare kontraktuale. Kjo listë e shembujve nuk është përfundimtare. Për më tepër, shembujt nuk kanë për qëllim për të diskutuar mbi të gjithë faktorët që mund të jenë të përshtatshëm për vlerësimin e modelit të biznesit të njësisë ekonomike dhe as për të përcaktuar rëndësinë relative të faktorëve.

Shembull	Analiza
<p>Shembulli 1</p> <p>Një njësi ekonomike mban investimet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale të tyre. Nevojat e financimit të njësisë ekonomike janë të parashikueshme dhe maturimi i aktiveve të saj financiare përputhet me nevojat e vlerësuara të njësisë ekonomike për financim.</p> <p>Njësia ekonomike kryen aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të kredisë me qëllim të minimizojë humbjet e kredisë. Në të kaluarën, shitjet kanë ndodhur në mënyrë tipike, kur rreziku i kredisë së aktiveve financiare është rritur i tillë që aktivet nuk plotësojnë më kriteret e kreditit specifikuar në politikën e investimit të dokumentuar të njësisë ekonomike. Përveç kësaj, shitjet rrallë kanë ndodhur si rezultat i nevojave të papritura për financim.</p> <p>Raportet për personelin drejtues kryesor përqendrohen në cilësinë e kredisë së aktiveve financiare dhe raportin e kthimit kontraktual. Njësia ekonomike gjithashtu monitoron vlerat e drejta të aktiveve financiare, midis informacioneve të tjera.</p>	<p>Edhe pse njësia ekonomike merr parasysh, ndër të dhëna të tjera, vlerën e drejtë të aktiveve financiare nga këndvështrimi i likuiditetit (d.m.th. shuma monetare që do të realizohet nëse njësia ekonomike duhet t'i shesë aktivet) qëllimi i njësisë ekonomike është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhë flukset monetare kontraktuale. Shitjet nuk do të kundërshtojnë këtë objektiv në qoftë se ato ishin në përgjigje të një rritje në rrezikun e kredisë së aktiveve, për shembull nëse aktivet nuk plotësojnë më kriteret e kreditit të specifikuar në politikën e investimit të dokumentuar të njësisë ekonomike. Shitjet e rralla që rezultojnë nga nevoja të papritura të financimit (p.sh. në një rast skenar stresi) gjithashtu nuk do të kundërshtojnë këtë objektiv, edhe pse shitjet e tilla janë të rëndësishme në vlerë.</p>
<p>Shembulli 2</p> <p>Një model biznesi i një njësie ekonomike është blerja e portofolave të aktiveve financiare, të tilla si kreditë. Këto portofole mund ose nuk mund të përfshijnë aktive financiare që janë me kredit të çvlerësuar.</p> <p>Nëse pagesa për kreditë nuk bëhet në kohën e duhur, njësia ekonomike përpigjet të çlirojë flukset monetare kontraktuale me mjete të ndryshme-për shembull, duke kontaktuar me debitorin me telefon, postë elektronike ose metoda të tjera. Objektivi i njësisë ekonomike është që të mbledhë flukset monetare kontraktuale dhe njësia ekonomike nuk mban ndonjë prej kredive në këtë portofol me një objektiv për të realizuar flukse monetare nga shitja e tyre.</p> <p>Në disa raste, njësia ekonomike hyn në kontrata këmbimi të normës së interesit për të ndryshuar normën e interesit për aktive financiare të veçanta në një portofol nga një normë interesi të ndryshueshme në një normë interesi fikse.</p>	<p>Objektivi i modelit të biznesit të njësisë ekonomike është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukset monetare kontraktuale.</p> <p>E njëjta analizë do të zbatohet edhe në qoftë se njësia ekonomike nuk pret të arkëtojë të gjitha flukset e mjeteve monetare kontraktuale (p.sh. disa prej aktiveve financiare janë me kredit të çvlerësuar që në njohjen fillestare).</p> <p>Për më tepër, fakti që njësia ekonomike hyn në derivativë për të modifikuar flukset e mjeteve monetare të portofolit, në vetvete, nuk ndryshon modelin e biznesit të njësisë ekonomike.</p>

Shembull	Analiza
<p>Shembulli 3</p> <p>Një njësi ekonomike ka një model biznesi me objektivin e krijimit të kredive për klientët dhe më pas për t'ia shitur këto kredi një agjenti krijues instrumentesh financiare. Agjenti i emeton instrumentet tek investitorët.</p> <p>Njësia ekonomike krijuese kontrollon agjentin dhe kështu e konsolidon atë.</p> <p>Agjenti mbledh flukset monetare kontraktuale nga kreditë dhe i kalon ato tek investitorët.</p> <p>Supozohet për qëllime të këtij shembulli se kreditë vazhdojnë të njihen në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar, sepse ato nuk janë çregjistruar nga agjenti.</p>	<p>Grupi i konsoliduar i krijon kreditë me objektivin e mbajtjes së tyre për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.</p> <p>Megjithatë, njësia ekonomike krijuese ka një objektiv të realizimit të flukseve monetare nga portofoli i kredisë duke ia shitur kreditë agjentit, kështu që menaxhimi i këtij portofoli për të mbledhur flukset monetare kontraktuale nuk do të konsiderohet për qëllime të pasqyrave financiare individuale.</p>
<p>Shembulli 4</p> <p>Një institucion financiar mban aktive financiare për të përmbushur nevojat për likuiditet në një skenar "rast stresi" (p.sh., tërheqje masive e depozitave nga banka). Njësia ekonomike nuk parashikon shitjen e këtyre aktiveve, përveç se në skenarë të tillë.</p> <p>Njësia ekonomike monitoron cilësinë e kredisë së aktiveve financiare dhe objektivat e saj në menaxhimin e aktiveve financiare që është mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale. Njësia ekonomike vlerëson performancën e aktiveve në bazë të të ardhurave nga interesi të fituara dhe humbjet e realizuara nga kredia.</p> <p>Megjithatë, njësia ekonomike gjithashtu monitoron vlerën e drejtë të aktiveve financiare nga këndvështrimi i likuiditetit për të siguruar që shuma e parave që do të realizohet nëse njësia ekonomike do t'i nevojitej të shiste aktivet në një rast skenar stresi do të ishte e mjaftueshme për të përmbushur nevojat për likuiditet të njësisë ekonomike. Periodikisht, njësia ekonomike bën shitje që janë të parëndësishëm në vlerë për të krijuar likuiditet.</p>	<p>Objektivi i modelit të biznesit të njësisë ekonomike është që të mbajë aktivet financiare, të mbledhë flukset monetare kontraktuale.</p> <p>Analiza nuk do të ndryshojë edhe nëse gjatë një skenari të mëparshëm rast stresi njësia ekonomike do të kishte shitje që janë të rëndësishme në vlerë në mënyrë që të plotësojnë nevojat e saj për likuiditet. Në mënyrë të ngjashme, veprimtari të përsëritura shitjeje që janë të parëndësishme në vlerë nuk janë në kundërshtim me mbajtjen e aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.</p> <p>Në të kundërt, në qoftë se një njësi ekonomike mban aktive financiare për të plotësuar nevojat e saj për likuiditet të përditshëm dhe përmbushja e këtij objektivi përfshin shitjet e shpeshta që janë të rëndësishme në vlerë, objektivi i modelit të biznesit të njësisë ekonomike nuk është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.</p> <p>Në mënyrë të ngjashme, nëse njësisë ekonomike i kërkohet nga rregullatori i saj që në mënyrë rutinë të shesë aktivet financiare për të demonstruar se aktivet janë të transferueshme në likuiditet, dhe vlera e aktiveve të shitura është e rëndësishme, modeli i biznesit të njësisë ekonomike nuk është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Nëse një palë e tretë imponon kërkesën për të shitur aktivet financiare, apo që aktiviteti është në gjykimin e njësisë ekonomike, kjo nuk ka lidhje me këtë analizë.</p>

Një model biznesit, objektivi i të cilit është arritur si duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare

B4.1.4A Një njësi ekonomike mund të mbajë aktive financiare në një model biznesi, objektivi i të cilit është arritur si duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare. Në këtë lloj të modelit të biznesit, personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike ka marrë një vendim që si aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ashtu dhe shitjet e aktiveve financiare janë pjesë integrale për të arritur objektivin e modelit të biznesit. Ka objektiva të ndryshme që mund të jenë në

përputhje me këtë lloj të modelit të biznesit. Për shembull, objektivi i modelit të biznesit mund të jetë për të menaxhuar nevojat e përditshme të likuiditetit, për të mbajtur një profil të veçantë të nivelit të interesit apo të përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që ato aktive financojnë. Për të arritur një objektiv të tillë, njësi ekonomike do të mbledhë si flukse monetare kontraktuale por edhe do të shesë aktive financiare.

- B4.1.4B Krahasuar me një model biznesi objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, ky model biznesi në mënyrë tipike do të përfshinte një frekuencën më të madhe dhe vlerë më të madhe të shitjeve. Kjo është për shkak se shitja e aktiveve financiare është pjesë integrale e arritjes së objektivit të modelit të biznesit në vend të të qenit vetëm i rastësishëm për të. Megjithatë, nuk ka prag për frekuencën apo vlerën e shitjeve që duhet të ndodhin në këtë model të biznesit për shkak se si mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare janë pjesë përbërëse për të arritur objektivin e tij.
- B4.1.4C Në vijim janë shembujt se kur objektivi i modelit të biznesit të njësisë ekonomike mund të arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu dhe nga shitja e aktiveve financiare. Kjo listë e shembujve nuk është përfundimtare. Për më tepër, shembujt nuk kanë për qëllim për të përshkruar të gjithë faktorët që mund të jenë të përshtatshëm për vlerësimin e modelit të biznesit të njësisë ekonomike dhe as për të përcaktuar rëndësinë relative të faktorëve.

Shembull	Analiza
<p>Shembulli 5</p> <p>Një njësi ekonomike parashikon shpenzimet kapitale në disa vjet. Njësia ekonomike investon paratë e saj të tepërta në aktive financiare afatshkurtra dhe afatgjata në mënyrë që ajo të mund të financojë shpenzimet kur lind nevoja. Shumë prej aktiveve financiare kanë jetë kontraktuale që tejkalojnë periudhën e investimeve të parashikuara të njësisë ekonomike.</p> <p>Njësia ekonomike do të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe, kur lind një mundësi, ajo do të shesë aktivet financiare për të ri-investuar paratë në aktive financiare me një kthim më të lartë.</p> <p>Menaxherët përgjegjës për portofolin shpërblehen në bazë të normës së kthimit të përgjithshëm që gjeneron portofoli.</p>	<p>Objektivi i një model biznesi është arritur si duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare Njësia ekonomike do të marrë vendime në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me faktin nëse mbledhja e flukseve monetare kontraktuale apo shitja e aktiveve financiare do të maksimizojë normën e kthimit të portofolit derisa të lindë nevoja për paratë e investuara.</p> <p>Në të kundërt, konsiderohet një njësi ekonomike që parashikon një dalje të parave për pesë vjet për të financuar shpenzimet kapitale dhe investon paratë e tepërta në aktive financiare afatshkurtra. Kur investimet maturaohen, njësia ekonomike ri investon të holla në aktive të reja financiare afatshkurtra. Subjekti mban këtë strategji derisa lind nevoja për fonde, kohë në të cilën njësia ekonomike përdor të ardhurat nga aktivet financiare të maturuara për të financuar shpenzimet kapitale. Vetëm shitjet që janë të parëndësishme në vlerë ndodhin para datës së të pjekurisë (përveç nëse ka një rritje në rrezikun e kredisë). Objektivi i këtij modeli kundërt biznesi është që të mbajë aktivet financiare dhe të mbledhë flukset monetare kontraktuale.</p>

Shembull	Analiza
<p>Shembulli 6</p> <p>Një institucion financiar mban aktive financiare për të përmbushur nevojat e saj të përditshme të likuiditetit. Njësia ekonomike kërkon të minimizojë kostot e menaxhimit të këtyre nevojave për likuiditet dhe për këtë arsye në mënyrë aktive menaxhon normën e kthimit të portofolit. Kjo normë kthimi konsiston në mbledhjen e pagesave kontraktuale si dhe fitimet dhe humbjet nga shitja e aktiveve financiare.</p> <p>Si rezultat, njësia ekonomike mban aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe shet aktivet financiare për të investuar në aktive financiare me kthim më të lartë ose që të përputhë më mirë kohëzgjatjen e detyrimeve të saj. Në të kaluarën, kjo strategji ka rezultuar në aktivitete të shpeshta të shitjes dhe këto shitjet kanë qenë të mëdha në vlerë. Ky aktivitet pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen.</p>	<p>Objektivi i modelit të biznesit është për të maksimizuar kthimin e portofolit për të përmbushur nevojat e përditshme të likuiditetit dhe njësia ekonomike arrin këtë objektivi si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu dhe nga shitja e aktiveve financiare. Me fjalë të tjera, të dyja të mbledhja flukse monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare janë pjesë përbërëse për të arritur objektivin e modelit të biznesit.</p>
<p>Shembulli 7</p> <p>Një sigurues mban aktive financiare në mënyrë për të financuar detyrimet e kontratës së sigurimit. Siguruesi përdor të ardhurat nga flukset e mjeteve monetare kontraktuale mbi aktivet financiare të shlyejë detyrimet e kontratës së sigurimit ashtu siç atyre i vjen afati. Për të siguruar që flukset e mjeteve monetare kontraktuale nga aktivet financiare janë të mjaftueshme për të shlyer këto detyrime, siguruesi merr përsipër aktivitet të rëndësishëm blerje dhe shitje në mënyrë të rregullt për të ri balancuar portofolin e saj të aktiveve dhe për të përmbushur nevojat për flukse monetare që mund të dalin.</p>	<p>Objektivi i modelit të biznesit është për të financuar detyrimet e kontratës së sigurimit. Për të arritur këtë objektivi, njësia ekonomike mbledh flukset monetare kontraktuale siç ato maturohen dhe shet aktivet financiare për të ruajtur profilin e dëshiruar të portofolit të aktiveve. Kështu të dyja, si mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare janë pjesë përbërëse për të arritur objektivin e modelit të biznesit.</p>

Modele të tjera të biznesit

- B4.1.5 Aktivet financiare janë matur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ata nuk janë të mbajtur brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit është arritur si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe nga shitja e aktiveve financiare (por shih edhe paragrafin 5.7.5). Një model biznesi që rezulton në matjen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është ai në të cilën një njësi ekonomike menaxhon mjetet financiare me qëllim të realizimit të flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve. Njësia ekonomike merr vendime të bazuara në vlerat e drejta të këtyre aktiveve dhe menaxhon aktivet për të realizuar këto vlera të drejta. Në këtë rast, objektivi i njësisë ekonomike në mënyrë tipike do të rezultojë në blerjen dhe shitjen e aktiveve. Edhe pse njësia ekonomike do të mbledhë flukset monetare kontraktuale ndërsa ajo mban aktivet financiare, objektivi i një modeli të tillë biznesi nuk është arritur nga nga të dyja, si mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare. Kjo është për shkak se mbledhja e flukseve monetare kontraktuale nuk është pjesë integrale e arritjes së objektivit të modelit të biznesit; përkundrazi, ajo është e rastësishme për të.
- B4.1.6 Një portofol aktivesh financiare që menaxhohet dhe performanca e të cilit vlerësohet në bazë të vlerës së drejtë (siç përshkruhet në paragrafin 4.2.2 (b)) nuk mbahet as për të mbledhur flukse monetare kontraktuale

dhe as për të dyja, mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare njëkohësisht. Njësia ekonomike është e përqendruar kryesisht në informacionin për vlerën e drejtë dhe përdor këtë informacion për të vlerësuar performancën e aktiveve dhe për të marrë vendime. Përveç kësaj, një portofol aktivesh financiare që plotëson përkufizimin si e mbajtur për tregtim, nuk mbahet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale apo për të dyja, për të mbledhur e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur aktivet financiare. Për portofole të tilla, mbledhja e flukseve monetare kontraktuale është dytësore për të arritur objektivin e modelit të biznesit. Si pasojë, këto portofole instrumentesh financiare duhet të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Flukset e mjeteve monetare kontraktuale të cilat janë pagesa vetëm të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar

- B4.1.7 Paragrafi 4.1.1 (b), nëse nuk zbatohet paragrafi 4.1.5, kërkon që një njësi ekonomike të klasifikojë një aktiv financiar në bazë të karakteristikave të tij kontraktuale të fluksit të mjeteve monetare nëse aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit është arritur nga të dyja si mbajtjen e aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ashtu dhe nga shitja e aktiveve financiare. Për ta bërë këtë, kushti në paragrafin 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A (b) kërkon që njësia ekonomike për të përcaktuar nëse flukset monetare kontraktuale të aktivitetit janë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar.
- B4.1.7A Flukset e mjeteve monetare kontraktuale të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies. Në një marrëveshje bazë të huadhënies, shumën për vlerën në kohë të parasë (shih paragrafët B4.1.9A-B4.1.9E) dhe rreziku i kredisë janë zakonisht elementet më të rëndësishme të interesit. Megjithatë, në një marrëveshje të tillë, interesi mund të përfshijë edhe shumën për rreziqet e tjera bazë të huadhënies (për shembull, rrezikut të likuiditetit) dhe shpenzimeve (për shembull, shpenzimet administrative) që lidhen me mbajtjen e aktivitetit financiar për një periudhë të caktuar kohore. Përveç kësaj, interesi mund të përfshijë një marzh fitimi që është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies. Në rrethana ekstreme ekonomike, interesi mund të jetë negativ nëse, për shembull, mbajtësi i një aktivi financiar ose në mënyrë eksplicite ose të nënkuptuar paguan për depozitimin e parave të tij për një periudhë të caktuar kohore (dhe që kjo tarifë e kalon shumën që mbajtësi merr për vlerën në kohë e parasë, rrezikun e kredisë dhe rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe kostot). Megjithatë, kushtet e kontratës që paraqesin ekspozimin ndaj rreziqeve apo luhatshmërisë së flukseve monetare kontraktuale që është e lidhur me një marrëveshje bazë të huadhënies, të tilla si ekspozimi ndaj ndryshimeve në çmimet e kapitalit ose të çmimeve të mallrave, nuk do të japin rritje të flukseve monetare kontraktuale që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Një aktiv financiar i krijuar ose i blerë mund të jetë një marrëveshje bazë huadhënie pavarësisht nëse ajo është një kredi në formën e saj ligjore.
- B4.1.7B Në përputhje me paragrafin 4.1.3 (a), principalit është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. Megjithatë kjo shumë e principalit mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivitetit financiar (për shembull, në qoftë se ka shlyerje të principalit).
- B4.1.8 Një njësi ekonomike do të vlerësojë nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar në monedhën me të cilën aktivi financiar është shprehur.
- B4.1.9 Leva është një karakteristikë e fluksit monetar kontraktual të disa aktiveve financiare. Leva rrit ndryshueshmërinë e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të cilat nuk kanë karakteristikat ekonomike të interesit. Opsioni i veçuar dhe kontratat e të ardhmes janë shembuj të aktiveve financiare që përfshijnë këtë levë. Kështu, kontratat e tilla nuk i plotësojnë kushtet në paragrafët 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A (b) dhe nuk mund të maten më pas me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Shuma që paguhet për vlerën në kohë të parasë

- B4.1.9A Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që paguhet vetëm për kalimin e kohës. Që është, vlera në kohë e elementit para nuk na jep ndonjë shumë për rreziqet ose shpenzimet e tjera të lidhura me mbajtjen aktivitetit financiar. Për të vlerësuar nëse elementi ofron pagesën vetëm për kalimin e kohës, një njësi ekonomike zbaton gjykimin dhe e konsideron faktorët përkatës siç janë monedha në të cilën aktivi financiar është i shprehur dhe periudha për të cilën është vendosur norma e interesit.
- B4.1.9B Megjithatë, në disa raste, vlera në kohë e elementit para mund të modifikohet (d.m.th nuk është e përsosur). Kjo do të ishte rasti, për shembull, nëse norma e interesit të një aktivi financiar rishikohet periodikisht por frekuenca e rishikimit nuk përputhet me kohën e normës së interesit (për shembull, normat e interesit

rishikohen çdo muaj bazuar në nivelin e normës vjetore të interesit) ose në qoftë se norma e interesit të një aktivi financiar rishikohet periodikisht bazuar në një mesatare të veçantë të normave afatgjata dhe afatshkurtra të interesit. Në të tilla raste, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë modifikimin për të përcaktuar nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Në disa rrethana, njësi ekonomike mund të jetë në gjendje për ta bërë këtë përcaktim duke kryer një vlerësim cilësor të vlerës në kohë të elementit para ndërsa, në rrethana të tjera, mund të jetë e nevojshme për të kryer një vlerësim sasior.

- B4.1.9C** Kur vlerësojmë modifikimin e vlerës në kohë të elementit para, objektivi është për të përcaktuar se sa ndryshojnë flukset monetare kontraktuale (të pa skontuara) nga flukset e mjeteve monetare (të pa skontuara) që do të lindin në qoftë se vlera në kohë e elementit para nuk do të ishte ndryshuar (fluksi i mjeteve monetare si pikë referuese). Për shembull, në qoftë se aktivi financiar që vlerësohet përmban një normë interesi të ndryshueshme që rishikohet çdo muaj bazuar në një normë interesi vjetore, njësi ekonomike do të krahasojnë atë aktiv financiar me një instrument financiar me kushte të njëjta kontraktuale dhe rrezik të njëjtë të kredisë me përjashtim që norma e interesit e ndryshueshme rishikohet çdo muaj bazuar në një normë interesi një mujore. Nëse vlera e modifikuar në kohë e elementit para mund të rezultojë në flukset e mjeteve monetare kontraktuale (të pa skontuara) që janë dukshëm të ndryshme nga flukset monetare (të pa skontuara) të pikës referuese, aktivi financiar nuk i plotëson kushtet në paragrafët 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A (b). Për të bërë këtë përcaktim, njësi ekonomike duhet të marrë parasysh efektin e vlerës së modifikuar në kohë të elementit para në çdo datë raportimi dhe në mënyrë kumulative mbi jetën e instrumentit financiar. Arsyeja që norma e interesit vendoset në këtë mënyrë nuk është relevante për analizën. Në qoftë se është e qartë, me pak ose aspak analizë, nëse flukset monetare kontraktuale (të pa skontuara) për aktivin financiar që vlerësohet mund (ose nuk mund) të jenë dukshëm më të ndryshme nga flukset monetare (të pa skontuara) të pikës referuese, një njësi ekonomike nuk ka nevojë të kryejë një vlerësim të detajuar.
- B4.1.9D** Kur vlerësojmë vlerën e modifikuar në kohë të elementit para, një njësi ekonomike duhet të marrë parasysh faktorët që mund të ndikojnë në flukset monetare kontraktuale të ardhshme. Për shembull, nëse një njësi ekonomike është duke vlerësuar një obligacion me një afat pesëvjeçar dhe norma e ndryshueshme e interesit rishikohet çdo gjashtë muaj bazuar në normën pesë-vjeçare, njësi ekonomike nuk mund të konkludojë se flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar thjesht sepse kurba e normës së interesit në kohën e vlerësimit është e tillë që ndryshimi midis një normë interesi pesëvjeçare dhe një normë interesi prej gjashtë muajsh nuk është i rëndësishëm. Në vend të kësaj, njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse marrëdhënia në mes të normës së interesit pesëvjeçar dhe normës së interesit prej gjashtë muajsh mund të ndryshojë gjatë jetës së instrumentit në mënyrë të tillë që flukset monetare kontraktuale (të pa skontuara) gjatë jetës së instrumentit mund të jenë në mënyrë të konsiderueshme ndryshe nga flukset e mjeteve monetare (pa skontuara) të fluksit të mjeteve monetare të pikës së referimit. Megjithatë, një njësi ekonomike duhet të marrë parasysh vetëm skenarët e arsyeshëm dhe jo çdo skenar të mundshëm. Nëse një njësi ekonomike arrin në përfundimin se flukset monetare kontraktuale (të pa skontuara) mund të jenë shumë të ndryshëm nga flukset monetare (të pa skontuara) të pikës së referimit, aktivi financiar nuk i plotëson kushtet në paragrafin 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A (b) dhe për këtë arsye nuk mund të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse.
- B4.1.9E** Në disa vende, qeveria apo një autoritet rregullator përcaktojnë normat e interesit. Për shembull, këto rregullime të qeverisë të normave të interesit mund të jenë pjesë e një politike të gjerë makroekonomike ose ajo mund të jetë vendosur për të inkurajuar subjektet për të investuar në një sektor të caktuar të ekonomisë. Në disa prej këtyre rasteve, objektivi i vlerës në kohë të elementit para nuk është vetëm të sigurojë interesa për kalimin e kohës. Megjithatë, pavarësisht nga paragrafët B4.1.9A-B4.1.9D, një normë interesi e rregulluar do të konsiderohet si një garanci për vlerën në kohë të elementit para me qëllim të zbatimit kushtit në paragrafët 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A (b) në qoftë se norma e interesit na jep një shumë që është gjerësisht në përputhje me kalimin e kohës dhe nuk na ekspozon ndaj rreziqeve apo të luhatshmërisë të flukseve monetare kontraktuale që janë në kundërshtim me një marrëveshje bazë të huadhënies.

Kushtet e kontratës që ndryshojnë afatin/ kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale

- B4.1.10** Nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale (për shembull, në qoftë se aktivi mund të jetë parapaguar para maturimit ose afati i tij mund të zgjatet), njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale që mund të lindin gjatë jetës së instrumentit për shkak të këtij elementi kontraktual janë pagesa vetëm të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Për të bërë këtë përcaktim, njësi ekonomike duhet të vlerësojë flukset e mjeteve monetare kontraktuale që mund të lindin si para, ashtu dhe pas ndryshimit të flukseve të mjeteve monetare kontraktuale. Njësi ekonomike mund gjithashtu të ketë nevojë për të vlerësuar natyrën e çdo ngjarje të kushtëzuar (d.m.th. shkaktarin) që do të ndryshonin kohën

ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale. Ndërsa natyra e ngjarjes të kushtëzuar në vetvete nuk është një faktor përcaktues në vlerësimin nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe të interesit, por mund të jetë një tregues. Për shembull, krahasoni një instrument financiar me një normë interesi që rishikohet bazuar në një normë më të lartë në qoftë se debitori nuk bën një numër të caktuar të pagesave të një instrumenti financiar me një normë interesi që rishikohet bazuar në një normë më të lartë nëse një indeks i veçantë i kapitalit neto arrin një nivel të caktuar. Kjo është me shumë gjasa rasti që flukset e mjeteve monetare kontraktuale mbi jetën e instrumentit do të jenë pagesa vetëm të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar për shkak të marrëdhënieve midis pagesave që nuk janë bërë dhe një rrezikut në rritje të kredisë. (Shiko gjithashtu paragrafin B4.1.18.)

- B4.1.11 Shembujt e mëposhtëm janë raste të kushteve kontraktuale që rezultojnë në flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar:
- (a) një normë interesi e ndryshueshme që konsiston në shpërblimin për vlerën në kohë të parasë, rreziku i kredisë i lidhur me shumën e principalit të pa paguar gjatë një periudhe të caktuar kohe (shuma për rrezikun e kredisë mund të përcaktohet vetëm në momentin e njohjes fillestare, dhe kështu mund të fiksohet) dhe kostot dhe rreziqet e tjera bazë të huadhënies, si dhe një marzh fitimi;
 - (b) një kusht kontraktual që lejon emetuesin (d.m.th. debitorin) të parapaguajë një instrument borxhi ose lejon mbajtësin (d.m.th. kreditorin) për të kthyer një instrument borxhi përsëri tek emetuesi para maturimit dhe shuma e parapagimit në thelb paraqet shumat e papaguara të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës; dhe
 - (c) një kusht kontraktual që lejon emetuesin ose mbajtësin të zgjasë afatin kontraktual të një instrumenti borxhi (d.m.th. një opsion zgjatje) dhe kushtet e rezultatit të zgjatjes së opsionit në flukset e mjeteve monetare kontraktuale gjatë periudhës së zgjatur që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për zgjatjen e kontratës.
- B4.1.12 Pavarësisht paragrafit B4.1.10, një aktiv financiar që ndryshe do të plotësonte kushtin në paragrafin 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A (b), por nuk e bëjnë këtë vetëm si rezultat i një kushti kontraktual që lejon (ose kërkon) emetuesin të parapaguajë një instrument borxhi ose lejon (ose kërkon) mbajtësin për ti kthyer mbrapsht një instrument borxhi emetuesit para maturimit mund të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (që i nënshtrohet plotësimit kushtin në paragrafin 4.1.2 (a) ose kushtit në paragrafin 4.1.2A (a)) nëse:
- (a) njëësia ekonomike ka blerë ose ka krijuar aktivin financiar me fitim ose zbritje në krahasim me shumën kontraktuale të deklaruar;
 - (b) shuma e parapagimit në thelb paraqet shumën kontraktuale të deklaruar dhe përlogaritur (por të papaguar) interesin kontraktual, i cili mund të përfshijë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës; dhe
 - (c) kur njëësia ekonomike fillimisht njeht aktivin financiar, vlera e drejtë e parapagimit është e parëndësishme.
- B4.1.12A Për qëllimin e zbatimit të paragrafëve B4.1.11 (b) dhe B4.1.12 (b), pavarësisht nga ngjarja ose rrethana që shkakton ndërprerjen e parakohshme të kontratës, njëra palë mund të paguajë **ose** të marrë kompensim të arsyeshëm për atë ndërprerje të parakohshme. Për shembull, një palë mund të paguajë ose të marrë kompensim të arsyeshëm kur zgjedh të ndërpresë kontratën më herët (ose përndryshe shkakton ndërprerjen e parakohshme të saj).
- B4.1.13 Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë flukset monetare kontraktuale që janë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Kjo listë e shembujve nuk është përfundimtare.

Instrumenti	Analiza
<p>Instrumenti A</p> <p>Instrumenti A është një obligacion me një datë maturimi të deklaruar. Pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar janë të lidhura me një indeks inflacioni të monedhës në të cilën instrumenti është emetuar. Lidhja e inflacionit nuk ka ndikim dhe principalit është i mbrojtur.</p>	<p>Flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Zinxhiri i pagesave të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar me një indeks inflacioni të pa ndikueshëm rregullon vlerën në kohë të parasë në një nivel aktual. Me fjalë të tjera, norma e interesit për instrumentin pasqyron interesin "e vërtetë". Kështu, shumat e interesit janë shuma për vlerën në kohë të parasë mbi shumën e principalit të papaguar.</p> <p>Megjithatë, në qoftë se pagesat e interesit do të ishin të indeksuara në një tjetër tregues të ndryshueshëm si performanca e debitorit (p.sh. të ardhurat neto të debitorit) ose në një indeks kapitalit neto, flukset monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar (vetëm nëse indeksimi tek rezultatet e performancës së debitorit rezultojnë në një rregullim që vetëm kompenson mbajtësin për ndryshimet në rrezikun e kredisë të instrumentit, të tilla që flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit). Kjo është për shkak se flukset monetare kontraktuale pasqyrojnë një kthim që është në kundërshtim me një marrëveshje bazë të huadhënies (shih paragrafin B4.1.7A).</p>
<p>Instrumenti B</p> <p>Instrumenti B është një instrument me normë interesi variabël me një datë maturimi të deklaruar që e lejon huamarrësin të zgjedhë normën e interesit të tregut mbi një bazë të vazhdueshme. Për shembull, në çdo datë të rivënies së normës së interesit, huamarrësi mund të zgjedhë të paguajë LIBOR tremujor për një afat prej tre muaj ose LIBOR një mujor për një afat për një muaj.</p>	<p>Flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar për sa kohë që interesi i paguar mbi jetën e instrumentit pasqyron shumën për vlerën në kohë të parasë, për rrezikun e kredisë të lidhur me instrumentin dhe për kostot dhe rreziqet bazë të kreditimit, si dhe një marzh fitimi (shih paragrafin B4.1.7A). Fakti që norma e interesit LIBOR është rivendosur gjatë jetës së instrumentit në vetvete nuk e s'kualifikon instrumentin.</p> <p>Megjithatë, në qoftë se huamarrësi është në gjendje të zgjedhë të paguajnë një normë interesi një-mujore që rishikohet çdo tre muaj, norma e interesit rishikohet me një frekuencë që nuk përputhet me kohëzgjatjen e normës së interesit. Rrjedhimisht, vlera në kohë e elementit para është e ndryshuar. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se një instrument ka një normë interesi kontraktual që është i bazuar në një afat që mund të kalojë jetën e mbetur të instrumentit (për shembull, nëse një instrument me një maturim pesëvjeçar paguan një normë interesi të ndryshueshme që rishikohet periodikisht por gjithmonë reflekton një maturim pesë-vjeçar), vlera në kohë e elementit para është e ndryshuar. Kjo është për shkak se interesi i pagueshëm në çdo periudhë është shkëputur nga periudha e interesit.</p>

Instrumenti	Analiza
	<p>Në raste të tilla, njësia ekonomike duhet të bëjë vlerësime cilësore apo sasiore të flukse të mjeteve monetare kundër atyre në një instrument që është identik në të gjitha aspektet, përveç afatit të normës së interesit që përputhet me periudhën e interesit për të përcaktuar nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar. (Por shih paragrafin B4.1.9E për udhëzime mbi normat e rregulluara të interesit.)</p> <p>Për shembull, në vlerësimin e një obligacioni me një afat pesë-vjeçar që paguan një normë të ndryshueshme që rishikohet çdo gjashtë muaj por gjithmonë reflekton një maturim pesë-vjeçar, një njësi ekonomike merr në konsideratë flukset e mjeteve monetare kontraktuale të një instrumenti që rishikohet çdo gjashtë muaj bazuar në një normë interesi gjashtë mujore, por është identike në çdo tjetër.</p> <p>E njëjta analizë do të zbatohet në qoftë se huamarrësi është në gjendje të zgjedhë mes normave të ndryshme të publikuara të interesit të huadhënësit (p.sh. huamarrësi mund të zgjedhë midis normës së ndryshueshme të interesit një-mujor të publikuar nga huadhënësi dhe normës së ndryshueshme të interesit tre-mujor të publikuar nga huadhënësi).</p>
<p>Instrumenti C</p> <p>Instrumenti C është një obligacion me një datë maturimi të shpallur dhe paguhet një normë interesi variabël tregu. Kjo normë variabël e interesit ka një kufi maksimal.</p>	<p>Flukset monetare kontraktuale si të:</p> <p>(a) një instrumenti që ka një normë interesi fikse dhe</p> <p>(b) një instrumenti që ka një normë interesi variabël</p> <p>janë pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principali të papaguar për sa kohë që interesi pasqyron shumën për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me instrumentin gjatë afatit të tij dhe për koston dhe rreziqe të tjera bazë të huadhënies, si dhe një marzh fitimi. (Shiko paragrafin B4.1.7A)</p> <p>Si pasojë, një instrument që është një kombinim i (a) dhe (b) (p.sh. një obligacion me një normë interesi me kufi maksimal) mund të ketë flukse monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Një kusht i tillë kontraktual mund të reduktojë ndryshueshmërinë e fluksit monetar duke vendosur një kufi mbi një normë interesi variabël (p.sh. një kufi maksimal apo minimal të normës së interesit) ose shton ndryshueshmërinë e fluksit monetar sepse një normë fikse bëhet variabël.</p>
<p>Instrumenti D</p> <p>Instrumenti D është një kredi me rikthim të plotë dhe është siguruar me kolateral.</p>	<p>Fakti që një kredi me një kthim të plotë është e kolateralizuar në vetvete nuk ndikon në analizën nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.</p>

Instrumenti	Analiza
<p>Instrumenti E</p> <p>Instrumenti E është lëshuar nga një bankë e rregulluar dhe ka një datë maturimi të deklaruar. Instrument paguan një normë interesi fikse dhe të gjitha flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë të detyrueshme.</p> <p>Megjithatë, emetuesi është subjekt i legjislacionit që lejon ose kërkon një autoritet kombëtar vendimmarrës të imponojë humbje mbi zotëruesit e instrumenteve të veçanta, duke përfshirë Instrumentin E, në rrethana të veçanta. Për shembull, autoriteti kombëtar vendimmarrës e ka fuqinë për të çvlerësuar vlerën nominale të Instrumentit E ose për të kthyer atë në një numër fiks të aksioneve të zakonshme të emetuesit nëse autoriteti kombëtar vendimmarrës konstaton se emetuesi po kalon vështirësi të mëdha financiare, ka nevojë të rrisë kapitalin rregullator ose po 'dështon'.</p>	<p>Mbajtësi do të analizojë kushtet kontraktuale të instrumentit financiar për të përcaktuar nëse ata japin rritje të flukseve të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar dhe në këtë mënyrë janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie.</p> <p>Kjo analizë nuk do të marrë parasysh pagesat që linden vetëm si rezultat i pushtetit të autoritetit kombëtar vendimmarrës për të imponuar humbje për mbajtësit e Instrumentit E. Kjo është për shkak se fuqia dhe pagesat që rezultojnë, nuk janë kushtet kontraktuale të instrumentit financiar.</p> <p>Në të kundërt, flukset monetare kontraktuale nuk do të ishin vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar në qoftë se kushtet kontraktuale të instrumentit financiar lejojnë ose të kërkojnë që emetuesi ose një tjetër njësi ekonomike të imponojë humbje tek mbajtësi (p.sh. duke çvlerësuar vlerën nominale ose duke konvertuar instrumentin në një numër fiks të aksioneve të zakonshme të emetuesit) për aq kohë sa ato kushte kontraktuale janë të vërteta, edhe pse probabiliteti është e largët se një humbje e tillë do të imponohet.</p>

B4.1.14 Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë flukset monetare kontraktuale që nuk janë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Kjo listë e shembujve nuk është përfundimtare.

Instrumenti	Analiza
<p>Instrumenti F</p> <p>Instrumenti F është një obligacion që është i konvertueshëm me një numër fiks të instrumenteve të kapitalit neto të emetuesit.</p>	<p>Mbajtësi do të analizojë obligacionin e konvertueshëm në tërësinë e tij.</p> <p>Flukset e mjeteve monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar sepse ato reflektojnë një kthim që është në kundërshtim me një marrëveshje bazë të kreditimit (shih paragrafin B4.1.7A); d.m.th. kthimi është i lidhur me vlerën e kapitalit neto të emetuesit.</p>
<p>Instrumenti G</p> <p>Instrumenti G është një hua që paguan një normë interesi të luhatshme të anasjelltë (d.m.th. norma e interesit ka një marrëdhënie të anasjelltë me normat e interesit të tregut).</p>	<p>Flukset e mjeteve monetare kontraktuale nuk janë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar.</p> <p>Shumat e interesit nuk janë shuma për vlerën në kohë të parasë mbi shumën e principalit të papaguar.</p>
<p>Instrumenti H</p> <p>Instrumenti H është një instrument borxhi i vazhdueshëm, por lëshuesi mund ta rimarrë instrumentin në çdo moment dhe t'i paguajë mbajtësit shumën nominale plus interesin e konstatuar.</p> <p>Instrumenti H paguan një normë interesi tregu, por pagesa e interesit nuk mund të bëhet nëse emetuesi është i aftë të paguajë menjëherë më vonë.</p> <p>Interesi i shtyrë nuk shkakton interes shtesë.</p>	<p>Flukset e mjeteve monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Kjo për shkak se emetuesit mund t'i kërkohet të shtyjë pagesat e interesit dhe nuk do të ketë interesa shtesë mbi shumat e interesit të shtyrë. Si rezultat, shuma e interesit nuk janë shuma për vlerën në kohë të parasë mbi shumën e principalit të papaguar.</p> <p>Nëse interesi konstatohet mbi shumat e shtyra, flukset monetare kontraktuale mund të jenë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.</p>
	<p>Fakti që Instrumenti H është i vazhdueshëm në vetvete nuk do të thotë se flukset monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Në fakt, një instrument i vazhdueshëm ka opsione të vazhdueshme (të shumta) të zgjatjes së afatit. Opsione të tilla mund të çojnë në flukse monetare kontraktuale që janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar në qoftë se pagesat e interesit janë të detyrueshme dhe duhet të paguhet në mënyrë të përhershme.</p> <p>Gjithashtu, fakti që Instrumenti H është i kërkueshëm nuk do të thotë se flukset monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, nëse nuk është i kërkueshëm në një shumë që nuk e pasqyron në thelb pagesën e principalit të papaguar dhe interesin mbi shumën e principalit të papaguar. Edhe në qoftë se shuma e kërkueshme përfshin një shumë që kompenson mbajtësin në mënyrë të arsyeshme për ndërprerjen para kohe të instrumentit, flukset monetare kontraktuale mund të jenë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar. (Shiko gjithashtu paragrafin B4.1.12.)</p>

- B4.1.15 Në disa raste një aktiv financiar mund të ketë flukse kontraktuale monetare që janë përshkruar si principali dhe interesi, por këto flukse të mjeteve monetare nuk përfaqësojnë pagesën e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar siç përshkruhet në paragrafët 4.1.2 (b), 4.1.2A(b) dhe 4.1.3 të këtij Standardi.
- B4.1.16 Ky mund të jetë rasti kur aktivi financiar përfaqëson një investim në aktive apo flukse monetare të veçantë dhe kështu flukset monetare kontraktuale nuk janë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Për shembull, në qoftë se kushtet e kontratës përcaktojnë që flukset e mjeteve monetare të aktivitetit financiar rriten sa më shumë automobila përdorin një rrugë të veçantë me pagesë, këto flukse monetare kontraktuale janë në kundërshtim me një marrëveshje bazë huadhënie. Si rezultat, instrumenti nuk do të përmbushë kushtet në paragrafët 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A(b). Ky mund të jetë rasti kur një kërkesë e kreditorit është e kufizuar në aktive të specifikuar të debitorit ose flukse monetare nga aktivet e specifikuar (për shembull, një aktiv financiar 'i pakthyesëm').
- B4.1.17 Megjithatë, fakti që një aktiv financiar është i pakthyesëm në vetvete nuk e përjashton domosdoshmërisht aktivin financiar nga plotësimi i kushtit në paragrafët 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A(b). Në situata të tilla, është e nevojshme që kreditori të vlerësojë ('të njihet me') aktivet bazë të veçantë ose flukset monetare për të përcaktuar nëse flukset monetare kontraktuale të aktivitetit financiar të klasifikuar janë pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Në qoftë se kushtet e aktivitetit financiar çojnë në flukse monetare të tjera ose kufizojnë flukset e mjeteve monetare në një mënyrë që nuk është në pajtueshmëri me pagesat e principalit dhe të interesit, aktivi financiar nuk i plotëson kushtet në paragrafët 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A(b). Nëse aktivet bazë janë aktive financiare ose jo-financiare në vetvete nuk ndikojnë në këtë vlerësim.
- B4.1.18 Një karakteristikë e fluksit monetar kontraktual nuk ndikon në klasifikimin e aktivitetit financiar nëse ajo mund të ketë vetëm një efekt minimal në flukset monetare kontraktuale të aktivitetit financiar. Për të bërë këtë përcaktim, një njësi ekonomike duhet të marrë parasysh efektin e mundshëm të karakteristikës kontraktuale të fluksit monetar në çdo periudhë raportimi dhe në mënyrë kumulative mbi jetën e instrumentit financiar. Përveç kësaj, në qoftë se një karakteristikë e fluksit të mjeteve monetare kontraktuale të mund të ketë një efekt në flukset monetare kontraktuale që është më shumë se sa minimale (ose në një periudhë të vetme raportuese ose kumulative), por se kjo karakteristikë e fluksit monetar nuk është e vërtetë, ajo nuk ndikon në klasifikimin e një aktiv financiar. Një karakteristikë e fluksit monetar nuk është e vërtetë në qoftë se ajo ndikon në flukset monetare kontraktuale të instrumentit vetëm kur ndodh një ngjarje që është shumë e rrallë, tepër e parregullt dhe nuk ka shumë gjasa të ndodhë.
- B4.1.19 Në pothuajse çdo transaksion kreditimi, instrumenti i kreditorit renditet në lidhje me instrumentet e kreditorëve të tjerë të debitorit. Një instrument që është në vartësi të instrumenteve të tjerë mund të ketë flukse monetare kontraktuale që janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar në qoftë se mospagesa nga ana e debitorit është një shkelje e kontratës dhe mbajtësi ka të drejtën kontraktuale mbi shumën e papaguar të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar edhe në rast falimentimi të debitorit. Për shembull, një llogari e arkëtueshme tregtare që rendit kreditorin e saj si kreditor të përgjithshëm do të kualifikohet si pagesë e principalit dhe interesit mbi shumën principale të papaguar. Ky është rasti edhe nëse debitori jep kredi që janë të kolateralizuara, i cili në rast falimentimi do t'i japë prioritet mbajtësit të borxhit kundrejt pretendimeve të kreditorit të përgjithshëm në lidhje me kolateralin, por nuk ndikon në të drejtën kontraktuale të kreditorit të përgjithshëm për shumën e papaguar të principalit dhe shumave të tjera për t'u paguar.

Instrumentet e lidhura kontraktualisht

- B4.1.20 Në disa lloje transaksionesh, një emetues mund t'u japë përparësi pagesave për mbajtësit e aktiveve financiare duke përdorur instrumente të shumta të lidhura kontraktualisht që krijojnë përqendrim të rrezikut të kredisë (këstet). Çdo këst ka një renditje varësie që përcakton rendin në të cilin çdo fluks monetar i krijuar nga emetuesi i caktohet këstit. Në situata të tilla, mbajtësit e një kësti kanë të drejtën për pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar vetëm në qoftë se emetuesi gjeneron flukse monetare të mjaftueshme për t'u përgjigjur kësteve sipas renditjes më të lartë.
- B4.1.21 Në transaksione të tilla, një këst ka karakteristikat e fluksit monetar që janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar vetëm nëse:
- kushtet kontraktuale të këstit të vlerësuar për klasifikim (pa shqyrtuar grupin bazë të instrumenteve financiare) shkaktojnë flukse monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar (p.sh. norma e interesit për këstin nuk lidhet me një indeks të mallrave);
 - grupi bazë i instrumenteve financiare ka karakteristikat e fluksit monetar të përcaktuara në paragrafët B4.1.23 dhe B4.1.24; dhe

- (c) ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë në grupin themelor të instrumenteve financiare e rëndësishme me këstin është e barabartë me ose më e ulët se ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë të grupit themelor të instrumenteve financiare (për shembull, klasifikimi i kreditit të këstit të vlerësuar për klasifikim është i barabartë ose më e lartë se klasifikimi i kredive që do të zbatohet për një këst të vetëm që ka financiar grupin themelor të instrumenteve financiare).
- B4.1.22 Një njësi ekonomike duhet të kërkojë deri sa ajo mund të identifikojë grupin bazë të instrumenteve që krijojnë (në vend që t'i anashkalojë) flukset monetare. Ky është grupi themelor i instrumenteve financiare.
- B4.1.23 Grupi bazë duhet të përmbajë një ose më shumë instrumente që kanë flukse monetare kontraktuale që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.
- B4.1.24 Grupi bazë i instrumenteve mund të përfshijë edhe instrumentet që:
- (a) pakësojnë ndryshueshmërinë e fluksit monetar të instrumenteve në paragrafin B4.1.23 dhe, kur kombinohet me instrumentet në paragrafin B4.1.23, çon në flukse monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar (p.sh. një normë interesi maksimale apo minimale ose një kontratë që zvogëlon rrezikun e kredisë në disa ose të gjitha instrumentet në paragrafin B4.1.23); ose
 - (b) lidh flukset monetare të kësteve me flukset e mjeteve monetare të grupit të instrumenteve bazë në paragrafin B4.1.23 për të adresuar diferencat në dhe vetëm në:
 - (i) normën e interesit kur është fikse apo e luhatshme;
 - (ii) monedhën në të cilën janë të shprehura flukset e mjeteve monetare, duke përfshirë edhe inflacionin në këtë monedhë; ose
 - (iii) afatin e flukseve monetare.
- B4.1.25 Nëse ndonjë instrument në grup nuk i plotëson kushtet në paragrafin B4.1.23 ose paragrafin B4.1.24, nuk plotësohet kushti në paragrafin B4.1.21 (b). Në kryerjen e këtij vlerësimi, një analizë e detajuar instrument-për-instrument i grupimit nuk mund të jetë e nevojshme. Megjithatë, një njësi ekonomike duhet të përdorë gjykimin dhe do të kryejë analiza të mjaftueshme për të përcaktuar nëse instrumentet në grupim plotësojnë kushtet në paragrafët B4.1.23-B4.1.24. (Shih gjithashtu paragrafin B4.1.18 për udhëzime mbi karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare kontraktuale që kanë vetëm një efekte minimale.)
- B4.1.26 Nëse mbajtësi nuk mund të vlerësojë kushtet në paragrafin B4.1.21 në njohjen fillestare, kësti duhet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Nëse grupi bazë i instrumenteve mund të ndryshojë pas njohjes fillestare në mënyrë të tillë që grupi nuk mund të plotësojë kushtet në paragrafët B4.1.23-B4.1.24, kësti nuk i plotëson kushtet në paragrafin B4.1.21 dhe duhet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Megjithatë, në qoftë se grupi themelor përfshin instrumente që janë të mbuluar me kolateral nga aktive që nuk i plotësojnë kushtet në paragrafët B4.1.23-B4.1.24, aftësia për të marrë posedimin e aktiveve të tilla do të shpërfillen për qëllime të zbatimit të këtij paragrafi nëse njësi ekonomike kontrollon këstin me qëllim të kontrollojë kolateralin.

Opsioni për të përcaktuar një aktiv financiar ose detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (Seksionet 4.1 dhe 4.2)

- B4.1.27 Në përputhje me kushtet në paragrafët 4.1.5 dhe 4.2.2, ky Standard lejon një njësi ekonomike të përcaktojë një aktiv financiar, një detyrim financiar, ose një grup të instrumenteve financiare (aktive financiare, detyrime financiare ose të dyja) me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes me kusht që duke vepruar kështu rezulton në një informacion më të përshtatshëm.
- B4.1.28 Vendimi i një njësie ekonomike për të përcaktuar një aktiv financiar ose detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është i ngjashëm me një zgjedhje të politikës kontabël (edhe pse, ndryshe nga një zgjedhje e politikës kontabël, nuk është e nevojshme të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha transaksionet e ngjashme). Kur njësi ekonomike mund të bëjë një zgjedhje të tillë, paragrafi 14 (b) i SNK 8 kërkon që politika e zgjedhur të çojë në pasqyra financiare që japin informacion më të besueshëm dhe më të rëndësishëm për efektet e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në pozicionin financiar të njësisë ekonomike, performancën financiare ose flukset monetare. Për shembull, në rastin e caktimit të një detyrimi financiar si detyrim me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, paragrafi 4.2.2 përcakton dy rrethanat kur duhet të plotësohet kërkesa për më shumë informacion përkatës. Prandaj, për të bërë këtë përcaktim në përputhje me paragrafin 4.2.2, njësi ekonomike duhet të tregojë se ai është në njërin (ose të dyja) prej këtyre dy rrethanave.

Përcaktimi eliminon apo redukon ndjeshëm një mospërputhje kontabël

- B4.1.29 Matja e një aktivi financiar ose detyrimi financiar dhe klasifikimi i ndryshimeve të njohura në vlerën e tij përcaktohet nga klasifikimi i elementit dhe nëse elementi është pjesë e një marrëdhënie mbrojtëse të caktuar. Këto kërkesa mund të krijojnë një mospërputhje të matjes apo të njohjes (nganjëherë referuar si një "mospërputhje kontabël") kur, për shembull, në mungesë të përcaktimit me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, një aktiv financiar do të klasifikohet më pas si i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe një detyrim që njësia ekonomike e konsideron të lidhur do të matej më pas me koston e amortizuar (pa njohur ndryshimet në vlerën e drejtë). Në rrethana të tilla, një njësia ekonomike mund të nxjerrë përfundimin se pasqyrat e saj financiare do të siguronin informacion më të përshtatshëm nëse edhe aktiviteti, dhe detyrimi janë të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- B4.1.30 Shembujt e mëposhtëm tregojnë se kur mund të përbushet ky kusht. Në të gjitha rastet, një njësia ekonomike mund ta përdorë këtë kusht për të përcaktuar aktivet financiare ose detyrimet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes vetëm nëse plotëson parimin në paragrafin 4.1.5 ose 4.2.2 (a):
- një njësia ekonomike ka detyrime sipas kontratave të sigurimit kontrata brenda objektit të SNRF 17 (matja e të cilave matja e të cilave përfshin informacionin aktual (siç lejohet nga paragrafi 24 i SNRF 4) dhe aktive financiare, që konsiderohen të lidhura dhe që në rast të kundërt do të mateshin ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, ose me koston e amortizuar.
 - një njësia ekonomike ka aktive financiare, detyrime financiare ose të dyja bashkë, që kanë një rrezik, të tillë si rreziku i normës së interesit, që shkakton ndryshime të kundërta në vlerën e drejtë që tentojnë të kompensojnë njëri-tjetrin. Megjithatë, vetëm disa nga instrumentet do të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (për shembull, ato që janë derivativë, ose janë të klasifikuar si të mbajtur për tregtim). Mund të jetë edhe rasti që kërkesat për kontabilitetin mbrojtës nuk janë plotësuar për shkak se, për shembull, nuk janë plotësuar kërkesat për mbrojtjen efektive në paragrafin 6.4.1.
 - Një njësia ekonomike ka aktive financiare, detyrime financiare, ose të dyja bashkë, që kanë një rrezik, të tillë si rrezikun e normës së interesit, që shkakton ndryshime të kundërta në vlerën e drejtë që tentojnë të kompensojnë njëri-tjetrin dhe asnjëri nga aktivet apo detyrimet financiare nuk kualifikohen për t'u përcaktuar si instrument mbulues për shkak se nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Për më tepër, në mungesë të kontabilitetit mbrojtës ka një mospërputhje të konsiderueshme në njohjen e fitimeve dhe të humbjeve neto. Për shembull, njësia ekonomike ka financiar një grup të caktuar huash duke emetuar obligacione tregtare me ndryshime në vlerën e drejtë që tentojnë të kompensojnë njëri-tjetrin. Nëse, përveç kësaj, njësia ekonomike blen dhe shet rregullisht obligacione, por rrallë, nëse ndodh ndonjëherë, blen dhe shet huatë, raportimi si i huave dhe i obligacioneve me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes eliminon mospërputhjen në momentin e njohjes së fitimeve dhe humbjeve neto që ndryshe do të rezultonin nga matja e tyre me koston e amortizuar dhe njohjen e një fitimi ose humbjeje çdo herë që një obligacion ri blihet.
- B4.1.31 Në raste të tilla, si ato të përshkruara në paragrafin e mësipërm, në njohjen fillestare, për të caktuar aktivet financiare dhe detyrimet financiare që nuk maten ndryshe veçse me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të eliminohen ose reduktohen ndjeshëm mospërputhjet e matjes ose të njohjes dhe të jepet më shumë informacion përkatës. Për qëllime praktike, njësia ekonomike nuk duhet të hyjë në të gjitha aktivet dhe detyrimet duke shkaktuar mospërputhje për matjen apo njohjen pikërisht në të njëjtën kohë. Një vonesë e arsyeshme është e lejuar me kusht që çdo transaksion përcaktohet si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në njohjen e tij fillestare dhe, në këtë kohë, çdo transaksion i mbetur pritet të ndodhë.
- B4.1.32 Nuk do të ishte e pranueshme të përcaktohen vetëm disa prej aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes që shkaktojnë mospërputhje nëse në këtë mënyrë nuk do të eliminohej ose zvogëlohej ndjeshëm mospërputhja dhe pra nuk do të kishte më shumë informacion të përshtatshëm. Megjithatë, do të ishte e pranueshme të përcaktohen vetëm disa nga një numër aktivesh financiare të ngjashme ose detyrimesh financiare të ngjashme, nëse duke vepruar kështu arrihet një zvogëlim i ndjeshëm (dhe ndoshta një ulje më e madhe se përcaktimet e tjera të lejueshme) i mospërputhjes. Për shembull, supozojmë një njësia ekonomike ka një numër detyrimesh financiare të ngjashme me një shumë prej 100NJM dhe një numër aktivesh financiare të ngjashme me një shumë prej 50NJM, por që janë të matura në baza të ndryshme. Njësia ekonomike mund të zvogëlojë ndjeshëm mospërputhjen në matje duke i përcaktuar në njohjen fillestare të gjitha aktivet, por vetëm disa nga detyrimet (për shembull, detyrimet individuale me një total të kombinuar prej 45NJM) me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Megjithatë, për shkak se përcaktimi si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të zbatohet vetëm për një instrument financiar në tërësi, njësia ekonomike në këtë shembull duhet të caktojë një ose më shumë detyrime në tërësinë e tyre. Ajo nuk mund të përcaktojë ose një përbërës të një detyrimi

(p.sh. ndryshimet në vlerë që i takojnë vetëm një rreziku, të tilla si ndryshimet në normën e interesit bazë), ose një pjesë (d.m.th. përqindje) të një detyrimi.

Një grup i detyrimeve ose aktiveve financiare dhe i detyrimeve financiare që menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet mbi bazën e vlerës së drejtë

- B4.1.33 Një njësi ekonomike mund të menaxhojë dhe të vlerësojë performancën e një grupi detyrimesh financiare ose aktivesh financiare dhe detyrimesh financiare në mënyrë të tillë që duke matur këtë grup me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes merret një informacion më i përshtatshëm. Në këtë rast, fokusi është në mënyrën se si njësi ekonomike menaxhon dhe vlerëson performancën, se sa në natyrën e instrumenteve financiare.
- B4.1.34 Për shembull, një njësi ekonomike mund ta përdorë këtë kusht për të përcaktuar detyrimet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse plotëson parimin në paragrafin 4.2.2 (b) dhe njësi ekonomike ka aktive financiare dhe detyrime financiare që ndajnë një ose më shumë rreziqe dhe këto rreziqe janë të menaxhuara dhe vlerësohen në bazë të vlerës së drejtë, në përputhje me një politikë të dokumentuar të menaxhimit të aktiveve dhe detyrimeve. Një shembull mund të jetë një njësi ekonomike që ka emetuar "produkte të strukturuar" që përbajnë derivativë të shumtë të përfshirë dhe menaxhon rreziqet që rezultojnë mbi bazën e vlerës së drejtë duke përdorur një përzjerje të instrumenteve derivative dhe financiare jo derivative.
- B4.1.35 Siç vërehet më sipër, ky kusht mbështetet në mënyrën se si njësi ekonomike menaxhon dhe vlerëson performancën e grupit të instrumenteve financiare në shqyrtim. Prandaj, një njësi ekonomike (subjekt i kërkesës së përcaktimit në njohjen fillestare) që i përcakton detyrimet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në bazë të këtij kushti, do të përcaktojë të gjitha detyrimet e përshtatshme financiare që janë menaxhuar dhe vlerësuar së bashku.
- B4.1.36 Dokumentimi i strategjisë së njësisë ekonomike nuk duhet të jetë gjithëpërfshirës, por duhet të jetë i mjaftueshëm për të dëshmuar përputhjen me paragrafin 4.2.2 (b). Dokumentimi i tillë nuk është i nevojshëm për çdo zë individual, por mund të jetë mbi një bazë portofoli. Për shembull, në qoftë se sistemi i menaxhimit të performancës për një departament-siç është miratuar nga personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike- tregon qartë se performanca e tij vlerësohet mbi këto baza, nuk kërkohet dokumentim i mëtejshëm për të demonstruar pajtueshmërinë me paragrafin 4.2.2 (b).

Derivatvët e përfshirë (Seksioni 4.3)

- B4.3.1 Kur një njësi ekonomike bëhet palë në një kontratë hibride me një instrument bazë që nuk është një aktiv brenda objektit të këtij Standardi, paragrafi 4.3.3 kërkon që njësi ekonomike të identifikojë çdo derivativ të përfshirë, të vlerësojë nëse është e nevojshme të jenë të ndarë nga kontrata bazë dhe, për ata që kërkohet të jenë të ndarë, të maten derivativët me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- B4.3.2 Nëse një kontratë bazë nuk e ka deklaruar apo paracaktuar maturimin dhe paraqet një interes të mbetur në aktivet neto të një njësie ekonomike, atëherë karakteristikat e saj ekonomike dhe rreziqet janë ato të një instrumenti të kapitalit neto, dhe një derivativ i përfshirë do të duhet të ketë karakteristikat e kapitalit që lidhen me të njëjtën njësi ekonomike që të konsiderohet si i lidhur ngushtë. Nëse kontrata bazë nuk është një instrument kapitali neto dhe plotëson përkufizimin e një instrumenti financiar, atëherë karakteristikat e saj ekonomike dhe rreziqet janë ato të një instrumenti borxhi.
- B4.3.3 Një derivativ i përfshirë pa opSION (i tillë si një kontratë e të ardhmes) ndahet nga kontrata bazë e tij mbështetur në kushtet thelbësore të paraqitura apo të nënkuptuara, në mënyrë që të ketë një vlerë të drejtë zero në njohjen fillestare. Një derivativ i përfshirë bazuar në opSION (i tillë si një kontratë me opSION kthimi, blerje, me kufi maksimal, kufi minimal ose shkëmbimi) ndahet nga kontrata bazë e tij mbështetur në kushtet e caktuara në funksion të opSIONIT. Shuma fillestare kontabël e instrumentit bazë është shuma e mbetur pasi ndahet derivativi i përfshirë.
- B4.3.4 Në përgjithësi, derivativët e shumëfishtë të përfshirë në një kontratë të vetme hibride trajtohen si një përbërës i vetëm i derivativit të përfshirë. Megjithatë, derivativët e përfshirë që klasifikohen si kapital neto (shih SNK 32 *Instrumentet financiare: Paraqitja*) trajtohen veças nga ato të klasifikuar si aktive ose detyrime. Përveç kësaj, nëse një kontratë hibride ka më shumë se një derivativ të përfshirë dhe këta derivativë lidhen me ekspozime të ndryshme ndaj rrezikut dhe janë lehtësisht të ndashëm dhe të pavarur nga njëri-tjetri, ata trajtohen veçmas nga njëri-tjetri.
- B4.3.5 Karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e një derivativi të përfshirë nuk janë të lidhura ngushtë me kontratën bazë (paragrafi 4.3.3 (a)) në shembujt e mëposhtëm. Në këta shembuj, duke supozuar se janë plotësuar

kushtet në paragrafin 4.3.3 (b) dhe (c), një njësi ekonomike i trajton derivativët e përfshirë veçmas nga kontrata bazë.

- (a) Një kontratë me opsjon e përfshirë në një instrument që i jep mundësi mbajtësit të kërkojë nga lëshuesi të riblejë instrumentin për një shumë mjetesh monetare ose aktivesh të tjera, që ndryshon në bazë të ndryshimit të çmimit të kapitalit ose të mallrave ose indeksit, nuk është e lidhur ngushtë me një instrument borxhi bazë.
- (b) Një opsjon apo një parashikim automatik për të zgjatur kohën e mbetur deri në maturim të një instrumenti borxhi nuk është i lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit nëse nuk ka një rregullim në harmoni me normën e përafërt aktuale të interesit të tregut në kohën e shtrirjes. Në qoftë se një njësi ekonomike emeton një instrument borxhi dhe mbajtësi i tij shkruan një opsjon blerjeje për instrumentin e borxhit me një palë të tretë, emetuesi e trajton opsionin e blerjes si një zgjatje të afatit të maturimit të instrumentit të borxhit me kusht që emetuesit mund t'i kërkojë të marrë pjesë në ose të lehtësojë ri tregtimin e instrumentit të borxhit, si rezultat i ushtrimit të opsionit.
- (c) Interesi i indeksuar i kapitalit ose pagesat e principalit të përfshira në një instrument borxhi ose në kontratën e sigurimit - me të cilin shuma e interesit ose e principalit është e indeksuar me vlerën e instrumenteve të kapitalit - nuk janë të lidhura ngushtë me instrumentin bazë, sepse rreziqet e natyrshme në derivativin bazë dhe të përfshirë janë të ndryshme.
- (d) Interesi i indeksuar i mallit ose pagesat e principalit të përfshirë në një instrument borxhi ose kontratës e sigurimit - me të cilin shuma e interesit ose principalit është indeksuar me çmimin e një malli (i tillë si ari) – nuk janë të lidhura ngushtë me instrumentin bazë për shkak se rreziqet e natyrshme në derivativin bazë dhe të përfshirë janë të ndryshme.
- (e) Një opsjon blerje, kthimi apo parapagimi i përfshirë në një kontratë bazë borxhi ose kontratë bazë sigurimi nuk është i lidhur ngushtë me kontratën bazë nëse:
 - (i) çmimi i ushtrimit të opsionit është përafërsisht i barabartë, në çdo datë të ushtrimit, me koston e amortizuar të instrumentit bazë të borxhit ose vlerën kontabël të kontratës bazë të sigurimit; ose
 - (ii) çmimi i ushtrimit të një opsioni parapagimi rimbursor huadhënësin për një shumë deri në vlerën e përafërt aktuale të interesit të humbur për periudhën e mbetur të kontratës bazë. Interesi i humbur është produkt i shumës së principalit të parapaguar shumëzuar me normën diferenciale të interesit. Norma diferenciale e interesit është tejkalimi i normës së interesit efektiv të kontratës bazë mbi normën e interesit efektiv të njësisë ekonomike që do të merrte në datën e parapagimit nëse ajo ri investon shumën e principalit të parapaguar në një kontratë të ngjashme për periudhën e mbetur të kontratës bazë.

Vlerësimi nëse opsioni i blerjes apo kthimit është i lidhur ngushtë me kontratën bazë të borxhit bëhet para se të ndahet elementi i kapitalit neto të një instrumenti borxhi të konvertueshëm në përputhje me SNK 32.
- (f) Derivatvët e kredisë, që janë të përfshirë në një instrument bazë borxhi dhe lejojnë një palë ('përfituesin') të transferojë rrezikun e kredisë të një aktivi të veçantë reference, të cilin nuk mund ta ketë, tek një palë tjetër ('garantuesi'), nuk janë të lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit. Derivatvë të tillë të kredisë lejojnë garantuesin të marrë përsipër rrezikun e kredisë lidhur me aktivin e referencës pa e zotëruar drejtpërdrejt atë.

B4.3.6 Një shembull i një kontrate hibride është një instrument financiar që i jep mbajtësit të drejtën për t'ia kthyer përsëri instrumentin financiar emetuesit në këmbim të një shume mjetesh monetare ose aktivesh të tjera financiare që ndryshon në bazë të ndryshimit në një indeks të kapitalit neto apo mallrave që mund të rritet ose zvogëlohet (një 'instrumenti i kthimit të aksionit'). Vetëm nëse emetuesi në njohjen fillestare i përcakton instrumentet e kthimit të aksioneve si një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, është e nevojshme të ndahet një derivativ i përfshirë (p.sh. pagesa e principalit të indeksuar) sipas paragrafit 4.3.3, sepse kontrata bazë është një instrument borxhi sipas paragrafit B4.3.2 dhe pagesa e principalit të indeksuar nuk është e lidhur ngushtë me një instrument bazë të borxhit sipas paragrafit B4.3.5 (a). Meqë pagesa e principalit mund të rritet dhe të ulet, derivativi i përfshirë është një derivativ pa opsjon, vlera e të cilit është e indeksuar me variabël bazë.

B4.3.7 Në rastin e një instrumenti të kthyeshëm që mund të kthehet përsëri në çdo kohë për një shumë mjetesh monetare të barabartë me një pjesë proporcionale të vlerës neto të aktivit të një njësie ekonomike (të tilla si njësitë e një fondi të përbashkët të hapur ose disa produkte investimesh të lidhura me njësinë), efekti i ndarjes së një derivativi të përfshirë dhe trajtimi kontabël për çdo përbërës është të matet kontrata hibride

me shumën e riblerjes që është e pagueshme në fund të periudhës raportuese, në qoftë se mbajtësi ushtron të drejtën e tij për t'ia kthyer përsëri instrumentin emetuesit.

B4.3.8 Karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e një derivativi të përfshirë janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e kontratës bazë në shembujt e mëposhtëm. Në këta shembuj, një njësi ekonomike nuk i trajton derivativët e përfshirë veçmas nga kontrata bazë.

- (a) Një derivativ i përfshirë në të cilin baza është një normë interesi ose indeksi i normës së interesit që mund të ndryshojë shumën e interesit, që ndryshe do të paguhej ose arkëtohej nga një kontratë bazë borxhi me interes ose një kontratë sigurimi e lidhur ngushtë me kontratën bazë përveç nëse kontrata hibride mund të shlyhet në një mënyrë të tillë që mbajtësi nuk do të mbulonte kryesisht të gjithë investimin e tij të njohur, ose derivativi i përfshirë mundet të paktën të dyfishojë normën fillestare të kthimit mbi kontratën bazë për mbajtësin dhe mund të çojë në një normë kthimi që është të paktën dyfish i asaj të tregut për një kontratë me kushte të njëjta si kontrata bazë.
- (b) Një derivativ me kufi maksimal ose minimal i përfshirë në normën e interesit të një kontrate borxhi ose kontratë sigurimi është i lidhur ngushtë me kontratën bazë, me kusht që kufiri maksimal në ose mbi normën e tregut të interesit dhe ai minimal është në ose nën normën e tregut të interesit kur kontrata emetohet, dhe kufiri maksimal ose minimal është i ndikuar nga lidhja me kontratën bazë. Në mënyrë të ngjashme, dispozitat e përfshira në një kontratë për të blerë ose shitur një aktiv (p.sh. një mall) që vendosin një kufi maksimal dhe minimal mbi çmimin që duhet paguar ose arkëtuar për aktivin janë të lidhura ngushtë me kontratën bazë nëse të dy kufijtë janë pa para në fillimin e kontratës dhe nuk janë të ndikuar.
- (c) Një derivativ në monedhë të huaj, që ofron një seri pagesash të principalit ose të interesit të shprehura në monedhë të huaj dhe është i përfshirë në një instrument borxhi (p.sh. një obligacion në monedhë të dyfishtë), është i lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit. Një derivativ i tillë nuk është i ndarë nga instrumenti bazë, sepse SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit*, kërkon që fitimet dhe humbjet neto në monedhë të huaj nga zërat monetarë të njihen në fitim ose humbje.
- (d) Një derivativ në monedhë të huaj i përfshirë në një kontratë bazë që është një kontratë sigurimi ose një instrument jofinanciar (si një kontratë për blerjen ose shitjen e një zëri jofinanciar, ku çmimi është i shprehur në monedhë të huaj), është i lidhur ngushtë me kontratën bazë po qe se është i ndikuar, nuk përmban një tipar opsioni, dhe kërkon pagesa të shprehura në një nga monedhat e mëposhtme:
 - (i) në monedhën funksionale të çdo pale të rëndësishme të kësaj kontrate;
 - (ii) në monedhën në të cilën zakonisht shprehet çmimi i mallit ose shërbimit përkatës që është blerë ose dorëzuar, në transaksionet tregtare në mbarë botën (të tilla si dollari amerikan për transaksionet e naftës së papërpunuar); ose
 - (iii) një monedhë që përdoret zakonisht në kontratat për të blerë ose shitur zërat jofinanciar në mjedisin ekonomik në të cilin transaksioni kryhet (p.sh. një monedhë relativisht e qëndrueshme dhe likuide që përdoret zakonisht në transaksionet e biznesit lokal ose të tregtisë së jashtme).
- (e) Një opion parapagimi i përfshirë në një interes të shitur veçmas ose principal të shitur veçmas është i lidhur ngushtë me kontratën bazë nëse kontrata bazë (i) fillimisht rezulton nga ndarja e të drejtës për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të një instrumenti financiar që, në vetvete, nuk përmban një derivativ të përfshirë, dhe (ii) nuk përmban asnjë kusht që nuk ka qenë i pranishëm në kontratën fillestare bazë të borxhit.
- (f) Një derivativ i përfshirë në një kontratë bazë qiraje është i lidhur ngushtë me kontratën bazë nëse derivativi i përfshirë është (i) një indeks i lidhur me inflacionin i tillë si një indeks i pagesave të qirasë për një indeks të çmimeve të konsumit (me kusht që qiraja nuk është e ndikuar dhe indeksi lidhet me inflacionin në mjedisin e vet ekonomik të njësisë ekonomike), (ii) qiratë e kushtëzuara në bazë të shitjeve përkatëse ose (iii) qiratë e kushtëzuara në bazë të normave variabël të interesit.
- (g) Një veti lidhëse e përfshirë në një instrument financiar bazë ose në një kontratë sigurimi bazë është e lidhur ngushtë me instrumentin bazë ose kontratën bazë nëse pagesat e shprehura në njësi janë të matura me vlerën aktuale të njësisë që pasqyrojnë vlerat e drejta të aktiveve të fondit. Një veti lidhëse është një term kontraktual që kërkon pagesa të shprehura në njësitë e një fondi investimesh të brendshme ose të jashtme.
- (h) Një derivativ i përfshirë në një kontratë sigurimi është i lidhur ngushtë me kontratën bazë të sigurimit, nëse derivativi i përfshirë dhe kontrata bazë e sigurimit janë caq të ndërvarur saqë një njësi ekonomike nuk mund ta matë derivativin e përfshirë në mënyrë të veçantë (d.m.th. pa marrë parasysh kontratën bazë).

Instrumentet që përmbajnë derivativët e përfshirë

- B4.3.9 Siç është përmendur në paragrafin B4.3.1, kur një njësi ekonomike bëhet palë në një kontratë hibride me një bazë që nuk është një aktiv brenda objektit të këtij Standardi dhe me një ose më shumë derivativë të përfshirë, paragrafi 4.3.3 kërkon që njësi ekonomike për të identifikuar derivativë të tillë të përfshirë, të vlerësojë nëse është e nevojshme të jenë të ndarë nga kontrata bazë, dhe për ata që është e nevojshme të ndahen, mat derivativët me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe më pas. Këto kërkesa mund të jenë më komplekse, ose të çojnë në matje më pak të besueshme, sesa matja e tërë instrumentit me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Për këtë arsye ky Standard lejon të përcaktohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes e tërë kontrata hibride.
- B4.3.10 Ky përcaktim mund të përdoret nëse paragrafi 4.3.3 kërkon që derivativët e përfshirë të ndahen nga kontrata bazë, ose ndalon një ndarje të tillë. Megjithatë, paragrafi 4.3.5 nuk do të justifikonte caktimin e kontratës hibride me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në rastet e përcaktuara në paragrafin 4.3.5 (a) dhe (b) sepse duke bërë kështu nuk do të zvogëlohej kompleksiteti ose të rritej besueshmëria.

Rivlerësimi i derivativëve të përfshirë

- B4.3.11 Në përputhje me paragrafin 4.3.3, një njësi ekonomike do të vlerësojë nëse një derivativ i përfshirë është e nevojshme të jetë i ndarë nga kontrata bazë dhe të trajtohet si një derivativ, kur njësi ekonomike më parë bëhet palë e kontratës. Rivlerësimi i mëpasshëm është i ndaluar nëse nuk ka një ndryshim në kushtet e kontratës që modifikon në mënyrë të konsiderueshme flukset monetare që përndryshe do të kërkoheshin sipas kontratës, rast në të cilin është i nevojshëm rivlerësimi. Një njësi ekonomike përcakton nëse është i rëndësishëm një modifikim në flukset monetare duke pasur parasysh shkallën në të cilën kanë ndryshuar flukset monetare të pritshme në të ardhmen të lidhura me derivativin e përfshirë, kontrata bazë ose që të dyja dhe nëse ndryshimi është i rëndësishëm në lidhje me flukset monetare të pritshme më parë në kontratë.
- B4.3.12 Paragrafi B4.3.11 nuk aplikohet për derivativët e përfshirë në kontratat e përfituara në:
- (a) një kombinim biznesi (siç përcaktohet në SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*);
 - (b) një kombinim të njësive ekonomike ose bizneseve nën kontroll të përbashkët siç përshkruhet në paragrafët B1-B4 të SNRF 3; ose
 - (c) formimin e një sipërmarrje të përbashkët siç përcaktohet në SNRF 11 *Marrëveshjet e Përbashkëta*
- ose rivlerësimin e tyre të mundshëm në datën e blerjes.³

Riklasifikimi i aktiveve financiare (Seksioni 4.4)

Riklasifikimi i aktiveve financiare

- B4.4.1 Paragrafi 4.4.1 kërkon që një njësi ekonomike të riklasifikojë aktivet financiare nëse ndryshon modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e këtyre aktiveve financiare. Këto ndryshime priten të jenë shumë të rralla. Këto ndryshime përcaktohen nga drejtimi i lartë i njësisë ekonomike, si rezultat i ndryshimeve të jashtme dhe të brendshme dhe duhet të jenë të rëndësishme për veprimtaritë e njësisë ekonomike dhe të demonstrueshme ndaj palëve të jashtme. Prandaj, një ndryshim në modelin e biznesit të një njësie ekonomike do të ndodhë vetëm kur një njësi ekonomike ose fillon ose pushon së kryeri një aktivitet që është i rëndësishëm për operacionet e saj; për shembull, kur njësi ekonomike ka blerë, ka shitur ose ka ndërprerë një linjë të biznesit. Shembuj të një ndryshimi në modelin e biznesit përfshijnë si në vijim:
- (a) Një njësi ekonomike ka një portofol të kredive tregtare që i mban për t'i shitur në afat të shkurtër kohor. Njësi ekonomike blen një kompani që menaxhon kreditë tregtare dhe ka një model biznesi që i mban kreditë në mënyrë që të mbledhë flukset monetare kontraktuale. Portofoli i kredive tregtare nuk është më për shitje, dhe menaxhohet tani së bashku me kreditë tregtare të blera dhe të gjitha mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.
 - (b) Një firmë e shërbimeve financiare vendos të mbyllë biznesin e shitjes me pakicë të hipotekave. Ky biznes nuk pranon më biznes të ri dhe firma e shërbimeve financiare është përfshirë në mënyrë aktive në marketingun e portofolit të kredive hipotekare për shitje.

³

SNRF 3 trajton blerjen e kontratave të derivativëve të trupëzuar në një kombinim biznesi.

- B4.4.2 Një ndryshim në objektivin e modelit të biznesit të njësisë ekonomike duhet të kryhet para datës së riklasifikimit. Për shembull, nëse një firmë e shërbimeve financiare vendos në 15 shkurt të mbyllë biznesin e saj të hipotekimit dhe kështu duhet të riklasifikojë të gjitha aktivet financiare të prekura më 1 prill (pra ditën e parë të periudhës tjetër raportuese të njësisë ekonomike), njësia ekonomike nuk duhet të pranojë biznesin e ri të shitjes me pakicë të kredive hipotekare ose të angazhohet në aktivitete në përputhje me modelin e saj të biznesit pas 15 shkurtit.
- B4.4.3 Në vijim nuk janë ndryshime në modelet e biznesit:
- një ndryshim në qëllimin përsa i përket aktiveve financiare të veçanta (edhe në rrethanat e ndryshimeve të rëndësishme në kushtet e tregut).
 - zhdukja e përkohshme e një tregu të caktuar për aktivet financiare.
 - transferimi i aktiveve financiare në mes pjesëve të njësisë ekonomike me modele të ndryshme biznesi.

Matja (Kapitulli 5)

Matja fillestare (Seksioni 5.1)

- B5.1.1 Vlera e drejtë e një aktivi financiar në njohjen fillestare është, zakonisht, çmimi i transaksionit (d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë, shih gjithashtu paragrafin B5.1.2A dhe SNRF 13). Megjithatë, nëse një pjesë e shumës së dhënë ose të marrë është për diçka tjetër, përveç instrumentit financiar, një njësi ekonomike do të matë vlerën e drejtë të instrumentit financiar. Për shembull, vlera e drejtë e një huaje ose llogari të arkëtueshme afatgjatë, që nuk mbart interes mund të matet si vlera aktuale e të gjitha arkëtimeve të flukseve monetare të ardhshme të skontuara duke përdorur normën(at) mbizotëruese të interesit të tregut (tregjeve), për një instrument të ngjashëm (i ngjashëm si për nga monedha, afati, lloji i normës së interesit dhe faktorë të tjerë) me një përcaktim të ngjashëm të kredisë. Çdo shumë shtesë e huazuar është një shpenzim ose një reduktim i të ardhurave, vetëm nëse nuk kualifikohet për njohje si një lloj tjetër aktivi.
- B5.1.2 Nëse një njësi ekonomike ka nisur një kredi që mbart një normë interesi jashtë tregut (p.sh. 5 përqind, kur norma e tregut për kredi të ngjashme është 8 përqind), dhe merr një tarifë në fillim si kompensim, njësia ekonomike e njeh kredinë me vlerën e drejtë, d.m.th. neto nga tarifa e marrë.
- B5.1.2A Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare zakonisht është çmimi i transaksionit (d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë, shih gjithashtu SNRF 13). Nëse një njësi ekonomike përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, siç përmendet në paragrafin 5.1.1A, njësia ekonomike do ta trajtojë këtë instrument në këtë datë si vijon:
- me matjen e kërkuar nga paragrafi 5.1.1, në qoftë se vlera e drejtë evidentohet me anë të një çmimi të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të njëjtë (d.m.th. input të Nivelit 1), ose bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna vetëm nga tregjet e mbikëqyrura. Një njësi ekonomike do të njohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit, si një fitim ose humbje.
 - në të gjitha rastet e tjera, me matjen e kërkuar nga paragrafi 5.1.1, të rregulluar me diferencën e shtyrë midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Pas njohjes fillestare, njësia ekonomike do ta njohë këtë diferencë të shtyrë si një fitim ose humbje vetëm në atë masë që ajo vjen nga një ndryshim në një faktor (përfshirë kohën), që pjesëmarrësit e tregut do të kishin parasysh gjatë caktimit të çmimit të aktivit ose detyrimit.

Matjet e mëpasshme (Seksioni 5.2 dhe 5.3)

- B5.2.1 Nëse një instrument financiar, që është njohur më parë si një aktiv financiar, matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe vlera e drejtë e tij bie nën zero, ai është një detyrim financiar i matur në përputhje me paragrafin 4.2.1. Megjithatë, kontrata hibride me instrumente bazë, që janë aktive brenda objektit të këtij Standardi, matet gjithmonë në përputhje me paragrafin 4.3.2.
- B5.2.2 Shembulli i mëposhtëm ilustron kontabilitetin për kostot e transaksionit në matjen fillestare dhe të mëpasshme të një aktivi financiar të matur me vlerën e drejtë me ndryshimet nëpërmjet të ardhurave të tjera të përgjithshme në përputhje ose me paragrafin 5.7.5 ose 4.2.1A. Një njësi ekonomike blen një aktiv financiar për 100NJM plus një komision blerje për 2NJM. Fillimisht, njësia ekonomike e njeh aktivin me 102NJM. Periudha e raportimit përfundon një ditë më vonë, kur çmimi i kuotuar në treg i aktivit është

100NJM. Nëse aktivi shitet, do të paguhet një komision për 3NJM. Në këtë datë, njësia ekonomike e mat aktivin me 100NJM (pa marrë parasysh komisionin e mundshëm në shitje) dhe një humbje prej 2NJM në të ardhura të tjera të përgjithshme. Në qoftë se aktivi financiar matet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2A, kostot e transaksionit amortizohen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

B5.2.2A Matja e mëpasshme e një aktivi financiar ose detyrimi financiar dhe njohja e mëpasshme e fitimeve dhe humbjeve neto, të përshkruara në paragrafin B5.1.2A, do të jetë në përputhje me kërkesat e këtij Standardi.

Investimet në instrumente të kapitalit neto dhe kontratat për këto investime

B5.2.3 Të gjitha investimet në instrumente kapitali dhe kontratat për këto instrumente duhet të maten me vlerën e drejtë. Megjithatë, në rrethana të kufizuara, kostoja mund të jetë një vlerësim i duhur i vlerës së drejtë. Ky mund të jetë rasti kur disponohet informacion i pamjaftueshëm i kohëve të fundit për të matur vlerën e drejtë, apo në qoftë se ka një interval të gjerë të matjeve të mundshme të vlerës së drejtë dhe kostoja përfaqëson vlerësimin më të mirë të vlerës së drejtë brenda këtij intervali.

B5.2.4 Treguesit që kostoja mund të mos jetë përfaqësuese e vlerës së drejtë përfshijnë:

- (a) një ndryshim i rëndësishëm në performancën e të investuarit krahasuar me buxhetet, planet apo objektivat.
- (b) ndryshimet në pritshmëritë që objektivat teknike të produktit do të arrihen nga i investuari.
- (c) një ndryshim i rëndësishëm në treg për kapitalin e të investuarit ose produkteve të tij apo i produkteve potenciale.
- (d) një ndryshim i rëndësishëm në ekonominë globale, ose mjedisin ekonomik në të cilin operon i investuari.
- (e) një ndryshim i rëndësishëm në performancën e njësive ekonomike të krahasueshme, ose në vlerësime të nënkuptuara nga tregu i përgjithshëm.
- (f) çështje të brendshme të të investuarit të tilla si mashtrimi, mosmarrëveshjet tregtare, gjyqësore, ndryshimet në menaxhimin apo strategjinë.
- (g) evidenca nga transaksionet e jashtme në kapitalin e të investuarit- ose nga i investuari (të tilla si emetimi i ri i kapitalit), ose nga transferimet e instrumenteve të kapitalit ndërmjet palëve të treta.

B5.5.47 Humbjet e pritshme e kreditit në një angazhim huaje do të skontohehen duke përdorur normën e interesit efektiv, ose një përafrim të saj, që do të zbatohet kur njihet aktivi financiar që rezulton nga ky angazhimi huaje. Kjo është kështu me qëllim që të zbatohen kërkesat e çvlerësimit, një aktiv financiar që është njohur si pasojë e një tërheqje të një angazhim të huasë do të trajtohen si një vazhdim të atij angazhim në vend që të njihet si një instrument i ri financiar. Humbjet e pritshme të kredisë mbi aktivin financiar, pra, do të matet duke pasur parasysh rrezikun fillestar të angazhimit të huasë nga data që njësi ekonomike u bë palë në angazhimin e parevokueshëm.

B5.5.48 Humbjet e pritshme të kredisë për kontratat e garancisë financiare ose për angazhime huaje për të cilat norma e interesit efektiv nuk mund të përcaktohet, do të skontohehen duke aplikuar një normë interesi e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet që janë specifike për flukset monetare por vetëm nëse, dhe deri në masën që, rreziqet janë marrë parasysh duke rregulluar normën e skontimit dhe jo duke rregulluar mungesën e mjeteve monetare që do ndërpriten.

Informacion i arsyeshëm dhe mbështetës

B5.5.49 Për qëllimet e këtij Standardi, informacioni i arsyeshëm dhe i mbështetur është ai që është në dispozicion në datën e raportimit, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, duke përfshirë informacion në lidhje me ngjarjet e së kaluarës, kushtet aktuale dhe parashikimet për kushtet ekonomike në të ardhmen. Informacioni që është në dispozicion për qëllime të raportimit financiar është konsideruar të jetë në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme.

B5.5.50 Një njësi ekonomike nuk i kërkohet që të përfshijë parashikimet për kushtet e ardhshme gjatë gjithë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Shkalla e gjykimit që është e nevojshme për të vlerësuar humbjet e pritshme të kredisë varet nga disponueshmëria e informacionit të detajuar. Ashtu si horizonti parashikimi rritet, disponueshmëria e informacionit të detajuar zvogëlohet dhe shkalla e gjykimit të nevojshme për të vlerësuar humbjet e pritshme të kredisë rritet. Vlerësimi i humbjeve të pritshme të kredisë nuk kërkon një vlerësim të detajuar për periudha që janë larg në të ardhmen, në fakt për periudha të tilla, një njësi ekonomike mund të shfrytëzojë parashikimet nga informacione të detajuara në dispozicion.

B5.5.51 Një njësi ekonomike nuk ka nevojë të ndërmarrë një kërkim të ekzagjeruar për informacion por duhet të marrin në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme dhe që është i përshtatshëm për vlerësimin e humbjeve të pritshme të kredisë, duke përfshirë efektin e parapagimeve të pritshme. Informacioni i përdorur duhet të përfshijë faktorët që janë specifike për huamarësin, kushtet e përgjithshme ekonomike dhe një vlerësim të djave, si drejtimin aktual dhe atë të parashikuar të kushteve në datën e raportimit. Një njësi ekonomike mund të përdorë burime të ndryshme të të dhënave, që mund të jenë si të brendshme (subjekti specifike) ashtu dhe të jashtme. Burimet e mundshme të të dhënave përfshijnë përvojën e brendshme historike të humbjeve të kredisë, vlerësimet e brendshme, përvojën e humbjeve të kredisë të subjekteve të tjera dhe vlerësimet e jashtme, raporte dhe statistika. Njësitë ekonomike që nuk kanë fare, ose kanë burime të pamjaftueshme, të

të dhënave specifike mund të përdorë përvojën e kolegëve për instrumente financiare të krahasueshme (ose grupe të instrumenteve financiare).

- B5.5.52 Informacioni historik është një referencë e rëndësishme ose baza nga e cila nisemi për të matur humbjet e pritshme të kredisë. Megjithatë, një njësi ekonomike duhet të rregullojë të dhënat historike, të tilla si përvojën humbjes së kredisë, në bazë të të dhënave aktuale për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale dhe parashikimet e kushteve për të ardhshmen që nuk prekin periudhën në të cilën të dhënat historike janë bazuar, dhe të mënjanojë efektet e kushteve në periudhën historike që nuk janë të përshtatshme për flukset e ardhshme kontraktuale të mjeteve monetare. Në disa raste, informacioni më i mirë i arsyeshëm dhe i mbështetur mund të jetë informacioni i parregulluar historik, në varësi të natyrës së informacionit historik dhe kur është llogaritur, krahasuar me rrethanat në datën e raportimit dhe karakteristikat e instrumentit financiar të marrë konsideratë. Vlerësimet e ndryshimeve në humbjet e pritshme të kredisë duhet të reflektojnë, dhe të jenë në përputhje me ndryshimet në të dhënat përkatëse nga periudha në periudhë (siç janë ndryshimet në normat e papunësisë, çmimet e pasurive të paluajtshme, çmimet e mallrave, statusin e pagesave apo faktorë të tjerë që janë tregues të humbjeve të kredisë të një instrumenti financiar ose të një grupi instrumentesh financiare dhe në madhësinë e këtyre ndryshimeve). Një njësi ekonomike do të rishikojë rregullisht metodologjinë dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e humbjeve të pritshme të kredisë për të reduktuar çdo diferencë ndërmjet vlerësimeve dhe përvojës aktuale të humbjes së kreditit.
- B5.5.53 Kur përdoret përvoja historike e humbjeve të kredisë në vlerësimin e humbjeve të pritshme të kredisë, është e rëndësishme që informacioni për normat historike të humbjeve të kredisë të zbatohet për grupet që janë të përcaktuara në një mënyrë të tillë që është në përputhje me grupet për të cilat janë vëzhguar normat historike të humbjeve të kredisë. Si rrjedhojë, metoda e përdorur duhet të mundësojë që secili grup i aktiveve financiare të jetë i shoqëruar me informacion lidhur me përvojën e kaluar të humbjes së kreditit në grupin e aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut dhe me të dhënat përkatëse të vëzhguara që reflektojnë kushtet aktuale.
- B5.5.54 Humbjet e pritshme e kreditit reflektojnë humbjet e pritshme të kredisë të njësisë ekonomike. Megjithatë, kur merret parasysh i gjithë informacioni i arsyeshëm dhe i mbështetur që është në dispozicion pa kosto apo përpjekje të panevojshme në vlerësimin e humbjeve të pritshme të kredisë, një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë informacionin e dukshëm të tregut në lidhje me rrezikun e kredisë të instrumentit të veçantë financiar ose instrumenteve financiare të ngjashme.

Kolaterali

- B5.5.55 Për qëllime të matjes së humbjeve të pritshme të kredisë, vlerësimi i mungesave monetare të pritshme duhet të pasqyrojë flukset e mjeteve monetare të pritshme nga kolaterali dhe aktivet e tjera garantuese të kredisë që janë pjesë e kushteve kontraktuale dhe që nuk janë njohur veçmas nga njësi ekonomike. Vlerësimi i mungesave monetare të pritshme në një instrument financiar të siguruar me kolateral pasqyron shumën dhe kohën e flukseve monetare që pritet nga shitja e kolateralit minus kostot e marrjes dhe shitjes së kolateralit, pavarësisht nëse shitja është e mundshme (d.m.th. vlerësimi i flukseve të pritshme të mjeteve monetare të marrë në konsideratë mundësinë e shitjes së kolateralit dhe flukset e mjeteve monetare që do të rezultojnë nga kjo shitje). Rrjedhimisht, çdo flukse të mjeteve monetare që priten nga shitja i kolateralit përtej maturimit kontraktual të kontratës duhet të përfshihet në këtë analizë. Çdo kolateral i marrë si rezultat i shitjes së kolateralit nuk njihet si një aktiv që është i ndarë nga instrumenti financiar i garantuar me kolateral nëse nuk i plotëson kriteret përkatëse të njohjes për një aktiv në këtë Standard apo Standarde të tjera.

Riklasifikimi i aktiveve financiare (seksioni 5.6)

- B5.6.1 Nëse një njësi ekonomike i riklasifikon aktivet financiare në përputhje me paragrafin 4.4.1, paragrafi 5.6.1 kërkon që ajo do të zbatohet në mënyrë prospektive riklasifikimin që nga data e riklasifikimit. Si kategoria e matjes me koston e amortizuar ashtu dhe ajo e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera përmbledhëse kërkojnë që norma efektive e interesit të përcaktohet në momentin e njohjes fillestare. Të dyja këto kategori të matjes gjithashtu të kërkojnë që kërkesat e çvlerësimit të zbatohen në të njëjtën mënyrë. Si pasojë, kur një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar ndërmjet kategorisë të matura me koston e amortizuar dhe kategorisë të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet të ketë parasysh që:
- njohja e të ardhurave nga interesi nuk do të ndryshojë dhe për këtë arsye njësi ekonomike vazhdon të përdorë të njëjtën normë efektive të interesit.
 - matja e humbjeve të pritshme të kredisë nuk do të ndryshojë për shkak se të dy kategoritë e matjeve zbatohen të njëjtën qasje për zhvlerësimin. Megjithatë nëse një aktiv financiar është riklasifikuar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera

përmbledhëse në kategorinë e matjes me koston e amortizuar, provizioni për humbje do të njihet si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivitetit financiar nga data riklasifikimit. Nëse një aktiv financiar është riklasifikuar nga kategoria e matjes me koston e amortizuar në kategorinë e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, provizioni për humbjen do të çregjistrohet (dhe kështu nuk do të njihen më si një rregullim i vlerës kontabël bruto), por në vend të kësaj do të njihet si një shumë e akumuluar zhvlerësimi (të një shumë të barabartë) në të ardhura të tjera përmbledhëse dhe do të japë informacion shpjegues nga data riklasifikimit.

- B5.6.2 Megjithatë, një njësi ekonomike nuk i kërkohet të njohë veç e veç të ardhurat nga interesi ose fitimet dhe humbjet nga çvlerësimi për një aktiv financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Si pasojë, kur një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar nga kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, norma efektive e interesit përcaktohet në bazë të vlerës së drejtë të aktivitetit në datën e riklasifikimit. Përveç kësaj, për qëllime të zbatimit të Seksionit 5.5 për aktivin financiar nga data e riklasifikimit, data e riklasifikimit trajtohet si data e njohjes fillestare.

Fitime dhe humbje neto (Seksioni 5.7)

- B5.7.1 Paragrafi 5.7.5 lejon një njësi ekonomike të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur në të ardhura të tjera të përgjithshme ndryshimet në vlerën e drejtë të një investimi në një instrument kapitali që nuk mbahet për tregtim. Kjo zgjedhje bëhet bazuar në instrument-për-instrument (d.m.th. aksion për aksion). Shumat e paraqitura në të ardhura të tjera të përgjithshme nuk do të transferohen më pas në fitim ose humbje. Megjithatë, njësi ekonomike mund të transferojë fitimin ose humbjen neto kumulative brenda kapitalit neto. Dividendët për investime të tilla njihen në fitim ose humbje në përputhje me paragrafin 5.7.6, përveç rastit kur dividendi paraqet qartë një mbulim të një pjese të koston së investimit.
- B5.7.1A Përveç rastit kur zbatohet paragrafi 4.1.5, paragrafi 4.1.2A kërkon që një aktiv financiar matet me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse në qoftë se kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar sjellin flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar dhe aktivi është mbajtur në një model biznesi objektiv i të cilit është arritur nga të dyja, si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu dhe nga shitja e aktiveve financiare. Kjo kategori matje njeh informacion në fitim ose humbje sikurse aktivi financiar të ishte matur me koston e amortizuar, ndërkohë që aktivi financiar matet në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë. Fitimet ose humbjet e tjera, përveç atyre që janë të njohur në fitim ose humbje në përputhje me paragrafët 5.7.10-5.7.11, njihen të ardhurat e tjera përmbledhëse. Kur këto aktivet financiare çregjistrohen, fitimet ose humbjet e akumuluarra të njohura më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohen në fitim ose humbje. Kjo reflekton fitimin ose humbjen që do të ishte njohur në fitim ose humbje në rastin e çregjistrimit nëse aktivi financiar kishte qenë i matur me koston e amortizuar.
- B5.7.2 Një njësi ekonomike zbaton SNK 21 për aktivet financiare dhe detyrimet financiare që janë zëra monetarë në përputhje me SNK 21 dhe të shprehura në monedhë të huaj. SNK 21 kërkon që çdo fitim dhe humbje neto nga këmbimi i monedhave të huaja për aktivet dhe detyrimet monetare të njihen në fitim ose humbje. Këtu bën përjashtim një zë monetar që është i përcaktuar si instrument mbulues në një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare (shih paragrafin 6.5.11), një mbrojtje të një investimi neto (shih paragrafin 6.5.13), ose një mbrojtje me vlerën e drejtë të një instrumenti të kapitalit neto, për të cilin njësi ekonomike ka vendosur të pasqyrojë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5 (shih paragrafin 6.5.8).
- B5.7.2A Për qëllim njohjen e fitimeve dhe humbjeve nga kurset e këmbimit të monedhave të huaja sipas SNK 21, një aktiv financiar i matur me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 4.1.2A është trajtuar si një zë monetar. Prandaj, një aktiv i tillë financiar është trajtuar si një aktiv i matur me koston e amortizuar në monedhë të huaj. Diferencat e këmbimit për koston e amortizuar njihen në fitim ose humbje dhe ndryshimet e tjera në vlerën kontabël njihen në përputhje me paragrafin 5.7.10.
- B5.7.3 Paragrafi 5.7.5 lejon një njësi ekonomike të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur në të ardhura të tjera të përmbledhëse ndryshimet e mëposhme në vlerën e drejtë të ndonjë investimi të veçantë në një instrument kapitali. Një investim i tillë nuk është një zë monetar. Kështu, fitimi ose humbja neto që është paraqitur në të ardhura të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.5 përfshin çdo përbërës që lidhet me këmbimin e monedhave të huaja.
- B5.7.4 Nëse ka një marrëdhënie mbrojtëse në mes të një aktivi jo-derivativ monetar dhe detyrimi jo-derivativ monetar, ndryshimet në përbërësin e monedhës së huaj të këtyre instrumenteve financiare paraqiten në fitim ose humbje.

Detyrimet e përcaktuar si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

- B5.7.5 Kur një njësi ekonomike përcakton një detyrim financiar si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ajo duhet të përcaktojë nëse paraqitja në të ardhura të tjera të përgjithshme e efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë të detyrimit do të krijonte ose shtonte një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje. Një mospërputhje kontabël do të krijohej apo shtohej, nëse paraqitja e efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë në të ardhura të tjera të përgjithshme do të çojë në një mospërputhje më të madhe në fitim ose humbje në qoftë se këto shuma paraqiten në fitim ose humbje.
- B5.7.6 Për të bërë këtë përcaktim, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse ajo pret që efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të detyrimit do të kompensohen në fitim ose humbje nga një ndryshim në vlerën e drejtë të një instrumenti tjetër financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Një pritshmëri e tillë duhet të bazohet në një marrëdhënie ekonomike në mes të karakteristikave të detyrimit dhe karakteristikave të instrumentit tjetër financiar.
- B5.7.7 Ky përcaktim bëhet në njohjen fillestare dhe nuk rivlerësohet. Për qëllime praktike njësi ekonomike nuk duhet të hyjë në të gjitha aktivitetet dhe detyrimet që shkaktojnë një mospërputhje kontabël saktësisht në të njëjtën kohë. Një shtyrje e arsyeshme lejohet me kushtin që pritet të ndodhin transaksionet e mbetura. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë vazhdimisht metodologjinë e saj për të përcaktuar nëse paraqitja në të ardhurat e tjera të përgjithshme të efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë të detyrimit do të krijojë ose zgjerojë një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje. Megjithatë, një njësi ekonomike mund të përdorë metodologjinë e ndryshme, kur ka marrëdhënie të ndryshme ekonomike në mes të karakteristikave të detyrimeve të përcaktuara si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe karakteristikave të instrumenteve të tjera financiare. SNRF 7 kërkon që njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese cilësore në shënimet e pasqyrave financiare në lidhje me metodologjinë e saj për të bërë këtë përcaktim.
- B5.7.8 Nëse do të krijohej apo zgjerohej një mospërputhje, njësi ekonomike duhet të paraqesë të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë (duke përfshirë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë), në fitim ose humbje. Nëse nuk do të krijohej apo zgjerohej një mospërputhje, njësi ekonomike është e detyruar të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë në të ardhura të tjera të përgjithshme.
- B5.7.9 Shumat e paraqitura në të ardhura të tjera të përgjithshme nuk do të transferohen më pas në fitim ose humbje. Megjithatë, njësi ekonomike mund të transferojë fitimin ose humbjen neto kumulative brenda kapitalit neto.
- B5.7.10 Shembulli i mëposhtëm përshkruan një situatë në të cilën do të krijohej një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje, nëse efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë paraqiten në të ardhura të tjera të përgjithshme. Një bankë huash hipotekare ofron kredi për konsumatorët dhe i financon këto kredi duke shitur obligacione me karakteristikat e përputhjes (p.sh. shuma e papaguar, profili i shlyerjes, afati dhe monedha) në treg. Kushtet kontraktuale të kredisë e lejojnë konsumatorin e kredisë hipotekare të parapaguajë kredinë e tij (d.m.th. plotëson detyrimin e tij ndaj bankës), duke blerë obligacionin përkatës me vlerën e drejtë në treg dhe duke ia dhënë atë bankës. Si rezultat i kësaj të drejte parapagimi kontraktuale, në qoftë se cilësia e kredisë e obligacionit përkeqësohet (dhe, në këtë mënyrë, zvogëlohet vlera e drejtë e detyrimit të bankës), vlera e drejtë e aktivitetit të kredisë hipotekare të bankës zvogëlohet. Ndryshimi në vlerën e drejtë të aktivitetit pasqyron të drejtën kontraktuale të konsumatorit të kredisë hipotekare për ta parapaguar kredinë duke blerë obligacione bazë me vlerën e drejtë (e cila, në këtë shembull, është ulur) dhe duke ia livruar këto obligacione bankës hipotekare. Prandaj, efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të detyrimit (obligacionit) do të kompensohen në fitimin ose humbjen nga një ndryshim korrespondues në vlerën e drejtë të një aktivi financiar (kredisë). Në qoftë se efektet e ndryshimeve në rrezikun e detyrimit të kredisë paraqiten në të ardhura të tjera të përgjithshme do të kishte një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje. Prandaj, banka hipotekare është e detyruar të paraqesë të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të detyrimit (duke përfshirë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të detyrimit) në fitim ose humbje.
- B5.7.11 Në shembullin në paragrafin B5.7.10, ka një lidhje kontraktuale midis efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë së detyrimit dhe ndryshimeve në vlerën e drejtë të aktivitetit financiar (d.m.th. si rezultat i të drejtës kontraktuale të konsumatorit të kredisë hipotekare për ta parapaguajë atë duke blerë obligacion me vlerën e drejtë dhe duke ia livruar bankës). Megjithatë, një mospërputhje kontabël mund të ndodhë edhe në mungesë të një lidhje kontraktuale.
- B5.7.12 Për qëllime të zbatimit të kërkesave në paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8, një mospërputhje kontabël nuk shkaktohet vetëm nga metoda e matjes, që një njësi ekonomike përdor për të përcaktuar efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë së një detyrimi. Një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje lind vetëm kur efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë (siç përcaktohet në SNRF 7) pritet të kompensohen nga ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti tjetër financiar. Një mospërputhje që lind vetëm si rezultat i metodës së matjes (p.sh. për shkak se një njësi ekonomike nuk i ka izoluar ndryshimet në rrezikun e kredisë të një detyrimi nga disa ndryshime të tjera në vlerën e tij të drejtë) nuk ndikon në përcaktimin e kërkuar nga paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8. Për shembull, një njësi ekonomike nuk mund të izolojë ndryshimet

në rrezikun e kredisë nga ndryshimet në rrezikun e likuiditetit. Nëse njësia ekonomike paraqet efektin e kombinuar të të dy faktorëve në të ardhura të tjera të përgjithshme, mund të ndodhë një mospërputhje për shkak se ndryshimet në rrezikun e likuiditetit mund të përfshihen në matjen e vlerës së drejtë të këtyre aktiveve të njësies ekonomike dhe i gjithë ndryshimi i vlerës së drejtë i këtyre aktiveve paraqitet në fitim ose humbje. Megjithatë, një mospërputhje e tillë shkaktohet nga pasaktësi të matjes, dhe jo nga marrëdhënie kompensimi të përshkruar në paragrafin B5.7.6 dhe, prandaj, nuk ndikon në përcaktimin e kërkuar nga paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8.

Kuptimi i "rrezikut të kredisë" (paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8)

- B5.7.13 SNRF 7 përcakton rrezikun e kredisë si "rrezikun që njëra palë në një instrument financiar do të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke mos arritur të kryejë një detyrim". Kërkesa në paragrafin 5.7.7 (a) ka të bëjë me rrezikun që emetuesi nuk do të arrijë të përmbushë këtë detyrim të veçantë. Kjo kërkesë jo medoemos lidhet me aftësinë huamarrëse të emetuesit. Për shembull, nëse një njësi ekonomike emeton një detyrim të kolateralizuar dhe detyrim jo të kolateralizuar që ndryshe janë identikë, rreziku i kredisë i këtyre dy detyrimeve do të jetë i ndryshëm, edhe pse ata janë emetuar nga e njëjta njësi ekonomike. Rreziku i kredisë për detyrimin e kolateralizuar do të jetë më i ulët se rreziku i kredisë të detyrimit të pa kolateralizuar. Rreziku i kredisë për një detyrim të kolateralizuar mund të jetë afër zeros.
- B5.7.14 Për qëllime të zbatimit të kërkesave në paragrafin 5.7.7 (a), rreziku i kredisë është i ndryshëm nga rreziku i performancës të aktivit specifik. Rreziku i performancës së aktivit specifik nuk lidhet me rrezikun që një njësi ekonomike nuk do të arrijë të përmbushë një detyrim të veçantë, por përkundrazi ai është i lidhur me rrezikun që një aktiv i vetëm ose një grup aktivesh do të funksionojë dobët (ose aspak).
- B5.7.15 Në vijim jepen shembuj të aktivitetit – me rrezik specifik të performancës:
- (a) një detyrim me një veti lidhëse ku shumica e detyrimit për investitorët është e përcaktuar me kontratë mbi bazën e performancës së aktiveve të specifikuara. Efekti i kësaj vetie lidhëse në vlerën e drejtë të detyrimit është rreziku i performancës së aktivitetit specifik dhe jo rreziku i kredisë.
 - (b) një detyrim i nxjerrë nga një njësi ekonomike e strukturuar me karakteristikat e mëposhtme. Njësia ekonomike është ligjrisht e izoluar në mënyrë që aktivet në njësinë ekonomike janë të mbrojtura vetëm për të mirën e investitorëve të saj, madje edhe në rast falimentimi. Njësia ekonomike nuk hyn në transaksione të tjera dhe aktivet në njësinë ekonomike nuk mund të hipotekohen. Shumat u paguhen investitorëve të njësies ekonomike vetëm nëse aktivet e mbrojtura gjenerojnë flukse monetare. Kështu, ndryshimet në vlerën e drejtë të detyrimit kryesisht pasqyrojnë ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve. Efekti i performancës së aktiveve në vlerën e drejtë të detyrimit është rreziku i performancës së aktiveve të veçanta, nuk është rreziku i kredisë.

Përcaktimi i efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë

- B5.7.16 Për qëllime të zbatimit të kërkesave në paragrafin 5.7.7 (a), një njësi ekonomike përcakton madhësinë e ndryshimit në vlerën e drejtë të detyrimit financiar që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë ose:
- (a) si shumë e ndryshimit në vlerën e drejtë të tij që nuk lidhet me ndryshimet në kushtet e tregut që shkaktojnë rrezikun e tregut (shih paragrafët B5.7.17 dhe B5.7.18); ose
 - (b) duke përdorur një metodë alternative, njësia ekonomike mendon se e përfaqëson më besnikërisht shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të detyrimit që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë.
- B5.7.17 Ndryshimet në kushtet e tregut që shkaktojnë rrezikun e tregut përfshijnë ndryshimet në një normë bazë interesi, çmimin e një instrumenti financiar të një njësie tjetër ekonomike, një çmim malli, një normë këmbimi të monedhave të huaja ose indeksin e çmimeve apo normave.
- B5.7.18 Në qoftë se ndryshimet në një normë interesi (bazë) të mbikëqyrur janë të vetmet ndryshime përkatëse të rëndësishme në kushtet e tregut të një detyrimi, shumica në paragrafin B5.7.16 (a) mund të vlerësohet si më poshtë:
- (a) Së pari, njësia ekonomike llogarit normën e brendshme të kthimit të detyrimit në fillim të periudhës duke përdorur vlerën e drejtë të detyrimit dhe flukset monetare kontraktuale të tij në fillim të periudhës. Nga kjo normë kthimi zbritet norma e mbikëqyrur (bazë) e interesit në fillim të periudhës, për të arritur në një përbërës specifik të normës së brendshme të kthimit të instrumentit.
 - (b) Pas kësaj, njësia ekonomike llogarit vlerën aktuale të flukseve monetare të lidhura me detyrimin duke përdorur flukset monetare kontraktuale të tij në fund të periudhës dhe një normë skontimi të

- barabartë me shumën e (i) normës së mbikëqyrur (bazë) të interesit në fund të periudhës dhe (ii) përbërësin specifik të normës së brendshme të kthimit të përcaktuar në pikën (a).
- (c) Diferenca midis vlerës së drejtë të detyrimit në fund të periudhës dhe shumës së përcaktuar në pikën (b) është ndryshimi në vlerën e drejtë që nuk iu takon ndryshimeve në normën e mbikëqyrur (bazë) të interesit. Kjo është shuma që do të paraqitet në të ardhura të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.7 (a).
- B5.7.19 Shembulli në paragrafin B5.7.18 supozon se ndryshimet në vlerën e drejtë që vijnë nga faktorë të tjerë dhe jo nga ndryshimet në rrezikun e kredisë ose ndryshimet në normat e mbikëqyrura (bazë) të interesit nuk janë të rëndësishme. Kjo metodë nuk do të ishte e përshtatshme në qoftë se ndryshimet në vlerën e drejtë, që vijnë nga faktorë të tjerë, janë të rëndësishme. Në këto raste, një njësi ekonomike kërkohet të përdorë një metodë alternative që mat më me besnikëri efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë (shih paragrafin B5.7.16 (a)). Për shembull, nëse instrumenti në shembull përmban një derivativ të përfshirë, ndryshimi në vlerën e drejtë të derivativit të përfshirë përjashtohet në përcaktimin e shumës që do të paraqitet në të ardhura të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.7 (a).
- B5.7.20 Si me të gjitha matjet me vlerën e drejtë, metoda e matjes e një njësie ekonomike, për përcaktimin e pjesës së ndryshimit në vlerën e drejtë të detyrimit, që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë, duhet të shfrytëzojë maksimumin e inputeve përkatëse të verifikueshme dhe përdorimin minimal të inputeve të paverifikueshme.

Kontabiliteti mbrojtës (Kapitulli 6)

Instrumentet mbulues (Seksioni 6.2)

Instrumentet kualifikues

- B6.2.1 Derivatvët që janë të përfshirë në kontrata hibride, por që nuk trajtohen më vete, nuk mund të përcaktohen si instrumente mbulues të veçantë.
- B6.2.2 Instrumentet e kapitalit neto të vetë njësisë ekonomike nuk janë aktive financiare apo detyrime financiare të njësisë ekonomike dhe kështu që nuk mund të përcaktohen si instrumente mbulues.
- B6.2.3 Për mbrojtje nga rreziku i kursit të këmbimit, përbërësi i rrezikut të monedhës së huaj të një instrumenti financiar jo derivativ, përcaktohet në përputhje me SNK 21.

Opsionet e shitur

- B6.2.4 Ky Standard nuk i kufizon rrethanat në të cilat një derivativ që matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të përcaktohet si një instrument mbulues, me përjashtim të disa opsioneve të shkruara. Një opion i shitur nuk kualifikohet si një instrument mbulues deri në momentin që ai përcaktohet si një kompensim i një opsioni të blerë, duke përfshirë edhe rastin kur ai është i përfshirë në një instrument financiar tjetër (për shembull, një opion i shitur për të blerë i përdorur për të mbuluar një detyrim të kërkueshëm).

Përcaktimi i instrumenteve mbulues

- B6.2.5 Për mbrojtje të ndryshme nga mbrojtjet e rrezikut të monedhës së huaj, kur një njësi ekonomike përcakton një aktiv financiar jo derivativ ose një detyrim financiar jo derivativ të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, si një instrument mbulues, kjo njësi ekonomike mund të përcaktojë vetëm instrumentin financiar jo derivativ në tërësi ose një pjesë të tij.
- B6.2.6 Një instrument mbulues i vetëm mund të përcaktohet si një instrument mbulues i më shumë se një lloji rreziku, me kusht që të ketë një përcaktim specifik të instrumentit mbulues dhe pozicionet e ndryshme të rrezikut si elemente të mbrojtur. Këto elemente të mbrojtur mund të jenë në marrëdhënie mbrojtëse të ndryshme.

Elementet e mbrojtur (Seksioni 6.3)

Kualifikimi i zërave

- B6.3.1 Një angazhim i përcaktuar për të blerë një biznes në një kombinim biznesi nuk mund të jetë një element i mbrojtur, përveç rrezikut të monedhës së huaj, për shkak se rreziqet e tjera që mbulohen nuk mund të jenë të identifikueshëm dhe të matshëm në mënyrë specifike. Këto rreziqe të tjera janë rreziqe të përgjithshme biznesi.
- B6.3.2 Një investim me metodën e kapitalit neto nuk mund të jetë një element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerën e drejtë. Kjo ndodh për shkak se metoda e kapitalit neto njihet në fitim ose humbje pjesën e investitorit në fitimin ose humbjen e të investuarit dhe jo ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit. Për të njëjtën arsye, një investim në një filial të konsoliduar nuk mund të jetë një element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerën e drejtë. Kjo ndodh për shkak se konsolidimi njihet në fitim ose humbje fitimin ose humbjen e filialit dhe jo ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit. Një mbrojtje e një investimi neto në një njësi ekonomike të huaj është ndryshe sepse ajo është një mbrojtje nga ekspozimi i monedhës së huaj, jo një mbrojtje me vlerën e drejtë në vlerën e investimit.
- B6.3.3 Paragrafi 6.3.4 i lejon një njësi ekonomike që të përcaktojë si elemente të mbrojtur ekspozime agregate që janë kombinim i një ekspozimi dhe një derivativi. Me përcaktimin e një elementi të tillë të mbrojtur, një njësi ekonomike vlerëson nëse ekspozimi agregat kombinon një ekspozim me një derivativ dhe kështu të krijojë një ekspozim agregat të ndryshëm nga ai i pari, që menaxhohet si ekspozim për një rrezik (ose rreziqe) të veçantë. Në këtë rast, njësi ekonomike mund të përcaktojë elementin e mbrojtur në bazë të ekspozimit agregat. Për shembull:
- (a) një njësi ekonomike mund të mbrojë një sasi të caktuar kafeje me probabilitet të lartë blerjeje në një periudhë 15 mujore, ndaj rrezikut të çmimit (të shprehur në USD) duke përdorur një kontratë të së ardhmes me periudhë 15 mujore për blerje kafeje. Kombinimi i blerjeve me probabilitet të lartë të kafesë dhe kontratave të së ardhmes për blerje kafeje, mund të konsiderohen si një ekspozim ndaj rrezikut të monedhës së huaj USD për një shumë fikse 15 mujore, për qëllime të menaxhimit të rrezikut (d.m.th. si çdo shumë tjetër fikse në USD e daljes së mjeteve monetare në një periudhë 15 mujore).
 - (b) një njësi ekonomike mund të mbrohet nga rreziku i kursit të këmbimit për të gjithë afatin e një borxhi me normë fikse 10 vjeçare të shprehur në monedhë të huaj. Megjithatë, njësi ekonomike kërkon ekspozim ndaj normës fikse në monedhën e saj funksionale vetëm për një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme (p.sh. dy vjet) dhe ekspozim ndaj normës së luhatshme në monedhën funksionale për periudhën e mbetur deri në maturim. Në fund të çdo intervali dy vjeçar (d.m.th. në baza dy vjeçare që përsëriten), njësi ekonomike fikson ekspozimin ndaj normës së interesit për dy vitet në vazhdim (në qoftë se niveli i interesit është i tillë që njësi ekonomike dëshiron që të fiksojë normat e interesit). Në një situatë të tillë, një njësi ekonomike mund të futet në një SWAP 10 vjeçare ndër monedhash, me normë interesi nga fikse në të luhatshme, i cili e shkëmben borxhin me normë fikse në monedhën e huaj, në një ekspozim me normë të ndryshueshme të monedhës funksionale. Kjo është e mbuluar me një normë interesi SWAP dy vjeçare, që - mbi bazën e monedhës funksionale - shkëmben borxhin me normë të ndryshueshme, në borxh me normë fikse. Në fakt, kombinimi i borxhit në monedhë të huaj me normë fikse dhe norma e interesit SWAP 10 vjeçare ndër monedhash nga fikse në të luhatshme, shihet si një ekspozim ndaj monedhës funksionale të një borxhi me afat 10 vjeçar me normë interesi variabël, për qëllim të menaxhimit të rrezikut.
- B6.3.4 Gjatë përcaktimit të elementit të mbrojtur në bazë të ekspozimit agregat, një njësi ekonomike merr në konsideratë efektin e kombinuar të zërave që përbëjnë ekspozimin agregat, me qëllim që të vlerësojë mbrojtjen efektive dhe të matë mbrojtjen jo efektive. Megjithatë, zërat që përbëjnë ekspozimin agregat mbeten të trajtuar veçmas nga njëri-tjetri. Kjo nënkupton që, për shembull:
- (a) derivativët që janë pjesë e një ekspozimi agregat do të njihen si aktive ose detyrime të veçanta, të matur me vlerën e drejtë; dhe
 - (b) nëse midis zërave që përbëjnë ekspozimin agregat është caktuar një marrëdhënie mbrojtëse, mënyra në të cilën një derivativ përfshihet si pjesë e një ekspozimi agregat duhet të jetë në përputhje me përcaktimin e atij derivativi si instrument mbulues në nivelin e ekspozimit agregat. Për shembull, nëse një njësi ekonomike përjashton elementin e ardhshëm të një derivativi nga përcaktimi për të qenë instrumenti mbulues për marrëdhënien mbrojtëse midis zërave që përbëjnë ekspozimin agregat, kjo njësi ekonomike duhet të përjashtojë gjithashtu elementin e ardhshëm

kur e përfshin atë derivativ si element të mbrojtur, si pjesë e ekspozimit agregat. Përndryshe, ekspozimi agregat duhet të përfshijë një derivativ, ose në tërësi ose një pjesë të tij.

- B6.3.5 Paragrafi 6.3.6 thekson se në pasqyrat financiare të konsoliduara, rreziku i valutës së huaj në një transaksion ndër grupi të parashikueshëm me probabilitet të lartë, mund të kualifikohet si element i mbrojtur në një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare, me kusht që transaksioni të jetë i shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike që ka kryer këtë transaksion dhe që rreziku nga valuta e huaj do të ketë ndikim në fitimin ose humbjen e konsoliduar. Për këtë qëllim, një njësi ekonomike mund të jetë një shoqëri mëmë, një filial, një pjesëmarrje, një marrëveshje e përbashkët ose një degë. Në qoftë se rreziku i kursit të këmbimit në një transaksion ndërgrupi të parashikuar nuk ndikon në fitimin ose humbjen e konsoliduar, transaksioni i ndërgrupit nuk mund të kualifikohet si një element i mbrojtur. Ky është zakonisht rasti i pagesave për përdorimin e pronës, pagesave të interesit, ose tarifave të menaxhimit midis pjesëtarëve të të njëjtit grup, deri në momentin që ka një transaksion të jashtëm që lidhet me këtë. Megjithatë, kur rreziku i kursit të këmbimit në një transaksion ndërgrupi të parashikuar ndikon në fitimin ose humbjen e konsoliduar, transaksioni i ndërgrupit mund të kualifikohet si një element i mbrojtur. Një shembull për këtë janë shitjet e parashikuara të inventarëve midis pjesëtarëve të të njëjtit grup, nëse ka një shitje të mëtejshme të inventarit tek një palë tjetër jashtë grupit. Në mënyrë të ngjashme, një shitje ndërgrupi e parashikuar e makinerive dhe pajisjeve, nga njësi ekonomike e grupit që i ka prodhuar ato tek një njësi ekonomike e grupit që do t'i përdorë këto makineri e pajisje në operacionet e saj, mund të ndikojë fitimin ose humbjen e konsoliduar. Kjo mund të ndodhë, për shembull, për shkak se makineritë e pajisjet do të amortizohen nga njësi ekonomike që i ka blerë dhe vlera e njohur fillimisht për makineritë dhe pajisjet mund të ndryshojë nëse transaksioni i ndërgrupit i parashikuar është i shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike blerëse.
- B6.3.6 Nëse një mbrojtje e një transaksioni të parashikuar ndër grupi kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës, çdo fitim ose humbje do të njihet në dhe do të merret nga, të ardhura të tjera përmbledhëse në përputhje me paragrafin 6.5.11. Periudha ose periudhat përkatëse gjatë të cilave rreziku i kursit të këmbimit i transaksionit të mbrojtur ndikon në fitimin ose humbjen, është kur ajo ndikon në fitimin ose humbjen e konsoliduar.

Përcaktimi i elementeve të mbrojtur

- B6.3.7 Një përbërës është një element i mbrojtur që është më pak se zëri në tërësi. Rrjedhimisht, një përbërës pasqyron vetëm disa prej rreziqeve të zërit në të cilin bën pjesë, apo pasqyron rreziqet vetëm në një masë të caktuar (për shembull, kur përcaktohet një pjesë e një zëri).

Përbërësit e rrezikut

- B6.3.8 Që të jetë i përshtatshëm për t'u përcaktuar si element i mbrojtur, një përbërës rreziku duhet të jetë një përbërës i identifikueshëm veças i zërit financiar ose jo-financiar dhe ndryshimet në flukset e mjeteve monetare ose vlerën e drejtë të zërit që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ndryshimet në atë përbërës rreziku, duhet të jenë të matshme me besueshmëri.
- B6.3.9 Gjatë identifikimit se cilët përbërës rreziku kualifikohen për t'u përcaktuar si element i mbrojtur, një njësi ekonomike vlerëson përbërës të tillë rreziku në kontekstin e strukturës së tregut përkatës me të cilin lidhen rreziku apo rreziqet dhe në të cilin ndodh aktiviteti mbulues. Një përcaktim i tillë kërkon një vlerësim të fakteve dhe rrethanave përkatëse, që ndryshojnë nga rreziku dhe tregu.
- B6.3.10 Gjatë përcaktimit të përbërësve të rrezikut si elemente të mbrojtur, një njësi ekonomike merr në konsideratë nëse përbërësit e rrezikut janë të specifikuar në mënyrë të qartë në një kontratë (përbërës rreziku të specifikuar me kontratë), ose nëse janë të nënkuptuar në vlerën e drejtë ose në flukset e mjeteve monetare të një zëri pjesë e të cilit janë (përbërës rreziku të specifikuar në mënyrë jo kontraktuale). Përbërësit e rrezikut të specifikuar në mënyrë jo kontraktuale mund të lidhen me zëra që nuk janë një kontratë (për shembull, transaksionet parashikues), ose kontratat që nuk e specifikojnë në mënyrë të qartë përbërësin (për shembull, një angazhim i përcaktuar i cili përfshin vetëm një çmim të vetëm në vend të një formule për përcaktimin e çmimit që i referohet bazave themelore të ndryshme). Për shembull:
- (a) Njësia ekonomike A ka një kontratë afat-gjatë për furnizim me gaz natyral çmimi i të cilit është përcaktuar duke përdorur një formulë të specifikuar me kontratë që i referohet mallrave dhe faktorëve të tjerë (për shembull, gazit të lëngshëm, naftës dhe përbërësve të tjerë, si tarifave të transportit). Njësia ekonomike A mbulon përbërësin naftë në këtë kontratë furnizimi duke përdorur një kontratë të ardhshme për naftë. Për shkak se përbërësi naftë specifikohet me anë të termave dhe kushteve të kontratës së furnizimit, ai është një përbërës rreziku i specifikuar me kontratë. Kështu që, për shkak të formulës së përcaktimit të çmimit, njësia ekonomike A arrin në përfundimin se ekspozimi i çmimit të naftës është i identifikueshëm veças. Në të njëjtën kohë, ka

një treg për kontratat e ardhshme të naftës. Kështu që, njësia ekonomike A arrin në përfundimin se ekspozimi i çmimit të naftës është i matshëm me besueshmëri. Rrjedhimisht, ekspozimi i çmimit të naftës në kontratën e furnizimit, është një përbërës rreziku që është i përshtatshëm për t'u përcaktuar si një element i mbrojtur.

- (b) Njësia ekonomike B mbulon blerjet e ardhshme të kafesë bazuar në parashikimin e prodhimit. Mbulimi fillon deri në 15 muaj para dorëzimit për një pjesë të volumit të blerjeve të parashikuara. Njësia ekonomike B e rrit volumin e mbulimit me kalimin e kohës (ndërsa afrohet data e blerjes). Njësia ekonomike B përdor dy lloje të ndryshme kontratash për të menaxhuar rrezikun e çmimit të kafesë:

- (i) kontrata të së ardhmes për kafe të tregtuara me këmbim; dhe
- (ii) kontrata furnizimi kafeje për kafe Arabike nga Kolumbia, dërguar në një fabrikë prodhimi të caktuar. Këto kontrata përcaktojnë çmimin e një ton kafe bazuar në çmimin e kontratës të së ardhmes për kafe të tregtuar me këmbim, plus një shtesë fikse si diferencë çmimi, plus një tarifë variabël për shërbim logjistik, duke përdorur një formulë për përcaktimin e çmimit. Kontrata për furnizim kafeje është një kontratë përmbare në përputhje me të cilën Njësia ekonomike B bën dorëzimin aktual të kafesë.

Për furnizime që kanë të bëjnë me të korrat aktuale, lidhja e kontratave për furnizim me kafe lejon Njësinë ekonomike B që të rregullojë diferencën e çmimit midis cilësisë aktuale të blerë të kafesë (kafe Arabike nga Kolumbia) dhe cilësisë standarde që është baza e kontratës të së ardhmes të tregtuar me këmbim. Megjithatë, për furnizime që kanë të bëjnë me të korrat e tjera, kontratat për furnizimin e kafesë nuk janë ende të mundshme, kështu që diferenciali i çmimit nuk mund të caktohet. Njësia ekonomike B përdor kontratat e së ardhmes për kafe të tregtuara me këmbim për të mbrojtur përbërësin e cilësisë standarde nga rreziku i çmimit të kafesë për furnizime që kanë të bëjnë me të korrat aktuale dhe me të korrat e tjera gjithashtu. Njësia ekonomike B përllogarit që është e ekspozuar ndaj tre rreziqeve të ndryshme: rreziku i çmimit të kafesë që reflekton cilësinë standarde, rreziku i çmimit të kafesë që reflekton diferencën (shpërndarjen) midis çmimit të kafesë së cilësisë standarde dhe kafesë së posaçme Arabike nga Kolumbia që ajo merr faktikisht, dhe kostot variabël logjistike. Për furnizime që kanë të bëjnë me të korrat aktuale, pasi Njësia ekonomike B lidh një kontratë për furnizim kafeje, rreziku i çmimit të kafesë që reflekton cilësinë standarde është një përbërës rreziku i specifikuar në mënyrë kontraktuale, për shkak se formula e përcaktimit të çmimit përfshin një indeksim për çmimin e kontratave të së ardhmes të kafesë të tregtuara me këmbim. Njësia ekonomike B konkludon që përbërësi i rrezikut është i identifikueshëm veças dhe i matshëm në mënyrë të besueshme. Për furnizime që kanë të bëjnë me të korrat e tjera, Njësia ekonomike B nuk ka lidhur ende ndonjë kontratë furnizimi kafeje (d.m.th. ato furnizime janë transaksione parashikuese). Kështu që, rreziku i çmimit të kafesë që reflekton cilësinë standarde është një përbërës rreziku i specifikuar në mënyrë jo kontraktuale. Analiza e Njësisë ekonomike B për strukturën e tregut merr në konsideratë sesi janë vendosur çmimet për dërgesat e mundshme të kafesë së posaçme. Kështu që, në bazë të kësaj analize të strukturës së tregut, Njësia ekonomike B konkludon që transaksionet parashikuese përfshijnë gjithashtu rrezikun e çmimit të kafesë që reflekton cilësinë standarde si një përbërës rreziku që është i identifikueshëm veças dhe i matshëm me besueshmëri, megjithëse nuk është i specifikuar me kontratë. Si rrjedhojë, Njësia ekonomike B mund të përcaktojë marrëdhënie mbrojtëse në bazë të përbërësve të rrezikut (për rrezikun e çmimit të kafesë që reflekton cilësinë standarde) për kontrata të furnizimit me kafe dhe për transaksionet parashikuese gjithashtu.

- (c) Njësia ekonomike C mbulon një pjesë të blerjeve të saj të karburantit në bazë të parashikimit të saj për konsum, deri në 24 muaj përpara dërgesës dhe e rrit me kalimin e kohës volumin që ajo mbulon. Njësia ekonomike C e mbulon këtë ekspozim duke përdorur lloje të ndryshme kontratash në varësi të afatit kohor të mbulimit, i cili ndikon në likuiditetin e tregut të derivativëve. Për afate më të gjata kohore (12-24 muaj) Njësia ekonomike C përdor kontrata naftë të papërpunuar sepse vetëm ato kanë likuiditet të mjaftueshëm në treg. Për afate kohore 6-12 muaj, Njësia ekonomike C përdor derivativë naftë sepse kanë likuiditet të mjaftueshëm. Për afate kohore deri në 6 muaj Njësia ekonomike C përdor kontrata karburanti. Analiza e Njësisë ekonomike C për strukturën e tregut për naftën dhe produktet e saj dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave përkatëse është si më poshtë:

Njësia ekonomike C operon në një zonë gjeografike në të cilën standardi i naftës së papërpunuar është Brent. Nafta e papërpunuar është lënda e parë standarde që ndikon në çmimin e produkteve të ndryshme të rafinuara të naftës si inputi i tyre më themelor. Nafta është një pikë referimi për produktet e rafinuara, i cili përdoret si një referencë për vendosjen e çmimeve për nënproduktet e tjera të naftës në përgjithësi. Kjo reflektohet gjithashtu në llojet e

instrumenteve financiare derivative për tregjet e naftës së papërpunuar dhe produkteve të rafinuar të naftës në mjedisin ku Njësia ekonomike operon, të tilla si• kontratat e së ardhmes për naftën e papërpunuar standarde, që është nafta e papërpunuar e llojit Brent;

- kontratat e së ardhmes për naftën standarde, e cila përdoret si një referencë për vendosjen e çmimeve për nënproduktet - për shembull, derivativët e karburantit për avionët mbulojnë diferencën e çmimit midis karburantit për avionët dhe naftës standarde; dhe
- derivativi i naftës së rafinuar standarde (d.m.th derivativi për diferencën e çmimit midis naftës së pa përpunuar dhe naftës së rafinuar - marzhi i rafinimit), i cili është indeksuar si naftë e pa përpunuar Brent.

- (ii) vendosja e çmimit për produktet e përpunuara të naftës nuk varet nga lloji i veçantë i naftës së pa përpunuar apo nga një rafineri e veçantë sepse këto lloje produktesh të naftës së rafinuar (siç është nafta e rafinuar apo nafta e avionëve) janë produkte të standardizuar.

Në këtë mënyrë, Njësia ekonomike C konkludon që rreziku i çmimit të naftës së avionëve për të, përfshin një përbërës të rrezikut të çmimit të naftës së pa përpunuar bazuar në përbërësin e rrezikut të çmimit të naftës së pa përpunuar të Brent, edhe pse nafta dhe gazi i pa përpunuar nuk janë përcaktuar në ndonjë marrëveshje kontraktuale. Njësia ekonomike E konkludon që këto dy përbërës rreziku janë të identifikueshëm veçmas dhe të matshëm në mënyrë të besueshme edhe pse ata nuk janë të përcaktuar në kontratë. Si pasojë, Njësia ekonomike C mund të përcaktojë marrëdhënie mbrojtëse për blerje të parashikuara të naftës për avionë mbi bazën e përbërëseve të rrezikut (për naftë të pa përpunuar ose për naftë të përpunuar). Kjo analizë do të thotë gjithashtu që në qoftë se, për shembull, Njësia ekonomike C ka përdorur derivativët e naftës së pa përpunuar të bazuar në naftën e pa përpunuar sipas West Texas Intermediate (WTI), ndryshimet në diferencën e çmimeve midis naftës së pa përpunuar sipas Brent dhe WTI mund të sjellë mbrojtje jo efektive.

- (d) Njësia ekonomike D zotëron një instrument borxhi me normë fikse. Ky instrument është emetuar në një mjedis ku ekziston një treg në të cilin një numër i madh instrumentesh borxhi të ngjashëm me të krahasohen duke u bazuar në një normë bazë (për shembull, LIBOR) dhe instrumente me normë variabël në këtë mjedis indeksohen në mënyrë tipike duke iu referuar kësaj norme bazë. Normat e interesit SWAP përdoren zakonisht për të menaxhuar rrezikun e normës së interesit duke u bazuar në këtë normë bazë, pavarësisht nga përhapja e instrumenteve të borxhit në atë normë bazë. Çmimi i instrumenteve të borxhit me normë fikse ndryshon në mënyrë direkte nga ndryshimet që ndodhin në normën bazë. Njësia ekonomike D arrin në konkluzionin që norma bazë është një përbërës që mund të jetë i identifikueshëm veças dhe i matur me besueshmëri. Si rrjedhojë, Njësia ekonomike D mund të përcaktojë marrëdhënie mbrojtëse për instrumentet e borxhit me normë fikse mbi baza të një përbërësi të rrezikut për rrezikun bazë të normës së interesit.

- B6.3.11 Kur përcaktohet një përbërës rreziku si një element i mbrojtur, kërkesat e kontabilitetit mbrojtës zbatohen për atë përbërës rreziku në të njëjtën mënyrë siç zbatohen për elementet e tjerë të mbrojtur që nuk janë përbërës rreziku. Për shembull, zbatohen kriteret kualifikuese, duke përfshirë edhe faktin që marrëdhënia mbrojtëse duhet të plotësojë kërkesat e mbrojtjes efektive dhe çdo mbrojtje jo efektive duhet të matet dhe të njihet.
- B6.3.12 Një njësi ekonomike mundet gjithashtu të përcaktojë vetëm ndryshimet në flukset e mjeteve monetare ose në vlerën e drejtë të një elementi të mbrojtur mbi ose nën një çmim specifik ose variacione të tjera (një rrezik i njëanshëm). Vlera e perceptuar e një opsioni të blerë për t'u përdorur si instrument mbulues (duke supozuar që ai ka të njëjtët terma principali si rreziku i përcaktuar), por jo vlera e tij në kohë, pasqyron një rrezik të njëanshëm në një element të mbrojtur. Për shembull, një njësi ekonomike mund të përcaktojë ndryshueshmërinë e rezultateve të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme që vjen si rezultat i rritjes së çmimit në blerjen e parashikuar të një malli. Në një situatë të tillë, njësi ekonomike përcakton vetëm humbjet nga flukset monetare që vijnë si rezultat i rritjes së çmimit mbi nivelin e specifikuar. Rreziku i mbuluar nuk e përfshin vlerën në kohë të një opsioni të blerë, sepse vlera në kohë nuk është një përbërës i transaksionit parashikues që ndikon në fitimin ose humbjen.
- B6.3.13 Ekziston një hipotezë e kundërshtueshme që për sa kohë rreziku i inflamacionit është i specifikuar në mënyrë kontraktuale, ai nuk është i identifikueshëm veças dhe i matshëm me besueshmëri, kështu që nuk mund të përcaktohet si një përbërës rreziku i një instrumenti financiar. Megjithatë, në disa raste, është e mundur që të identifikohet një përbërës rreziku për rrezikun e inflamacionit që është i identifikueshëm

veças dhe i matshëm me besueshmëri për shkak të rrethanave të veçanta të mjedisit të inflacionit dhe tregut përkatës të borxhit.

- B6.3.14 Për shembull, një njësi ekonomike emeton borxh në një mjedis në të cilin obligacionet që lidhen me inflacionin kanë një volum dhe strukturë afatesh të tillë që rezultojnë në një treg me likuiditet të mjaftueshëm, që i lejon njësisë ekonomike të ndërtojë një strukturë afatesh me norma interesi reale për instrumente me kupon zero. Kjo do të thotë që për monedhën përkatëse, inflacioni është një faktor i rëndësishëm që është i konsideruar veçmas nga tregjet e borxhit. Në këto rrethana, përbërësi i rrezikut të inflacionit mund të përcaktohet nga skontimi i flukseve të mjeteve monetare të instrumentit të borxhit të mbrojtur duke përdorur strukturën e afateve me normë interesi reale për instrumente me kupon zero (d.m.th. në të njëjtën mënyrë që përcaktohet një përbërës i normës së interesit (nominale) pa rrezik). Anasjelltas, në shumicën e rasteve një përbërës rreziku nga inflacioni nuk është i identifikueshëm veças dhe i matshëm me besueshmëri. Për shembull, një njësi ekonomike emeton vetëm borxh me normë interesi nominale në një mjedis ku ekziston një treg për obligacionet e lidhura me inflacionin që nuk ka likuiditet të mjaftueshëm për të lejuar ndërtimin e një strukture afati me normë interesi reale për instrumente me kupon zero. Në këtë rast, analizat e strukturës së tregut dhe e fakteve e rrethanave, nuk e mbështesin konkluzionin e njësisë ekonomike që inflacioni është një faktor i rëndësishëm që konsiderohet veçmas nga tregjet e borxhit. Kështu që, njësisia ekonomike nuk e kapërcen dot hipotezën e kundërshtueshme që rreziku i inflacionit që nuk është i specifikuar në mënyrë kontraktuale, nuk është i identifikueshëm veças dhe i matshëm me besueshmëri. Rrjedhimisht, një përbërës rreziku nga inflacioni nuk do të ishte i pranueshëm për t'u përcaktuar si element i mbrojtur. Kjo vlen pavarësisht nga çdo instrument mbulues i inflacionit që njësisia ekonomike tashmë ka krijuar. Në mënyrë të veçantë, njësisia ekonomike nuk mundet thjesht të ngarkojë - fusë- termat dhe kushtet e instrumentit mbulues të inflacionit aktual nëpërmjet projektimit të termave dhe kushteve të tij mbi borxhin me normë nominale interesi.
- B6.3.15 Një përbërës rreziku nga inflacioni i specifikuar në mënyrë kontraktuale i flukseve të mjeteve monetare për një obligacion të njohur që lidhet me inflacionin (duke supozuar që nuk kërkohet të trajtohet veçmas një derivativ i përfshirë), është i identifikueshëm veças dhe i matshëm me besueshmëri, për sa kohë që flukset e tjera të mjeteve monetare të këtij instrumenti nuk ndikohen nga përbërësi i rrezikut nga inflacioni.

Përbërësit e një vlere nominale

- B6.3.16 Ka dy lloje përbërësish të vlerave nominale që mund të përcaktohen si element i mbrojtur në një marrëdhënie mbrojtëse: një përbërës që është pjesë e një zëri në tërësi ose një përbërës shtresor. Lloji i përbërësit ndryshon rezultatit e kontabilitetit. Një njësi ekonomike do të përcaktojë përbërësin për qëllime të kontabilitetit në përputhje me objektivat e saj për menaxhimin e rrezikut.
- B6.3.17 Shembull i një përbërësi që është pjesë e një zëri është 50% i flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të një huaje.
- B6.3.18 Një përbërës shtresor mund të specifikohet nga një popullatë e përcaktuar, por e hapur, ose nga një vlerë nominale e përcaktuar. Shembujt përfshijnë:
- pjesë e vëllimit të një transaksioni monetar, për shembull, 10 njësitë e tjera në monedhë të huaj të flukseve të mjeteve monetare nga shitjet të shprehura në një monedhë të huaj pas 20 njësisive të para në monedhë të huaj në Mars 201X;⁴
 - pjesë e vëllimit fizik, për shembull, shtresa e poshtme, që shënon 5 milion metër kub, gaz natyror në vendndodhjen XYZ;
 - pjesë e vëllimit të transaksioneve fizike apo të tjera, për shembull, 100 fuçitë e para të blerjes së naftës në Qershor 201X apo 100 KWh e parë të shitjeve të energjisë elektrike në Qershor 201X; ose
 - një shtresë nga vlera nominale e elementit të mbrojtur, për shembull, 80 milion njësi monetare të fundit të një angazhimi të përcaktuar me vlerë 100 milion njësi monetare, shtresa e fundit prej 20 milion njësi monetare të një obligacioni me normë fikse me vlerë 100 milion njësi monetare, ose shtresa e sipërme prej 30 milion njësi monetare nga vlera totale prej 100 milion njësi monetare e borxhit me normë fikse që mund të parapaguhet me vlerën e drejtë (vlera nominale e përcaktuar është 100 milion njësi monetare).
- B6.3.19 Nëse një përbërës shtresor është i përcaktuar në një mbrojtje me vlerën e drejtë, një njësi ekonomike duhet ta specifikojë atë nga vlera nominale e përcaktuar. Në përputhje me kërkesat për kualifikimin e mbrojtjeve me vlerën e drejtë, një njësi ekonomike duhet të ri matë elementin e mbrojtur për ndryshimet me vlerën e drejtë (d.m.th. të ri matë zërin për ndryshimet me vlerën e drejtë që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me rrezikun e

⁴

Në këtë Standard vlerat monetare janë shprehur në "njësi monetare" (NJM) dhe "njësi në monedhë të huaj" (NJMH).

mbuluar). Rregullimi i mbrojtjes me vlerën e drejtë duhet të njihet në fitim ose humbje jo më vonë se kur bëhet çregjistrimi i zërit. Si rrjedhojë, është e nevojshme që të gjendet zëri me të cilin lidhet rregullimi i mbrojtjes me vlerën e drejtë. Për një përbërës shtresor në një mbrojtje me vlerën e drejtë, kjo kërkon që një njësi ekonomike të gjejë vlerën nominale nga e cila është përcaktuar ky përbërës. Për shembull, në paragrafin B6.3.18(d), duhet të gjendet vlera nominale totale e përcaktuar prej 100 milion njësi monetare në mënyrë që të gjendet shtresa e poshtme prej 20 milion njësi monetare, ose shtresa e sipërme prej 30 milion njësi monetare.

- B6.3.20 Një përbërës shtresor që përfshin një opSION parapagimi nuk mund të pranohet për t'u përcaktuar si element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerën e drejtë, në qoftë se vlera e drejtë e opSIONIT të parapagimit ndikohet nga ndryshimet në rrezikun e mbuluar, me përjashtim të rastit kur shtresa e përcaktuar përfshin efektin e opSIONIT të parapagimit në fjalë gjatë përcaktimit të ndryshimit në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur.

Marrëdhënia midis përbërësve dhe flukseve të mjeteve monetare të një zëri

- B6.3.21 Nëse një përbërës i flukseve të mjeteve monetare të një zëri financiar ose jo financiar është përcaktuar si element i mbrojtur, ky përbërës duhet të jetë më i vogël ose i barabartë me flukset e mjeteve monetare totale të zërit në tërësi. Megjithatë, të gjitha flukset e mjeteve monetare të zërit në tërësi mund të përcaktohen si element i mbrojtur dhe të mbulojnë vetëm një rrezik të veçantë (për shembull, vetëm për ato ndryshime që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ndryshimet në LIBOR ose me çmimin bazë të një malli).
- B6.3.22 Për shembull, në rastin e një detyrimi financiar norma e interesit efektiv të të cilit është më e ulët se LIBOR, një njësi ekonomike nuk mund të përcaktojë:
- një përbërës të detyrimit të barabartë me interesin në LIBOR (plus shumën e principalit në rastin e një mbrojtje me vlerën e drejtë); dhe
 - një përbërës i mbetur negativ.
- B6.3.23 Megjithatë, në rastin e një detyrimi financiar me normë fikse, norma e interesit efektiv të të cilit është (për shembull) 100 pikë bazë nën LIBOR, një njësi ekonomike mund të përcaktojë si element të mbrojtur ndryshimin në vlerën e detyrimit në tërësi (d.m.th. principal plus interes në LIBOR minus 100 pikë bazë) që ka të bëjë drejtpërdrejt me ndryshimet në LIBOR. Nëse për një instrument financiar fillon mbrojtja diku afër nisjes së tij dhe normat e interesit kanë ndryshuar ndërkohë, njësi ekonomike mund të përcaktojë një përbërës rreziku të barabartë me një normë bazë që është më e lartë se norma kontraktuale e paguar për këtë zë. Njësi ekonomike mund të veprojnë në këtë mënyrë me kusht që norma bazë të jetë më e ulët se norma e interesit efektiv e llogaritur duke u mbështetur në supozimin se njësi ekonomike e ka blerë instrumentin në ditën kur ajo përcakton për herë të parë elementin e mbrojtur. Për shembull, le të supozojmë që një njësi ekonomike krijon një aktiv financiar me normë fikse me vlerë 100 njësi monetare, që ka një normë interesi efektive prej 6 për qind në një kohë që LIBOR është 4 për qind. Kjo njësi ekonomike fillon ta mbrojë këtë aktiv pak kohë më vonë kur LIBOR është rritur në 8 për qind dhe vlera e drejtë e aktivit është ulur në 90 njësi monetare. Njësi ekonomike përlllogarit që nëse do ta kishte blerë aktivin në datën në të cilën ajo përcakton fillimisht rrezikun e normës së interesit të lidhur me LIBOR si element të mbrojtur, të ardhurat efektive nga aktiv i bazuar në vlerën e drejtë të tij prej 90 njësi monetare do të kishin qenë 9.5 për qind. Për shkak se LIBOR është më i ulët se të ardhurat efektive, njësi ekonomike mund të përcaktojë një përbërës LIBOR prej 8 për qind që përbëhet pjesërisht nga flukset e mjeteve monetare të interesit kontraktual dhe pjesërisht nga diferenca midis vlerës së drejtë aktuale (d.m.th. 90 njësi monetare) dhe vlerës së paguar në maturim (d.m.th. 100 njësi monetare).
- B6.3.24 Në qoftë se një detyrim financiar me normë variabël bart interes me (për shembull) 3 muaj LIBOR minus 20 pikë bazë (me një dyshe në 0 pikë bazë), një njësi ekonomike mund të përcaktojë si element të mbrojtur ndryshimin në flukset e mjeteve monetare të atij detyrimi në tërësi (d.m.th. 3 muaj LIBOR minus 20 pikë bazë- duke përfshirë edhe dyshe nën) që ka të bëjë drejtpërdrejt me ndryshimet në LIBOR. Kështu që, për sa kohë që kurba e LIBOR-it 3 mujor për të gjithë jetën e mbetur të këtij detyrimi nuk bie nën 20 pikë bazë, elementi i mbrojtur ka të njëjtën luhatje të fluksit monetar si një detyrim që bart interes me LIBOR 3 mujor me diferencë pozitive ose 0. Megjithatë, në qoftë se kurba e LIBOR-it 3 mujor për të gjithë jetën e mbetur të këtij detyrimi (ose një pjesë të tij) bie nën 20 pikë bazë, elementi i mbrojtur ka një luhatje më të vogël të fluksit monetar sesa një detyrim që bart interes me LIBOR 3 mujor me diferencë pozitive ose 0.
- B6.3.25 Një shembull i ngjashëm i një zëri jo financiar është një lloj i veçantë naftë e papërpunuar nga një fushë naftë e veçantë çmimi i së cilës është përcaktuar nga nafta e papërpunuar standarde përkatëse. Nëse një njësi ekonomike e shet këtë naftë të papërpunuar me një kontratë duke përdorur një formulë kontraktuale për përcaktimin e çmimit që përcakton çmimin për fuçi në çmimin e naftës së papërpunuar standarde minus 10 njësi monetare me një dyshe prej 15 njësi monetare, njësi ekonomike mund të përcaktojë si element të mbrojtur luhatjen totale të fluksit monetar nën kontratën e shitjes që lidhet drejtpërdrejt me ndryshimin në

çmimin e naftës së papërpunuar standarde. Megjithatë, njësia ekonomike nuk mund të përcaktojë një përbërës që është i barabartë me ndryshimin total në çmimin e naftës së papërpunuar standarde. Kështu që, për sa kohë që çmimi i ardhshëm (për çdo shpërndarje) nuk bie nën 25 njësi monetare, elementi i mbrojtur ka të njëjtën luhatje të fluksit monetar si një shitje naftë e papërpunuar në çmimin e naftës së papërpunuar standarde (ose me një diferencë pozitive). Megjithatë, nëse çmimi i ardhshëm për çdo shpërndarje bie nën 25 njësi monetare, elementi i mbrojtur ka një luhatje më të vogël të fluksit monetar se një shitje e naftës së papërpunuar në çmimin e naftës së papërpunuar standarde (ose me një diferencë pozitive).

Kriteret kualifikuese për kontabilitetin mbrojtës (Seksioni 6.4)

Mbrojtja efektive

- B6.4.1 Mbrojtja efektive është shkalla në të cilën ndryshimet në vlerën e drejtë ose në flukset e mjeteve monetare të instrumentit mbulues kompensojnë ndryshimet në vlerën e drejtë ose në flukset e mjeteve monetare të elementit të mbrojtur (për shembull, kur elementi i mbrojtur është një përbërës rreziku, ndryshimi kryesor në vlerën e drejtë ose në flukset e mjeteve monetare të një zëri është ai ndryshim që ka të bëjë drejtpërdrejt me rrezikun e mbuluar). Mbrojtja jo efektive është shkalla në të cilën ndryshimet në vlerën e drejtë ose në flukset e mjeteve monetare të instrumentit mbulues janë më të mëdha ose më të vogla se ndryshimet që kanë të bëjnë me elementin e mbrojtur.
- B6.4.2 Kur përcakton një marrëdhënie mbrojtëse dhe mbi baza të vazhdueshme, një njësi ekonomike duhet të analizojë burimet e mbrojtjes jo efektive që pritet të ndikojnë në marrëdhënien mbrojtëse gjatë periudhës që ajo ndodh. Kjo analizë (që përfshin çdo përditësim në përputhje me paragrafin B6.5.21 që rrjedhin nga vendosja rishtas në ekuilibër e një marrëdhënie mbrojtëse) është baza për të vlerësuar nëse janë arritur kërkesat mbrojtjes efektive për njësinë ekonomike.
- B6.4.3 Për të shmangur çfarëdo dyshimi, efektet e zëvendësimit të palës tjetër fillestare me një palë tjetër kleringu dhe duke bërë ndryshimet shoqëruese, siç përshkruhet në paragrafin 6.5.6 do të pasqyrohen në matjen e instrumentit mbulues dhe për këtë arsye në vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes dhe matjen e efektivitetit të mbrojtjes.

Marrëdhënia ekonomike midis elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues

- B6.4.4 Kërkesa që një marrëdhënie ekonomike të ekzistojë, do të thotë që instrumenti mbulues dhe elementi i mbrojtur të kenë vlera që përgjithësisht lëvizin në drejtime të kundërta për shkak të të njëjtit rrezik, që është rreziku i mbrojtur. Kështu që, duhet të ketë një pritishtëri që vlera e instrumentit mbulues dhe vlera e elementit të mbrojtur do të ndryshojnë në mënyrë sistematike në përgjigje të lëvizjeve në bazën ose bazat e tyre të njëjta që janë ekonomikisht të lidhura në një formë të tillë që ato përgjigjen në mënyra të ngjashme kundrejt rrezikut për të cilin janë mbrojtur (për shembull, nafta e pa përpunuar e Brent dhe e WTI).
- B6.4.5 Në qoftë se bazat nuk janë të njëjta por janë ekonomikisht të lidhura, mund të ketë situata në të cilat vlerat e instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur lëvizin në të njëjtin drejtim, për shembull, rasti kur diferenca e çmimit ndërmjet dy bazave ndryshon ndërkohë që bazat në vetvete nuk lëvizin ndjeshëm. Kjo është përsëri në përputhje me marrëdhënien ekonomike midis instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur në qoftë se vlerat e instrumentit mbulues dhe të elementit të mbrojtur pritet të lëvizin në mënyrë tipike në drejtime të kundërta sa herë që bazat lëvizin.
- B6.4.6 Vlerësimi nëse ekziston një marrëdhënie ekonomike apo jo, përfshin një analizë të sjelljes së mundshme të marrëdhënies së mbrojtur gjatë kohës së saj për të vërtetuar nëse mund të parashikohet se ajo e plotëson objektivin e menaxhimit të rrezikut. Ekzistenca e thjeshtë e një korrelacioni statistikor midis dy variablave në vetvete nuk është e mjaftueshme për të konkluduar që ekziston një marrëdhënie ekonomike.

Efektet e rrezikut të kredisë

- B6.4.7 Për shkak se modeli i kontabilitetit mbrojtës bazohet në një nocion të përgjithshëm të kompensimit midis fitimeve dhe humbjeve të një instrumenti mbulues dhe një elementi të mbrojtur, efektiviteti i mbrojtjes përcaktohet jo vetëm nga marrëdhënia ekonomike midis këtyre elementeve (d.m.th ndryshimi në bazat e tyre) por gjithashtu edhe nga efekti i rrezikut të kredisë në vlerën e të dyve, instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur. Efektet e rrezikut të kredisë do të thotë që edhe sikur të ketë një marrëdhënie ekonomike midis instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur, niveli i kompensimit mund të jetë i paparashikueshëm. Kjo mund të sjellë një ndryshim në rrezikun e kredisë të instrumentit mbulues ose të elementit të mbrojtur që mund të ketë rëndësi të tillë që të dominojë ndryshimin e vlerave që rezultojnë nga

marrëdhënia ekonomike (d.m.th efekti i ndryshimeve në bazave të tyre). Një nivel rëndësie që sjell dominim është ajo që mund të rezultojë në humbje (ose fitim) nga rreziku i kredisë duke mposhtur efektin e ndryshimeve në bazat përkatëse të vlerave të instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur, edhe sikur ndryshimet të ishin të konsiderueshme. Anasjelltas, në qoftë se gjatë një periudhe të caktuar ka një ndryshim të vogël të bazave, fakti që edhe rreziku i vogël i lidhura me kredinë ndryshon në vlerën e instrumentit mbulues apo të elementit të mbrojtur mund të ndikojë në vlerën më shumë sesa baza, nuk krijon dominim.

- B6.4.8 Një shembull i dominimit të rrezikut të kredisë mbi një marrëdhënie mbrojtëse është kur një njësi ekonomike mbulon një ekspozim ndaj çmimit të një malli duke përdorur një derivativ që nuk është i siguruar nga një kolateral. Në qoftë se kundër partia e këtij derivativi përkeqësohet ndjeshëm në renditjen e kredisë, efekti i ndryshimit në renditjen e kredisë të kundër partisë mund të eliminojë efektin e ndryshimit në çmimin e mallit në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues, ndërkohë që ndryshimi në vlerën e elementit të mbrojtur varet më së shumti nga ndryshimi në çmimin e mallit.

Raporti i mbulimit

- B6.4.9 Në përputhje me kërkesat e mbrojtjes efektive, raporti i mbulimit i marrëdhënies mbrojtëse duhet të jetë i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e elementit të mbrojtur që njësia ekonomike aktualisht mbulon dhe sasia e instrumentit mbulues që njësia ekonomike aktualisht përdor për të mbuluar atë sasi të elementit të mbrojtur. Kështu që, në qoftë se një njësi ekonomike mbron më pak se 100 për qind ekspozimin e një zëri, si për shembull 85 për qind, ajo duhet të përcaktojë marrëdhënien mbrojtëse duke përdorur një raport mbrojtjeje që është i njëjtë me atë që rezulton nga 85 për qind e ekspozimit dhe e madhësisë së instrumentit mbulues që njësia ekonomike përdor aktualisht për të mbrojtur këto 85 për qind. Në mënyrë të njëjtë, në qoftë se për shembull, një njësi ekonomike mbron një ekspozim duke përdorur një shumë nominale të 40 njësive të një instrumenti mbulues, ajo duhet të përcaktojë marrëdhënien mbrojtëse duke përdorur një raport mbrojtës që është e njëjtë si ai që rezulton nga sasia e 40 njësive (d.m.th njësia ekonomike nuk duhet të përdorë një raport mbrojtës bazuar në një sasi më të madhe sesa ajo që mund të mbajë në total, ose bazuar në një numër më të vogël njësish) dhe madhësia e elementit të mbrojtur që ajo aktualisht mbron me këto 40 njësi.
- B6.4.10 Megjithatë, përcaktimi i një marrëdhënie mbrojtëse duke përdorur të njëjtin raport mbulimi si ai që rezulton nga madhësitë e elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues që njësia ekonomike aktualisht përdor nuk duhet të reflektojë një mos balancim midis peshave të elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues i cili mund të sjellë një mbrojtje jo efektive (pavarësisht nëse është e njohur apo jo) që pastaj do të çonte në një rezultat kontabiliteti të papajtueshëm me qëllimin e kontabilitetit mbrojtës. Kështu që, për qëllime të përcaktimit të një marrëdhënie mbrojtëse, një njësi ekonomike duhet të rregullojë raportin mbulues që rezulton nga madhësitë e elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues që njësia ekonomike aktualisht përdor në qoftë se ky rregullim del i nevojshëm për të mënjeluar këtë mos balancim.
- B6.4.11 Shembuj të ngjashëm në konsideratë të vlerësimit nëse një metodë kontabiliteti është jo konsistente për qëllime të kontabilitetit mbrojtës janë:
- në se raporti mbrojtës i parashikuar është vendosur për të mënjeluar njohjen e mbrojtjes jo efektive për mbrojtjen e fluksit të parave, ose për të arritur rregullimin e mbrojtjes së vlerës së drejtë për më shumë elementë të mbrojtur me qëllimin e rritjes së përdorimit të kontabilitetit të vlerës së drejtë, por pa kompensimin e ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues; dhe
 - nëse ka një arsye tregtare për një balancim të veçantë të elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues, edhe pse kjo krijon një mbrojtje jo efektive. Për shembull, një njësi ekonomike futet në një marrëdhënie mbrojtje dhe përcakton madhësinë e instrumentit mbulues që nuk është madhësia që ajo përcaktoi si mbrojtja më e mirë e elementit të mbrojtur sepse volumi standard i instrumentit mbulues nuk e lejon atë të hyjë në ato përmasa ekzakte të instrumentit mbulues (kur kemi të bëjmë me lote, apo grupe njësish). Një shembull është një njësi ekonomike që do mbronte 100 ton blerje kafeje me kontrata të së ardhmes për kafe standarde që kanë një madhësi kontrate 37,500 paund (16,988 kg përafërsisht). Njësia ekonomike mund të përdorë ose 5 ose 6 kontrata (ekuivalente të 85.0 ose 102.1 ton) për të mbrojtur blerjen e volumit prej 100 ton kafe. Në këtë rast, njësia ekonomike përcakton si marrëdhënie mbrojtëse duke përdorur raportin mbrojtës që rezulton nga numri i kontratave të së ardhmes të kafesë që ajo është duke përdorur aktualisht, sepse mbrojtja jo efektive që rezulton nga mospërputhja e peshave të elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues nuk do të rezultojë në një metodë kontabiliteti që është e paqëndrueshme për qëllime të kontabilitetit mbrojtës.

Shpeshtësia e vlerësimit nëse janë plotësuar kërkesat e mbrojtjes efektive

- B6.4.12 Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë në momentin e fillimit të marrëdhënies mbrojtëse, dhe në mënyrë të vazhdueshme, nëse një marrëdhënie mbrojtëse plotëson kërkesat e një mbrojtje efektive. Si një minimum, një njësi ekonomike duhet të kryejë vlerësimin e vazhdueshëm në çdo datë raportimi ose në rast të ndonjë ndryshimi të rëndësishëm të rrethanave që ndikojnë në kërkesat për të qenë një mbrojtje efektive, cilado qoftë që të renditet e para. Vlerësimi lidhet me pritshmëritë rreth mbrojtjes efektive dhe si pasojë është e drejtuar nga e ardhmja.

Metodat e vlerësimit nëse janë plotësuar kërkesat e mbrojtjes efektive

- B6.4.13 Ky standard nuk përcakton një metodë për vlerësimin nëse një marrëdhënie mbrojtëse plotëson kërkesat e mbrojtjes efektive. Megjithatë, një njësi ekonomike duhet të përdorë një metodë e cila arrin të kapë karakteristikat përkatëse të marrëdhënies mbrojtëse duke përfshirë burimet e mbrojtjes jo efektive. Në varësi të këtyre faktorëve, metoda e vlerësimit mund të jetë cilësore ose sasiore.
- B6.4.14 Për shembull, kur termat kritik (si për shembull vlera nominale, maturimi dhe baza), të instrumentit mbulues dhe të elementit të mbrojtur përputhen ose janë të përafër, mund të ishte e mundur për një njësi ekonomike të konkludonte mbi bazën e një vlerësimi cilësor të këtyre termave kritik që instrumenti mbulues dhe elementi i mbrojtur kanë vlera që në përgjithësi do të lëvizin në drejtime të kundërta për shkak të të njëjtit rrezik dhe kështu që ekziston një marrëdhënie ekonomike midis elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues (shih paragrafët B6.4.4 - B6.4.6).
- B6.4.15 Fakti që një derivativ është brenda ose jashtë mjeteve monetare kur është përcaktuar si instrument mbulues nuk do të thotë që një vlerësim sasiore është i pa përshtatshëm. Varet nga rrethanat nëse një mbrojtje jo efektive që rrjedh nga fakti më sipër mund të ketë një rëndësi të tillë që një vlerësim cilësor mund të mos e ketë kapur.
- B6.4.16 Anasjelltas, nëse termat kritik të instrumentit mbulues dhe të elementit të mbrojtur nuk janë të përafër, kemi një nivel pasigurie të rritur për këtë kompensim. Si pasojë, mbrojtja efektive gjatë kohës së marrëdhënies mbrojtëse është më e vështirë për tu parashikuar. Në këto rrethana mund të jetë e mundur për një njësi ekonomike vetëm të konkludojë mbi bazën e një vlerësimi sasiore që një marrëdhënie ekonomike ekziston midis elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues (shiko paragrafët B6.4.4 - B6.4.6). Në disa situata një vlerësim sasiore mund të nevojitet për të vlerësuar nëse raporti i mbulimit i përdorur për përcaktimin e marrëdhënies mbrojtëse i plotëson kërkesat e mbrojtjes efektive (shih paragrafët B6.4/9 - B6.4.11). Një njësi ekonomike mund të përdorë të njëjtën metodë ose metoda të ndryshme për këto dy qëllime të ndryshme.
- B6.4.17 Nëse ka ndryshime në rrethanat që ndikojnë mbrojtjen efektive, një njësi ekonomike duhet të ndryshojë metodën për të vlerësuar nëse një marrëdhënie mbrojtëse plotëson kërkesat për mbrojtjen efektive në mënyrë që të sigurojë nëse janë arritur apo jo karakteristikat kryesore të marrëdhënies mbrojtëse, duke përfshirë edhe burimet e mbrojtjes jo efektive.
- B6.4.18 Menaxhimi i rrezikut të një njësie ekonomike është burimi kryesor i informacionit për të kryer vlerësimin nëse një marrëdhënie mbrojtëse plotëson kërkesat e mbrojtjes efektive. Kjo do të thotë që informacioni (ose analiza) i menaxhimit i përdorur për qëllimet e vendimmarrjes mund të përdoret si bazë për vlerësimin nëse një marrëdhënie mbrojtëse plotëson kërkesat e mbrojtjes efektive.
- B6.4.19 Dokumentimi i marrëdhënies mbrojtëse të një njësie ekonomike përfshin faktin se si do t'i vlerësojë ajo kërkesat e mbrojtjes efektive, duke përfshirë edhe metodën apo metodat e përdorura. Dokumentimi i marrëdhënies mbrojtëse duhet të azhurnohet për ndonjë ndryshim në metodat (shih paragrafin B6.4.17).

Kontabiliteti për kualifikimin e marrëdhënieve mbrojtëse (seksioni 6.5)

- B6.5.1 Një shembull i një mbrojtje me vlerën e drejtë është një mbrojtje e ekspozimeve ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë të një instrumenti borxhi me normë fikse që rrjedhin nga ndryshimet në normat e interesit. Një mbrojtje e tillë mund të përdoret nga emetuesi ose zotëruesi.
- B6.5.2 Qëllimi i një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare është që të shtyjë fitimin neto ose humbjen nga instrumenti mbulues deri në një periudhë ose disa periudha në të cilat flukset e mjeteve monetare të ardhshme që pritet të mbrohen, kanë ndikim në fitimin ose humbjen. Një shembull i një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare është përdorimi i një shkëmbimi për të ndryshuar borxhin me normë të luhatshme (qoftë ky i matur me koston e amortizuar apo me vlerën e drejtë) në borxh me normë fikse (d.m.th. një mbrojtje e një transaksioni të ardhshëm në të cilin flukset e mjeteve monetare të ardhshme që mbrohen janë

pagesat e interesit të ardhshëm). Anasjelltas, një blerje e parashikuar e një instrumenti të kapitalit neto që me t'u blerë, do të kontabilizohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, është një shembull i një zëri që nuk mund të jetë elementi i mbrojtur në një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare, për shkak se çdo fitim ose humbje nga instrumenti mbulues që do të shtyhej nuk mund të riklasifikohet në mënyrë të përshtatshme në fitim ose humbje gjatë një periudhe në të cilën ai do të arrinte të kompensohej. Për të njëjtën arsye, një blerje e parashikuar e një instrumenti kapitali neto që, me t'u blerë, do të kontabilizohet me vlerën e drejtë me ndryshime në vlerën e drejtë të pasqyruara në të ardhura të tjera përmbledhëse, gjithashtu nuk mund të jetë elementi i mbrojtur në një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare.

- B6.5.3 Një mbrojtje e një angazhimi të përcaktuar (për shembull, një mbrojtje nga ndryshimi në çmimin e lëndës djegëse në lidhje me një angazhim kontraktual të panjohur nga një prodhues i energjisë elektrike për të blerë lëndë djegëse me një çmim fiks) është një mbrojtje e ekspozimit ndaj një ndryshimi në vlerën e drejtë. Në këtë mënyrë, një mbrojtje e tillë është një mbrojtje me vlerën e drejtë. Megjithatë, në përputhje me paragrafin 6.5.4, një mbrojtje nga rreziku i kursit të këmbimit në një angazhim të papërcaktuar, në mënyrë alternative mund të trajtohet si një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare.

Matja e mbrojtjes jo efektive

- B6.5.4 Kur mat mbrojtjen jo efektive, një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë vlerën në kohë të parasë. Si rrjedhojë, njësi ekonomike përcakton vlerën e elementit të mbrojtur në bazë të vlerës aktuale dhe për këtë arsye ndryshimi në vlerën e elementit të mbrojtur përfshin gjithashtu edhe efektin e vlerës në kohë të parasë.
- B6.5.5 Për të llogaritur ndryshimin në vlerën e elementit të mbrojtur me qëllim matjen e mbrojtjes jo efektive, një njësi ekonomike mund të përdorë një derivativ që do të ketë kushte që përputhen me kushtet kritike të elementit të mbrojtur (kësaj zakonisht i referohemi si një 'derivativ hipotetik'), dhe, për shembull për një mbrojtje të një transaksioni parashikues, do të bëhet kalibrimi duke përdorur nivelin e çmimit (normës) mbrojtës. Për shembull, në qoftë se mbrojtja do të ishte për një rrezik të dyanshëm në nivelin e tregut aktual, derivativi hipotetik do të përfaqësojë një kontratë të ardhshme hipotetike që kalibrohet në vlerën zero në momentin e përcaktimit të marrëdhënies mbrojtëse. Në qoftë se mbrojtja do të ishte për shembull për një rrezik të njëanshëm, derivativi hipotetik do të përfaqësojë vlerën e perceptuar të një opsioni hipotetik që në momentin e përcaktimit të marrëdhënies mbrojtëse është në mjete monetare nëse niveli i çmimit të mbrojtur është niveli i tregut aktual, ose pa mjete monetare nëse niveli i çmimit të mbrojtur është më lart (ose, për një mbrojtje të një pozicioni të gjatë, me poshtë) se niveli i tregut aktual. Përdorimi i një derivativi hipotetik është një mënyrë e mundshme për të llogaritur ndryshimin në vlerën e elementit të mbrojtur. Derivativi hipotetik kopjon elementin e mbrojtur dhe kështu që rezulton në të njëjtin përfundim që do kishim nëse ndryshimi në vlerë do të përcaktohej nga një trajtim i ndryshëm. Kështu që, përdorimi i një 'derivativi hipotetik' nuk është një metodë në vetvete por një përshtatje matematikore që mund të përdoret vetëm për të llogaritur vlerën e elementit të mbrojtur. Si pasojë, një 'derivativ hipotetik' nuk mund të përdoret për të përfshirë në vlerën e elementit të mbrojtur tipare që ekzistojnë vetëm në instrumentin mbulues (por jo në elementin e mbrojtur). Një shembull është borxhi i shprehur në një monedhë të huaj (pavarësisht nga fakti nëse është borxh me normë fikse apo variabël). Kur përdor një derivativ hipotetik për të llogaritur ndryshimin në vlerën e një borxhi të tillë ose në vlerën aktuale të ndryshimit të akumuluar në flukset e mjeteve monetare, derivativi hipotetik nuk mundet thjesht të vendosë një tarifë për të shkëmbyer monedha të ndryshme megjithëse derivativët aktualë nën të cilët shkëmbehen monedha të ndryshme mund të përfshijnë një tarifë të tillë (për shembull, normë interesi SWAP ndër monedhash).
- B6.5.6 Ndryshimi në vlerën e elementit të mbrojtur të përcaktuar duke përdorur një derivativ hipotetik mund të jetë i dobishëm për qëllim të vlerësimit nëse një marrëdhënie mbrojtëse i plotëson kërkesat e mbrojtjes efektive.

Ribalancimi i marrëdhënies mbrojtëse dhe ndryshimet në raportin e mbrojtjes

- B6.5.7 Ri balancimi i referohet rregullimit që i është bërë sasisë së përcaktuar të elementit të mbrojtur ose instrumentit mbulues të një marrëdhënie mbrojtëse ekzistuese për qëllim të mirëmbajtjes së një raporti mbrojtës që plotëson kërkesat e mbrojtjes efektive. Ndryshimet në sasi të përcaktuara të një elementi të mbrojtur ose instrumenti mbulues për qëllime të ndryshme nuk konsistojnë në ri balancim për qëllime të këtij Standardi.
- B6.5.8 Ri balancimi trajtohet në kontabilitet si një vazhdim i marrëdhënies mbrojtëse në përputhje me paragrafët B6.5.9 - B6.5.21. Kur kemi të bëjmë me ri balancim, mbrojtja efektive e një marrëdhënies mbrojtëse përcaktohet dhe njihet menjëherë para se të rregullohet marrëdhënia mbrojtëse.
- B6.5.9 Rregullimi i raportit të mbrojtjes e lejon një njësi ekonomike të përgjigjet ndryshimit në këtë marrëdhënie midis instrumentit mbulues dhe elementit mbrojtës, që vijnë prej bazave të tyre apo prej rrezikut të variabëlave. Për shembull, një marrëdhënie mbrojtëse në të cilën instrumenti mbulues dhe elementi i

mbrojtur kanë baza të ndryshme por që lidhen me njëra tjetrën, ndryshon si përgjigje e ndryshimeve në marrëdhënie midis dy bazave (për shembull, referenca të ndryshme por të lidhura për treguesit, normat, apo çmimet) Kështu që, ri balancimi e lejon vazhdimin e një marrëdhënie mbrojtëse në situatën kur marrëdhënia midis instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur ndryshon në një mënyrë të tillë që mund të kompensohet duke rregulluar raportin e mbrojtjes.

B6.5.10 Për shembull, një njësi ekonomike mbron një ekspozim ndaj Monedhës së Huaj A duke përdorur një derivativ që i referohet Monedhës së Huaj B dhe Monedhat e Huaja A dhe B janë të fiksuara (d.m.th. kursi i këmbimit të tyre mbahet në të njëjtin brez ose në një kurs këmbimi të përcaktuar nga një bankë qendrore ose autoritet tjetër). Në qoftë se kursi i këmbimit midis Monedhës së Huaj A dhe Monedhës së Huaj B do të ndryshonte (d.m.th. të përcaktohej një brez i ri ose një kurs tjetër), ri balancimi i marrëdhënies mbrojtëse që të pasqyrojë kursin e ri të këmbimit do të siguronte që marrëdhënia mbrojtëse të vazhdonte të plotësonte kërkesën e mbrojtjes efektive për raportin e mbrojtjes në rrethanat e reja. Në të kundërt, nëse do të kishte një mungesë të plotësimit të kushteve në derivativin monetar, ndryshimi i raportit të mbrojtjes nuk do të garantonte që marrëdhënia mbrojtëse të vazhdonte të plotësonte kërkesën e mbrojtjes efektive. Kështu që, ri balancimi nuk e ndihmon vazhdimin e një marrëdhënie mbrojtëse në situatën kur marrëdhënia midis instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur ndryshon në një mënyrë të tillë që nuk mund të kompensohet duke rregulluar raportin e mbrojtjes.

B6.5.11 Jo çdo ndryshim në masën e kompensimit midis ndryshimeve në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues dhe vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të elementit të mbrojtur përbën një ndryshim në marrëdhënien midis instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur. Një njësi ekonomike analizon burimet e mbrojtjes jo efektive që pritet të ketë ndikim mbi marrëdhënien mbrojtëse gjatë periudhës që ajo zgjat dhe vlerëson nëse ndryshimet në masën e kompensimit janë:

- (a) luhatje rreth raportit të mbrojtjes, i cili mbetet i vlefshëm (d.m.th. vazhdon të pasqyrojë në mënyrë të përshtatshme marrëdhënien midis instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur); ose
- (b) një tregues se raporti i mbrojtjes nuk pasqyron më në mënyrë të përshtatshme marrëdhënien midis instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur.

Një njësi ekonomike e kryen këtë vlerësim ndaj kërkesës së mbrojtjes efektive për raportin e mbrojtjes, d.m.th. të garantojë që marrëdhënia mbrojtëse nuk pasqyron një çekuilibër mes peshave përkatëse të elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues i cili mund të sjellë një mbrojtje jo efektive (pavarësisht nëse është e njohur apo jo), e cila mund të sjellë një rezultat kontabël të papajtueshëm me qëllimin e kontabilitetit mbrojtës. Kështu që, ky vlerësim kërkon gjykim.

B6.5.12 Luhatja rreth një raporti të mbrojtjes konstant (dhe kështu edhe të mbrojtjes jo efektive përkatëse), nuk mund të reduktohet duke rregulluar raportin e mbrojtjes për çdo rezultat të veçantë. Kështu që, në rrethana të tilla, ndryshimi në masën e kompensimit është çështje matje dhe njohje e mbrojtjes jo efektive por nuk kërkon ri balancim.

B6.5.13 Anasjelltas, në qoftë se ndryshimet në masën e kompensimit tregojnë se luhatja është rreth një raporti të mbrojtjes që është i ndryshëm nga raporti i mbrojtjes që është përdorur aktualisht për marrëdhënien mbrojtëse, ose nëse ka një tendencë për t'u larguar nga raporti i mbrojtjes, mbrojtja jo efektive mund të reduktohet duke rregulluar raportin e mbrojtjes, ndërkohë që duke ruajtur raportin e mbrojtjes do të krijohej një mbrojtje jo efektive gjithnjë e më e madhe. Kështu që, në rrethana të tilla, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse marrëdhënia mbrojtëse pasqyron një çekuilibër mes peshave përkatëse të elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues që do të krijonte një mbrojtje jo efektive (pavarësisht nëse njihet apo jo), e cila mund të sjellë një rezultat kontabël të papajtueshëm me qëllimin e kontabilitetit mbrojtës. Nëse bëhet rregullimi i raportit të mbrojtjes, ai gjithashtu do të ndikojë në matjen dhe njohjen e mbrojtjes jo efektive sepse, pas vendosjes rishtas në ekuilibër, mbrojtja jo efektive e marrëdhënies mbrojtëse duhet të përcaktohet dhe njihet menjëherë para se të bëhet rregullimi i marrëdhënies mbrojtëse në përputhje me paragrafin B6.5.8.

B6.5.14 Vendosija rishtas në ekuilibër nënkupton që, për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, pas fillimit të një marrëdhënie mbrojtëse, një njësi ekonomike rregullon sasinë e instrumentit mbulues ose elementit të mbrojtur në përgjigje të rrethanave që ndikojnë në raportin e mbrojtjes të kësaj marrëdhënieje mbrojtëse. Në mënyrë tipike, ky rregullim duhet të pasqyrojë rregullimet në sasinë e instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur që njësi ekonomike aktualisht përdor. Megjithatë, një njësi ekonomike duhet të rregullojë raportin e mbrojtjes që rezulton nga sasinë e elementit të mbrojtur ose instrumentit mbulues që ajo përdor aktualisht nëse:

- (a) raporti i mbrojtjes që rezulton nga ndryshimet në sasinë e instrumentit mbulues ose elementit të mbrojtur që njësi ekonomike përdor aktualisht do të pasqyrojë një mosbalancim që do të krijonte mbrojtje jo efektive, e cila do të çonte në një rezultat të kontabilitetit që do të ishte i papajtueshëm me qëllimin e kontabilitetit mbrojtës; ose

- (b) një njësi ekonomike do të ruante sasi të e instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur që përdor aktualisht, duke rezultuar në një raport mbrojtjeje që, në rrethana të reja, do të pasqyronte një mosbalancim që do të krijonte mbrojtje jo efektive e cila do të çonte në një rezultat të kontabilitetit që do të ishte i papajtueshëm me qëllimin e kontabilitetit mbrojtës (d.m.th. një njësi ekonomike nuk duhet të krijojë një mosbalancim duke lënë mënjanë rregullimin e raportit të mbrojtjes).
- B6.5.15** Vendosja rishtas në ekuilibër nuk zbatohet nëse objektivi i menaxhimit të rrezikut për një marrëdhënie mbrojtëse ka ndryshuar. Në vend të kësaj, kontabiliteti mbrojtës për këtë marrëdhënie mbrojtëse duhet të ndërpritet (pavarësisht nëse njësi ekonomike mund të përcaktojë një marrëdhënie mbrojtëse që përfshin instrumentin mbulues ose elementin e mbrojtur të marrëdhënies mbrojtëse të mëparshme siç përshkruhet në paragrafin B6.5.28).
- B6.5.16** Nëse bëhet vendosja rishtas në ekuilibër e një marrëdhënie mbrojtëse, rregullimi për raportin e mbrojtjes mund të bëhet në mënyra të ndryshme:
- (a) koeficienti i elementit të mbrojtur mund të rritet (që në të njëjtën kohë çon në zvogëlimin e koeficientit të instrumentit mbulues) duke:
- (i) rritur volumin e elementit të mbrojtur; ose
- (ii) zvogëluar volumin e instrumentit mbulues.
- (b) koeficienti i instrumentit mbulues mund të rritet (që në të njëjtën kohë çon në zvogëlimin e koeficientit të elementit të mbrojtur) duke:
- (i) rritur volumin e instrumentit mbulues; ose
- (ii) zvogëluar volumin e elementit të mbrojtur.
- Ndryshimet në volum i referohen sasive që janë pjesë e marrëdhënies mbrojtëse. Kështu që, zvogëlimet në volum jo domosdoshmërisht nënkuptojnë që zërat apo transaksionet nuk ekzistojnë më, apo që nuk pritet të ndodhin më, por nënkuptojnë që ato nuk janë më pjesë e marrëdhënies mbrojtëse. Për shembull, zvogëlimi i volumit të instrumentit mbulues mund të rezultojë në mbajtjen e një derivativi nga njësi ekonomike, por vetëm një pjesë e tij mund të mbetet si instrument mbulues i marrëdhënies mbrojtëse. Kjo mund të ndodhë nëse vendosja rishtas në ekuilibër mund të bëhet vetëm duke zvogëluar volumin e instrumentit mbulues në marrëdhënien mbrojtëse, ndërkohë që njësi ekonomike mban volumin që nuk nevojitet më. Në këtë rast, pjesa e papërcaktuar e derivativit do të kontabilizohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (përveç rastit kur është përcaktuar si instrument mbulues në një marrëdhënie tjetër mbrojtëse).
- B6.5.17** Rregullimi i raportit të mbrojtjes duke rritur volumin e elementit të mbrojtur nuk ndikon në mënyrën e matjes së ndryshimeve në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues. Matja e ndryshimeve në vlerën e elementit të mbrojtur që lidhet me volumin e përcaktuar më parë të tij mbetet gjithashtu e pandikuar. Megjithatë, që nga data e vendosjes rishtas në ekuilibër, ndryshimet në vlerën e elementit të mbrojtur përfshijnë gjithashtu ndryshimin në vlerën e volumit shtesë të elementit të mbrojtur. Këto ndryshime maten duke filluar nga, dhe duke iu referuar, datës së vendosjes rishtas në ekuilibër në vend të datës në të cilën është përcaktuar marrëdhënia mbrojtëse. Për shembull, në qoftë se një njësi ekonomike ka mbrojtur fillimisht një volum prej 100 ton të një malli me një çmim të ardhshëm prej 80 njësi monetare (çmimi i ardhshëm në fillimin e marrëdhënies mbrojtëse) dhe shton një volum prej 10 ton me vendosjen rishtas në ekuilibër kur çmimi i ardhshëm është 90 njësi monetare, elementi i mbrojtur pas vendosjes rishtas në ekuilibër do të përbëhet nga dy shtresa: 100 ton të mbrojtur me 80 njësi monetare dhe 10 ton të mbrojtur me 90 njësi monetare.
- B6.5.18** Rregullimi i raportit të mbrojtjes duke zvogëluar volumin e instrumentit mbulues nuk ndikon në mënyrën e matjes së ndryshimeve në vlerën e elementit të mbrojtur. Matja e ndryshimeve në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues që lidhet me volumin që vazhdon të jetë i përcaktuar, mbetet gjithashtu e pandikuar. Megjithatë, që nga data e vendosjes rishtas në ekuilibër, volumi me të cilin instrumenti mbulues është zvogëluar nuk është më pjesë e marrëdhënies mbrojtëse. Për shembull, në qoftë se një njësi ekonomike ka mbrojtur fillimisht rrezikun e çmimit të një malli duke përdorur një volum derivativi prej 100 ton si instrument mbulues dhe e zvogëlon këtë volum me 10 ton në vendosjen rishtas në ekuilibër, do të mbetet një vlerë nominale prej 90 ton nga volumi i instrumentit mbulues (shih paragrafin B6.5.16 për pasojat e volumit të derivativit (d.m.th. 10 ton) që nuk është më pjesë e marrëdhënies mbrojtëse).
- B6.5.19** Rregullimi i raportit të mbrojtjes duke rritur volumin e instrumentit mbulues nuk ndikon në mënyrën e matjes së ndryshimeve në vlerën e elementit të mbrojtur. Matja e ndryshimeve në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues që lidhet me volumin e përcaktuar më parë të tij mbetet gjithashtu e pandikuar. Megjithatë, që nga data e vendosjes rishtas në ekuilibër, ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues përfshijnë gjithashtu ndryshimet në vlerën e volumit shtesë të instrumentit mbulues. Ndryshime maten duke filluar nga, dhe duke iu referuar, datës së vendosjes rishtas në ekuilibër në vend të datës në të

cilën është përcaktuar marrëdhënia mbrojtëse. Për shembull, në qoftë se një njësi ekonomike ka mbrojtur fillimisht rrezikun e çmimit të një malli duke përdorur një volum derivativi prej 100 ton si instrument mbulues dhe shton një volum prej 10 ton me vendosjen rishtas në ekuilibër, instrumenti mbulues pas vendosjes rishtas në ekuilibër do të përfshijë një volum total derivativi prej 110 ton. Ndryshimi në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues është ndryshimi total në vlerën e drejtë të derivativëve që përbëjnë volumin total prej 110 ton. Këto derivativë mund të (dhe me shumë mundësi do të) kenë kushte të ndryshme kritike, si normat e ardhshme të tyre, për shkak se ato kanë filluar në momente të ndryshme kohore (duke përfshirë edhe mundësinë e përcaktimit të derivativëve në marrëdhëniet mbrojtëse pas njohjes fillestare të tyre).

- B6.5.20 Rregullimi i raportit të mbrojtjes duke zvogëluar volumin e elementit të mbrojtur nuk ndikon në mënyrën e matjes së ndryshimeve në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues. Matja e ndryshimeve në vlerën e elementit të mbrojtur që lidhet me volumin që vazhdon të jetë i përcaktuar, mbetet gjithashtu e pandikuar. Megjithatë, që nga data e vendosjes rishtas në ekuilibër, volumi me të cilin elementi i mbrojtur është zvogëluar nuk është më pjesë e marrëdhënies mbrojtëse. Për shembull, në qoftë se një njësi ekonomike ka mbrojtur fillimisht një volum prej 100 ton të një malli me një çmim të ardhshëm prej 80 njësi monetare dhe e zvogëlon këtë volum me 10 ton me vendosjen rishtas në ekuilibër, elementi i mbrojtur pas vendosjes rishtas në ekuilibër do të jetë 90 ton, i mbrojtur me 80 njësi monetare. 10 tonët e elementit të mbrojtur që nuk janë më pjesë e marrëdhënies mbrojtëse do të kontabilizohen në përputhje me kërkesat për ndërprerjen e kontabilitetit mbrojtës (shih paragrafët 6.5.6-6.5.7 dhe B6.5.22-B6.5.28).
- B6.5.21 Kur ri balancon një marrëdhënie mbrojtëse, një njësi ekonomike duhet të azhurnojë analizat e burimeve të mbrojtjes jo efektive që priten të ndikojnë në marrëdhënien mbrojtëse gjatë periudhës (të mbetur) të saj (shih paragrafin B6.4.2). Dokumentimi i marrëdhënies mbrojtëse duhet të azhurnohet në përputhje me rrethanat.

Ndërprerja e kontabilitetit mbrojtës

- B6.5.22 Ndërprerja e kontabilitetit mbrojtës zbatohet në mënyrë prospektive që në momentin që nuk plotësohen më kriteret kualifikuese.
- B6.5.23 Një njësi ekonomike nuk duhet të anulojë përcaktimin dhe në këtë mënyrë të ndërpresë një marrëdhënie mbrojtëse që:
- plotëson ende objektivin e menaxhimit të rrezikut në bazë të të cilit është kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës (d.m.th. njësi ekonomike ende zbaton objektivin e menaxhimit të rrezikut); dhe
 - vazhdon të plotësojë të gjitha kriteret e tjera kualifikuese (pas marrjes në konsideratë të çdo vendosjeje rishtas në ekuilibër të marrëdhënies mbrojtëse, nëse është e zbatueshme).
- B6.5.24 Për qëllime të këtij Standardi, strategjia e menaxhimit të rrezikut të një njësie ekonomike ndahet nga objektivat e saj për menaxhimin e rrezikut. Strategjia e menaxhimit të rrezikut vendoset në nivelin më të lartë në të cilin një njësi ekonomike përcakton se si e menaxhon rrezikun e saj. Strategjitë e menaxhimit të rrezikut identifikojnë në mënyrë tipike rreziqet ndaj të cilave njësi ekonomike është e ekspozuar dhe përcakton mënyrën sesi do të reagojë ndaj tyre. Një strategji e menaxhimit të rrezikut zakonisht qëndron për një periudhë të gjatë dhe mund të ketë fleksibilitet për t'u përgjigjur ndaj ndryshimeve në rrethanat të cilat ndodhin ndërkohë që strategjia është e vlefshme (për shembull, norma interesi të ndryshme ose nivele çmimi mallrash që rezultojnë në një shkallë të ndryshme mbulimi). Kjo zakonisht përcaktohet në një dokument të përgjithshëm që përçohet në të gjitha nivelet e një njësie ekonomike nëpërmjet politikave që përmbajnë udhëzime më specifike. Në të kundërt, objektivi i menaxhimit të rrezikut për një marrëdhënie mbrojtëse zbatohet në nivelin e një marrëdhënie mbrojtëse të veçantë. Kjo ka të bëjë me mënyrën sesi një instrument mbulues i veçantë që ka qenë i përcaktuar përdoret për të mbrojtur ekspozimin e veçantë që ka qenë i përcaktuar si element i mbrojtur. Kështu që, një strategji e menaxhimit të rrezikut mund të përfshijë shumë marrëdhënie mbrojtëse të ndryshme, objektivat e menaxhimit të rrezikut të të cilave kanë të bëjnë me vënien në zbatim të strategjisë së përgjithshme të menaxhimit të rrezikut. Për shembull:
- një njësi ekonomike ka një strategji për menaxhimin e ekspozimit ndaj normës së saj të interesit në financimin e borxhit që përcakton rangun për kombinimin midis financimit me normë variabël dhe financimit me normë fikse për njësinë ekonomike në përgjithësi. Strategjia është që të mbajë 20 për qind deri në 40 për qind të borxhit me normë fikse. Njësi ekonomike vendos nga koha në kohë si do ta vërë në zbatim këtë strategji (d.m.th. ku e pozicionon veten midis rangut 20 deri në 40 për qind për ekspozimin ndaj interesit me normë fikse) në varësi të nivelit të normave të interesit. Nëse normat e interesit janë të ulëta njësi ekonomike cakton interesin për një borxh më të madh sesa kur normat e interesit janë të larta. Borxhi me normë variabël i njësisë ekonomike është 100 njësi monetare, nga të cilat 30 njësi monetare shkëmbehen në një ekspozim me normë fikse. Njësi ekonomike shfrytëzon avantazhin e normave të ulëta të interesit për të emetuar një shtesë borxhi prej 50 njësi monetare për të financuar një investim të madh, të cilën njësi

ekonomike e kryen duke emetuar një obligacion me normë fikse. Në kontekstin e normave të ulëta të interesit, njësia ekonomike vendos të caktojë ekspozimin e vet ndaj normave fikse të interesit në masën 40 për qind të borxhit total duke reduktuar me 20 njësi monetare masën me të cilën ajo mbron më parë ekspozimin me normë variabël, duke rezultuar kështu në një ekspozim me normë fikse prej 60 njësi monetare. Në këtë situatë vetë strategjia e menaxhimit të rrezikut mbetet e pandryshuar. Megjithatë, në kundërshtim me sa më sipër zbatimi i kësaj strategjie nga njësia ekonomike ka ndryshuar dhe kjo do të thotë që, për ekspozimin me normë variabël prej 20 njësi monetare që ka qenë e mbrojtur më parë, objektivi i menaxhimit të rrezikut ka ndryshuar (d.m.th. në nivelin e marrëdhënies mbrojtëse). Si rrjedhojë, në këtë situatë kontabiliteti mbrojtës duhet të ndërpritet për 20 njësi monetare të ekspozimit me normë variabël që ka qenë i mbrojtur më parë. Kjo mund të përfshijë reduktimin e pozicionit të shkëmbimit me 20 njësi monetare por, në varësi të rrethanave, një njësi ekonomike mund të mbajë këtë volum shkëmbimi dhe, për shembull, ta përdorë atë për të mbuluar një ekspozim të ndryshëm ose mund të bëhet pjesë e librit të transaksioneve tregtare. Anasjelltas, në qoftë se njësia ekonomike në vend të kësaj shkëmben një pjesë të borxhit të saj të ri me normë fikse në një ekspozim me normë variabël, kontabiliteti mbrojtës duhet të vazhdojë për ekspozimin e tij të mëparshëm të mbrojtur me normë variabël.

- (b) disa ekspozime vijnë si pasojë e pozicioneve që ndryshojnë shpesh, për shembull, rreziku i normës së interesit i një portofoli të hapur në një instrument borxhi. Shtesa e instrumenteve të reja të borxhit dhe çregjistrimi i instrumenteve të borxhit e ndryshojnë këtë ekspozim në mënyrë të vazhdueshme (d.m.th. kjo është ndryshe nga thjesht largimi i një pozicioni që maturohet). Ky është një proces dinamik në të cilin edhe ekspozimi edhe instrumenti mbulues i përdorur për të menaxhuar atë, nuk mbeten të njëjtë për një kohë të gjatë. Si rrjedhojë, një njësi ekonomike me një ekspozim të tillë përshtat në mënyrë të shpeshtë instrumentet mbulues që përdor për të menaxhuar rrezikun e normës së interesit ndërkohë që ndryshon ekspozimi. Për shembull, instrumentet e borxhit me afat të mbetur maturimi 24 muaj përcaktohen si elementë të mbrojtur për rrezikun e normës së interesit për 24 muaj. E njëjta procedurë zbatohet për periudha të tjera kohore ose periudha maturimi. Pas një periudhe të shkurtër kohe, njësia ekonomike i ndërpret të gjitha, disa ose një pjesë të marrëdhënies mbrojtëse të përcaktuara më parë për periudha maturimi dhe përcakton marrëdhënie të reja mbrojtëse për periudha maturimi në bazë të madhësisë së tyre dhe instrumenteve mbulues që përdoren aktualisht. Ndërprerja e kontabilitetit mbrojtës në këtë situatë pasqyron faktin që këto marrëdhënie mbrojtëse janë krijuar në një mënyrë të tillë që njësia ekonomike shikon për një instrument mbulues të ri dhe një element të mbrojtur të ri në vend të instrumentit mbulues dhe elementit të mbrojtur që ishin të përcaktuar më parë. Strategjia e menaxhimit të rrezikut mbetet e njëjtë, por nuk ka asnjë objektivi të menaxhimit të rrezikut që vazhdon të jetë i vlefshëm për ato marrëdhënie mbrojtëse të përcaktuara më parë, të cilat nuk ekzistojnë më si të tilla. Në një situatë të tillë, ndërprerja e kontabilitetit mbrojtës zbatohet deri në atë masë në të cilën ka ndryshuar objektivi i menaxhimit të rrezikut. Kjo varet nga situata në të cilën ndodhet njësia ekonomike dhe mund, për shembull, të ndikojë në të gjitha ose vetëm disa prej marrëdhënies mbrojtëse të një periudhe maturimi, ose vetëm në një pjesë të marrëdhënies mbrojtëse.
- (c) një njësi ekonomike ka një strategji për menaxhimin e rrezikut me anë të së cilës ajo menaxhon rrezikun e monedhës së huaj në shitjet e parashikuara dhe llogaritë e arkëtueshme që rrjedhin prej tyre. Në kuadër të kësaj strategjie njësia ekonomike menaxhon rrezikun e monedhës së huaj si një marrëdhënie mbrojtëse të posaçme vetëm deri në pikën e njohjes të llogarive të arkëtueshme. Pas kësaj, njësia ekonomike nuk e menaxhon më rrezikun e monedhës së huaj në bazë të kësaj marrëdhënie mbrojtëse të posaçme. Në vend të kësaj, ajo i menaxhon së bashku rrezikun e monedhës së huaj nga llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme dhe derivativët (që nuk kanë të bëjnë me transaksionet parashikuese që nuk janë kryer ende) të shprehur në të njëjtën monedhë të huaj. Për qëllime të kontabilitetit, kjo funksionon si një mbrojtje 'natyrale' sepse fitimet dhe humbjet nga rreziku i kursit të këmbimit në të gjithë këto zëra njihen menjëherë në fitim ose humbje. Rrjedhimisht, për qëllime të kontabilitetit, në qoftë se marrëdhënia mbrojtëse është përcaktuar për periudhën deri në datën e pagesës, ajo duhet të ndërpritet në momentin e njohjes së llogarisë së arkëtueshme, për shkak se objektivi i menaxhimit të rrezikut i marrëdhënies mbrojtëse nuk zbatohet më. Rreziku i kursit të këmbimit tashmë menaxhohet brenda së njëjtës strategji por mbi baza të ndryshme. Nga ana tjetër, në qoftë se një njësi ekonomike ka pasur një objektivi të ndryshëm të menaxhimit të rrezikut dhe menaxhonte rrezikun e monedhës së huaj si një marrëdhënie mbrojtëse e vazhdueshme në mënyrë të veçantë për atë shumë të shitjeve të parashikuara dhe llogaritë e arkëtueshme që rrjedhin prej saj deri në datën e shlyerjes, kontabiliteti mbrojtës do të vazhdojë deri në atë datë.

B6.5.25 Ndërprerja e kontabilitetit mbrojtës mund të ndikojë:

- (a) një marrëdhënie mbrojtëse në tërësinë e saj; ose

- (b) një pjesë të marrëdhënies mbrojtëse (që do të thotë se kontabiliteti mbrojtës vazhdon për pjesën e mbetur të marrëdhënies mbrojtëse).
- B6.5.26 Një marrëdhënie mbrojtëse ndërpritet në tërësi kur, si një e tërë, ajo nuk e përmbush më kriterin e kualifikimit. Për shembull:
- (a) Marrëdhënia mbrojtëse nuk e plotëson më objektivin e menaxhimit të rrezikut në bazë të të cilit është kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës (d.m.th njësia ekonomike nuk e zbaton më këtë objektivi të menaxhimit të rrezikut);
- (b) instrumenti apo instrumentet mbrojtëse janë shitur ose ndërprerë (në lidhje me volumin total që ishte pjesë e marrëdhënies mbrojtëse); ose
- (c) nuk ekziston më një marrëdhënie ekonomike midis elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbulues, ose efekti i rrezikut të kredisë fillon të dominojë ndryshimet në vlerë që vijnë si rezultat i kësaj marrëdhënie ekonomike.
- B6.5.27 Një pjesë e marrëdhënies mbrojtëse ndërpritet (dhe kontabiliteti mbrojtës vazhdon për pjesën tjetër të saj) kur vetëm një pjesë e marrëdhënies mbrojtëse nuk përmbush më kriteret kualifikuese. Për shembull:
- (a) në vendosjen rishtas në ekuilibër të marrëdhënies mbrojtëse, raporti i mbrojtjes mund të rregullohet në mënyrë të tillë që një pjesë e volumit të elementit të mbrojtur nuk është më pjesë e marrëdhënies mbrojtëse (shih paragrafin B6.5.20); kështu që, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet vetëm për atë pjesë të elementit të mbrojtur që nuk është më pjesë e marrëdhënies mbrojtëse; ose
- (b) kur një pjesë e elementit të mbrojtur që është një transaksion parashikues (ose është një përbërës i tij) nuk është më me probabilitet të lartë që të ndodhë, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet vetëm për atë pjesë të elementit të mbrojtur ndodhja e të cilit nuk ka më probabilitet të lartë. Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike ka një histori të përcaktimit të mbulimit të transaksioneve parashikuese dhe më pas ka vendosur se transaksionet parashikuese nuk pritet më të ndodhin, aftësia e njësish ekonomike për të parashikuar transaksionet parashikuese me saktësi vihet në dyshim kur parashikon transaksione parashikuese të ngjashme. Kjo ndikon në vlerësimin nëse transaksionet parashikuese të ngjashme janë me probabilitet të lartë (shih paragrafin 6.3.3) dhe nëse janë të përshtatshëm si elemente të mbrojtur.
- B6.5.28 Një njësi ekonomike mund të përcaktojë një marrëdhënie mbrojtëse të re që përfshin instrumentin mbulues ose elementin e mbrojtur të një marrëdhënie mbrojtëse të mëparshme për të cilën kontabiliteti mbrojtës (një pjesë ose në tërësi) është ndërprerë. Ky nuk përbën një vazhdim të një marrëdhënie mbrojtëse por është një rifillim. Për shembull:
- (a) një instrument mbulues pëson një përkeqësim drastik të kredisë saqë njësia ekonomike e zëvendëson atë me një instrument mbulues të ri. Kjo do të thotë që marrëdhënia mbrojtëse fillestare ka dështuar për të arritur objektivin e menaxhimit të rrezikut dhe kështu që ndërpritet tërësisht. Instrumenti i ri mbulues përcaktohet si mbrojtje e të njëjtit ekspozim që ishte i mbrojtur edhe më parë dhe formon një marrëdhënie të re mbrojtëse. Kështu që, ndryshimet në vlerën e drejtë ose në flukset e mjeteve monetare të elementit të mbrojtur maten duke filluar nga, dhe duke u referuar nga, data e përcaktimit të marrëdhënies së re mbrojtëse në vend të datës në të cilën ishte përcaktuar marrëdhënia mbrojtëse fillestare.
- (b) një marrëdhënie mbrojtëse ndërpritet para përfundimit të mandatit të saj. Instrumenti mbulues në atë marrëdhënie mbrojtëse mund të përcaktohet si instrument mbulues në një marrëdhënie tjetër mbrojtëse (për shembull, kur rregullon raportin e mbrojtjes me vendosjen rishtas në ekuilibër duke rritur volumin e instrumentit mbulues apo kur përcakton një marrëdhënie mbrojtëse komplet të re).

Kontabiliteti për vlerën në kohë të opsioneve

- B6.5.29 Një opsjon mund të konsiderohet si i lidhur me një periudhë kohore, sepse vlera në kohë e tij përfaqëson një detyrim për të siguruar mbrojtje për mbajtësin e opsionit gjatë një periudhe kohore. Megjithatë, pikëpamjet kryesore për qëllimin e vlerësimit nëse një opsjon mbulon një transaksion ose një element të mbrojtur që lidhet me periudhën kohore janë karakteristikat e atij elementi të mbrojtur, duke përfshirë edhe faktin si dhe kur ai ndikon në fitimin ose humbjen. Kështu që, një njësi ekonomike do të vlerësojë llojin e elementit të mbrojtur (shih paragrafin 6.5.15(a)) në bazë të natyrës së elementit të mbrojtur (pavarësisht nga fakti nëse marrëdhënia mbrojtëse është një mbrojtje e fluksit monetar apo një mbrojtje me vlerën e drejtë):
- (a) vlera në kohë e një opsioni ka të bëjë me një element të mbrojtur që lidhet me një transaksion nëse natyra e elementit të mbrojtur është një transaksion për të cilin vlera në kohë ka karakterin e kostove të këtij transaksioni. Një shembull i tillë është kur vlera në kohë e një opsioni lidhet me një element të mbrojtur që rezulton në njohjen e një zëri matja fillestare e të cilit përfshin the

kostot e transaksionit (për shembull, një njësi ekonomike mbron blerjen e një malli, nëse kjo është një transaksion parashikues apo një angazhim i përcaktuar, nga rreziku i çmimit të mallit dhe përfshin dhe kostot e transaksionit në matjen fillestare të inventarit). Si pasojë e përfshirjes së vlerës në kohë të një opsioni në matjen fillestare të një elementi të mbrojtur të veçantë, vlera në kohë ndikon fitimin ose humbjen në të njëjtën kohë si dhe elementi i mbrojtur. Në mënyrë të ngjashme, një njësi ekonomike që mbron shitjen e një malli, nëse kjo është një transaksion i ardhshëm apo një angazhim i përcaktuar, duhet të përfshijë vlerën në kohë të opsionit si pjesë e kostos së shitjes të këtij malli (kështu që, vlera në kohë do të ishte njohur në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë që janë njohur dhe të ardhurat nga shitja e kësaj mbrojtje).

- (b) vlera në kohë e një opsioni ka të bëjë me një periudhë kohore që lidhet me një element të mbrojtur në qoftë se natyra e elementit të mbrojtur është e tillë që vlera në kohë ka karakterin e një kosto për të siguruar mbrojtje kundrejt një rreziku për një periudhë të caktuar kohore (por elementi i mbrojtur nuk rezulton në një transaksion që përfshin nocionin e një kosto transaksioni sipas pikës (a)). Për shembull, në qoftë se inventari i mallit është i mbrojtur nga rreziku i rënies së vlerës së drejtë për gjashtë muaj nëpërmjet një opsion-malli me një afat përkatës, vlera në kohë e opsionit do të ishte shpërndarë në fitim ose humbje (d.m.th do të amortizohej në mënyrë sistematike lineare) për një periudhë kohore gjashtë muaj. Një shembull tjetër është mbrojtja e një investimi neto në një njësi ekonomike të huaj që është i mbrojtur për 18 muaj nëpërmjet një opsioni të këmbimit në monedha të huaja, i cili mund të rezultojë në shpërndarjen e vlerës në kohë të opsionit për një periudhë kohore 18 mujore.

B6.5.30 Karakteristikat e elementit të mbrojtur, përfshirë dhe faktin si dhe kur elementi i mbrojtur ndikon në fitim ose humbje, kanë efekt gjithashtu mbi periudhën gjatë së cilës amortizohet vlera në kohë e opsionit që mbron një element i mbrojtur të lidhur me një një periudhë kohore, i cili është i qëndrueshëm në periudhën kur gjatë së cilës vlera e perceptuar e opsionit mund të ndikojë fitimin ose humbjen në përputhje me kontabilitetin mbrojtës. Për shembull, nëse një opsion i normës së interesit (kufi maksimal) përdoret për të ofruar mbrojtje kundrejt rrezikut të rritjes së shpenzimeve për interesa në një obligacion me normë të luhatshme, vlera në kohë e këtij kufiri maksimal do amortizohet në fitim ose humbje përgjatë së njëjtës periudhë në të cilën vlera e perceptuar e kufirit maksimal do të ndikonte në fitim ose humbje:

- (a) në qoftë se kufiri maksimal mbron nga rritjet e normave të interesit për tre vitet e para të jetës të një obligacioni pesë vjeçar me normë të luhatshme, vlera në kohë e këtij kufiri maksimal amortizohet përgjatë tre viteve; ose
- (b) në qoftë se kufiri maksimal është një opsion të së ardhmes me fillim të përcaktuar që mbron nga rritjet e normave të interesit për vitin e dytë dhe të tretë të jetës të një obligacioni pesë vjeçar me normë të luhatshme, vlera në kohë e këtij kufiri maksimal amortizohet përgjatë vitit të dytë dhe të tretë;

B6.5.31 Kontabiliteti i vlerës në kohë të opsioneve në përputhje me paragrafin 6.5.15 zbatohet gjithashtu edhe për një kombinim të një opsioni të blerë dhe një opsioni të shitur (njëri është opsion për të shitur dhe tjetri është opsion për të blerë), i cili në datën e përcaktimit si instrument mbulues e ka vlerën në kohë neto zero (zakonisht i referohemi si një opsion investimi mbrojtës me kosto zero). Në këtë rast, njësia ekonomike duhet të njohë çdo ndryshim në vlerën në kohë në të ardhura të tjera përmbledhëse, megjithëse ndryshimi në vlerën në kohë përgjatë të gjithë periudhës së marrëdhënies mbrojtëse është zero. Kështu që, në qoftë se vlera në kohë e opsionit ka të bëjë me:

- (a) një element të mbrojtur që lidhet me një transaksion, shuma e vlerës në kohë në fund të marrëdhënies mbrojtëse që rregullon elementin e mbrojtur ose që rriklasifikohet në fitim ose humbje (shih paragrafin 6.5.15(b)) do të jetë zero.
- (b) një element të mbrojtur që lidhet me periudhën kohore, shpenzimet e amortizimit që kanë të bëjnë me vlerën në kohë janë zero.

B6.5.32 Kontabiliteti për vlerën në kohë të opsioneve në përputhje me paragrafin 6.5.15 zbatohet vetëm në atë masë në të cilën vlera në kohë lidhet me elementin e mbrojtur (vlera në kohë e përafëruar). Vlera në kohë e një opsioni ka të bëjë me elementin e mbrojtur në qoftë se termat e rëndësishme (si vlera nominale, jeta dhe bazat e tij) janë të përafëruara me elementin e mbrojtur. Kështu që, nëse termat kritike të opsionit dhe elementit të mbrojtur nuk janë plotësisht të përafëruar, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë vlerën në kohë të përafëruar, d.m.th. sa nga vlera në kohë e përfshirë në prim (vlera në kohë aktuale) ka të bëjë me elementin e mbrojtur (dhe në këtë mënyrë duhet të trajtohet në përputhje me paragrafin 6.5.15). Një njësi ekonomike përcakton vlerën në kohë të përafëruar duke përdorur vlerësimin e opsionit që ka terma kritike që përputhen plotësisht me elementin e mbrojtur.

B6.5.33 Në qoftë se vlera në kohë aktuale dhe vlera në kohë e përafëruar ndryshojnë, njësia ekonomike duhet të përcaktojë shumën që është akumuluar në një përbërës kapitali të veçantë në përputhje me paragrafin 6.5.15 si më poshtë:

- (a) në qoftë se, në fillim të marrëdhënies mbrojtëse, vlera në kohë aktuale është më e madhe se vlera në kohë e përafuar, njësia ekonomike do të:
- (i) përcaktojë shumën që është akumuluar në një përbërës kapitali të veçantë në bazë të vlerës në kohë të përafuar; dhe
 - (ii) kontabilizojë diferencat në ndryshimet në vlerën e drejtë midis dy vlerave në kohë në fitim ose humbje.
- (b) në qoftë se, në fillim të marrëdhënies mbrojtëse, vlera në kohë aktuale është më e ulët se vlera në kohë e përafuar, njësia ekonomike do të përcaktojë shumën që është akumuluar në një përbërës të veçantë kapitali duke iu referuar ndryshimit më të ulët të akumuluar në vlerën e drejtë të:
- (i) vlerës në kohë aktuale; dhe
 - (ii) vlerës në kohë të përafuar.

Çdo tepricë e ndryshimit në vlerën e drejtë të vlerës në kohë aktuale do të njihet në fitim ose humbje.

Kontabiliteti për elementin e ardhshëm të kontratave të ardhshme dhe shpërndarja e bazës së monedhës së huaj të instrumenteve financiare

B6.5.34 Një kontratë e ardhshme mund të konsiderohet si e lidhur me një periudhë kohore sepse elementi i ardhshëm i saj përfaqëson detyrime për një periudhë kohore (e cila është gjëja thelbësore për të cilën është përcaktuar). Megjithatë, pikëpamjet kryesore për qëllimin e vlerësimit nëse një instrument mbulues mbron një transaksion ose një element të mbrojtur që lidhet me periudhën kohore janë karakteristikat e atij elementi të mbrojtur, duke përfshirë edhe faktin si dhe kur ai ndikon në fitimin ose humbjen. Kështu që, një njësi ekonomike do të vlerësojë llojin e elementit të mbrojtur (shih paragrafët 6.5.16 dhe 6.5.15(a)) në bazë të natyrës së elementit të mbrojtur (pavarësisht nga fakti nëse marrëdhënia mbrojtëse është një mbrojtje e fluksit monetar apo një mbrojtje me vlerën e drejtë):

- (a) elementi i ardhshëm i një kontrate të ardhshme ka të bëjë me një element të mbrojtur që lidhet me një transaksion nëse natyra e elementit të mbrojtur është një transaksion për të cilin elementi i ardhshëm ka karakterin e kostove të këtij transaksioni. Një shembull i tillë është kur elementi i ardhshëm lidhet me një element të mbrojtur që rezulton në njohjen e një zëri matja fillestare e të cilit përfshin the kostot e transaksionit (për shembull, një njësi ekonomike mbron një blerje inventari të shprehur në monedhë të huaj, qoftë ky një transaksion parashikues apo një angazhim i përcaktuar, nga rreziku i kursit të këmbimit dhe përfshin edhe kostot e transaksionit në matjen fillestare të inventarit). Si pasojë e përfshirjes së elementit të ardhshëm në matjen fillestare të një elementi të mbrojtur të veçantë, elementi i ardhshëm ndikon fitimin ose humbjen në të njëjtën kohë si dhe elementi i mbrojtur. Në mënyrë të ngjashme, një njësi ekonomike që mbron shitjen e një malli të shprehur në monedhë të huaj ndaj rrezikut nga monedha e huaj, qoftë ky një transaksion parashikues apo një angazhim i përcaktuar, duhet të përfshijë elementin e ardhshëm si pjesë e kostos së shitjes të këtij malli (kështu që, elementi i ardhshëm do të ishte njohur në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë që janë njohur dhe të ardhurat nga shitja e mbrojtur).
- (b) elementi i ardhshëm i një kontrate të ardhshme ka të bëjë me një element të mbrojtur që lidhet me një periudhë kohore në qoftë se natyra e elementit të mbrojtur është e tillë që elementi i ardhshëm ka karakterin e një kostoje për të siguruar mbrojtje kundrejt një rreziku për një periudhë të caktuar kohore (por elementi i mbrojtur nuk rezulton në një transaksion që përfshin nocionin e një kosto transaksioni sipas pikës (a)). Për shembull, në qoftë se inventari i mallit është i mbrojtur nga ndryshimet në vlerën e drejtë për gjashtë muaj nëpërmjet një kontrate të ardhshme për mallra me një afat përkatës, elementi i ardhshëm i kontratës së ardhshme do të ishte shpërndarë në fitim ose humbje (d.m.th do të amortizohet në mënyrë sistematike lineare) për një periudhë kohore gjashtë muaj. Një shembull tjetër është mbrojtja e një investimi neto në një njësi ekonomike të huaj që është i mbrojtur për 18 muaj nëpërmjet një kontrate të ardhshme të këmbimit në monedha të huaja, i cili mund të rezultojë në shpërndarjen e elementit të ardhshëm të kontratës së ardhshme për atë periudhë kohore 18 mujore.

B6.5.35 Karakteristikat e elementit të mbrojtur, përfshirë edhe faktin si dhe kur elementi i mbrojtur ndikon në fitim ose humbje, kanë efekt gjithashtu mbi periudhën gjatë së cilës amortizohet elementi i ardhshëm i një kontrate të ardhshme që mbron një element të mbrojtur të lidhur me një një periudhë kohore, gjë e cila ndodh përgjatë periudhës me të cilën ka të bëjë elementi i ardhshëm. Për shembull, nëse një kontratë e ardhshme mbron ekspozimin ndaj luhatjeve të normave 3-mujore të interesit për një periudhë 3-mujore që fillon pas gjashtë muajsh, elementi i ardhshëm amortizohet përgjatë periudhës që shtrihet nga muaji i shtatë deri në muajin e nëntë.

- B6.5.36 Kontabiliteti për elementin e ardhshëm të një kontrate të ardhshme në përputhje me paragrafin 6.5.16 zbatohet gjithashtu nëse, në datën në të cilën kontrata e ardhshme përcaktohet si instrument mbulues, elementi i ardhshëm është zero. Në këtë rast, njësia ekonomike duhet të njohë çdo ndryshim në vlerën e drejtë që ka të bëjë drejtpërdrejt me elementin e ardhshëm, në të ardhura të tjera përmbledhëse, megjithëse ndryshimi i akumuluar në vlerën e drejtë që ka të bëjë drejtpërdrejt me elementin e ardhshëm përgjatë të gjithë periudhës së marrëdhënies mbrojtëse është zero. Kështu që, nëse elementi i ardhshëm i një kontrate të ardhshme ka të bëjë me:
- (a) një element i mbrojtur që lidhet me një transaksion, vlera në lidhje me elementin e ardhshëm në fund të marrëdhënies mbrojtëse që rregullon elementin e mbrojtur ose që riklasifikohet në fitim ose humbje (shih paragrafët 6.5.16 dhe 6.5.15(b)) do të jetë zero.
 - (b) një element i mbrojtur që lidhet me periudhën kohore, vlera e amortizimit që ka të bëjë me elementin e ardhshëm është zero.
- B6.5.37 Kontabiliteti për elementin e ardhshëm të kontratave të ardhshme në përputhje me paragrafin 6.5.16 zbatohet vetëm në atë masë në të cilën elementi i ardhshëm lidhet me elementin e mbrojtur (elementi i ardhshëm i përafuar). Elementi i ardhshëm i një kontrate të ardhshme ka të bëjë me elementin e mbrojtur nëse termat e rëndësishme të kontratës së ardhshme (si vlera nominale, jeta dhe bazat e saj) janë të përafuara me elementin e mbrojtur. Kështu që, nëse termat e rëndësishme të kontratës së ardhshme dhe elementit të mbrojtur nuk janë plotësisht të përafuara, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë elementin e ardhshëm të përafuar, d.m.th. sa nga elementi i ardhshëm i përfshirë në kontratën e ardhshme (elementi i ardhshëm aktual) ka të bëjë me elementin e mbrojtur (dhe në këtë mënyrë duhet të trajtohet në përputhje me paragrafin 6.5.16). Një njësi ekonomike përcakton elementin e ardhshëm të përafuar duke përdorur vlerësimin e kontratës së ardhshme që do të kishte termat e rëndësishme që përputhen plotësisht me elementin e mbrojtur.
- B6.5.38 Në qoftë se elementi i ardhshëm aktual dhe elementi i ardhshëm i përafuar ndryshojnë, njësia ekonomike duhet të përcaktojë shumën që është akumuluar në një përbërës kapitali të veçantë në përputhje me paragrafin 6.5.16 si më poshtë:
- (a) në qoftë se, në fillim të marrëdhënies mbrojtëse, vlera absolute e elementit të ardhshëm aktual është më e madhe se vlera e elementit të ardhshëm të përafuar, njësia ekonomike duhet të:
 - (i) përcaktojë shumën që është akumuluar në një përbërës kapitali të veçantë në bazë të elementit të ardhshëm të përafuar; dhe
 - (ii) kontabilizojë diferencat në ndryshimet në vlerën e drejtë midis dy elementëve të ardhshëm në fitim ose humbje.
 - (b) në qoftë se, në fillim të marrëdhënies mbrojtëse, vlera absolute e elementit të ardhshëm aktual është më e vogël se ajo e elementit të ardhshëm të përafuar, njësia ekonomike duhet të përcaktojë shumën që është akumuluar në një përbërës kapitali të veçantë duke iu referuar ndryshimit të akumuluar më të vogël në vlerën e drejtë të:
 - (i) vlerës absolute të elementit të ardhshëm aktual; dhe
 - (ii) vlerës absolute të elementit të ardhshëm të përafuar.

Çdo tepriçë e ndryshimit në vlerën e drejtë të elementit të ardhshëm aktual do të njihet në fitim ose humbje.

- B6.5.39 Kur një njësi ekonomike veçon shpërndarjen e bazës së monedhës së huaj nga një instrument financiar dhe e përjashton këtë instrument financiar nga përcaktimi si instrument mbulues (shih paragrafin 6.2.4(b)), udhëzimet e zbatimit në paragrafët B6.5.34-B6.5.38 zbatohen për shpërndarjen e bazës së monedhës së huaj në të njëjtën mënyrë siç zbatohen për elementin e ardhshëm të kontratës së ardhshme.

Mbulimi i një grupi zërash (Seksioni 6.6)

Mbulimi i një pozicioni neto

Përshtatshmëria e kontabilitetit mbrojtës dhe përcaktimi i një pozicioni neto

- B6.6.1 Një pozicion neto është i përshtatshëm për kontabilitetin mbrojtës vetëm nëse njësia ekonomike mbron mbi baza neto për qëllime të menaxhimit të rrezikut. Nëse një njësi ekonomike përdor mbrojtjen në këtë mënyrë është fakt absolut (jo thjesht çështje pohimi apo dokumentacioni). Kështu që, një njësi ekonomike nuk mund të zbatojë kontabilitetin mbrojtës mbi baza neto vetëm për të arritur një rezultat të veçantë

kontabiliteti në qoftë se kjo nuk do të pasqyronte metodën e menaxhimit të rrezikut të saj. Mbulimi i pozicionit neto duhet të jetë pjesë e një strategjie të përcaktuar për menaxhimin e rrezikut. Normalisht kjo duhet të aprovohet nga personeli drejtues kryesor siç përcaktohet në SNK 24.

- B6.6.2 Për shembull, Njësia ekonomike A, monedha funksionale e së cilës është monedha lokale, ka një angazhim të përcaktuar për të paguar 150,000 njësi në monedhë të huaj për shpenzime publiciteti në një periudhë kohore prej 9 muajsh dhe një angazhim të përcaktuar për të shitur produkte të gatshme në vlerën 150,000 njësi në monedhë të huaj në një periudhë 15 mujore. Njësia ekonomike A futet në një derivativ në monedhë të huaj që shtrihet në periudhën kohore 9 mujore gjatë së cilës kjo njësi ekonomike merr 100 njësi në monedhë të huaj dhe paguan 70 njësi monetare. Njësia ekonomike A nuk ka asnjë ekspozim tjetër ndaj monedhës së huaj. Njësia ekonomike A nuk menaxhon rrezikun e monedhës së huaj mbi baza neto. Kështu që, Njësia ekonomike A nuk mund të zbatojë kontabilitetin mbrojtës për një marrëdhënie mbrojtëse midis derivativit në monedhë të huaj dhe një pozicioni neto prej 100 njësi në monedhë të huaj (përbërë nga 150,000 njësi në monedhë të huaj nga angazhimi i blerjes së përcaktuar-d.m.th. shërbime publiciteti-dhe 149,900 njësi në monedhë të huaj (nga 150,000 njësi në monedhë të huaj) nga angazhimi i shitjes së përcaktuar) për një periudhë 9 mujore.
- B6.6.3 Në qoftë se Njësia ekonomike A do të kishte menaxhuar rrezikun e monedhës së huaj mbi një bazë neto dhe nuk do të ishte futur në një derivativ në monedhë të huaj (sepse ai e rrit ekspozimin ndaj rrezikut të monedhës së huaj në vend që ta ulë atë), atëherë njësia ekonomike do të ishte në një pozicion të mbrojtur normal për nëntë muaj. Normalisht, ky pozicion i mbrojtur nuk do të pasqyrohej në pasqyrat financiare sepse transaksionet njihen në periudha raportimi të ndryshme në të ardhmen. Pozicioni neto zero do të ishte i përshtatshëm për kontabilitetin mbrojtës vetëm nëse plotësohen kushtet në paragrafin 6.6.6.
- B6.6.4 Kur një grup zërash që përbëjnë një pozicion neto përcaktohet si element i mbrojtur, njësia ekonomike do të përcaktojë në tërësi grupin e zërave i cili përfshin ato zëra që përbëjnë pozicionin neto. Një njësi ekonomike nuk lejohet që të përcaktojë një vlerë abstrakte jo specifike të një pozicioni neto. Për shembull, një njësi ekonomike ka një grup angazhimesh shitjeje të përcaktuara në një periudhë 9 mujore për 100 njësi në monedhë të huaj dhe një grup angazhimesh blerjeje të përcaktuara në një periudhë 18 mujore për 120 njësi në monedhë të huaj. Njësia ekonomike nuk mund të përcaktojë një vlerë abstrakte të një pozicioni neto deri në 20 njësi monedhe të huaj. Në vend të kësaj, kjo njësi ekonomike duhet të përcaktojë një vlerë bruto për blerjet dhe një vlerë bruto për shitjet që të dyja bashkë çojnë në pozicionin neto të mbrojtur. Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë pozicionet bruto që çojnë në pozicionin neto në mënyrë që njësia ekonomike të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat për kontabilitetin për kualifikimin e marrëdhënieve mbrojtëse.

Zbatimi i kërkesave të mbrojtjes efektive për një mbrojtje të një pozicioni neto

- B6.6.5 Kur një njësi ekonomike përcakton nëse plotësohen kërkesat e mbrojtjes efektive në paragrafin 6.4.1(c) kur mbron një pozicion neto, ajo duhet të marrë në konsideratë ndryshimet në vlerën e zërave në pozicionin neto që kanë një efekt të ngjashëm si instrumenti mbulues në lidhje me ndryshimin në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues. Për shembull, një njësi ekonomike ka një grup angazhimesh shitjeje të përcaktuara në një periudhë 9 mujore për 100 njësi në monedhë të huaj dhe një grup angazhimesh blerjeje të përcaktuara në një periudhë 18 mujore për 120 njësi në monedhë të huaj. Ajo mbron rrezikun e monedhës së huaj të pozicionit neto prej 20 njësi monedhe të huaj duke përdorur një kontratë të ardhshme këmbimi për 20 njësi monedhë e huaj. Kur përcakton nëse plotësohen kërkesat e mbrojtjes efektive sipas paragrafit 6.4.1(c), njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë marrëdhënien midis:
- ndryshimit në vlerën e drejtë në kontratën e ardhshme të këmbimit së bashku me ndryshimet e lidhura me rrezikun e monedhës së huaj në vlerën e angazhimeve të shitjes të përcaktuar; dhe
 - ndryshimet e lidhura me rrezikun e monedhës së huaj në vlerën e angazhimeve të blerjes së përcaktuar.
- B6.6.6 Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se në shembullin e dhënë në paragrafin B6.6.5 njësia ekonomike do të kishte një pozicion neto zero, do të merrte në konsideratë marrëdhënien midis ndryshimeve të lidhura me rrezikun e monedhës së huaj në vlerën e angazhimeve të shitjes të përcaktuar dhe ndryshimeve të lidhura me rrezikun e monedhës së huaj në vlerën e angazhimeve të blerjes së përcaktuar, kur përcakton nëse plotësohen ose jo kërkesat për mbrojtjen efektive sipas paragrafit 6.4.1(c).

Mbrojtjet e fluksit të mjeteve monetare që përbëjnë një pozicion neto

- B6.6.7 Kur një njësi ekonomike mbron një grup zërash me pozicione të kompensimit të rrezikut (d.m.th. një pozicion neto), përshtatshmëria e kontabilitetit mbrojtës varet nga lloji i mbrojtjes. Në qoftë se mbrojtja është një mbrojtje me vlerën e drejtë, atëherë pozicioni neto mund të jetë i përshtatshëm si element i mbrojtur. Nëse, megjithatë, mbrojtja është një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare, atëherë pozicioni neto

mund të jetë i përshtatshëm si element i mbrojtur vetëm nëse është një mbrojtje e rrezikut të monedhës së huaj dhe përcaktimi i atij pozicioni neto specifikon periudhën e raportimit në të cilën transaksionet parashikuese pritet të ndikojnë fitimin ose humbjen dhe specifikon gjithashtu edhe natyrën dhe volumin e tyre.

B6.6.8 Për shembull, një njësi ekonomike ka një pozicion neto që përbëhet nga një shtresë e poshtme e shitjeve prej 100 njësi monedhë e huaj dhe një shtresë e poshtme e blerjeve prej 150 njësi monedhë e huaj. Si shitjet ashtu edhe blerjet janë të shprehura në të njëjtën monedhë të huaj. Me qëllim që të specifikojë në mënyrë të mjaftueshme përcaktimin e pozicionit neto të mbrojtur, njësi ekonomike specifikon në dokumentacionin origjinal të marrëdhënies mbrojtëse që shitjet konsistojnë në Produktin A ose Produktin B dhe blerjet konsistojnë në Makinerinë e tipit A, Makinerinë e tipit B dhe Lëndën e parë A. Njësi ekonomike specifikon gjithashtu volumet e transaksioneve nga natyra e secilit prej tyre. Njësi ekonomike dokumenton që shtresa e poshtme e shitjeve (100 njësi monedhë e huaj) është e përbërë nga një vëllim shitjesh të parashikuara prej 70 njësitë e para monedhë e huaj të Produktit A dhe 30 njësitë e para monedhë e huaj të Produktit B. Në qoftë se këto vëllime shitje pritet të ndikojnë në fitimin ose humbjen në periudha raportimi të ndryshme, njësi ekonomike do ta përfshinte këtë në dokumentacion, për shembull, 70 njësitë e para monedhë e huaj nga shitjet e Produktit A që pritet të ndikojnë fitimin ose humbjen në periudhën e parë raportuese dhe 30 njësitë e para monedhë e huaj nga shitjet e Produktit B që pritet të ndikojnë fitimin ose humbjen në periudhën e dytë raportuese. Njësi ekonomike dokumenton gjithashtu që shtresa e poshtme e blerjeve (150 njësi monedhë e huaj) përbëhet nga blerjet prej 60 njësite të para monedhë e huaj të Makinerisë Tipi A, 40 njësitë e para monedhë e huaj të Makinerisë Tipi B dhe 50 njësitë e para monedhë e huaj Lëndë e parë A. Në qoftë se këto vëllime blerje pritet të ndikojnë fitimin ose humbjen në periudha raportimi të ndryshme, njësi ekonomike duhet të përfshijë në dokumentim një ndarje të vëllimeve të blerjes sipas periudhave të raportimit në të cilat ato pritet që të ndikojnë fitimin ose humbjen (njësoj siç dokumenton vëllimet e shitjeve). Për shembull, transaksioni parashikues do të specifikohet si:

- (a) 60 njësitë e para monedhë e huaj të blerjes së Makinerisë Tipi A që pritet të kenë ndikim në fitim ose humbje nga periudha e tretë raportuese përgjatë dhjetë periudhave të tjera raportuese;
- (b) 40 njësitë e para monedhë e huaj të blerjes së Makinerisë Tipi B që pritet të kenë ndikim në fitim ose humbje nga periudha e katërt raportuese përgjatë njëzet periudhave të tjera raportuese; dhe
- (c) 50 njësitë e para monedhë e huaj të blerjes së Lëndës së parë A që pritet të merren në dorëzim në periudhën e tretë raportuese dhe të shiten, d.m.th. të kenë ndikim mbi fitimin ose humbjen, në atë periudhë dhe në periudhën raportuese vijuese.

Specifikimi i natyrës së vëllimeve të transaksionit parashikues do të përfshijë aspekte të tilla si modeli i amortizimit për tokën, ndërtesën, makineritë e pajisjet e të njëjtit lloj, nëse natyra e këtyre zërave është e tillë që modeli i amortizimit mund të ndryshojë në varësi të faktit se si njësi ekonomike i përdor këto zëra. Për shembull, në qoftë se njësi ekonomike përdor zërat e Makinerisë Tipi A në dy procese të ndryshme prodhimi që rezultojnë në amortizimin linear përgjatë dhjetë periudhave të raportimit dhe njësitë e metodës së prodhimit përkatësisht, dokumentimi i vëllimit të blerjes së parashikuar për Makinerinë e Tipit A do të veçojë atë vëllim nga lloji i modeleve amortizimit që do të zbatohen.

B6.6.9 Për një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare të një pozicioni neto, vlerat e përcaktuara në përputhje me paragrafin 6.5.11 duhet të përfshijnë ndryshimet në vlerën e zërave në pozicionin neto që kanë një efekt të ngjashëm si instrumenti mbulues në lidhje me ndryshimin në vlerën e drejtë të instrumentit mbulues. Megjithatë, ndryshimet në vlerën e zërave në pozicionin neto që kanë efekt të njëjtë si instrumenti mbulues do të njihen vetëm kur të njihen transaksionet me të cilat ato lidhen, njësoj siç njihet një shitje e parashikuar si e ardhur. Për shembull, një njësi ekonomike ka një grup shitjesh të parashikuara me probabilitet të lartë në një periudhë 9 mujore për 100 njësi në monedhë të huaj dhe një grup blerjesh të parashikuara me probabilitet të lartë në një periudhë 18 mujore për 120 njësi në monedhë të huaj. Ajo mbron rrezikun e monedhës së huaj të pozicionit neto prej 20 njësi monedhe të huaj duke përdorur një kontratë të ardhshme këmbimi për 20 njësi monedhë e huaj. Kur përcakton vlerat që do të njihen në rezervën e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare sipas paragrafëve 6.5.11(a)-6.5.11(b), njësi ekonomike bën krahasimin e:

- (a) ndryshimit në vlerën e drejtë të kontratës së ardhshme të këmbimit së bashku me ndryshimet e lidhura me rrezikun e monedhës së huaj në vlerën e shitjeve të parashikuara me probabilitet të lartë; me
- (b) ndryshimet e lidhura me rrezikun e monedhës së huaj në vlerën e blerjeve të parashikuara me probabilitet të lartë.

Megjithatë, njësi ekonomike njeh vetëm vlerat e lidhura me kontratën e ardhshme të këmbimit deri në momentin që transaksionet e shitjeve të parashikuara me probabilitet të lartë do të njihen në pasqyrat financiare, kohë në të cilën njihen edhe fitimet ose humbjet nga këto transaksione parashikuese (d.m.th. ndryshimi në vlerë që ka të bëjë drejtpërdrejt me ndryshimin në kurset e këmbimit të monedhave të huaja midis përcaktimit të marrëdhënies mbrojtëse dhe njohjes së të ardhurave).

- B6.6.10 Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se tek shembulli më sipër njësi ekonomike do të kishte një pozicion neto zero, ajo do të krahasonte ndryshimet e lidhura me rrezikun e monedhës së huaj në vlerën e shitjeve të parashikuara me probabilitet të lartë me ndryshimet e lidhura me rrezikun e monedhës së huaj në vlerën e blerjeve të parashikuara me probabilitet të lartë. Megjithatë, këto vlera do të njihen vetëm në momentin kur transaksionet parashikuese me të cilat ato lidhen do të njihen në pasqyrat financiare.

Shtresat e grupeve të zërave të përcaktuar si element i mbrojtur

- B6.6.11 Për të njëjtat arsye të theksuara në paragrafin B6.3.19, përcaktimi i përbërësve shtresorë të grupeve të zërave ekzistues kërkon identifikim specifik të vlerës nominale të grupit të zërave nga i cili është përcaktuar përbërësi shtresor i mbrojtur.
- B6.6.12 Një marrëdhënie mbrojtëse mund të përfshijë shtresa nga disa grupe të ndryshme zërash. Për shembull, në një mbrojtje të një pozicioni neto të një grupi aktivesh dhe një grupi detyrimesh, marrëdhënia mbrojtëse mund të përmbajë, në kombinim, një përbërës shtresor të grupit të aktiveve dhe një përbërës shtresor të grupit të detyrimeve.

Paraqitja e fitimeve ose humbjeve të instrumentit mbulues

- B6.6.13 Në qoftë se zërat janë të mbrojtur së bashku si grup në një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare, ato mund të ndikojnë nën zëra të ndryshëm në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në të ardhura të tjera përmbledhëse. Paraqitja e fitimeve ose humbjeve mbuluese në këtë pasqyrë varet nga grupi i zërave.
- B6.6.14 Në qoftë se grupi i zërave nuk ka ndonjë pozicion kompensimi të rrezikut (për shembull, një grup shpenzimesh në monedhë të huaj që prekin nën zëra të ndryshëm në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhura të tjera përmbledhëse që mbrohen nga rreziku i kursit të këmbimit), atëherë fitimet ose humbjet e instrumenteve mbulues të ri klasifikuar do të shpërndahen në nën zërat e prekur nga elementet e mbrojtur. Kjo shpërndarje do të bëhet mbi baza sistematike dhe racionale dhe nuk do të rezultojë në një shumë bruto të fitimeve ose humbjeve neto që rrjedhin nga një instrument i vetëm mbulues.
- B6.6.15 Në qoftë se grupi i zërave ka pozicione të kompensimit të rrezikut (për shembull, një grup shitjesh dhe shpenzimesh të shprehura në një monedhë të huaj të mbrojtura së bashku nga rreziku i kursit të këmbimit), atëherë një njësi ekonomike do të pasqyrojë fitimet ose humbjet mbuluese në një nënzë të veçantë në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse. Të konsiderojmë, për shembull, një mbrojtje nga rreziku i kursit të këmbimit të një pozicioni neto të shitjeve në monedhë të huaj me vlerë 100 njësi dhe shpenzimeve në monedhë të huaj me vlerë 80 njësi duke përdorur një kontratë të ardhshme këmbimi për 20 njësi monedhë e huaj. Fitimi neto ose humbja për kontratën e ardhshme të këmbimit që riklasifikohet nga rezerva e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare në fitim ose humbje (kur pozicioni neto ka ndikim mbi fitimin ose humbjen), do të pasqyrohet në një nën zë të veçantë nga shitjet dhe shpenzimet e mbuluara. Për më tepër, në qoftë se shitjet ndodhin në një periudhë më të hershme sesa shpenzimet, të ardhurat nga shitjet vazhdojnë të maten me kursin e këmbimit të çastit sipas SNK 21. Fitimi neto ose humbja e mbuluar që ka të bëjë me to pasqyrohet në një nën zë të veçantë, në mënyrë që fitimi ose humbja të pasqyrojnë efektin e mbulimit të pozicionit neto, me një një rregullim përkatës në rezervën e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare. Kur shpenzimet e mbuluara ndikojnë mbi fitimin ose humbjen në një periudhë të mëvonshme, fitimi neto ose humbja e mbuluar që më parë ishte njohur në rezervën e mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare të shitjeve do të riklasifikohet në fitim ose humbje dhe do të paraqitet si një nën zë i veçantë nga nën zërat që përfshijnë shpenzimet e mbuluara, të cilat maten me kursin e këmbimit të çastit sipas SNK 21.
- B6.6.16 Për disa lloje të mbrojtjes me vlerën e drejtë, objektivi i mbrojtjes nuk është pikësepër që të kompensojë ndryshimin e vlerës së drejtë të elementit të mbrojtur, por që të transformojë flukset e mjeteve monetare të elementit të mbrojtur. Për shembull, një njësi ekonomike mbron rrezikun e normës së interesit të vlerës së drejtë të një instrumenti borxhi me normë fikse duke përdorur një normë interesi SWAP. Objektivi i mbrojtjes së njësisë ekonomike është që të transformojë flukset e mjeteve monetare me interes fiks në flukse mjjetesh monetare me interes të luhatshëm. Ky objektivi është pasqyruar në kontabilitetin për marrëdhënien mbrojtëse duke shtuar interesin neto rritës mbi normën e interesit SWAP në fitim ose humbje. Në rastin e një mbrojtje të një pozicioni neto (për shembull, një pozicion neto i një aktivi me normë fikse dhe një detyrimi me normë fikse), ky interes rritës duhet të pasqyrohet në një nën zë të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse. Kjo bëhet për të shmangur dhënien e një shume bruto për fitimet neto ose humbjet neto të një instrumenti të vetëm në kompensimin e vlerave bruto dhe njohjen e tyre në nën zëra të ndryshëm (për shembull, kjo shmang dhënien e një shume bruto për një të ardhur neto nga interesi të një norme interesi SWAP të vetme në të ardhura bruto nga interesi dhe shpenzime bruto nga interesi).

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare (Kapitulli 7)

Periudha kalimtare (Seksioni 7.2)

Aktivitetet financiare të mbajtura për tregtim

B7.2.1 Në datën e zbatimit fillestar të këtij Standardi, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse objektivi i modelit të biznesit të saj për menaxhimin e aktiveve të saj financiare plotëson kushtin në paragrafin 4.1.2 (a) ose kushtin në paragrafin 4.1.2A(a) apo nëse një aktiv financiar është i përshtatshëm për zgjedhjen në paragrafin 5.7.5. Për këtë qëllim, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse aktivitetet financiare plotësojnë përkufizimin e mbajtur për tregtim sikur njësi ekonomike t'i kishte blerë aktivet në datën e zbatimit për herë të parë.

Zhvlerësimi

B7.2.2 Në tranzicion, një njësi ekonomike duhet të kërkojë për të përafëruar rrezikun e kredisë në momentin e njohjes fillestare duke marrë në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Një njësi ekonomike nuk i kërkohet të ndërmarrë një kërkim të ekzagjeruar për informacion kur përcakton, në datën e kalimit, nëse ka pasur rritje të rëndësishme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare. Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje për të bërë këtë përcaktim, pa kosto ose përpjekje të panevojshme ajo zbaton paragrafin 7.2.20.

B7.2.3 Në mënyrë që të përcaktohet provizioni për humbjen mbi instrumentet financiare të njohur fillimisht (apo angazhimet për hua ose kontrata të garancisë financiare për të cilat njësi ekonomike është palë në kontratë) përpara datës së zbatimit fillestar, si në periudhën kalimtare dhe deri në çregjistrimin e këtyre artikujve një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë informacionin që është përcaktues në përcaktimin ose përafrimin e rrezikut të kredisë në njohjen fillestare. Për të përcaktuar ose përafëruar rrezikun fillestar të kredisë, një njësi ekonomike mund të marrë parasysh informacionin e brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë informacionin e portofolit, në përputhje me paragrafët B5.5.1-B5.5.6.

B7.2.4 Një njësi ekonomike me pak informacion historik mund të përdorë informacion nga raportet dhe statistikat e brendshme (që mund të ketë qenë përgatitur kur është marrë vendimi për të filluar një produkt të ri), informacion në lidhje me produkte të ngjashme ose përvojën e grupeve të tjerë për instrumentet financiare të krahasueshme, nëse është e përshtatshme.

Përkufizimet (Shtojca A)

Derivativët

BA.1 Shembuj tipikë të derivativëve janë kontrata të së ardhmes, të këmbimit dhe opsionet. Një derivativ zakonisht ka një shumë imagjinare, e cila është një sasi e monedhës, një numër aksionesh, një numër i njësive të peshës apo vëllimit, ose njësi të tjera të specifikuar në kontratë. Megjithatë, një instrument derivativ nuk kërkon që mbajtësi apo shkruesi të investojë ose të arkëtojë shumën imagjinare në fillimin e kontratës. Nga ana tjetër, një derivativ mund të kërkojë një pagesë fikse ose pagesën e një shume që mund të ndryshojë (por jo në mënyrë proporcionale me një ndryshim në bazë) si rezultat i disa ngjarjeve të ardhshme që nuk janë të lidhura me një shumë imagjinare. Për shembull, një kontratë mund të kërkojë një pagesë të caktuar të 1,000NJM në qoftë se LIBOR për gjashtë muaj rritet me 100 pikë bazë. Një kontratë e tillë është një derivativ edhe pse nuk është e specifikuar një shumë imagjinare.

BA.2 Përkufizimi i një derivativi në këtë SNRF përfshin kontratat që shlyhen bruto nëpërmjet lëvrimit të zërit bazë (p.sh. një kontratë të ardhshme për të blerë një instrument borxhi me normë fikse). Një njësi ekonomike mund të ketë një kontratë për të blerë ose shitur një zë jo-financiar që mund të shlyhet neto me mjete monetare ose instrument financiar tjetër ose duke këmbyer instrumentet financiare (p.sh. një kontratë për të blerë ose shitur një mall me një çmim të fiksuar në një datë në të ardhmen). Një kontratë e tillë është brenda objektit të këtij Standard, nëse nuk është lidhur dhe vazhdon të mbahet me qëllim të lëvrimit të një zëri jo-financiar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë ekonomike për blerjen, shitjen apo përdorimin. Megjithatë, ky Standard zbatohet në kontrata të tilla për blerjet e parashikuara, shitjet ose

kërkesat për përdorim të një njësie ekonomike nëse njësi ekonomike bën një përcaktim në përputhje me paragrafin 2.5 (shih paragrafët 2.4-2.7).

- BA.3 Një nga karakteristikat përcaktuese të një derivativi është se ai ka një investim fillestar neto që është më i vogël se sa do të ishte e nevojshme për llojet e tjera të kontratave që pritet të kenë një reagim të ngjashëm ndaj ndryshimeve në faktorët e tregut. Një kontratë opsioni e plotëson këtë përkufizim, sepse primi është më i vogël se investimi që do të ishte i nevojshëm për të përfutur instrumentin financiar bazë për të cilin është i lidhur opsioni. Një shkëmbim i monedhave që kërkon një shkëmbim fillestar monedhash të ndryshme ndërmjet vlerave të drejta të barabarta plotëson përkufizimin, sepse ka një investim fillestar neto zero.
- BA.4 Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje krijon një angazhim me çmim fiks mes datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes që plotëson përkufizimin e një derivativi. Megjithatë, për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër, angazhimi nuk njihet si një instrument financiar derivativ. Përkundrazi, ky Standard jep një trajtim kontabël të veçantë për këto kontrata (shih paragrafët 3.1.2 dhe B3.1.3-B3.1.6).
- BA.5 Përkufizimi i një derivativi i referohet variablave jo-financiare që nuk janë specifike për një palë të kontratës. Këto përfshijnë një indeks të humbjeve nga tërmeti në një rajon të veçantë dhe një indeks të temperaturave në një qytet të veçantë. Variablat jo-financiare specifike për një palë të kontratës përfshijnë rënien ose jo të një zjarri që dëmton ose shkatërron një aktiv të një pale në kontratë. Një ndryshim në vlerën e drejtë të një aktivi jo-financiar është specifik për pronarin, nëse vlera e drejtë pasqyron ndryshimet jo vetëm në çmimet e tregut për këto aktive (një variabël financiar), por edhe gjendjen e aktivit të veçantë jo-financiar të mbajtur (variabël jo-financiar). Për shembull, nëse një garanci për vlerën e mbetur të një makine specifike e ekspozon garantuesin ndaj rrezikut të ndryshimeve në gjendjen fizike të makinës, ndryshimi në këtë vlerë të mbetur është specifik për pronarin e makinës.

Aktivet dhe detyrimet financiare e mbajtura për tregtim

- BA.6 Tregtimi në përgjithësi pasqyron blerjen dhe shitjen aktive dhe të shpeshtë, ndaj dhe instrumentet financiare të mbajtura për tregtim në përgjithësi përdoren me qëllim që të gjenerojnë një fitim nga luhatjet afatshkurtra në çmimin ose marzhin e ndërmjetësit.

- BA.7 Detyrimet financiare të mbajtura për tregtim përfshijnë:
- (a) detyrimet derivative që nuk trajtohen si instrumente mbrojtëse;
 - (b) detyrimet për të livruar aktive financiare të huazuara nga një shitës instrumentesh që nuk i ka në pronësi (d.m.th. një njësi ekonomike që shet aktive financiare që ka i marrë hua dhe nuk i ka akoma të vetat);
 - (c) detyrimet financiare që janë krijuar me qëllim riblerjeje të tyre në të ardhmen e afërt (p.sh. një instrument borxhi i kuotuar që emetuesi mund ta blejë përsëri në të ardhmen e afërt në varësi të ndryshimeve në vlerën e drejtë); dhe
 - (d) detyrimet financiare që janë pjesë e një portofoli instrumentesh financiarë të identifikuar që drejtohen së bashku dhe për të cilin ka evidencë të një modeli më të fundit të sigurimit të fitimeve afatshkurtra.
- BA.8 Fakti që një detyrim është përdorur për të financuar aktivitetet tregtare nuk do të thotë se ky detyrim është i mbajtur për tregtim.